



BULETIN

Revistë Informative
Periodike

Qershor-Dhjetor 2016



Republika e Kosovës



Komuna e Gjiçanit



Prezantohet projekti i autostradës Prishtinë-Gjiçan-Konçul

Autostrada ka një gjatësi 47.1 kilometra, përbëhet prej shtatë segmenteve dhe gjerësia e saj do të jetë 32 metra. Autostrada lidhë korridorin 6, 7 dhe 10/.

Haziri: "Është lajm jashtëzakonisht i mirë. Investim kapital dhe historik për tërë Anamoravën dhe zonën lindore të Kosovës".

Zharku: "Autostrada është njëri nga projektet më të rëndësishme që presim të fillojë vitin e ardhshëm - 2017".



Gjiçani e mbyllë vitin
2016 pa borxhe



Gjiçanit i është kthyer
fuqishëm përkujdesja e
qeverisë në investime



Balancë investimesh
qytet-fshat

Botoi
KK Gjilan, Zyra për Informim

E përgatiti:
Stafi i Zyrës për Informim:
Ilmi Musliu
Ibrahim Ademi
Muhamet Pajaziti
Eroll Jonuzi - Fotoreporter

kk.rks-gov.net/gjilan
0280/321 486



Për Gjilanin

Gjilani gjendet në pjesën juglindore të Kosovës. Si njëra ndër komunat e mëdha të Kosovës, me rreth 100 mijë banorë rezidentë, është qendër e Anamoravës dhe regjionit të lindjes, në përgjithësi. Gjilani si vendbanim është formuar rreth vitit 1750, ndërsa si qendër urbane - në vitin 1772. Si qendër urbane është zhvilluar krahas shuarjes së Novobërdës (Artanës), e cila në mesjetë ka qenë njëri nga qytetet dhe qendrat më të mëdha tregtare dhe ekonomike në Ballkan.

Pozita gjeografike që ka Gjilani, si një gjeo-komunitet, i mundëson atij lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit. Gjilani është larg nga Prishtina, kryeqendra e Kosovës, 46 kilometra, nga Kamenica - 27 km, nga Vitia - 22 km, nga Artana - rreth 25 kilometra.

Me komunat e regjionit, në juglindje kufizohet me Preševën (33 km) dhe Kumanovën (53 km), ndërsa në lindje - me Bujanocin (40 km). Ndërtimi i rrugës Gjilan-Lipjan, nga drejtimi i Kishnapolës, ka shkurtuar dukshëm distancat e kësaj komune me aeroportin e Prishtinës, me rrugën e kombit si dhe me hekurudhat e Kosovës.

Gjilani do të bëhet së shpejti me autostradë. Gjilani pret të lidhet së shpejti edhe me Kumanovën, nga drejtimi i Stançiqit, ku parashihet hapja e një pikedoganore.

Qyteti përshkohet nga tre lumenj të vegjël, Mirusha, Banja dhe Stanishori, të cilët bashkohen dhe derdhen në Moravën e Binçës, që përbën njërin prej tre lumenjve më të mëdhenj në Kosovë.

Gjilani ka dy liqej akumulues, në Përlepnice, që shfrytëzohet për furnizimin e qytetit me ujë të pijes dhe në Livoc të Epërm, që shfrytëzohet si qendër rekreative. Gjilani njihet edhe për ujërat termale dhe ka dy banja, në Miresh e Uglar.

Gjilani ka kushte të mira për bujqësi dhe njihet si qytet agro-industrial. Rrethina e Gjilanit është e pasur me xehe (hekur e leucid) dhe me burime minerale (Nasalë, Pidiq, Kmetoc, Uglar, Përlepnice).

Gjilani njihet edhe si qytet i bashkatdhetarëve, meqë besohet se në botën e jashtme jetojnë mbi 35 për qinde qytetarëve të kësaj komune.

Gjilani është shpallur “Qytet i Pages” nga Këshilli i Europës.

Qyteti i Gjilanit është dekoruar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani si dhe nga Presidentja e Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga.

Fjala e kryetarit

2017-ta do të jetë vit i kthesave të mëdha në Gjilan

Edhe viti i tretë i qeverisjes sonë, karakterizohet me suksese dhe sfida. Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2016, kemi arritur të realizojmë një sërë projektesh të rëndësishme për Komunën tonë. Më e rëndësishmja është se e kemi përgatitur terrenin për investime të mëdha në vitin që kemi hyrë.

2017-ta do të jetë vit i gjilanasve, falë mobilizimit financiar që është siguruar, jo vetëm nga qeveria e Kosovës, por edhe nga Banka Evropiane, nga qeveria e Austrisë, nga qeveria Amerikane dhe qeveritë e shteteve mike të Kosovës.

Këtë vit, Gjilani do të përjetojë kthesa të mëdha në infrastrukturë, siç është ndërtimi i autostradës, i rrugëve të tjera rajonale e lokale, investime të fuqishme në ujërat e zeza, në infrastrukturën shkollore, në çerdhe të reja, sikurse edhe në kulturë, rini, sport dhe në të gjitha fushat tjera.

Vitin 2017 ia kemi kushtuar po ashtu edhe kolosit të madh, Idriz Seferi. Të gjitha aktivitetet kulturore të man-

ifestimit “Flaka e Janarit” dhe të tjera do t’i kushtohen këtij heroi, deri në vendosjen e shtatores, në qendër të qytetit. Njëkohësisht do të bëhet rivarrimi i eshtrave të heroit në varrezat e dëshmorëve.

Jemi Komunë që e kemi realizuar buxhetin e vitit 2016 qind për qind.

Dua të nënvizoj se ne e kemi marrë mandatin qeverisës me mbi 9 milionë euro borxhe ndaj operatorëve, ndërsa në vitin 2017 hyjmë pa borxhe ndaj operatorëve dhe me 29 milionë euro investime publike, kryesisht në infrastrukturë, që janë investimet më të mëdha pas luftës.

Ne do të vazhdojmë me punë deri në ditën e fundit të mandatit tonë.

Lutfi Haziri

Kryetar i Komunës së Gjilanit

Gjilani e mbyllë vitin 2016 pa borxhe



30
DHJETOR

Nën udhëheqjen e kryetarit Lutfi Haziri, Bordi i Drejtorëve i Komunës së Gjilanit ka mbajtur mbledhjen e fundit për këtë vit, e cila si zakonisht ishte e hapur për publikun, ku është bërë një rekapitullim i punës për vitin 2016. Kryetari Haziri tha se ka qenë një vit jashtëzakonisht i rëndësishëm, por edhe i rëndë për Komunën e Gjilanit, jo për qytetarët, po për zyrtarët, pasi janë suspenduar 28 zyrtarë, pas aktakuzës së prokurorisë për krim të organizuar për periudhën 2009-2012.

Ai ka përmendur sukseset në të gjitha fushat e rëndësishme, duke filluar nga kujdesi primar, të cilin e shpalli si më të suksesshmin e vitit, pastaj në arsim, bujqësi, zhvillim ekonomik, administratë, urbanizëm, e shërbime publike. Haziri tha se Komuna e Gjilanit mban rekordin sa i përket numrit të madh të tubimeve publike, dëgjimeve buxhetore e konsultimeve. “28 takime publike janë realizuar në vitin 2016. Besoj që jemi Komuna rekorde për organizim të një numri kaq të madh të debateve dhe transparencës që e kemi imponuar”, tha ai. Si projekt tejet të rëndësishëm, kryetari Haziri ka përmendur ndërtimin e kampusit të shkollave të mesme përmes PPP, duke thënë se për herë të parë në një hapësirë publike është vendosur një rregull ku nuk përdoret alkooli dhe duhani. Një sukses i madh i Komunës së Gjilanit, është realizimi qind për qind i planit buxhetor. Kryetari i Gjilanit ka theksuar se mandatin e kishte marrë me mbi 9 milionë euro borxhe ndaj operatorëve, ndërsa në vitin 2017 Komuna hyn pa borxhe. “Ne mandatin e kemi marrë me 3.8 milionë euro investime të planifikuara dhe me 9 milionë euro borxhe. Tash jemi Komunë që nuk kemi borxhe operatorëve, përveç atyre kontingjente. Gjilanin, viti 2017 e gjen pa borxhe ndaj operatorëve dhe me 29 milionë euro investime publike, kryesisht në infrastrukturë, që janë investimet më të mëdha pas luftës, ku përfshihet stadiumi qytetit, palestra në

Zhegër, lumi “Mirusha” dhe “Stanishorka”, tri hyrje-daljet e qytetit, varrezat e qytetit, varrezat e martirëve në Llashticë si dhe investimetjera në çdo cep të qytetit dhe fshatit”, ka thënë Haziri. Ndërkaq, sa i përket administratës, drejtori Nazim Gagica ka thënë se këtë vit e karakterizon implementimi i programit “Gjilani Smart City”, i pari në rajon, përderisa drejtori i Bujqësisë, Ramiz Ramadani theksoi se gjatë këtij viti bujqit e Gjilanit kanë përfituar afër 2 milionë euro nga subvencionet. Drejtori i Shërbimeve Publike, Naser Korça, ka thënë se kanë punuar me përkushtim në çdo vend, duke ndërtuar qindra kilometra rrugë të asfaltuara, kanalizim, ujësjellës e ndriçim, ndërsa drejtoresha e DKA-së, Shqipe Haziri, ka nënvizuar investimet në shkollat e Gjilanit dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit. Drejtori për Buxhet dhe Financa, Zijadin Maliqi, ka thënë se Komuna e Gjilanit është e vetmja në Republikë që e ka tejkaluar planifikimin vjetor për për 27 për qind, përderisa ai i Shëndetësisë, Nexhat Hajrullahu theksoi se gjatë këtij viti kanë ofruar mbi 500 mijë shërbime për qytetarët në kujdesin primar, janë ndërtuar 38 shtëpi për familjet me gjendje të rëndë sociale, janë meremetuar 40 shtëpi, kurse 45 familjeve u është kompensuar qiraja e banimit. Si i përket Urbanizimit, drejtori Valon Shefkui, ka thënë se kanë arritur t’i inkasojnë mbi 900 mijë euro, të cilat kryesisht janë nga lejet e ndërtimit, ndërkaq ai i Zhvillimit Ekonomik, Agim Zuzaku, ka thënë se tashmë Komuna e Gjilanit ka hequr taksat për bizneset, për t’i lehtësuar sado pak në vepërimtarinë e tyre, duke shtuar se nga partneriteti me donatorë dhe qeveritë botërore, kanë arritur t’i gjenerojnë mbi 1 mijë vende të reja pune. Drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim, Ensar Kadriu, ka thënë se sivjet numri i zjarreve ka qenë dukshëm më i vogël se në vitin paraprak, falë menaxhimit të mirë të situatës, ndërsa drejtori i Prokurimit, Salih Kqiku e ka cilësuar 2016-tën si vit tejet sfidues, duke marrë parasysh suspendimin e zyrtarëve në këtë departament, ku ai po punon i vetëm.



Kuvendarët e Gjilanit miratojnë rregulloren për taksa komunale

29

DHJETOR

Kuvendi Komunal i Gjilanit, të enjten, në mbledhjen e fundit për këtë vit, ka miratuar rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale, rregulloren për subvencione, vendimin për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme komunale, planin komunal të veprimit për të zhvendosurit, planin e punës së Kuvendit për vitin 2017, orarin e punës së Kuvendit dhe Komiteteve për vitin e ardhshëm si dhe raportin e kontrollimit shëndetësor të nxënësve.

Kryesuesja Valentina Bunjaku-Rexhepi, ka thënë se të gjitha këto pika janë shqyrtuar e diskutuar paraprakisht nëpër komitetet përkatëse dhe pastaj janë rekomanduar për miratim në Kuvend Komunal. Sa i përket rregullores komunale për taksa, Hevzi Matoshi nga Zyra Ligjore, ka thënë se disa tarifa janë hequr, disa janë ulur, kurse një numër tjetër janë modifikuar, ndërkaq sqarime shtesë për ndryshimet e tarifave në sektorin e Administratës

dhe Ekonomisë, kanë dhënë drejtorët Nazim Gagica e Agim Zuzaku. Ata janë përgjigjur edhe në pyetjet konkrete të anëtarëve të Kuvendit, Ibsih Ibishi, Bajram Hasani, Fehmi Sylejmani dhe të tjerë. Ndërsa sa i përket vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme komunale, Arjeta Rexhepi (VV), ka kërkuar që çështja të rishikohet, duke thënë se banesat duhet t'i jepen në shfrytëzim rasteve sociale, që nuk e kanë të zgjidhur problemin e banimit, meqë dihet se për një numër prej tyre, qiranë e kompenson Komuna. Përndryshe, edhe në këtë seancë, përmes pyetjeve të drejtpërdrejta, opozita ka ngritur shqetësime për problematika të ndryshme dhe për shumicën prej tyre ka marrë përgjigje nga nënkryetari i Komunës, Rexhep Kadriu si dhe drejtorët komunalë, Naser Korça (Shërbime Publike, Nazim Gagica (Administratë e Përgjithshme) dhe të tjerë, ndërkohë që kryesuesja Valentina Bunjaku-Rexhepi, ka premtuar se

për pyetjet tjera, që kryesisht kishin të bënin me sektorin e arsimit dhe u shtruan nga Fehmi Sylejmani, Bujar Nevzati, Shukrije Rapuca, Leonora Bunjaku, Nevzad Isufi dhe të tjerë, përgjigjet do t'i marrin me shkrim nga drejtoritë përkatëse. Në pyetjet që kishin të bënin me investimet në infrastrukturë, ndriçim publik dhe të tjera, të cilat u ngritën nga Ibish Ibishi, Krenare Latifi, Arjeta Rexhepi, Sejdiullah Kadriu, Fehmi Sylejmani dhe të tjerë, janë përgjigjur nënkryetari i Komunës, Rexhep Kadriu si dhe drejtori i Shërbimeve Publike, Naser Korça. Ata kanë thënë se projekti i rrugës me katër krosi, për të cilën pati më së shumti interesime, nuk ka përfunduar ende. Përndryshe, Kuvendi Komunal i Gjilanit, përsëri është dashur të merret me anëtarin e tij, Srgjan Mitroviq, i cili disa herë deri tani është përjashtuar nga seancat, për shkak se nga qeveria e Serbisë është emëruar në krye të strukturave paralele dhe nuk ka pranuar të deklarohet me shkrim që është vetëm anëtar i Kuvendit Komunal në Gjilan dhe nuk përfaqëson interesa tjera. Në të vërtetë deklarata që kishte sjellë sot Mitroviq, ku nuk thuhej se ishte tërhequr nga strukturat paralele, por vetëm nënvizohej fakti se ai ka marrë pjesë në zgjedhjet lokale në Kosovë dhe, sipas ligjit është zgjedhur për të përfaqësuar komunitetin serb, nuk u konsiderua e mjaftueshme nga shumica e këshilltarëve komunalë. Kryesuesja Valentina Bunjaku-Rexhepi, ka thënë se me këtë shkresë, Srgjan Mitroviq e ka plotësuar kërkesën tonë që të deklarohet se ai është vetëm anëtar i Kuvendit Komunal dhe se këtu nuk përfaqëson interesa të tjera, pos atyre të serbëve lokalë, të cilët e kanë zgjedhur. "Ne nuk i njohim strukturat paralele dhe nuk mund t'i kërkojmë atij që të sjellë ndonjë shkresë prej atyre strukturave, por mjafton që ai u deklarua se është vetëm anëtar i Kuvendit Komunal", ka

thënë ajo. Megjithatë, ky rast mbeti i hapur edhe më tutje për shkak të mospajtimeve të shumicës së anëtarëve të Kuvendit me këtë formë të deklarimit të Mitroviqit. Sahit Abazi (PDK) tha se në këtë rast kemi të bëjmë me shkelje të Kushtetutës së Kosovës dhe ky është një problem shumë serioz. Që t'i lejohet pjesëmarrja në Kuvend Komunal, Mitroviq duhet të deklarojë qartë se nuk është pjesë e strukturave paralele, të cilat në Kosovë janë struktura kriminale, ka thënë Abazi. Nevzad Isufi (VV), ka thënë se Mitroviq është përpjekur të bëjë mashtrim, ndërkohë që nuk është tërhequr prej strukturave paralele, që kanë edhe zyra në Kufçë. Ai duhet të sjellë dëshmi nga qeveria e Serbisë se është shkarkuar nga strukturat paralele dhe pastaj t'iu kthehet përgjegjësisë së tij në Kuvendin Komunal të Gjilanit, ka thënë Isufi. Qëndrim të njëjtë ka mbajtur edhe shefi i grupit të këshilltarëve të AAK-së, Selami Xhemajli, duke shtuar se Mitroviq po vazhdon të tallet me ne, meqë as sot nuk deklaroi që nuk është më kryetar i strukturave paralele. Avdyli Aliu (LDK) kërkoi që Kuvendi t'i kthehet agjendës së punës dhe t'i kryejë përgjegjësitë e veta. Bujar Nevzati (PDK) ka thënë se problemi është i qartë. Mitroviq mund të vazhdojë të jetë anëtar i Kuvendit Komunal, pasi të deklarohet qartë se nuk është më në strukturat paralele dhe se i njeh institucionet e Republikës së Kosovës. Në të vërtetë, derisa po zhvillohej ky debat, Srgjan Mitroviq e kishte lëshuar seancën e Kuvendit, ende pa iu kërkuar që ta bënte këtë gjë, për dallim prej herëve tjera, kur kishte refuzuar të largohej. Përndryshe, Kuvendi Komunal i Gjilanit e ka filluar seancën e sotme me nderimin për veteranin e arsimit, Nuhi Leka, i cili ka ndërruar jetë. Bunjaku-Rexhepi tha se Leka ka dhënë një kontribut të madh në arsimimin e brezave të rinj dhe afirmimin e shkollës shqipe.



Debat publik për Strategjinë për zhvillim socio-ekonomik lokal 2017-2021

22
DHJETOR

Organizuar nga Komuna e Gjilanit, sot është mbajtur debat publik për Strategjinë për Zhvillim Socio-Ekonomik Lokal 2017-2021, që është investuar nga USAID me mbështetje edhe të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe "Ri Investit", ku të pranishëm në prezantimin e këtij dokumenti ishin edhe kryetari i Komunës Lutfi Haziri, me stafin e tij dhe përfaqësues të bizneseve të kësaj komune, përfaqësuesi i USAID-it Agim Salihu nga Programi Avancojmë Kosovën së Bashku dhe përfaqësuesit e Riinvestit.

Prezantimin e strategjisë e ka bërë drejtori i Zhvillimit Ekonomik, Agim Zuzaku, i cili ka thënë se është një dokument me rëndësi të veçantë për orientimin e hershëm të zhvillimit ekonomik lokal për Gjilanin. "Gjithçka është shënuar në këtë strategji, duke nisur nga profile i Komunës së Gjilanit, metodologjia, gjendja aktuale, analiza për përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet, vizioni, synimet dhe objektivat e strategjisë por edhe rekomandimet dhe masat që duhet të ndërmerren me kohë. Ky dokument që do të merr edhe aprovimin e Kuvendit të Komunës është një udhërrëfyes për 5 vitet e ardhshme. Përparësitë kryesore janë vlerësuar të jenë, pozita e volitshme gjeografike, industria përpunuese, resurset natyrore të mjaftueshme, qendra universitare, infrastruktura

fizike e volitshme, potenciali bujqësor popullsia e re dhe e arsimuar dhe diaspora", ka thënë ai. Ndërsa, siç ka thënë Zuzaku "Dobësitë që ka identifikuar kjo strategji për momentin janë buxheti i pamjaftueshëm për projekte, problem i pronës publike, mungesa e statistikave të për popullatën dhe ekonomitë familjare, mungesa e zonave ekonomike, e politikave stimuluese për biznese, mungesa e ndërmarrjeve të mëdha dhe e investimeve të huaja etj.", ka thënë drejtori i Zhvillimit Ekonomik, Agim Zuzaku. Gjithashtu, drejtori Zuzaku ka potencuar edhe mundësitë që ka kjo strategji por edhe rreziqet që e presin në fusha të ndryshme, që normalisht kanë të bëjnë edhe me politikat më të larta në nivelin qendror. Në këtë strategji sipas tij janë të parapara më shumë se 60 projekte të rëndësishme dhe strategjike, për investime nga burime të ndryshme financiare, me theks të veçantë nga bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare dhe nga thithja e investimeve të huaja por edhe biznese të huaja në Kosovë. Kjo strategji prek edhe sistemin e shëndetësisë, arsimin, bujqësisë, kulturës, sportit dhe investimet e ndryshme e të shumta në fusha të tjera. Ndryshe, nga ky debat është dhënë një mbështetje për strategjinë, duke kërkuar që ky dokument të plotësohet e pasurohet edhe më tej, nga grupe të ndryshme të shoqërisë.



Haziri e Bajrami bisedojnë për zonat e lira ekonomike në Gjilan

20
DHJETOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i shoqëruar nga drejtori për Zhvillim Ekonomik, Agim Zuzaku, ka pritur sot në takim pune ministren e Tregtisë dhe Industrisë, Hykmete Bajrami. Pasi e ka falënderuar për vizitën, kryetari Lutfi Haziri e njoftoi ministren Bajrami me të arriturat e Komunës në përgjithësi dhe me krijimin e lehtësirave të të bërit biznes dhe me mbështetjen që i ofrojnë bizneseve gjilanasë.

Në këtë takim është diskutuar kryesisht për funksionalizimin e dy zonave të lira ekonomike, njëra që do t'i shërbej regjionit të Anamoravës dhe tjetra që është enkas për bizneset gjilanasë. "Biseduam me ministren Bajrami, përveç tjerash, edhe për nevojën e funksionalizimit të zonave të lira ekonomike për Anamoravë, e cila mund të përfshinte edhe komunat nga brezi kufitar dhe ndër-kufitar mes Kosovës dhe vendeve në regjion, ku përfshihen 17 komuna. Mbi të gjitha, prioritet i kemi investitorët dhe

bizneset që kanë mundësi dhe potencial për zhvillim të zonës sonë", ka thënë Haziri. Ministra e Tregtisë dhe Industrisë, Hykmete Bajrami, e falënderoi kryetarin Haziri për pritjen dhe për bashkëpunimin e mirë e në kontinuitet të Komunës me këtë dikaster qeveritar. "Ne jemi në një fazë shumë të avancuar në Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, të cilët do ta bëjnë ndërtimin e këtyre zonave ekonomike. Biseduam me kryetarin Haziri që sa më shpejt të bëhet ndarja e një parcele, pronë komunale për krijimin e dy zonave të lira ekonomike, njëra që do t'i shërbej rajonit të Anamoravës dhe tjetra që do t'iu shërbej enkas bizneseve gjilanasë. Si MTI, i kemi top prioritet investimet në zonat ekonomike në bashkëpunim me BERZH-in", ka thënë ministria Bajrami. Përndryshe, takimi i sotëm i ka paraprirë konferencës informuese për Zhvillimin e Sektorit Privat e cila po mbahet në Gjilan, e organizuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.



Në Gjilan mbahet konferenca informuese për zhvillim të sektorit privat

20
DHJETOR

"Nuk ka ngjarje më të mirë për t'i përmbyllë aktivitetet e fundvitit se sa kjo konferencë me bizneset, e cila lidhë komunikim të drejtpërdrejt. Prezenca e dy ministrave, Bajrami e Hoti, tregon interesimin që drejtpërdrejt që të komunikojnë me ju edhe për pakot dhe lehtësimet fiskale që qeveria ka ndërmarrë përmes Ministrisë së Financave, sikurse edhe për logjikën e ndërtimit të Partneritetit Publiko Privat që Komuna e Gjilanit është në shpallje të ofertave, e mbi të gjitha për lidhshmërinë që e kemi me ATK-në, Doganën dhe me institucionet tjera që janë sot këtu".

Kështu ka thënë në hapjen e Konferencës Informuese për Zhvillimin e Sektorit Privat, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, e cila është mbajtur sot në Gjilan, organizuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Në këtë konferencë bashkëbisedimi kanë marrë pjesë edhe dy ministrat, Abdulla Hoti i MF-së e Hykmete Bajrami e MTI-së, sikurse edhe përfaqësues të ATK-së, doganës, e dhjetëra përfaqësues të bizneseve gjilanasë. "Po e nënvizoj gatishmërinë e Komunës së Gjilanit të mbështetjes së partneritetit, në mënyrë që të zhvillohen disa nga programet që tashmë duhet të realizohen në kuadër të Partneritetit Publiko Privat, i cili në Gjilan në dy raste po tregohet i suksesshëm, megjithëse njëri po ka vështirësi. Ne po mundohemi të krijojmë ambient të qëndrueshëm, në mënyrë që sektori privat dhe ndërmarrja private ta ketë rolin kryesor në zhvillim ekonomik në Gjilan", ka nënvizuar kryetari Haziri. Ministrija e Tregtisë dhe Industrisë, Hykmete Bajrami, ka thënë se qëllimi i kësaj konference

është që të shpaloset pakoja e re fiskale preliminare e qeverisë, për t'i marrë të gjitha kërkesat e komunitetit të biznesit sa i përket arsyetimit të heqjes së taksave dhe akcizës në mënyrë që ato të përfshihen në këtë pako. Ajo ka rikonfirmuar mbështetjen për Komunën e Gjilanit për funksionalizimin e dy zonave të lira ekonomike, njëra që do t'i shërbej regjionit e Anamoravës dhe tjetra që është enkas për bizneset gjilanasë. Ministri i Financave, Abdulla Hoti, ka theksuar se vlerëson angazhimin e kryetarit Haziri për të krijuar një ambient më të mirë për bizneset. "Mendoj angazhimi i kryetarit Haziri është shembull i jashtëzakonshëm i lidhshimit sepse ka tendencë nganjëherë që kryetarët e komunave vetëm të kufizohen në rol strikt të vetëqeverisjes lokale pa i shfrytëzuar mundësitë që kanë për të krijuar zhvillim më të madh ekonomik", ka thënë Hoti. Ministri Hoti, para përfaqësuesve të bizneseve gjilanasë, ka prezantuar fazën e dytë të pakos së re fiskale të qeverisë. "E para është zgjerimi i listës së lëndëve të para që lirohen nga tatimi doganor, pastaj masa e dytë është heqja e normës së akcizës që përdoret për qëllime të prodhimit dhe masa e tretë që mendoj se është shumë e rëndësishme nga këndvështrimi i konsumatorit është ndryshimi dhe plotësimi i listës së produkteve që i nënshtrohen normës së reduktuar të TVSH-s", ka thënë Hoti. Ndërkaq, përfaqësuesit e komunitetit të biznesit në Gjilan kanë kontribuar me pyetje e sugjerime për dy ministrat, që kryesisht kishin të bënin për lirin nga disa taksa dhe akciza për prodhimet e ndryshme.



Delegacioni i Asociacionit Hotelier të Ballkanit (BAHA) në Gjilan

17

DHJETOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur sot në takim miqësor një delegacion të Asociacionit Hotelier të Ballkanit (BAHA), në të cilën janë të anëtarësuar Kosova, Shqipëria, Mali i Zi, Bullgaria dhe Serbia, të kryesuar nga Blagoje Ragin. Kryetari Haziri i ka uruar mirëseardhje përfaqësuesve të këtij Asociacioni, të cilët për herë të dytë po e vizitojnë Gjilanin, duke vënë në theks suksesin e Shoqatës Hoteliere Turistike dhe Agjencioneve të Kosovës (TAK).

Nga ana e tij, kryetari i Asociacionit Hotelier të Ballkanit (BAHA), ka falënderuar kryetarin Haziri për mikpritjen dhe

bashkëpunimin dhe përkrahjen e ofruar për veprimtaritë hoteliere. Në këtë takim ka folur edhe Naser Shabani, pronar i restorant “Bujana” në Gjilan, duke theksuar se synim i Shoqatës Hoteliere Turistike dhe Agjencioneve të Kosovës (TAK) është që të sillen sa më shumë turistë nga vendet e ndryshme, duke realizuar aktivitetet të ndryshme rekreative. Përndryshe, Shoqata Ballkanike e Hoteleve (BAHA), në vitin e kaluar e ka nderuar kryetarin e Komunës së Gjilanit, Lutfi Hazirin, me çmimin “Simboli Mbrojtës”, për përkrahjen e dhënë veprimtarive hoteliere dhe restoranteve.

Haziri u jep mbështetje projekteve të KCBS në Gjilanin



15

DHJETOR

Kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur sot në takim përfaqësuesit e organizatës Kosovo Center for Business Support (KCBS), Burim Korqa - menaxher dhe koordinatorët e Arta Qupeva e Besim Haziri, ku është njoftuar rreth fillimit të implementimit të dy projekteve të rëndësishme për Gjilanin, “Të drejtat Pronësore të Grave, Fuqizimi i Tyre” dhe “Fuqizimi Ekonomik i Gruas, Avancimi i Shoqërisë Kosovare”.

Kryetari Haziri, pasi i ka falënderuar përfaqësuesit e kësaj organizate për vizitën, i ka ofruar mbështetje maksimale institucionale për implementimin e këtyre projekteve, të cilat janë në të mirë të qytetarëve të Gjilanit. Projekti “Të drejtat Pronësore të Grave, Fuqizimi i Tyre”, i cili

financohet nga USAID, ka për qëllim funksionalizimin e zyrës për regjistrim civil në zbatimin e obligimeve ligjore për dërgimin e certifikatave të aktit të vdekjes në gjykatë për procedurë të mëtutjeshme trashëgimore në komunën e Gjilanit. Ndërkaq, projekti “Fuqizimi Ekonomik i Gruas, Avancimi i Shoqërisë Kosovare” financohet nga Zyra e Bashkimit Europian në Kosovë dhe ka për qëllim fuqizimin socio-ekonomik të gruas afariste përmes edukimit dhe angazhimit të saj në vendimmarrje, me qëllim të krijimit të politikave lokale në favor të bizneseve. Përfaqësuesit e organizatës Kosovo Center for Business Support (KCBS), kanë falënderuar kryetarin Haziri për pritjen dhe për ofrimin e mbështetjes institucionale.



Gjilanit i është kthyer fuqishëm përkujdesja e qeverisë në investime

14

DHJETOR

Kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, pas takimeve maratonike me kryeministrin Isa Mustafa, i cili vizitoi këtë Komunë dje, ka thënë se përfundimisht Gjilanit i është kthyer fuqishëm përkujdesja e qeverisë në investime. “Nëse dikur ky vend ka qenë i harruar e i anashkaluar e anashkaluar, sot gjendja është krejtësisht ndryshe. Gjilanit iu rikonfirmua edhe njëherë mbështetja e fuqishme e Qeverisë së Kosovës sa i përket investimeve në infrastrukturë dhe në fushat tjera. Pos kësaj, e kemi edhe mbështetjen e fuqishme të donatorëve dhe në fillim të vitit të ardhshëm do të ndodhin investimet milionëshe në rehabilitimin e lumenjve, “Mirusha” e “Stanishorka”, duke zgjidhur përgjithmonë problemet me lloç e vada. Përfundimisht, gjilanasve i është kthyer dinjiteti”, ka thënë Haziri pas takimeve të shumta me kryeministrin Mustafa.

Ndërkohë, kreu i Qeverisë së Kosovës, Isa Mustafa, është zotuar për mbështetjen e fuqishme ndaj Gjilanit, kryesisht në infrastrukturë, duke paralajmëruar edhe fillimin e autostradës Gjilan-Prishtinë në fillim të vitit të ardhshëm. Ai ka thënë se krejt këto investime po ndodhin në Gjilan për shkak se kjo Komunë është tatimpaguesja më e madhe pas Prishtinës dhe shkak i disiplinës së

ashpër buxhetore që është vendosur në këtë Komunë nga ana e Lutfi Hazirit. Përndryshe, kryetari Lutfi Haziri me bashkëpunëtorë, fillimisht ka prituri në zyrën e tij kryeministrin Isa Mustafa dhe ekipin e tij, për të vazhduar me vënien e gurthemelit për QKMF-në, derisa kanë vizituar edhe Universitetin “Kadri Zeka”, kazermën e Batalionit të Parë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, ndërkaj në fund kanë zhvilluar një drekë pune me përfaqësuesit politikë të shqiptarëve të Kosovës Lindore.





Fermerët subvencionohen me fidane te mjedrës

14

DHJETOR

Drejtoria e Bujqësisë e Komunës së Gjilanit, ka subvencionuar sot 40 fermerë me fidanë të mjedrës, projekt ky i cili po realizohet në partneritet me kompaninë "Fresh Fruit" dhe mbështetje të USAID. Drejtori i Bujqësisë në Gjilan, Ramiz Ramadani, ka thënë se vëmendje të veçantë i kanë kushtuar përzgjedhjes së fermerëve nga viset e larta, ngase kultura e mjedrës i përballon këto terrene. "Materiali fidanor është i cilësisë së lartë, varieteti Polka dhe është me origjinë nga Polonia. Pra, është i njëjti material fidanor të cilin bujqit e kanë marrë në pranverë dhe nga monitorimi që e kemi pasur ne si Drejtori, te shumica e fermerëve janë arritur rezultate brilante", ka thënë drejtori i Bujqësisë në Gjilan, Ramiz Ramadani.

"Me këtë projekt, po i përmbysim investimet e planifikuara për këtë vit në bujqësi, të cilin e vlerësojmë si vit

shumë të suksesshëm, për çka në mënyrë të veçantë e falënderoj kryetarin Haziri për mbështetjen e vazhdueshme dhe me prioritet të këtij sektori", ka shtuar Ramadani. Ilir Kozhani, nga projekti i "Agro" i USAID, ka thënë se qëllimi i mbështetjes është që këta fermerë të punësohen dhe të jetojnë nga duart e tyre, nga toka e tyre. Ndërsa, fermeri Shefki Latifi nga fshati Kmetoc, ka falënderuar Komunën e Gjilanit për këtë subvencionim, duke thënë se ky është lehtësim i madh për të dhe familjen e tij, për funksionalizimin e kësaj veprimtarie. Vlera e këtij projekti është 60 mijë euro, ku Komuna ka participuar me 50 për qind të shumës dhe partneriteti strategjik po ashtu me gjysmën e shumës. Për këtë përkrahje të bujqve gjilanas, kompania "Fresh Fruit" mbështetet nga USAID në ngritjen e kapaciteteve përpunuese.



Haziri në Zhegër: Përfundimisht po i zgjidhim problemet me lloç dhe vada

13
DHJETOR

Komuna e Gjilanit ka mbajtur mbrëmë debat publik në Zhegër, që është i 28-ti për vitin 2016. Lutfi Haziri, kryetar i Komunës, ka thënë se ndihet shumë i nderuar me pjesëmarrjen masive të qytetarëve të Zhegërës. “Në Grykën e Karadakut kemi mbajtur edhe dëgjime buxhetore dhe qëllimi është që t’i marrim kërkesat tuaja në mënyrë që t’i fusim në planifikim dhe miratimi i buxhetit të qeverisë të përputhet me këto kërkesa”, ka thënë Haziri.

Ai ka përmendur faktin se gjatë këtij mandati, Komuna e Gjilanit ka investuar në fshatrat e Grykës së Karadakut me të gjitha mundësitë e saj, duke thënë se me intensitet edhe më të madh do të vazhdohet në vitin e ardhshëm. “Është përfunduar me sukses shkolla e Shurdhanit. Kemi asfaltuar shumë rrugë të domosdoshme sikurse edhe kanalizim e ndriçim në të gjitha fshatrat e Karadakut.

Kemi filluar edhe me ndërtimin e rrugëve të arave dhe pas 40 vjetësh po ndodhë kjo. Palestra e sportit tashmë është në fazën finale të fillimit të ndërtimit, derisa e kemi prioritet edhe ndërtimin e shkollës fillore në Haxhaj. Përfundimisht, për ato punë që e kemi marrë mandatin, po i realizojmë. Po e zgjidhim njëherë e përgjithmonë problemin e lloçit dhe vadave”, ka thënë Haziri. Me pyetje, kërkesa e lëvdata janë paraqitur Hamzi Osmani, Rahman Agushi, Ali Tahiri, Fehmi Maloku, Flamur Hamiti, Gëzim Tahiri etj., të cilat kryesisht kishin të bënin me ato në ndërtim të infrastrukturës rrugore. Duke iu përgjigjur të gjitha interesimeve, kryetari Haziri u zotua se kërkesat që kanë dalë nga ky debat publik, do të fusin në planifikim për vitin e ardhshëm. “Është shumë i rëndësishëm fakti se i kemi i barazuar investimet në qytet dhe fshatra. Kemi krijuar balancë”, ka përfunduar kreu i Gjilanit.

Lutfi Haziri e Isa Mustafa vunë gurëthemelin e objektit të QKMF-së



13

DHJETOR

Kryeministri i Republikës, Isa Mustafa, pas takimit që pati me kryetarin e Gjilanit, Lutfi Haziri, kanë vënë gurëthemelin e objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Gjilan, që është një investim mbi 1.4 milionë euro. “E falënderoj kryeministrin Mustafa për mbështetjen e drejtpërdrejt për Komunën e Gjilanit, në këtë rast për ndërtimin e QKMF-së, e cila përveç ambulancës në Llashicë që do të fillojë të ndërtohen vitin e ardhshëm, përmbyllë ciklin e investimeve të plota në shëndetësinë primare. Mund të themi se jemi krenarë me këto arritje. Kryeministrin sot e njoftova edhe për investimet tjera në sektorin publik që kapin shifrën e mbi 5.3 milionë eurove, si mbështetje edhe e qeverisë së Kosovës, pa llogaritur këtu mbështetjen e madhe të donatorëve”, ka deklaruar pas vënies së gurëthemelit kreu i Gjilanit, Lutfi Haziri.

Ai ka paralajmëruar se në vitin e ardhshëm po përgatiten për ndërtimin e korridorit Gjilan-Ferizaj dhe Gjilan-Prishtinë, sikurse edhe fillimin e autostradës, e cila është investim i qeverisë së Republikës. “Në këtë mënyrë, Gjilani integrohet në infrastrukturën kombëtare dhe ndërkombëtare”, tha Haziri. Kryeministri Isa Mustafa, gjatë adresimit para gazetarëve, është shprehur i lumtur që me vënien e gurëthemelit për QKMF-në, po përmbyllet cikli i investimeve në shëndetin primar në Gjilan. “Me vënien e gurëthemelit për QKMF-në, jemi shumë të lumtur që po përmbyllet cikli i shëndetit primar në këtë komunë. Natyrisht, Gjilani dhe kjo pjesë e Kosovës ka tërë rezultate shumë të mira për kujdesin shëndetësor. Kemi rezultate shumë të mira në zhvillimin ekonomik

sepse kemi një ekonomi, e cila është mjaft aktive dhe e mjaft e diversifikuar, e cila dallon nga ajo që kemi arritur në pjesët tjera të vendit”, ka deklaruar kryeministri vendit. “Do të ketë investime në infrastrukturë dhe mendoj se do ta ndihmojë zhvillimin ekonomik të Gjilanit. Edhe autostrada e re, e cila do të ndërtohet këtu, edhe lidhjet me Ferizajn dhe Prishtinën, që e shpejtojnë komunikimin ekonomik dhe komunikimin e qytetarëve me pjesë tjera të vendit. Do të mundohemi maksimalisht që t’i bashkërendimit të gjitha punët me pushtetet lokale edhe me Gjilanin si komunë tepër e rëndësishme për Kosovën”, ka shtuar i pari i qeverisë kosovare. Përndryshe,

kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, së bashku me kryetarin e Gjilanit Lutfi Haziri, kanë vizituar rrugën katër krosi Gjilan-Bujanoc, e cila është në prag të finalizimit. Mustafa është shprehur i impresionuar me pamjen e bukur dhe cilësinë e punimeve. “Jemi të interesuar që sa më parë të vazhdojmë me këto korridore edhe brenda qytetit edhe në autostradën më vonë, për të krijuar një unazë e cila do ta lidhë këtë pjesë të Kosovës me gjithë infrastrukturën që ne komunikojmë me vendet fqinje. Këto rrugë na mundësojnë që të dalim sa më shpejt në Europë me standarde të infrastrukturës europiane”, ka thënë kryeministri Mustafa. Nga ana e tij, kryetari Haziri e ka njoftuar kryeministrin për ndërtimin e kësaj rruge me të hyrat komunale, duke e falënderuar për mbështetjen në infrastrukturë në vlerë prej mbi 5.3 milionë euro në realizimin e një numri të madh të projekteve tjera. Rruga Gjilan-Bujanoc, e cila ka një gjatësi prej 1.4 kilometra dhe gjerësi 27 metra, kap koston e investimeve në vlerë prej 900 mijë eurove.



Mustafa e Haziri takojnë kryetarët e komunave të Kosovës Lindore

13

DHJETOR

Gjatë vizitës në Gjilan, kryeministri i vendit, Isa Mustafa, së bashku me kryetarin Lutfi Haziri, kanë takuar kryetarët dhe udhëheqësit e komunave Preshevë, Bujanoc e Medvegje dhe Këshillin Nacional të Shqiptarëve atje, përkatësisht Jonuz Musliu, Shaip Kamberi e Ardita Sinani.

“Kryeministri ka kërkuar edhe nga unë personalisht, që si kryetar i Komunës më të madhe në regjion, të kujdesem dhe angazhohem në kuadër të programit të bashkëpunimit ndërkufitar dhe ndërkomunal për Preshevën, Bujanocin dhe Medvegjën, sepse është interes i përbashkët dhe jetik që qytetarët të jetojnë atje dhe të mos lëvizin në drejtim të Kosovës”, ka deklaruar kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri. Ndërsa, kryeministri i Republikës së Kosovës, Isa Mustafa, është shprehur se takimet e tilla mungojnë në nivel qendror, duke vlerësuar lartë takimet e mëhershme të regjionit të organizuara

nga Komuna e Gjilanit, për të cilat tha se janë arritur rezultate të mira. “Vërtetë mund të them se neve na mungojnë takime të tilla në nivel qendror. Ka pasur takime të përbashkëta në Komunën e Gjilanit dhe me këtë regjion dhe mund të them se janë arritur rezultate të mira sepse është krijuar një komunikim. Ne jemi të interesuar që edhe më tutje ta thellojmë bashkëpunimin. Është e drejtë e jona që të ndihmojmë për zhvillimin ekonomik, arsimor e kulturor sepse ne jetojmë në Europë dhe karta europiane dhe e qeverisjes lokale përmban në vetvete edhe këtë formë të bashkëpunimit”, ka thënë kryeministri Mustafa. Nga ana e tyre, përfaqësuesit e komunave të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, kanë falënderuar kryeministrin Mustafa dhe kryetarin Haziri për takimin, duke thënë se ky takim ishte shumë i frytshëm, inkurajues dhe motivues për shqiptarët e Luginës së Preshevës.



Bunjaku-Rexhepi: Gjilani ka nevojë për Lutfi Hazirin edhe për një mandat

8

DHJETOR

Ciklin e konferencave me gazetarë të shfave të grupimeve politike që përfaqësohen në asamblenë komunale, të organizuar nga Zyra për Informim, e ka përmbyllur të enjten Valentina Bunjaku-Rexhepi, kryesuese e Kuvendit Komunal, e cila fillimisht ka thënë se organi më i lart vendimmarrës në nivel lokal, së bashku me trupat e tij ndihmës e ka kryer punën e vetë në mënyrën më të mirë të mundshme, duke marrë vendime në interes të qytetarëve, në 12 seancat e veta të rregullta dhe të jashtëzakonshme, sa i ka mbajtur deri tani.

"Secili anëtar i Kuvendit ka pasur mundësi të barabarta për të marrë fjalën dhe për të paraqitur kërkesa e propozime që kanë qenë me interes për qytetarët e Komunës së Gjilanit. Madje, shpeshherë e kemi anashkaluar edhe rregulloren e punës, për t'i dhënë sa më shumë hapësirë opozitës", ka thënë Bunjaku-Rexhepi. Sa i përket propozim-vendimit për ndryshimin e statutit, i cili nuk u procedua në seancën e fundit, edhe pse ishte në rend dite, kryesuesja e Kuvendit sqaroi se opozita kishte treguar gatishmëri për të përkrahur ndryshimet dhe plotësimet në statut, për të rikthyer në kuadër të ekzekutivit dy drejtorë - Kulturën, Rininë e Sportin si dhe Inspektionin, por në momentin e fundit është penguar nga shefat e partisë. Ndryshimin e qëndrimit të opozitës, në momentin e fundit, pasi e kishte votuar nismën për ndryshimin e statutit dhe pasi ishte deklaruar se do të marrë pjesë edhe në procedurën e miratimit në Kuvend Komunal, ajo e ka cilësuar një lloj tradhtie. Bunjaku-Rexhepi u shpreh optimiste se në një të ardhme të afërt, opozita do të ndryshojë bindjen dhe do ta votojë statutin. "Nëse nuk ndodh kjo, atëherë qeverisja do të vazhdojë punën kështu siç është, sepse në raport me qytetarët nuk ka asnjë mangësi", ka thënë ajo, duke sqaruar se rikthimi i dy drejtorëve duhet të bëhet për shkak të disa vështirësive të natyrës teknike. Ar-

syetimi pse është i nevojshëm ky ndryshim, i kërkuar prej opozitës, është dhënë me kohë dhe në formë të shkruar, ndërkaq organogrami nuk ka mundur të bëhet para se të miratohet statuti dhe të vendoset për rikthimin e këtyre dy drejtorëve, ka thënë Valentina Bunjaku-Rexhepi. "Megjithatë, pavarësisht këtij qëndrimi, raportet tona me opozitën mbeten të mira", ka thënë ajo, ndërkohë që ka përgënjeshtuar fjalët e disa anëtarëve të Kuvendit për, kinse tërheqjen e opozitës nga procesi i votimit, për shkak të refuzimit të një kushti të tyre. "PDK e Nisma kanë probleme mes vete për shkak të zgjedhjeve në Drenas", ka thënë Bunjaku-Rexhepi, duke mohuar të ketë pasur ndonjë kërkesë nga PDK-ja për ta votuar statutin. Për më tepër, ajo ka thënë se LDK-ja nuk hyn në pazar me askënd, sepse i ka votat e veta dhe nuk ka nevojë ta bëjë këtë, por nga opozita kërkon bashkëpunim në çështjet që janë me interes për qytetarët. Sa i përket LVV, që është ankuar se rekomandimet e tyre nuk janë marrë parasysh, ajo ka thënë se në Kuvend Komunal ka edhe anëtarë të rinj, të cilët nuk i njohin mirë procedurat. Opozita duhet ta kuptojë se një numër rekord i rekomandimeve të saj, sa ka paraqitur LVV, nuk mund të futen si pika të veçanta të rendit të ditës, ka thënë Bunjaku-Rexhepi, duke rikujtuar se në disa raste të tjera, kërkesat e opozitës (PDK-VV), janë pranuar dhe shqyrtuar në Kuvend. "Nuk është faji ynë, nëse propozimet e opozitës nuk kalojnë, por faji është i tyre që nuk i kanë numrat dhe këta numra mund të fitohen vetëm në zgjedhje". Njëherësh, Valentina Bunjaku-Rexhepi ka mohuar që ajo do të jetë kandidate e LDK-së për kryetar Komune në zgjedhjet e ardhshme, duke thënë se personalisht i pëlqejnë sfidat, por jo me Lutfi Hazirin, të cilit do t'i kërkohej që të mbetet në krye të Komunës edhe për një mandat. "Gjilani ka nevojë për Lutfi Hazirin. Gjilani, asnjëherë në historinë e vetë nuk ka pasur kaq shumë investime sa tani", ka thënë ajo.

Isufi (VV): Në Kuvend mungon debati i mirëfilltë

7

DHJETOR

7 dhjetor 2016 / Cikli i konferencave të subjekteve politike që përfaqësohen në Kuvendin Komunal të Gjilanit, ka vazhduar të mërkurën me Nevzad Isufin, shëf i grupit të këshilltarëve të Lëvizjes Vetëvendosje, i cili i ka bërë një vlerësim të gjerë punës së qeverisjes dhe vendimmarrjes komunale. Duke mos mohuar se janë bërë edhe punë të mira, Isufi ka thënë se ai do t'i nënvizojë të metat e këtij pushteti, meqë ky është edhe roli i opozitës. "Kritika e mirëfilltë duhet vlerësuar", ka thënë ai.

Sipas tij, ulja qind për qind e taksave, shlyerja e borxheve për bizneset, sistemi i ujitjes dhe projektet tjera në bujqësi, ulja e tatimit në pronë për 40 për qind, pastaj ujërat e zeza në Malishevë, rritja e përfaqësimit të femrave në ekzekutiv, përkrahja më e madhe për familjet e dëshmorëve si dhe premtime të tjera të kësaj qeverisje, nuk janë realizuar fare, ose janë realizuar pjesërisht. Si premtime tjera të pa realizuara, Isufi ka përmendur edhe rrugën me katër krosi Gjilan-Prishtinë, rritjen e pastërtisë në qytet, më shumë parqe dhe kopshte për fëmijë, ndriçimin publik, depolitizimin e arsimit dhe administratës, shërbimet më të mira mjekësore për qytetarë dhe të tjera. Ndërkaq, si premtime të mbajtura, ai ka përmendur dhënien e objektit të Komunës për muze, ndërtimin e çerdhes në lagjen "Dardania", ku janë duke vazhduar punimet si dhe ndonjë investim tjetër. Shëfi i grupit të



këshilltarëve të VV-së, ka folur edhe për raportin e kryetarit të Komunës me opozitën. "Do të ishte jo korrekte të thosha që kryetari, në paraqitjet e tij, na ka injoruar neve si opozitë, madje disa herë na ka cituar dhe na ka dhënë të drejtë gjatë seancës, por rekomandimet tona nuk janë proceduar më tutje". Kështu p.sh. në gjysmën e parë të muajit mars, ne si grup opozitar patëm bërë një varg propozimesh për të eliminuar shumë shkelje e parregullsi në Kuvend dhe Komitete, por seanca e premtuar e Kuvendit, për t'i trajtuar këto rekomandime, nuk u thirr. Edhe puna e Kuvendit dhe trupave të tij, është përcjellë me mangësi e shkelje të rregullores. Plani i punës së Kuvendit, për këtë vit, ka qenë relativisht i varfër dhe me gabime serioze. "Në Kuvend mungon debati i mirëfilltë, i arsyeshëm dhe konstruktiv", ka thënë Isufi. Isufi është ndalur edhe te puna e drejtorive komunale dhe veçmas te Arsimit, ku sipas tij, ka pasur punësime me kontrata në vepër, pastaj parregullsi tek regjistrimi i nxënësve, sikurse edhe te kampusi i shkollave të mesme, te për gatitjet për periudhën e dimrit dhe të tjera. "Unë mendoj se qytetarët meritojnë një qeverisje shumë më të mirë, më të përgjegjshme dhe më efikase se kjo", ka thënë Isufi. Konferencën e organizuar nga Zyra për Informim, Isufi e ka vlerësuar si një mundësi të mirë për opozitën, që t'i paraqes vërejtjet e saj për punën e institucioneve komunale. LVV përfaqësohet në Kuvend Komunal me 4 këshilltarë.

Nuk arrihet konsensusi politik për ndryshimin e statutit të Komunës

6

DHJETOR

Kuvendi Komunal i Gjilanit vendosi të martën të mos e nxjerrë fare në votim propozim-vendimin për ndryshimin e statutit, meqë subjektet politike nuk arritën konsensus. Nisma për ndryshimin e statutit, si nevojë për t'i hapur rrugë riorganizimit të ekzekutivit, përkatësisht rikthimit në dy drejtorive komunale, Kulturës, Rinisë e Sportit dhe Inspeksionit, është bërë nga kryetari i Komunës dhe në procedurat paraprake është përkrahur nga të gjitha subjektet politike.

Valentina Bunjaku Rexhepi, kryesuese e Kuvendit Komunal, ka thënë se mungoi vullneti politik për t'i miratuar ndryshimet, të cilat bëhen për të rikthyer dy drejtori komunale - Drejtorinë për Kulturë, Rinie e Sport si dhe Drejtorinë e Inspeksionit. "Unë jam konsultuar paraprakisht me shëfat e grupeve politike dhe ata kanë qenë për këtë ndryshim, prandaj edhe e kemi proceduar në Kuvend, por tani janë kundër", ka thënë ajo, duke rikujtuar se opozita, e cila ka qenë kundër shuarjes së këtyre dy drejtorive, tani del kundër kthimit të tyre. Bunjaku-Rexhepi ka thënë se të gjitha sqarimet janë dhënë deri tani dhe anëtarëve të Kuvendit u është dorëzuar edhe një arsyetim me shkrim. Reduktimi i numrit të drejtorive komunale si dhe modifikimi i disa shërbimeve në kuadër të administratës komunale, ishte bërë me qëllim të depolitizimit të këtyre sektorëve. "Ne vlerësojmë se ka pasur rezultate në këta sektorë, por jemi të vetëdijshëm se kemi mundur edhe më shumë, prandaj në funksion të këtij qëllimi të mirë, kemi vendosur që të rikthejmë këto dy drejtori", ka thënë Bunjaku-Rexhepi, duke nënvizuar se këto ndryshime nuk lidhen me mandate politike, por me interesa të qytetarëve dhe të institucioneve komunale. Opozita vendosi të mos marrë pjesë në këtë proces. Sahit Abazi (PDK) ka



thënë se grupimi i tij politik ka qenë kundër shuarjes së dy drejtorive. "As sot nuk jemi kudër kthimit të këtyre dy drejtorive, por nuk mund të jemi aleatë në votim me koalicionin qeverisës", ka thënë ai. Kurse Nevzad Isufi (VV) ka thënë se arsyetimi pse është i nevojshëm të bëhet ky ndryshim, nuk ka qenë serioz, ndërsa nuk është ofruar as raporti i kërkuar nga ne, për gjendjen në këta dy sektorë, gjatë periudhës së kaluar tre vjeçare, ka thënë ai. Për dallim prej opozitës, subjektet tjera politike (LDK, AAK dhe G4), përfshirë edhe këshilltarin e pavarur Bajram Hasani, janë deklaruar në favor të këtij ndryshimi. Selami Xhemajli (AAK) ka thënë se ky subjekt politik do të votojë çdo vendim që është në interes të qytetarëve të komunës së Gjilanit, edhe sikur të jetë në opozitë.

Avdyl Aliu (LDK) ka thënë se opozita po bën moral të dyfishtë politik, sepse atëherë ishte kundër shuarjes së dy drejtorive, kurse tani del kundër rikthimit të tyre. Aliu ka kërkuar të mos favorizohet interesi partiak, para interesit të qytetarëve, duke rikujtuar se LDK e kishte votuar ndryshimin e statutit në qeverisjen e kaluar. Ismet Hajdini (G-4), ka thënë se AKR, PD, PDK dhe një këshilltar i pavarur, grupim ky i sapo formuar, vlerësojnë se riorganizimi i ekzekutivit, përmes kthimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtorisë së Inspeksionit, është interes i qytetarëve, prandaj do të votojnë për këtë ndryshim të statutit. Megjithatë, kryesuesja e Kuvendit ka vendosur të mos e procedojë për votim propozim-vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të Komunës, pa konsensus politik. Seanca e radhës pritet të mbahet në janar dhe deri atëherë, subjektet politike kanë kohë të mjaftueshme për të arritur konsensusin.



Kryetari Haziri priti ambasadorin britanik O`Connell

5

DHJETOR

Lutfi Haziri, kryetar i Komunës së Gjilanit, ka pritur në një takim ambasadorin e Britanisë së Madhe në Kosovë, Ruairi O`Connell, i cili paraprakisht ka marrë pjesë në një takim të asamblesë së fëmijëve në këtë qytet. Në një konferencë për gazetarë, pas takimit, Haziri është shprehur i kënaqur që sot në Gjilan ishte për vizitë ambasadori i Britanisë së Madhe, Ruairi O`Connell, i cili ka takuar njësinë për rini dhe klubin e rinisë në Gjilan, që është institucioni më i ri në këtë Komunë, që bashkon të gjitha grupet rinore si dhe asamblenë e fëmijëve të Gjilanit.

Kryetari Haziri e ka falënderuar ambasadorin për interesimin që ka treguar për punën dhe kushtet e punës në Komunën e Gjilanit, duke nënvizuar se O`Connell është njohës i mirë i rrethanave tek ne.

“Vizita e ambasadorit shënon një histori, sepse është hera e parë që ai vjen në Gjilan, pas një shërbimi shumë të gjatë në Kosovë”, ka thënë Haziri. Edhe ambasadori britanik Ruairi O`Connell u shpreh i kënaqur me ato që kishte dëgjuar nga kryetari Haziri, për situatën ekonomike dhe politike në këtë Komunë dhe veçmas për mikpritjen që iu bë këtu. Sa u përket zgjedhjeve në Drenas, diplomati anglez tha se për mua, e rëndësishme është që qytetarët të ndihen fuqiplotë në cilat do zgjedhje në Kosovë, sepse shprehja e pikëpamjeve politike, është ky është themeli i demokracisë. Ambasadori O`Connell tha

se asamblenë e fëmijëve e ka inkurajuar që të kërkojë më shumë prej politikanëve, sepse askush tjetër nuk do ta ndryshojë botën për ju, nëse ju vetë nuk i bëni ndryshimet që dëshironi. Po ashtu kemi lansuar edhe projektin për vullnetarizëm, sepse çdo demokraci në botë ka nevojë për qytetarë të angazhuar, për të kërkuar ndryshime dhe për të bërë ndryshime, ka thënë diplomati anglez. “Kemi folur edhe për projekte tjera, si ai për digjitalizimin e librave për të verbrit si dhe jam interesuar për projektet e Britanisë në Gjilan, sidomos për projektin e ri-integrimit të të rinjve që kanë shkuar për të luftuar në Irak apo Siri”, ka thënë O`Connell. Ambasadori nuk ka ngurruar të flas edhe për sportin në Kosovë dhe Britani, nga këndvështrimi krahasues sa i përket cilësisë së futbollit dhe infrastrukturës, pa mohuar se edhe Kosova është një shembull pozitiv në këtë aspekt. “Është gabim të mendohet se vetëm Kosova duhet të mësojë prej Britanisë, sepse edhe ne mund të mësojmë prej Kosovës”, ka thënë ai, duke shtuar se kushtet në Britani janë më të avancuara, për dallim prej Kosovës, për shkak të historisë së Britanisë, përkatësisht historisë së Kosovës. Sa i përket infrastrukturës sportive, Haziri ka thënë se në Gjilan do të investohen 1.2 milionë euro për rinovimin e stadiumit të qytetit, për të krijuar kushte për sportistët e këtushëm dhe ata që vijnë në këtë qytet për të zhvilluar gara, meqë sporti i Kosovës tashmë është anëtar i organizatave evropiane e botërore.

Haziri në debat me qytetarë: Kemi krijuar balancë investimesh qytet-fshat

5

DHJETOR

Kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, i shoqëruar nga drejtorët komunalë si dhe kryesuesja e Kuvendit, Valentina Bunjaku Rexhepi, ka mbajtur të hënën debatin e dytë me qytetarë, ku ka prezantuar të arriturat e këtij viti, sukseset dhe sfidat si dhe planet për vitin e ardhshëm, që në të vërtetë ishte përmbyllje e një cikli të gjerë takimesh me publikun, të cilat janë mbajtur nëpër lokalitete të ndryshme. “Vetëm sivjet, investimet në infrastrukturën publike, ku janë përfshirë të gjitha lokalitetet, arrijnë vlerën 5.6 milionë euro, por investime edhe më të mëdha do të ketë vitin tjetër”, ka thënë Haziri.

Fillimisht, kryetari Haziri ka thënë se në këto tri vite të qeverisjes së tij, është investuar shumë në infrastrukturën publike, që ka qenë kërkesë kryesore e qytetarëve, si në dëgjimet publike, ashtu edhe në takimet javore me ta. Për më tepër, kryetari Haziri tha se qeverisja e tij ka vendosur një balancë të investimeve qytet-fshat. Përveç infrastrukturës publike, investimet tjera më të mëdha, 3 milionë euro, i ka marrë arsimit, ku, siç ka thënë Haziri, ka probleme me ndarjen jo të drejtë të buxhetit, përkatësisht ndarjen jo të dejtë të normave në arsim. Pasi i ka përmendur projektet konkrete që janë realizuar, ose që janë në proces e sipër në këtë sektor, siç është çerdhja në lagjen “Dardania”, palestrat e sporteve për shkollën “Abaz Ajeti” dhe fshatin Pogragjë si dhe projekte të tjera, Haziri ka thënë se me ndërtimin e objektit të ri shkollor në fshatin Haxhaj, vitin e ardhshëm, përmbyllet cikli i investimeve në infrastrukturën shkollore. Një sektor tjetër që ka pasur vëmendje të madhe sivjet, ka qenë kultura, rinia dhe sporti, sektarë këta për të cilët janë ndarë 120 mijë euro subvencione, pa përfshirë teatrin. “Gradualisht po i rritim investimet në këtë sektor, për të stabilizuar sa më mirë kulturën në përgjithësi dhe teatrin, në veçanti”, ka thënë kryetari i Komunës. Bujqësia po ashtu është subvencionuar me prioritet, sidomos sektori prodhues dhe familjet bujqësore, ku sivjet janë investuar 1.6 milion euro, duke përfshirë mjetet nga buxheti i Komunës dhe Ministria. “Synimi ynë është që shpenzimet e familjeve bujqësore t’i zbresin në zero”, ka



thënë Haziri. Shëndetësia primare, po ashtu ka qenë një sektor shumë i suksesshëm këtë vit. Përveç fshatit Llashticë, ku vitin e ardhshëm do të ndërtohet ambulanca, në lokalitetet tjera janë kryer investimet sa i përket infrastrukturës. Qendra e re e Mjekësisë Familjare, do të jetë një investim tjetër i madh që fillon këto ditë, përballë Spitalit Regjional dhe pos që do të përmirësojë shërbimet, do të mundësojë edhe qasje më të lehtë të qytetarëve në sektorin dytësor të shëndetësisë, ka thënë ndër të tjera kryetari Haziri. Ai ka prezantuar në pika të shkurta edhe planet për vitin e ardhshëm, kur investimet do të shkojnë në 29 milionë euro. Së shpejti pritet fillimi i projektit për trajtimin e ujërave të zeza, përmes kredisë nga qeveria austriake, në vlerë 13 milionë euro, për të zgjidhur një nga problemet më jetike të kësaj komune, pastaj ndërtimi i rrugës Gjilan-Klloko, e cila do të bëhet sipas parametrave të rrugës hyrëse-dalëse Gjilan-Bujanoc, rruga Gjilan-Prishtinë, deri te liqeni i Livoçit, projekte këto që do të kenë trotuare, ndriçim dhe gjelbërim. Po ashtu do të asfaltohet edhe rruga për Vërbicë të Zhegocit, lokalitet ky nga do të kalojë edhe autostrada për Gjilan, që këtë regjion e lidh përfundimisht me korridoret e mëdha ndërkombëtare. Haziri ka thënë se do të punohet për të kompletuar infrastrukturën e nevojshme në çdo fshat, sikurse tashmë është bërë në disa prej fshatrave të kësaj Komune. Ai ka thënë se ka kërkesa të ndryshme nga qytetarët, sa u përket investimeve, por ka premtuar se përparësi do të kenë zonat e banuara. Gjilani planifikon ta organizojë sërish konferencën e donatorëve, në fund të dhjetorit, ose në janarin e vitit të ardhshëm, për të rikthyer atë në tavolinën e donatorëve të mëdhenj, si nevojë për zhvillimin e Komunës. Kryetari Haziri është përgjigjur edhe në pyetjet e qytetarëve për investime, duke thënë se të gjitha kërkesat do të merren parasysh sipas prioriteteve dhe përgjigja e tij ka gëzuar veçmas banorët e Vërbicës së Zhegocit, ku vitin e ardhshëm do të asfaltohet rruga. Në pyetjet tjera janë përgjigjur edhe drejtorët Naser Korça (Shërbime Publike), Nazim Gagica (Administratë e Përgjithshme) dhe të tjerë.

Aliu (LDK): Kuvendi i Gjilanit është model sa i përket tolerancës ndërpartiake dhe bashkëpunimit

30
Nëntor

Zyra për Informim e Komunës së Gjilanit ka vazhduar praktikën e organizimit të konferencave me shefat e grupimeve politike, për t'iu dhënë mundësi të gjitha subjekteve politike që përfaqësohen më me tepër se një mandat në Kuvend Komunal, që t'i paraqesin vlerësimet e tyre për punën e vendimmarrjes dhe ekzekutivit. Cikli i konferencave për periudhën 9-mujore të këtij viti, është hapur me Avdyli Aliun (LDK).

Kuvendi i Komunës së Gjilanit, si organi më i lartë vendimmarrës në pushtetin lokal, gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 10 seanca të rregullta, një seancë të jashtëzakonshme dhe 2 seanca solemne, ku janë miratuar 30 vendime, 5 rregullore, 12 rekomandime, pastaj plani për menaxhim të mbeturinave, plani i veprimit për energji të qëndrueshme, 2 nisma, 2 marrëveshje bashkëpunimi me Komunat fqinje, memorandume, raporte, plane pune dhe të tjera, ka thënë Aliu. "Kuvendi Komunal i Gjilanit, në të gjitha aktivitetet e veta, në fokus të interesit e ka pasur qytetarin dhe assesit interesat e ndonjë grupi të ngushtë", ka thënë Aliu. Përndryshe, Aliu ka theksuar se në Kuvendin Komunal të Gjilanit vazhdon të mbretërojë një frymë e mirë dhe tolerante ndërmjet të gjitha grupimeve politike, që nga fillimi i punës së kësaj përbërje. Të gjithë anëtarët e Kuvendit kanë të drejta të njëjta dhe mundësi të barabarta për të marrë



pjesë në të gjitha proceset e punës, ka thënë ai. Shefi i grupit të këshilltarëve të LDK-së, Avdyli Aliu beson se asnjë anëtar i Kuvendit nuk e ka shpenzuar në mënyrë të padobishme kohën e tij në vendimmarrjen komunale, ose duke i shërbyer një interesi të ngushtë, por duke u munduar që të bëjë një punë të mirë për qytetarët e Gjilanit. "Në Kuvend është instaluar një demokraci e mirëfilltë. Ka marrëdhënie dhe bashkëpunim të mirë pozitë-opozitë dhe shpresoj se kështu do të vazhdojmë edhe më tutje, pavarësisht faktit se po shkojmë drejt një viti zgjedhor". Aliu beson se Kuvendi Komunal i Gjilanit dhe Komuna e Gjilanit, në përgjithësi janë një model i mirë për komunat dhe kuvendet tjera komunale në aspektin e tolerancës dhe bashkëpunimit ndërmjet grupimeve politike. "Të vetëdijshëm se gjithmonë ka vend edhe për më mirë, ne synojmë të bëjmë edhe më shumë në të ardhmen për interesa të qytetarëve të komunës së Gjilanit", ka thënë Aliu. Po ashtu, me qëllim të mbarëvajtjes së punës në Kuvend dhe në Komunë, në përgjithësi, Aliu ka thënë se ekziston një bashkëpunim i kënaqshëm edhe me ekzekutivin. "Ne vazhdimisht koordinohemi për interesa të qytetarëve të komunës së Gjilanit", ka thënë ai, duke shtuar se vlerësimet tona në përgjithësi, janë se po punohet mirë. LDK përfaqësohet në Kuvend Komunal me 14 këshilltarë dhe është partia më e madhe.



Një delagacion i Strong City Network viziton Gjilanin

30
NËNTOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri me bashkëpunëtorë, ka pritur në një takim pune përfaqësuesit, nga Strong City Network, konkretisht Vera Orloff dhe Biserka Ivanociq, të shoqëruar edhe nga zyrtarë të tjerë me të cilët kanë biseduar për bashkëpunimin mes qyteteve të cilat janë anëtare të Rrjetit Global të Komunave - Qyteteve të Forta për bashkëpunim për parandalim të akteve ekstremiste që shpjen në radikalizëm dhe terrorizëm.

Kryetari Haziri, ka thënë se Komuna e Gjilanit është pjesë e Strong City Network, dhe në kuadër të kësaj ka tashmë aktiv Mekanizmin Referues, i cili, është duke punuar në parandalim të akteve kriminale. "Mekanizmi Referues është një trupë e themeluar pas anëtarësimit të Komunës së Gjilanit në mesin e qyteteve të forta të botës, që detyrë kryesore ka preventivën e involvimit të qytetarëve në akte ekstremiste të cilat shpijnë në radikalizëm dhe terrorizëm.

Në këtë grup janë të përfshirë institucionet nga të gjitha nivelet duke nisur nga të gjithë resorët e Komunës së Gjilanit, pastaj Policia e Kosovës, prokuroria, shëndetësia, arsimi, qendra për punë sociale, enti i punësimit, shoqëria civile dhe agjensione e organizata të tjera qeveritare e jo-qeveritare", ka thënë kryetari Haziri, duke potencuar angazhimin e tij personal në të mirën e qytetarëve të Gjilanit në përgjithësi. Ai më tej ka potencuar edhe angazhimet e këtij mekanizmi që nga themelimi e deri më tani, duke pohuar që pos aktiviteteve të deritanishme, duhet edhe angazhim shtesë për ngritje të kapaciteteve në këtë fushë, si dhe në angazhimin për përgatitjen e dokumenteve strategjike, gjithnjë në kuadër të përcaktimit të nivelit qeveritar në fushën e sigurisë. Ndërsa përfaqësueset nga Strong City Network, kanë paralajmëruar se kjo vizitë është në kuadër të vizitave për vendet e Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë informimin dhe gjendjen në të cilat janë shtetet e ndryshme në kuadër të këtij regjioni të Ballkanit.



Në Gjilan u mbajt konferenca informuese për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit

29

NËNTOR

Në Gjilan sot është mbajtur konferenca e parë informuese për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, e organizuar nga Instituti për Studime Politike dhe Grupi për Studime Politike dhe Juridike, në mbështetje të Ambasadës së Holandës në Kosovë dhe Komunës së Gjilanit, ku janë dhënë informacionet detaje për këtë marrëveshje, obligimet e Kosovës ndaj kësaj marrëveshje, por edhe roli i Komunave në përmbushjen e objektivave të cilat përbëjnë lehtësim të zbatimit të marrëveshjes gjatë të ardhmes.

Me këtë rast kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se kjo marrëveshje është arritur me vështirësi dhe kushte të mëdha, në mënyrë që Kosova të ecë përpara drejtë integritit dhe rrugës së saj të synuar për në BE. “Kosova, ka kaluar fazën e parë atë të lirisë dhe krijimit si shtet, janë kaluar procese jashtëzakonisht të rënda dhe rreth 10 vjet jemi duke punuar në rrugën tonë drejtë BE-së dhe në këtë proces të kësaj marrëveshje, ndërsa tani faza e parë është formalizuar. Është ngjarja më e mirë dhe më e madhe që Kosova ka pasur shpalljes së pavarësisë. Integritet Evropiane janë rruga e vetme e Kosovës, nuk ka rrugë dhe alternativë tjetër. Lus edhe zyrtarët e Komunave të cilët merren me implementimin por edhe përfaqësuesit e qeverisë dhe institucioneve të tjera që do të bëjnë punën e tyre në implementim të

kësaj marrëveshje, duke qenë vigjilent dhe duke marrë parasysh që ky proces është i brendshëm, është kap-tin që lëviz dhe që duhet të përmbushim qind për qind, në mënyrë që Kosova përmes saj të përfitoj shumë dhe dua kështu që të largohen zërat e ndryshëm skeptik që Kosova humb diçka. Kosova do të fitoj shumë më shumë se kaq, sepse përpara ka një qëllim, atë të integritit në familjen Evropiane”, ka thënë në fjalën e tij, në këtë konferencë, kryetari i Gjilanit Lutfi Haziri. Me fjalën e tyre janë paraqitur edhe drejtoresha e Institutit të Prishtinës për Studime Politike që njëherësh ka kryesuar këtë konferencë, Leonora Kryeziu, pastaj Felix Rathje, nga zyra për Politikë në zyrën e BE-së, Venera Ramaj nga Ambasada e Holandës në Kosovë, Arjeta Meraj hulumtuese nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Jeton Karaqica nga Ministria e Integritimeve Evropiane dhe të tjerë të pranishëm, të cilët këtë marrëveshje e kanë cilësuar si një hap të fuqishëm të ecjes së Kosovës, dhe një mundësi e madhe për përgatitjen edhe në aspektin e zhvillimit të gjithmbarshëm të Kosovës në raport me konkurrencën Evropiane. Ata më tej kanë përshkruar edhe shembujt e tjerë të ndjekur nga shtetet anëtare para Kosovës, por edhe vështirësitë dhe rrugën që të tjerët kanë kaluar para nesh e të cilat duhet t’i kemi parasysh. Ndryshe në këtë takim kanë qenë të ftuar të marrin pjesë zyrtarë të Komunave të ndryshme të regjionit të Gjilanit.



Kuvendarët e Gjiçanit pajtohen që miratimin e statutit ta bëjnë në vazhdimin e seancës

29
NËNTOR

Tri subjektet më të mëdha politike që përfaqësohen në Kuvendin Komunal të Gjiçanit (LDK, PDK e AAK), me përjashtim të LVV, që e kishte braktisur sallën e mbledhjeve gjatë kohës së pauzës, janë pajtuar që seancën e sotme ta vazhdojnë një ditë tjetër, për t'i miratuar ndryshimet dhe plotësimet në statutin e Komunës, meqë të martën nuk arritën konsensus për ta bërë këtë. Valentina Bunjaku Rexhepi, kryesuese e Kuvendit Komunal, ka thënë se mungoi vullneti politik për t'i miratuar ndryshimet, të cilat bëhen për të rikthyer dy drejtori komunale - Drejtorinë për Kulturë, Rini e Sport si dhe Drejtorinë e Inspektionit.

Sahit Abazi (PDK) tha se grupi i këshilltarëve të këtij subjekti është pajtuar në parim për ndryshimin e statutit, por për t'i votuar këto ndryshime, ka kërkuar që të sillen një

organogram, për të parë se si do të duket ekzekutivi pas kthimit të këtyre dy drejtorive. Bunjaku-Rexhepi ka thënë se të gjitha sqarimet e nevojshme janë dhënë deri tani, organogrami është gati, ndërkaq anëtarëve të Kuvendit u është dorëzuar edhe një arsyetim me shkrim. Ajo e ka rikujtuar opozitën se asokohe ka qenë kundër shuarjes së këtyre dy drejtorive, ndërkaq tani refuzon miratimin e statutit, për t'i hapur rrugë rikthimit të atyre dy drejtorive. Përndryshe, Kuvendi Komunal, ka miratuar të martën edhe vendimin për këmbimin e pronës komunale me pronën private për nevoja të rrugës "Jugu I", vendimin për shpalljen e interesit të përgjithshëm në disa prona shoqërore, të cilat administrohen nga AKP, të cilat i ka arsyetuar Refik Shala, kryesues i Komitetit të Pronës, duke thënë se të dyja këto pika janë shqyrtuar dhe rekomanduar nga kjo trupë komunale. Vendimi për miratimin

e planit rregullues "Qendra 4" ka zgjuar më shumë interesim dhe debat te anëtarët e Kuvendit Komunal, madje opozita (PDK) ka kërkuar edhe shtyrjen e kësaj pike. Sahit Abazi (PDK) ka thënë se bë këtë zonë po legalizohet një gjendje ekzistuese. Sipas Riad Rashitit (PDK) "Qendra 4" dëmton planin rregullues. Edhe Nevzad Isufi (VV), ka thënë se dyshon që plani është dashur t'i përshtatet gjendjes ekzistuese. Isa Agushi (LDK) ka thënë se duhet t'iu besohet ekspertëve, të cilët e kanë bërë këtë plan dhe jo të ngritën dyshime pa arsye. Nevzad Rushiti (LDK) tha se ekspertët e drejtorisë kanë bërë një zgjidhje shumë të mirë brenda gjendjes ekzistuese në këtë zonë, e cila kryesisht është private. Sqarime ka dhënë drejtori i Urbanizimit, Valon Shefkiu. Ai ka thënë se tërë këtë punë e ka bërë Drejtoria dhe Komuna nuk ka pasur nevojë të paguajë asnjë cent, siç është dashur të bëjë për planet tjera rregulluese. Ai e ka rikujtuar opozitën se vendimi është marrë në mandatin e kaluar, ku është vendosur që kompensimi i pronës, e cila merret nga pronarët privatë për infrastrukturë publike, të kompensohet përmes etazhitetit. Detajet e planit i ka prezantuar Fadil Sherifi, shef i Sektorit të Planifikimit, i cili ka thënë se asgjë nuk ka ndryshuar nga plani zhvillimor urban. Po ashtu u miratua edhe vendimi për komisionin vlerësues të ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronave të Komunës, ku Naser Sylejmani u zëvendësua me Sali Fazliun, kurse Enver Biçku me Samid Robellin. Kuvendi ka miratuar edhe vendimin për emërimin e këshillit komunal për vlerësimin e meritave historike e shoqërore të personaliteteve dhe ngjarjeve nga territori i komunës së Gjilanit, tërësia etnike shqiptare dhe më gjerë, i cili plotësua me dy propozimet e Lidhjes së Historianëve, Blerim Haziri e Ilir Vokshi, ndërkohë që AAK-ja do ta bëjë më vonë propozimin e saj, për të zëvendësuar Shaban Rexhepin, i cili është tërhequr nga ky këshill, për arsye të disa mospajtimeve, shkaku i refuzimit të dy propozimeve që

ka bërë ai për Llashticë. Kuvendi miratoi edhe planin e veprimit për përmirësimin e shërbimeve dhe punës në edukimin parashkollor. Ndërkaq, grupi punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2017, ku përfaqësohen të gjitha subjektet politike, do të përbëhet nga: Nevzad Rushiti e Fatmir Hoxha (LDK), Riad Rashiti (PDK), Ibish Ibishi (AAK), Selvetë Shurdhani (PD), Bajram Hasani (i pa varur). LVV ka refuzuar ta dërgojë anëtarin e saj në këtë grup punues, me arsyetim se propozimet e tyre nuk janë përfillur vitin e kaluar. Kuvendarët e kanë miratuar edhe projektin e manifestimit "Flaka e Janarit 2017", pas një arsytimi të shkurtër që ka dhënë Shpresa Kurteshi, kryesuese e Komitetit të linjës, e cila ka propozuar që shumica e mjeteve të kërkuara prej 53 mijë euro, të zbritet në 40 mijë euro. Propozimi i saj është përkrahur nga vendimmarrësit komunalë, të cilët janë pajtuar që kjo shumë të mos jetë më e lartë se 40 mijë euro. Fehmi Sylejmani (VV) ka thënë se manifestimi duhet të pasurohet me lojëra popullore tradicionale, ndërkaq Leonora Bunjaku ka pasur vërejtje të përbërja e grupeve punuese, ku përfaqësimi gjinor është simbolik. Kuvendi është plotësuar me anëtarin e ri, Fatmir Hoxha (LDK) i cili ka zëvendësuar Arben Mehmetin, që është zgjedhur përfaqësues ligjor i Komunës dhe si pjesë e shërbimit civil, nuk ka të drejtë të mbajë post politik. Kuvendi është detyruar sërish të vendos për përjashtimin nga seanca të këshilltarët Srgjan Mitrovic, i cili nga qeveria e Serbisë është emëruar kryetar i Komunës paralele dhe deri tani ka refuzuar të sjellë dëshmi me shkrim se është tërhequr nga këto struktura, të cilat në Kosovë janë ilegale. Valentina Bunjaku-Rexhepi ka thënë se ky është qëndrim i të gjitha subjekteve politike që përfaqësohen në Kuvend Komunal, të cilat nuk pajtohen të bashkëpunojnë me Mitrovic, derisa ai nuk deklarohet që këtu nuk përfaqëson interesa tjera, pos atyre të komunitetit që i përket.



Haziri: Dëshmorët, heronjtë, martirët dhe viktimat janë më meritorët për këto ditë të bardha

28
NËNTOR

Komuna e Gjilanit, me homazhe tek varrezat e dëshmorëve, ka nisur aktivitetet e shumëta për nderë të 28 Nëntorit, shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë dhe ditën e Flamurit. Kryetari Lutfi Haziri, pasi ka uruar të gjithë shqiptarët, ka thënë se sot po nderohen të gjithë ata që janë më meritorët, dëshmorët, heronjtë, martirët dhe viktimat, të cilët u sakrifkuan për këtë ditë të bardhë.

“Uroj të gjithë bashkëvendësit dhe të gjithë shqiptarët kudo që janë këtë festë të madhe të 28 Nëntorit. Ne sot nderojmë të gjithë ata që janë më meritorët, dëshmorët, heronjtë, martirët dhe viktimat, të cilët u sakrifkuan për këtë ditë të bardhë. Gjilani dhe Anamorava në këtë përvjetor të madh, përveç kryengritjes së madhe të Idriz Seferit, shënon edhe përvjetorin e rëndë të masakrës së Gjilanit dhe kryengritjes së Mulla Idriz Gjilanit”, tha Haziri. “Ne do të vazhdojmë t’i përmbyllim këta përvjetorë të mëdhenj, në mënyrë që historia të zbardhet mbi veprën

e këtyre patriotëve të mëdhenj, në mënyrë që qytetarët të jenë sa më të njoftuar me aktin sublim. Në këtë ditë të bardhë, uroj vërtetë të ketë harmoni dhe çdo të mirë në çdo familje shqiptare”, ka shtuar Haziri. Më pas, kryetari i Gjilanit me bashkëpunëtorë ka bërë homazhe para lapidarit të Agim Ramadanit, tek dëshmorët Nuhi Beridha e Rexhep Mala dhe tek busti i Alban Ajetit.



Gjilani inauguron Muzeun e Qytetit



28
NËNTOR

Pikërisht më 28 Nëntor, Komuna e Gjilanit në krye me Lutfi Hazirin kanë inauguruar Muzeun e Qytetit. Në ceremoninë e inaugurimit, pos kryetarit Haziri dhe bashkëpunëtorëve, kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të Departamentit të Trashëgimisë Kulturore si dhe artdashës të shumtë.

“Kjo shtëpi do t’i grumbullojë artefaktet dhe gjithçka që lidhet me historinë dhe me trashëgiminë që Gjilanit dhe që regjioni e ka. Ne jemi një thesar arkeologjik i pazbuluar dhe duhet të punojmë shumë që të zbardhet historia jonë e çmuar. Ky 28 Nëntor dhe ky Muze i Qytetit dhe i regjionit, tashmë ruhet nga zyrtarët e qendrës së trashëgimisë regjionale”, tha me këtë rast kryetari Lutfi

Haziri. Ai premtoi se në vitin e ardhshëm Gjilani do t’i ketë tri kinema dhe galerinë e qytetit në vendet e merit-uara.”Gjilani e ka pasur mungesë muzeun, sikurse edhe kinemanë që është duke u ndërtuar. Gjilani do t’i ketë 3 kinema, të cilat planifikohen të ndërtohen në vitin e ardhshëm. Poashtu, ne po punojmë që ta gjejmë vendin adekuat për një galeri të qytetit, që të rumbullakohen ato shtëpi të kulturës, dijes dhe të trashëgimisë që çdo qytet duhet t’i ketë”, u shpreh Haziri. Fjalë rasti në këtë ngjarje pati edhe drejtoresha e Departamentit të Trashëgimisë Kulturore, Vjollca Aliu dhe drejtori i Muzeut Rajonal, Artan Hoxha, të cilët falënderuan kryetarin Haziri i cili ish-zyrën e kryetarit ia dhuroi Muzeut të Qytetit.



Haziri: Këtë 28 Nëntor, Gjilani ia dedikon kryengritësit të madh shqiptar, Idriz Seferi

28
NËNTOR

“Këtë 28 Nëntor të madh, Komuna e Gjilanit ia dedikon kryengritësit të madh të shqiptarë, kolosit Idriz Seferi. Nga ky nëntor, deri në nëntorin e ardhshëm, ne do t’ia kushtojmë këtij kolosi dhe të gjithë bashkëluftëtarëve të tij. Do të kërkojmë fakte, do të kërkojmë dëshmi, do ta zbardhim edhe më shumë historinë e tij dhe të luftëtarëve të tij, do ta bëjmë rivarimin e tij në varrezat e dëshmorëve dhe do ta ndërtojmë shtatoren e tij në qendër të Gjilanit”.

Këtë vlerësim kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, e ka dhënë gjatë inaugurimit të Muzeut të Qytetit. Ai tha se do t’i bëjnë nderimet më të mëdha sepse u bënë mbi 100 vjet Pavarësi dhe e edhe më tutje ky kolos i madh nuk është në vendin e merituar të historisë dhe të lavdisë. “Ai, me krismen e tij dhe me kryengritjen e ka bërë, jo vetëm çlirimin e Gjilanit, por edhe të kryeqytetit të Vilajetit të Kosovës në atë kohë, që ka qenë Shkupi”, tha Haziri.



Haziri: Familja Malaj dhe Berisha janë sinonim i lirisë dhe pavarësisë

28
NËNTOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka qëndruar sot në familjen e heroit Rexhep Mala dhe atë të Nuhi Berishës, për t'ua uruar festat e nëntorit, ku janë pritur dhe falënderuar nga zonja Hanife Malaj, përkatësisht baca Rexhep Berisha. Pasi ua uroi festat e Nëntorit, Haziri tha se familja Malaj dhe Berisha janë dy familje që janë sinonim i lirisë së këtij vendi.

"Familja Malaj dhe Berisha janë dy familje që janë sinonim i lirisë së këtij vendi, i Pavarësisë dhe i kësaj ditë të bardhe që ne sot e shënojmë. Zonja Hanife dhe mix-

ha Rexhep, dytë tashmë "Qytetarë Nderi" të Gjilanit dhe familjet e tyre, janë krenaria e gjithë shqiptarëve kudo që janë. Ne e kemi për nder që i kemi gjilanas dhe kontributi i tyre në histori është jashtëzakonisht i madh. Ne i nderojmë dhe i respektojmë shumë", ka thënë kryetari i Komunës së Gjilanit. Përndryshe, aktivitetet e shumta të Komunës së Gjilanit për nder të 28 Nëntorit, kurorëzohen në mbrëmje me koncertin festiv "Gëzuar Ditën e Flamurit" me fillim në ora 19:30, ku do të performojnë emra të shumtë të estradës.



Haziri: Duhet edhe një hap i madh që shqiptarët në Ballkan t'i realizojnë objektivat e tyre

28
NENTORI

Festa e Flamurit Kombëtar, në Gjilan është shënuar me aktivitete të shumta kulturore për tri ditë rresht, për të kulmuar sonte me mbylljen e kësaj feste përmes koncertit të madh festiv me solist, ansamblet dhe qytetarët e Gjilanit.

Haziri ka thënë se 28 Nëntorin këtë vit iu ka kushtuar veprës heroike të Idriz Seferit, i cili, me bashkëluftëtarët e tij, arriti të jetë çlirimtar i Gjilanit, Anamoravës, Karadakut dhe Shupit, pikërisht në kuadër të nëntorit të 1912-tës. "28 Nëntori ishte hap i identitetit kombëtar por edhe shtetëror para 104 vjetësh. Na duhet ta realizojmë edhe një hap tjetër të madh ne shqiptarët në Ballkan, në mënyrë që Republika e Kosovës të jetë pjesë e bashkuar e pandashme e shqiptarëve kudo që jetojnë, në mënyrë që ti realizojmë qëllimet dhe objektivat tona. Këtë vit,

ne këtë 28 Nëntor, ia dedikojmë Idriz Seferit. Ky kolos i madh dhe ky njeri që e çliroi jo vetëm Gjilanin, Anamoravën, Karadakun, por edhe Shkupin, për tu bërë pjesë e pavarësisë së Shqipërisë. Prandaj këto tri ditë feste, po përmbyllet sonte nën moton "Të festojmë së bashku" apo "Festoni me ne", për të gëzuar të gjithë bashkërisht 28 Nëntorin", ka thënë kryetari Haziri, para një numri jashtëzakonisht të madh të qytetarëve të mbledhur në Teatrin e qytetit. Ai ka uruar që ky 28 Nëntor dhe të ardhshmit pas tij, ta gjejnë çdo familje në Gjilan më mirë, më shëndetshëm, të begatshëm dhe mbi të gjitha duke punuar së bashku për zhvillimin e Gjilanit, Anamoravës dhe vendit në përgjithësi, sepse siç ka thënë ai kjo është thirrja e dëshmorëve për të cilët ne gjunjëzohemi dhe jemi krenar në veçanti.



Për nder të 28 Nëntorit, në Gjiçan u mbajt Festivali i Këngës për Fëmijë "Dëbora"

26
NËNTOR

Për nderë të festave të Nëntorit, në Gjiçan është mbajtur me sukses aktiviteti i radhës, Festivali i Këngës për Fëmijë "Dëbora", në të cilën kanë performuar para publikut dhjetëra fëmijë gjiçanas. Festivalin e ka shpallur të hapur kryesuesja e Kuvendit Komunal, Valentina Bunjaku Rexhepi, e cila tha se dëshmorët e kombit u flijuan në ne sot të frymojmë lirshëm në të gjitha aspektet.

"Falë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe arkitektit të pavarësisë, Dr. Ibrahim Rugova, sot ne po

kremtojmë të lirë. Sot po performon para gjithë neve me shumë krenari Alban Ajeti i vogël, nipi i dëshmorit të kombit. Kjo është dëshmia që gjeneratat e reja po i gëzojnë ditët më të mira, krahasuar me gjeneratën tonë. Dëshmorët e kombit u flijuan në ne sot të frymojmë lirshëm në të gjitha aspektet. Ju uroj suksese dhe gëzuar festën", ka thënë Bunjaku Rexhepi. Ndërkohë, sonte në ora 19:30 para publikut gjiçanas jepet shfaqja teatrale "Vdekja Aksidentale e një Anarkisti".

Gjilani shënon Ditën Ndërkombëtare kundër dhunës ndaj gruas

25
Nëntor

Simbolikisht sot Gjilani ka shënuar Ditën Ndërkombëtare kundër dhunës ndaj gruas, aktivitet në të cilin kanë marrë pjesë kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, me kabinetin e tij, nga ku me zbulimin e panos kundër dhunës ndaj gruas, kanë bartur mesazhin e fuqishëm për ndalim të dhunës dhe ecje përpara drejtë një familje të shëndoshë dhe me harmoni të plotë e me respekt të ndërsjellë mes dy gjinive.

Kryetari Haziri ka thënë se dhuna ndaj gruas është një dobësi e burrit, është shkelje e turpshme e ligjit kur merret parasysh viktimat e asaj dhune dhe në përgjithësi në asnjë mënyrë nuk është zgjidhje, por është vetëm një regres i madh dhe një dobësi e shoqërisë me të cilën po përballlet e gjithë bota. "Dhuna ndaj gruas është dhunë e

turpits që mund të bëjë burri. Ka shumë arsye që ajo të mos ndodhë dhe poashtu ka shumë arsye që gruaja të çmohet, të vlerësohet dhe të jetë mbështetëse e fuqishme e burrit gjatë gjithë jetës si shtyllë tashmë e dëshmuar e familjes. Sot, sikur çdo vit, jemi këtu bashkërisht që publikisht të themi, "ndal dhunën ndaj gruas". Dhuna nuk ka justifikim asnjëherë në asnjë mënyrë, prandaj të jemi bashkë të gjithë, që dhunën to mos e kemi në fjalorin e Kosovës, e posaqërisht të qytetarëve të Gjilanit", ka thënë mes tjerash, kryetari Haziri, derisa mbante të veshur fanellën me kordelen e bardhë, në aktivitetin e për-bashkët të grave dhe burrave gjilanas. Ndryshe ky aktivitet është organizuar nga Zyra për Barazi Gjinore në Gjilan me mbështetje të fuqishme të kryetarit Haziri.



Gjilani nis aktivitetet maratonike në shënim të festave të nëntorit



25
NËNTOR

Komuna e Gjilanit ka nisur aktivitetet maratonike në shënimin e festave të nëntorit, të cilat organizohen nën përkujdesjen e kryetarit, Lutfi Haziri. Fillimisht, kreu i Komunës, Lutfi Haziri i shoqëruar nga bashkëpunëtorët ka vizituar kazermën e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Gjilan, e cila shënon sot ditën e themelimit, ku është pritur nga komandanti i Batalionit, Haki Xhemajli.

“Në kuadër të shënimit të festave të nëntorit, sot vizitova kazermën e FSK-së në Gjilan dhe i urova për ditën e tyre. Natyrisht, është madhështi dhe është krenari që Batalio-

ni i parë i FSK-së dhe baza e tyre në Gjilan kanë rezultate jashtëzakonisht të mëdha gjatë kësaj periudhe kohore. Janë jashtë jashtëzakonisht të përgatitur këta djem e vajza, këta burra e gra, që e sigurojnë dhe e mbrojnë territorin dhe kufirin në pjesën më të madhe të Republikës sonë, që përfshinë trekëndëshin kufitar në plotni”, ka thënë kryetari Haziri. Përndryshe, në kuadër të shënimit të festave të nëntorit, sot është mbajtur edhe aktiviteti sportiv në karate, ndërsa pritet të mbahen edhe disa aktivitete të tjera gjatë ditës, kulmuar me shfaqjen e baletit “Xhulieta pa Romeon”, e cila mbahet në teatrin e qytetit në ora 19:30.



Gjilani inauguron një sallë moderne të edukatës fizike në prag të festave të nëntorit

25
NËNTOR

Në vigjilje të shënimit të festës së 28 Nëntorit, Komuna e Gjilanit ka përruar sot sallën moderne të edukatës fizike në shkollën fillore “Abaz Ajeti”. Në përrurim ka marrë pjesë kryetari Lutfi Haziri, i shoqëruar nga kryesuesja Valentina Bunjaku Rexhepi, nxënës të shumtë e arsimtarë të kësaj shkolle.

“Jam jashtëzakonisht i nderuar që në kuadër të festës së 28 Nëntorit, po e inauugurojmë këtë sallë sportive. Nuk ka ditë më të lumtur se shënimi i ditës së krenarisë. Shkolla fillore “Abaz Ajeti” po bëhet shembull i kompletimit të infrastrukturës dhe ju sot, përveç sallës së sportive, e keni edhe institucionin parashkollor. Komuna do të vazhdojë ta mbështesë çdo program, në mënyrë që

arsimtarët dhe nxënësit të kenë kushte më të mira për punë. Gëzuar për shumë vite, urime “Dita e Flamurit”, ka thënë kryetari Haziri, pas inaugurimit.





Ministrja Kodheli në Kuvendin e Gjilanit: Ditët më të mira ende nuk kanë ardhur për kombin tonë

25
Nëntor

Kuvendi Komunal i Gjilanit ka mbajtur të premten pasdite një seancë solemne për nder të 28 Nëntorit - Ditës së Flamurit, ku ka marrë pjesë edhe Mimi Kodheli, ministre e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë, e shoqëruar nga ambasadori Qemajl Minxhozi, me ç'rast ajo ka mbajtur edhe një fjalë rasti para anëtarëve të asamblesë së këtushme. Valentina Bunjaku-Rexhepi, kryesuese e Kuvendit Komunal, në hapje të kësaj seance ka thënë se 28 Nëntori është një ditë historike për mbarë kombin tonë, e cila e bën të lumtur dhe krenar çdo shqiptar, kudo që jeton.

Ndërkaq, Lutfi Haziri, kryetar i Komunës, duke e përshëndetur ministren Mimi Kodheli, ka thënë se ajo është e lidhur që herët me çështjen e Kosovës. Ardhja e saj në Gjilan, si ministrja e parë e Mbrojtjes që viziton këtë komunë, është mirënjohja më e madhe që u bëhet kryengritësve të kësaj ane, të cilët luftuan për t'i bashkuar shqiptarët, kudo që janë. "Në këtë rrugëtim të pambaruar, tani është detyra jonë ta vazhdojmë luftën me mjete tjera, që idealet e heronjve tanë t'i çojmë përpara dhe t'i bëjmë realitet" ka thënë Haziri. Ministrja Mimi Kodheli, në fjalën e saj para anëtarëve të Kuvendit Komunal në Gjilan, tha se për historinë e kësaj treve të lashtë, që ndodhet në një qoshe të Kosovës, ka pasur mundësi të dëgjojë e mësojë shumë nga

shkrimet e Sami Frashërit, qysh sa ishte në shkollën e Tiranës. Duke hedhur një vështrim mbi gjendjen aktuale të shqiptarëve në Ballkan, ajo tha se ditët e mira nuk kanë ardhur ende për kombin tonë, por që ajo kohë të mos vonohet tepër, ministrja Kodheli ka kërkuar të punohet së bashku. "Në këtë rrugëtim, që do të dëshiroja të ishte fillimi i një epoke tjetër, ne duhet të jemi bashkë në vendimmarrje, sepse kemi për të bërë akoma shumë punë", ka thënë Kodheli. Ajo e ka nënvizuar edhe rolin dhe rëndësinë e faktorit ndërkombëtar në këtë proces, por ka rikujtuar se punët kryesore duhet t'i bëjmë vetë, nëse duam që, siç ka theksuar Kodheli, fëmijëve tanë t'iu sigurojmë një të ardhëm më të mirë. "Ne kemi miq dhe ky është fat i madh për ne, por gjerat kryesore duhet t'i bëjmë vetë dhe ato mund t'i bëjmë vetëm duke qenë së bashku", ka thënë ministrja Kodheli. Duke u ndërlidhur me simbolikën e 28 Nëntorit, ajo tha se një flamur kaq i mirë si yni, nuk gjendet tjetër, edhe sikur t'i rreshtojmë të gjithë flamujt e botës. Përndryshe, paraprakisht, ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, është pritur nga kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, në zyrën e tij, ndërkohë që pas seancës solemne ka vizituar ekspozitën tematike për nder të ditës së flamurit, në galerinë e arteve pamore si dhe ka ndjekur shfaqjen e Trupës së Baletit Kombëtar "Xhulieta pa Romeo", që teatrin e qytetit në Gjilan.



Gjilani shënon të hyra rekorde nga lejet e ndërtimit – mbi 800 mijë euro

24
NENTOR

“Trendet pozitive dhe gatishmëria e qytetarëve të Komunës së Gjilanit për të legalizuar ndërtimet e reja, pajisja me leje ndërtimore, por edhe planifikimi i zonave të reja urbane, implementimi i planeve në terren, monitorimin dhe angazhimin për legalizim të objekteve pa leje më qëllim që gjithçka që ndërtohet në Gjilan të jetë në kuadër të planifikimit dhe kushteve të përcaktuara ndërtimore”.

Kështu ka thënë në konferencën me gazetarë drejtori i Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Valon Shefkriu. Shefkriu ka thënë, gjithashtu, se është një fat shumë i madh që qytetarët e Gjilanit janë të vetëdijësuar dhe fillimisht drejtohen në zyrat e drejtorisë, pastaj fillojnë ndërtimin në terren, konform kushteve dhe pëlqimit urbanistik që i lëshon Drejtoria e Urbanizmit. “Aktivitetet e ndërmarra gjatë kësaj periudhe janë të shumta duke nisur që nga hartimi i planeve rregulluese, miratimi i tyre nga Kuvendi Komunal, pastaj përfundimi i projekteve të zonave mikro urbane si hapësira përcjellëse për banim kolektiv në lagjen “Kamnik”, trotuari përgjatë stacionit të autobusëve, hapësira të xhamia në lagjen “Dardania”, hapësira për banim kolektiv në Bulevardin e Pavarësisë, në rrugën Reshat Ymeri, para Teatrit të Qytetit, hapësirës publike të “Sahat Kulla”, të “Sheshi i Ilegalës”, prapa “Soliterit”, etj., ka thënë drejtori Shefkriu. Ai konfirmoi se

përgatitja e Planit Rregullues të Hollësishëm “Qendra 4”, pa asnjë shpenzim të vetëm financiar, është rasti i parë në nivel të Kosovës që është përgatitur nga ekspertët e tyre. Shefkriu ka informuar se në këtë periudhë kohore kanë marrë aprovimin e Kuvendit të Komunës për disa plane urbanistike dhe implementimin praktik të planeve të miratuara më herët. “Në të hyrat vetanake, Komuna e Gjilanit ka krijuar të hyra rekorde që nga paslufta nga kodi i lejeve ndërtimore me afro 800 mijë euro, ose mbi 163 mijë metra katrorë hapësirë ndërtimore. Kurse, nga legalizimi i objekteve pa leje për këtë pjesë të vitit janë krijuar të hyra në shumën prej rreth 70 mijë euro. Së bashku edhe me të hyrat tjera nga kode të ndryshme në kuadër të kësaj Drejtorie në total janë 851 mijë e 846 euro, ose 100 për qind realizim i planifikimit për vitin 2016 vetëm për nëntë muaj të punës gjatë këtij viti”, ka deklaruar i pari i Urbanizmit në Gjilan. Sektori i Inspeksionit, sipas Shefkriut, ka ndikuar që këto të hyra të jenë në këtë nivel, me monitorimin dhe me angazhimin konkret në terren, duke bërë që vendimet për rrënim, ato për ndërprerje të punimeve, inicimi i procedurave për kundërvajtje dhe shqiptimi i gjobave të ndikojnë në rritjen e këtyre të hyrave gjatë vitit 2016. Përkushtimi i stafit të Drejtorisë është në nivelin më të lartë të mundshëm dhe gjithçka po punohet në baza profesionale dhe sipas planifikimit vjetor.

Në infrastrukturë, deri më tani, janë investuar mbi 5.2 milionë euro



23
Nëntor

“Investimet në infrastrukturën publike të Komunës së Gjilanit nga mjetet vetanake dhe nga grandet qeveritare, janë mbi 5.2 milionë euro, për periudhën janar - shtator 2016, dhe atë mbi 24 kilometra asfaltim, 15 kilometra rrjet të ri të kanalizimit, mbi 10 kilometra trotuare, 1500 metra katrorë hapësirë dhe sheshe dhe rreth 20 kilometra sanime të rrugëve. Kur llogarisim pjesën e mbetur të vitit, del që këto shifra do të ndryshojnë edhe më shumë, gjithnjë në favor të ndërtimeve shtesë të infrastrukturës publike”, ka thënë në konferencën me gazetarë, drejtori i Shërbimeve Publike, Infrastrukturës dhe Banimi, Naser Korqa.

Korqa ka bërë të ditur se për këtë periudhë të udhëheqjes së tij me këtë dikaster të rëndësishëm të Komunës së Gjilanit, të gjitha kërkesat e qytetarëve janë shqyrtuar me kujdesin e veçantë, gjithnjë në kuadër të krijimit të kushteve më të mira për qytetarët e Gjilanit, me trajtimin e barabartë të zonës së qytetit dhe zonave rurale, pavarësisht se ku ato kanë qenë. “Me kohë janë bërë

intervenimet në lumenj duke bërë pastrimin e tyre, që janë eliminuar në masë të madhe vërshimet, por edhe përgatitjet e përgjithshme në funksion të investimeve në infrastrukturën publike, duke përfshirë asfaltimet e rrugëve, rrjetit të kanalizimeve, ujësjellësit, trotuareve, ndriçimit, sanimeve, mirëmbajtjes së hapësirave publike në përgjithësi, por edhe shumë punë të tjera që janë në domenin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, duke përfshirë përgatitjet e dokumentacionit për investime e deri tek shërbimet ditore që ofrohen nga ky resor”, ka thënë drejtori Korqa. Ai ka pohuar se e gjitha kjo është bërë falë mbështetjes së madhe dhe angazhimit edhe personal të kryetarit të Komunës, Lutfi Haziri, dhe kështu është arritur në shumë lagje dhe fshatra të ndërtohet infrastruktura, për herë të parë që nga ekzistimi i këtyre vendbanimeve që nga Karadaku, deri në Malësinë e Zhegocit dhe deri në fshatrat në kufi me Komunën e Kamenicës, siq është fshati Dobërqqan, apo fshatrat e brezit kufitar me Bujanocin dhe Preshevën.



Qeverisja lokale dhe Bashkësia Islame në Gjilan marrin pjesë në gurthemelin e xhamisë

23

NËNTOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri, ka pritur në një takim pune myftiun e Kosovës, Naim Tërrnava me bashkëpunëtorë.

Haziri, në një konferencë me gazetarë, pas takimit, ka thënë se bashkëpunimi ndërinstytucional është temë e përhershme mes dy institucioneve. Haziri ka dhënë mbështetjen e tij edhe sa i përket ligjit për bashkësitë fetare të cilin e ka cilësuar si "interesi i përbashkët i të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës", duke thënë se ligji duhet të përputhet me interesat e Bashkësinë Islame, që është institucioni fetar më i vjetër në Kosovë dhe si i tillë ka nevojë të ketë qartësi edhe në ligj dhe akses nuk duhet të lejohet konfuzitet apo mundësi për

sektarizma dhe ndarje të pa nevojshme. Kryetari Haziri në këtë takim ka përmendur edhe angazhimin që Komuna e Gjilanit ka bërë në hapjen e rrugës ligjore për ndërtimin e xhamisë në lagjen "Baleci", sikur që ka përmendur edhe angazhimin konkret në zgjidhjen e kontesteve pronësore dhe lëshimin e lejes së ndërtimit të objekteve fetare. Kurse, myftiu i Kosovës, Naim Tërrnava, tha se gatishmëria e kryetarit Haziri për të bashkëpunuar, është një lehtësi e madhe për ecjen tonë përpara drejt realizimit të planifikimeve të BIK-ut. "Për problemet e pronës, infrastrukturës publike dhe aspektet tjera, Komuna e Gjilanit, me kohë ka marrë të gjitha hapat e nevojshëm dhe gjithçka është gati për ndërtimin e xhamisë në lagjen "Baleci". Mbështetja e kryetarit dhe mesazhi i tij për

ligjin për bashkësitë fetare në Kosovë, është mesazh i mbështetjes për të gjitha komunitetet fetare. BIK-u, me kohë ka shfaqur brengën lidhur me disa nene të këtij ligji, që nëse aprovohen kështu siç janë, do të shkojnë në dëm të çështjes nacionale dhe kombëtare në Kosovë, sepse mbetet e hapur pastaj mundësia e grupimeve të ndryshme, të sekteve të ndryshme dhe bashkësive të reja, që do të shkojnë në dëm të ardhmërisë së vendit, por edhe

në dëm të ardhmërisë së përbashkët edhe ndërfaqetare.”Toleranca ndërfaqetare ka ekzistuar me shekuj dhe është amanet nga të parët tanë që ta ruajmë deri në përjetësi”, ka thënë Tërrnava. Pas konferencës, kryetari i Komunës dhe myftiu i Kosovës, me bashkëpunëtorë, kanë vënë gurthemelin e xhamisë në lagjen “Baleci”.





Haziri: Fshati punëtor i Llashticës po rikthen prodhimet tradicionale të ushqimit

23
Nëntor

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i shoqëruar nga drejtori i Bujqësisë, Ramiz Ramadani me bashkëpunëtor, kanë vizituar sot familjen Berisha nga fshati Llashticë, familje e cila pos angazhimit të fuqishëm në bujqësi si traditë, ka bërë investimin edhe në fermën për rritjen e zogjve për furnizimin e qytetarëve me mish, por edhe investimin tjetër të “magjes” për gatimet e ndryshme të brumit me receta të vjetra qindra-vjeçare, por me kushte moderne.

Kryetari Haziri gjatë vizitës në këtë familje, ka thënë se Llashtica si një fshat me përkushtim të madh në punën e bujqësisë, ka marrë hapa të tjerë tutje, duke rikthyer “magjes” e produkteve të gatuar nga mielli i grurit dhe misrit, dhe duke sjellë për qytetarët recetat e vjetra tradicionale. “Familja Berisha dhe të gjitha familjet në Llashticë janë sinonim i punës së madhe të tokës

bujqësore. Angazhimi në fermën për rritjen e zogjve të mishit, por edhe kthimit të “magjes” së pasur me receta të vjetra, janë një dëshmi që tradicionalja dhe modernia, kanë të përbashkët kulturën dhe suksesin por edhe vendosmërinë e pse jo edhe leverdinë materiale. Inkurajoj edhe familje të tjera të vazhdojnë me ide të tilla dhe rritje të veprimtarive, ngase vetëm me bujqësinë është e mundur të krijohen vendet e reja të qëndrueshme të punës. Komuna e Gjilanit në këtë rast do të përkujdeset në krijimin e infrastrukturës publike si kanalizimin, rrugët dhe aspektet tjera publike deri edhe në subvencionim nëse është e nevojshme si dhe investime tjera për këtë fshat”, ka thënë ndër të tjerash kryetari Haziri. Haziri ka thënë të shpresoj që Ministria e Bujqësisë do ta mbajë premtimin për pagesën e mjeteve për programin e mbështetjes dhe stimulimit të bujqësisë dhe zhvillimin e saj. Kurse,

Komuna e Gjilanit do të jetë mbështetëse në të gjitha format dhe mundësitë buxhetore. Ndërsa në emër të familjes ka folur Liridon Berisha, i cili ka thënë se gjithçka është e mundur me një përkushtim dhe vendosmëri, sepse produktet e tilla qytetari i kërkon vazhdimisht dhe sipas tij tregu është i sigurt për produktet e tilla cilësore. "Shpresojmë që Ministria e Bujqësisë të realizojë mbështetjen që është zotuar në vlerën 65 për qind për fermën. Kapacitetet e fermës janë deri në 10 mijë zogj, si produkt i freskët. Të punësuarit do të jenë katër punëtorë të përhershëm dhe angazhimin e punëtorëve

shtesë stinorë, kurse angazhimi në "magje" për prodhimin e produkteve tradicionale nga mielli i grurit dhe misri, është në një numër më të madh, por ajo është në fazën përfundimtare dhe po punojmë që shumë shpejt të futemi në prodhim. Risitë që ka në vete "magjja" për prodhimin e recetave të vjetra tradicionale shqiptare datojnë qindra vjet më parë dhe të gjitha janë përgatitur t'i sillen qytetarit në këtë shekull të ri", tha ndër të tjerash Berisha, duke iu falënderuar Komunës së Gjilanit për interesimin dhe mbështetjen e ofruar nga kryetari Lutfi Haziri.



Komuna dhe banorët e Llashticës debatojnë për investimet në infrastrukturë



22
NËNTOR

Në kuadër të debateve publike të organizuara nga kryetari i Komunës së Gjilanit, është mbajtur debate me qytetarë në fshatin Llashticë dhe me këshillin e këtij fshati, të kryesuar nga Ekrem Hasani, ku është debatuar kryesisht për investimet në infrastrukturën publike për këtë fshat dhe lokalitetet për rreth.

I pranishëm në këtë debat ishte nënkryetari i Komunës, Rexhep Kadriu, i shoqëruar nga drejtori i Bujqësisë, Ramiz Ramadani, drejtori i Shërbimeve Publike, Naser Korqa dhe drejtori i Shëndetësisë, Nexhat Hajrullahu, të cilët iu kanë përgjigjur qytetarëve lidhur me shqetsimet e tyre por edhe kërkesat që i drejtuan qeverisjes lokale. Nënkryetari Rexhep Kadriu, është shprehur se qëllimi i këtyre takimeve që po bëhen nën përkujdesjen e kryetarit Haziri, është që t'i marrim drejtpërdrejt kërkesat, me synim të ngritjes së mirëqenies së qytetarëve, duke filluar nga infrastruktura publike. "Llashtica është njëri nga fshatrat që është në përkujdesje të vazhdueshme të qeverisë

Haziri sa u përket investimeve. Gjithnjë ka hapësirë për më mirë. Këtu kemi ardhur që t'i marrim të gjitha kërkesat tuaja në mënyrë që t'i fusim në prioritet tona për investimet në vitin 2017. Projekti i parë gjatë vitit 2017 për fshatin Llashticë do të jetë investimi i kanalizimit, reabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe funksionalizimin e tij e më pas edhe investimi i rrugicave nëpër fshat. Gjithashtu nuk do të mbetet aspak më keq edhe investimi në fushat tjera siç janë trotualet, investimet në shkollë dhe hapësirën e shkollës por edhe një përkujdesje për intervenim tek varrezat e fshatit", ka përfunduar fjalën e tij nënkryetari Kadriu. Me pyetje dhe kërkesa është paraqitur Bekim Ibishi, Hjrush Bajrami, etj., të cilët kryesisht u interesuan për infrastrukturën publike, mundësitë më të mëdha për investime dhe trajtimin e barabartë të gjithë fshatit Llashticë. Për të gjitha pyetjet është përgjigjur nënkryetari dhe drejtorët e drejtorive komunale, varësisht nga natyra e problematikës sqë shtrohej.



Haziri mbështet organizimet shqiptare në diasporë dhe bashkëpunimin me Gjilanin

22
NËNTOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur sot në një takim pune përfaqësuesit e Unionit të Shoqatave Shqiptare në Suedi, nën kryesimin e Agim Bellës, të shoqëruar nga Agim Bërdynaj, zëvendës ministër i Arsimit, me të cilët ka bashkëbiseduar për mundësinë e bashkëpunimit mes Komunës së Gjilanit dhe mërgatës shqiptare në shtetin e Suedisë, shtet ky mik i Republikës së Kosovës.

Në këtë takim kryetari Haziri është shprehur i gatshëm për vazhdimin e bashkëpunimit të Komunës së Gjilanit, me Unionin e Shoqatave Shqiptare në Suedi, por edhe me mërgatën në përgjithësi, me qëllim të ruajtjes, kultivimit dhe afirmimit të vlerave kulturore, artistike, shkencore e intelektuale.

Haziri pos tjerash ka thënë se Komuna e Gjilanit ka një përqindje të lartë të banorëve të saj në botën perëndimore, kryesisht në Zvicër, Gjermani, Francë, në vendet skandinave, gjithandej nëpër Evropë dhe deri në Amerikë,

Kanada dhe shtete të shumta gjithandej botës, që shprehur në përqindje del se këto shifra janë mbi 33 për qind. "Numër i madh i qytetarëve të Gjilanit jetojnë në mërgatë. Gjilani është përherë falënderues për mbështetjen që ata japin vazhdimisht për Kosovën dhe për Gjilanin në veçanti. Aktivitetet e ndryshme do të vazhdojnë përherë në Gjilan, dhe urat lidhëse të bashkëpunimit institucional asnjëherë nuk do të shpëputen, por çdo herë do të forcohen edhe më shumë", ka thënë mes tjerash kryetari Haziri në fjalën e tij. Ndërsa, nga ana e tij, në emër të delegacionit, Ahmet Bella, nga Unioni i Shoqatave shqiptare në Suedi, ka thënë se në kuadër të këtij unioni janë të përfshirë një numër i madh i organizimeve shqiptare, që në përgjithësi ky numër arrin në rreth 70 shoqata të ndryshme. Gjithashtu Bella është shprehur falënderues për gatishmërinë e Komunës që të bashkëpunojë përmes projekteve të ndryshme në aspektin e organizimeve kulturore, artistike, shëndetësore, sportive, arsimore etj., në mënyrë që mërgata të jetë pjesë e agjendës shtetërore të Republikës së Kosovës.



Viti 2016, më i suksesshmi për Gjilanin që nga pas lufta për të hyrat buxhetore

21
NENTOR

“Bazuar në shifrat të cilat i ka Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Gjilanit, sa i përket të hyrave vetanake nga Tatimi në Pronë, por edhe nga të hyrat tjera në buxhetin e Komunës së Gjilanit, del se ky vit është viti më i suksesshëm buxhetor për Gjilanin që nga periudha e pas luftës”, ka thënë në konferencën për gazetarë, drejtori i Drejtorisë Komunale për Buxhet dhe Financa, Zijadin Maliqi.

Në prezantimin e tij, drejtori Maliqi, tha se falë angazhimit të fuqishëm të stafit të drejtorisë dhe mbështetjes së kryetarit të Komunës, Lutfi Haziri, fokusin kryesor e kanë pasur tek të hyrat vetanake, por edhe një disiplinë të fuqishme sa i përket shpenzimit të parasë publike. “Drejtoria e Buxhetit është angazhuar gjatë gjithë kohës në gjenerimin e të hyrave vetanake, konform planit vjetor për vitin 2016. Falë këtij angazhimi deri në këtë fazë është arritur që të bëhet përmbushja e këtij planifikimi, e cila shprehur në numra, del të jetë mbi 96 për qind të planifikimit vjetor, apo 19 për qind tejkalim të planit për periudhën e kaluar të vitit. Sa i përket të hyrave, për këtë

periudhë kohore, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, është bërë tejkalim për mbi 62.5 për qind”, tha drejtori Maliqi, duke bërë të ditur se ky angazhim i stafit të Drejtorisë do të vazhdojë përherë me dinamikë edhe më të shtuar. Ai më tej ka përmendur edhe përgatitjet që janë bërë gjatë këtij viti për planifikimin buxhetor, së bashku me qytetarët, përmes dhjetëra dëgjimeve publike, deri në përpilimin përfundimtarë të buxhetit të vitit 2017 dhe planifikimin e hershëm për periudhën 2018 - 2019. Pos tjerash, i pari i Drejtorisë së Buxhetit, Zijadin Maliqi, ka dhënë edhe informacione shtesë sa i përket informimit të qytetarëve lidhur me rrjedhën e parasë publike, shpërndarjen me kohë të faturave të Tatimit në Pronë, por edhe për angazhimin e përditshëm të stafit në zotimin e lëndëve, shpenzimet, certifikimin dhe arkivimin e lëndëve. “Pos angazhimeve në bazë të ligjit, është impresionues për neve edhe raporti i Auditorit Gjeneral që përfshinë periudhën e 2015, ku pos tjerash Gjilani në aspektin e financave në këtë Drejtori, ka marrë vlerësime shumë pozitive, të cilat na obligojnë të jemi edhe më të përkushtuar”, ka përfunduar Maliqi.



Haziri: Po të ishte gjallë shkencëtari Xhavit Ahmeti, Kosova do të ishte ndryshe

21
NËNTOR

Komuna e Gjilanit ka shënuar sot 20-vjetorin e ndarjes tragjike nga jeta të prof. dr. Xhavit Ahmeti. Fillimisht, kryetari Lutfi Haziri me bashkëpunëtorët kanë bërë homazhe tek varri i tij në Prishtinë, për të vazhduar tek lapidari në Përlepnice të Gjilanit.

"20-vjetori i ndarjes nga jeta të profesorit, shkencëtarit dhe kimistit më të madh të regjionit, jo vetëm të Kosovës dhe këshilltarit të presidentit Rugova, shënon ditën më të rëndë për gjilanasit, për Përlepniceën e për shqiptarët kudo që janë. Nuk ka fjalë që e përshkruan personalitetin e një njeriu çfarë ka qenë Xhavit. Ka qenë njeri i afërt, i buzëqeshur, i gatshëm gjithmonë që t'iu ndihmojë njerëzve", ka thënë Haziri pas homazheve. "Mbi të gjitha, ka qenë veprimtar i madh. Besoj shumë që po të ishte gjallë, Kosova do të ishte ndryshe. Me pjesëmarrjen aktive e si ministër në hije i presidentit Rugova për çështje të arsimit, por edhe si deputet i Gjilanit në Parlament, ai

do të bënte shumë më shumë dhe shumë më ndryshe se ne që jemi sot gjallë. Ne jemi krenarë që e kemi njohur dhe emri i tij skalitet sot në gjimnazin ku ka mësuar ai. Një njeri i tillë, nuk lind shpesh. Ne do të ecim rrugës së tij dhe këshillave të tij. Lavdi e përjetshme jetës dhe veprës së tij", është shprehur Haziri. Në emër të familjes ka folur vëllai i profesor Ahmetit, Qemajli, i cili tha se prezenca e kryetarit Haziri dhe strukturave komunale në këtë përvjetor, ua bënë më të lehtë dhembjen. "I falënderoj të gjithë pjesëmarrësit që janë sot këtu në ditën përkujtimore për vëllain tim. Në veçanti, falënderoj kryetarin Lutfi Haziri dhe delegacionin e Komunës. Për neve është një ditë e rëndë që po e shënojmë 20-vjetorin e vdekjes së vëllait tonë, por prezenca e këtyre njerëzve, e kreut të Komunës, na e bënë më të lehtë dhembjen", tha Ahmeti. Në fund, në shkollën fillore "Skënderbeu" në Përlepnice është mbajtur një orë letrare kushtuar kolosit të shkencës, prof. dr. Xhavit Ahmetit.

Ambasadori i Çekisë falënderon kryetarin Haziri për partneritetin e shkëlqyer

21
NËNTOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur sot në takim ambasadorin e Republikës së Çekisë në Kosovë, Ivo Šilhavý. Kryetari Haziri e ka falënderuar ambasadorin Šilhavý për bashkëpunimin mes shkollës "Liria" në Pogradjë dhe shkollës "Valleticka" në Pragë në shkëmbim të përvojave dhe njohurive mes vete.

"Ambasadori Šilhavý po e viziton Komunën e Gjilanit pas një vizite në shkollën fillore "Liria" në Pogradjë. Kjo formë e bashkëpunimit mes shkollës "Liria" dhe asaj "Valleticka" në Pragë dhe vetë interesimi dhe mbështetja e pakursyer e ambasadorit, neve na bënë të nderuar si gjilanas, si Komunë dhe si qytetarë sepse ndihma iu shkon fëmijëve, shkollës, arsimtarëve dhe prindërve drejtpërdrejt në ndarjen e përvojave dhe njohurive në marrjen e shumë informacioneve që sot Europa i ka. Republika Çeke ndan shumë vlera kulturore të Europës së

vjetër dhe të Europës së re", ka thënë Haziri pas takimit. Ambasadori i Republikës së Çekisë në Kosovë, Ivo Šilhavý, pasi ka falënderuar kryetarin Haziri për pritjen, ka theksuar se është shumë i kënaqur me bashkëpunimin e Komunës dhe të nxënësve të shkollës "Liria" në Pogradjë dhe shkollës "Valleticka" në Pragë. "Falënderoj kryetarin Haziri për mikpritjen. Unë jam shumë i kënaqur që e kemi një bashkëpunim të mirë me Gjilanin, përkatësisht me shkollën fillore "Liria" në Pogradjë, e cila ka partneritet me shkollën "Valleticka" në Pragë. Këtë vit e kemi nënshkruar memorandum për bashkëpunim dhe mund të them se për gjysmë viti është një bashkëpunim i shkëlqyer. Nxënësit e kanë një uebfaqe të përbashkët dhe aty publikojnë gjëra që bashkëpunojnë në largësi. Mezi s'po presin të takohen mes vete. Nxënësit e shkollës "Valleticka" në vitin e ardhshëm do ta vizitojnë shkollën "Liria" dhe anasjelltas", ka deklaruar ambasadori i Çekisë në Kosovë, Ivo Šilhavý.





Haziri: Mekanizmi Referues, trupë në shërbim të sigurtisë së qytetarëve

21
NËNTOR

Në takimin e rregullt të mbajtur sot të Mekanizmit Referues është diskutuar për hapat e ardhshëm të këtij mekanizmi dhe për funksionalizimin e plotë të kësaj trupe për parandalim, vlerësim dhe identifikim të hershëm të rasteve që mund të përfshihen në akte të cilat shpijnë në ekstremizëm, radikalizëm dhe terrorizëm.

Pjesëmarrës në këtë takim ishte edhe kryetari i Komunës, Lutfi Haziri dhe përfaqësuesi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Lulzim Fushtica, të cilët potencuan rëndësinë e angazhimit permanent të kësaj trupe, në krijimin e sigurtisë së përgjithshme për qytetarët e Komunës së Gjilanit. “Në këtë mekanizëm, anëtarët janë nga të gjitha institucionet duke nisur nga policia e shtetit, prokuroria, arsimi, shëndetësia, rinia, enti i punësimit, qendra për punë sociale dhe institucione e organizime të ndryshme shoqërore. Angazhimi im është i përhershëm dhe do të vazhdoj të jem gjithmonë në takimet e Mekanizmit, në mënyrë që të jemi edhe më mirë të organizuar në parandalim, identifikim dhe adresim të rasteve even-

tuale, por edhe informim në përgjithësi”, ka thënë kryetari Haziri. Ai ka potencuar rëndësinë që ka kjo trupë në sigurtinë e përgjithshme të qytetarëve të Gjilanit, duke qenë të mbështetur edhe nga nivelet më të larta institucionale duke përfshirë Ministrinë e Punëve të Brendshme, OSCE, Ambasadën Amerikane, UNDP, etj. Edhe, Lulzim Fushtica, nga MPB, ka thënë se ky është Mekanizmi i vetëm Referues në nivel të vendit që trajton drejtpërdrejtë problemet e kësaj natyre, duke qenë gjithnjë nën koordinimin e MPB-së duke u dëshmuar që vërtetë po punohet në këtë drejtim. Fushtica, poashtu, ka paralajmëruar edhe ngjarjet të cilat e presin Mekanizmin Referues, por edhe aktivitetet që do të ndërmerren karshi nevojës për të punuar në këtë drejtim si dhe në ngritjen e kapaciteteve për anëtarët e këtij Mekanizmi. Në këtë takim u theksua se Gjilani si Komunë që tashmë është pjesë e “Strong Cities Netëork Global”, po punon me vendosmëri që detyrat të cilat i ka si anëtarë, t’i përmbushë vazhdimisht, që nga niveli lokal të parandalohet përhapja e ekstremizmit të dhunshëm apo çfarëdo rasti që përfshinë ekstremizmin, radikalizmin apo terrorizmin.



Lutfi Haziri: Rruga Gjilan–Bujanoc po bëhet sipas standardeve europiane

20
NENTOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, me bashkëpunëtorë, ka vizituar sot punimet në asfaltimin e fazës së parë të rrugës hyrëse dhe dalëse Gjilan-Bujanoc, për të cilën tha se po bëhet sipas standardeve europiane.

“Është projekti kryesor i hyrje-daljes Gjilan-Bujanoc. Jemi në fazën finale të realizimit të punimeve të lotit të parë, e cila kap vlerën më të madhe të investimeve. Ky projekt përfshinë jo vetëm asfaltimin, por edhe ndërtimin e rrugës, trotuareve, ndriçimin e ri, rrjetin e ri të rrymës, ujërat atmosferik dhe tretmanin e ujërave të zeza. Kjo rrugë, e plotëson kërkesën e kësaj zone dhe eliminon nevojën që në të ardhmen me pasur investime. Pavarësisht që dikush dëshiron t’i qes pikë të zezë, kjo rrugë po bëhet sipas standardeve europiane. Përkundër problemeve pronësore dhe rrjetin nëntokësor që ka qenë

i vjetruar, ne kemi arritur që ta përfundojmë dhe shumë shpejt do të bëhet inaugurimi”, ka thënë Haziri. Kryetari Haziri tha se po punohet me dinamikë të madhe në infrastrukturë gjithandej territorit të Komunës, në qytet e fshatra. “Sot, për kohëzotim ka filluar edhe ndërtimi i rrugës prej Nasalës në drejtim të Remnikut. Po ashtu, do të fillojë ndërtimi i rrugës së Kosaqës, që janë investime të përbashkëta me Ministrinë e Infrastrukturës, pastaj, ndërtimi i rrugës “Sadulla Brestovci, tek “Tregu i Gjellbërt”, ndërtimi i rrugëve në Llashticë, Lladovë, Malishevë e Epërme dhe e Poshtme, Pogragjë dhe vendbanimeve tjera”, ka deklaruar kryetari i Gjilanit. Kreu i Gjilanit ka paralajmëruar që pas përfundimit të kësaj rruge, do të fillojnë me hapjen e rrugës Gjilan-Ferizaj dhe Gjilan-Prishtinë, të cilat do të realizohen me financim të BERZH-it dhe Ministrisë së Infrastrukturës.

Për nëntë muaj, Gjilani ka ofruar mbi 400 mijë shërbime shëndetësore

18
NËNTOR

“Mbi 400 mijë shërbime shëndetësore janë dhënë për qytetarët e Gjilanit nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, QMF-të dhe AMF-të për këtë vit”.

Me këtë informatë e ka nisur konferencën për media drejtori i QKMF-së “Dr.Nagip Rexhepi” në Gjilan, Fejzulla Berisha, i cili ka paraqitur një kronologji të të arriturave dhe sfidave gjatë nëntë muajit të punës. “Në fillim të vitit në bashkëpunimin mes Komunës së Gjilanit, MSH-së dhe Caritas Kosova, është bërë pranimi i një numri të caktuar të punëtorëve shëndetësorë, me ç’rast është përmirësuar dukshëm shërbimi shëndetësor, është bërë ngritja e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve dhe kujdesit shtesë për familjet në nevojë në gjithë hapësirën e Gjilanit. Gjatë muajit shkurt është emërtuar QKMF me emrin e doktorit Nagip Rexhepi. Po ashtu, gjatë këtij viti kemi filluar zbatimin e statutit të ri të aprovuar nga Kuvendi komunal, duke pasuar me aktivitetin tjetër për kontrollet sistematike për nxënësit e shkollave fillore të Komunës së Gjilanit, duke përfshirë nxënësit e klasave të para, pesta dhe të nënta dhe rezultatet do të publikohen së shpejti”, ka thënë drejtori Berisha, në adresimin para gazetarëve. Ai ka përmendur konferencën “Vizitat shtëpiake dhe përkujdesja e nënës dhe fëmijëve”, të mbajtur këtë vit nën organizimin dhe mbështetjen e UNICEF-it, Komunës së Gjilanit dhe Ministrisë së Shëndetësisë. “Tashmë ky program ka filluar së aplikuari me një staf të përgatitur në aspektin profesional dhe ky program është duke funksionuar normalisht me vizitat shtëpiake të përkujdesjes së nënës dhe fëmi-



jës”, ka thënë Berisha. Ai ka informuar se në investimet publike dhe në infrastrukturë janë bërë ndryshime të mëdha duke u krijuar kushte komode për trajtimin dhe ndihmën që jepet për pacientët e Komunës së Gjilanit dhe më gjerë. “Falë përkrahjes së madhe të parzervë të kryetarit të Komunës, Lutfi Haziri, kemi arritur që për dy vjet të investojmë dhe përmirësojmë infrastrukturën në 95 për qind të objekteve shëndetësore, në një vlerë prej rreth 200 mijë euro”, tha ai. Drejtori i QKMF-së në Gjilan ka bërë të ditur se edhe sa i përket furnizimit me barna dhe material tjetër harxhues nga lista esenciale e Ministrisë së Shëndetësisë qëndrojnë mjaftë mirë, duke shtuar se vetëm me insulinë është bërë furnizimi i mbi 1 mijë pacientëve të rregullt, për të vazhduar edhe me dhënien e vaksinave kundër gripit sezonal për moshat e caktuara. “Kujdestaria dhe ndihma e shpejtë janë 24 orë në shërbimin e pacientëve, ndërsa qendrat tjera shëndetësore në kuadër të shëndetësisë primare, kanë punuar sipas orarit të përcaktuar gjithnjë duke marrë për bazë, kërkesat e qytetarëve dhe nevojat”, ka nënvizuar ai.

Lajm tjetër të mirë për nivelin primar të shëndetësisë, Berisha ka dhënë edhe për hapjen e procedurave të prokurimit për ndërtimin e objektit të ri të QKMF-së. “Ndërkaq, aktivitetet tjera kanë vazhduar për edukimin, promovimin dhe mbështetjen e qytetarëve të cilët kanë kërkuar ndihmën e mjekut, sikur që janë shënuar edhe të gjitha ditët ndërkombëtare me aktivitete simbolike në kuadër të promovimit të një jete të shëndoshë për të gjithë qytetarët e Gjilanit”, ka përfunduar drejtori Berisha, pasi u është përgjigjur të gjitha pyetjeve të gazetarëve.



Zymberi: Komuna e Gjilanit me përkushtim maksimal i trajton rastet sociale

17
NËNTOR

Drejtori i Qendrës për Punës Sociale në Gjilan, Mursel Zymberi, në konferencën e sotme e për media, ka thënë se puna në këtë sektor ka vazhduar me përkushtim të lartë në mbështetjen e rasteve sociale, të familjeve pa kulm mbi kokë, të fëmijëve jetimë, fëmijëve të braktisur, por edhe angazhim tjetër në aspektin e këshillimeve, riintegrit, trajtimit, raportimit të rasteve të dhunës në familje.

Ai tha se gjatë kësaj periudhe janë shpërndarë disa mijëra pako ushqimore për familjet në nevojë, me të cilat është arritur që të stabilizohet sadopak gjendja e rëndë në shumë familje. Po ashtu, Zymberi ka thënë se edhe sa i përket asistencës në pagesën e qirave mujore, të renovimit dhe ndërtimit të shtëpive për familjet të cilat jetonin në shtëpi të degraduara është vazhduar dhe tashmë kemi një numër të konsiderueshëm të shtëpive të ndërtuara, nga iniciativa “Pak nga ne, shumë për ata”, por ende nevojat janë të mëdha dhe kërkojnë veprim të menjëhershëm. Ndërsa, siç ka thënë ai, sa i përket dhunës në familje dhe aspektet tjera, ka një lëvizje pozitive

në raportimin e tyre, raste të cilat pastaj menjëherë trajtohen në bazë të ligjit duke u kujdesur për gjetjen e mundësisë së përmirësimit të raporteve dhe tejkalimin e konfliktit të dhunës si një fenomen negative i shoqërisë në familje në përgjithësi. Ai nuk ka lënë pa përmendur edhe rastet e delikuencës, përfshirja e fëmijëve në punë të rënda, rastet në rritje të shkurorëzimeve krahasuar me periudhën e njëjtë. “Të gjitha këto raste që janë adresuar në Qendrën për Punë Sociale i kemi trajtuar në mënyrën më profesionale të mundshme. Tashmë prej kohës zyrtarët e QPS-së, janë shqyrtuesit dhe trajtuesit e rasteve të ndryshme nga aspekti social dhe ekonomik. Kemi numër të madh të fëmijëve të përfshirë në kryerjen e punëve të rënda, raste të raportimit janë duke i paraqitur, sikur që edhe fëmijë pa prindër, braktisje të fëmijëve dhe raste të tilla”, tha Zymberi. Drejtori i QPS-së në Gjilan ka nënvizuar se problemet e shumta të cilat janë me epilog të dhunës në familje, braktisje të fëmijëve, shkurorëzime, por edhe raste të njëjta të kësaj natyre janë trajtuar me kujdes të veçantë dhe me synimin që kjo të kthehet në normalitet.

Mbi 90 mijë euro subvencione për rastet sociale, shoqatat dhe familjet e dëshmorëve



16
NËNTOR

Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale e Komunës së Gjilanit ka njoftuar se për këtë vit ka dhënë subvencione për çështje sociale, barëra e shoqata në shumën prej mbi 90 mijë eurove. Në konferencën për media, drejtori Nexhat Hajrullahu ka prezantuar të arriturat gjatë kësaj periudhe, në sektorin e shëndetësisë, duke përfshirë edhe atë të mirëqenies sociale.

“Me vullnetin e donatorëve dhe të qeverisë Haziri po vazhdojmë me ndërtimin e shtëpive, ku kemi arritur t'i përfundojmë 38 dhe presim të fillojmë edhe me ndërtimin e gjashtë shtëpive tjera, si dhe kemi meremetuar mbi 40 shtëpi, derisa po vazhdojmë me pagesën e qirasë për 47 familje”, tha Hajrullahu. Hajrullahu ka thënë se janë 496 kërkesa për strehim drejtuar komisionit “ad hoc”, nga të cilat 176 për ndërtim të shtëpive, 130 për meremetim dhe përfundim të shtëpive, 122 për qira, 5 shtëpi të djegura, 34 kërkesa për pronë për ndërtim shtëpie, dhe 27 kërkesa për banesa sociale. Në sferën shëndetësisë primare, ai ka informuar se kanë arritur të përmirësojnë cilësinë e shërbimeve, duke shtuar se kanë arritur një

mbulueshmëri maksimale të terrenit si me ambulanca ashtu edhe me ekipet në terren. “Kemi angazhuar tri ekipe, Emergjencën, Ekipin për Vizita Familjare si dhe Ekipin e Trajnuar për Nëna dhe Fëmijë”, tha ai. Sa i përket inspeksionit sanitar, drejtori i DSHMS-së tha se kanë vazhduar me kontrollime dhe inspektimin e subjekteve tregtare ushqimore, subjektet hoteliere, institucioneve parashkollore dhe ato shkollore e institucione private shëndetësore. “Gjatë këtij nëntëmujori janë zhvilluar 120 kontrollime, janë lëshuar 54 procesverbale, 7 pëlqime sanitare, janë shqiptuar 26 dënime mandatore për ligjin anti-duhan, dhe janë shqiptuar 18 fletëparaqitje të tjera”, tha ai. Si pjesë e rëndësishme e punës në kuadër të DSHMS-së, drejtori Hajrullahu ka përmendur Zyrën për Ujë, e cila në vazhdimësi ka monitoruar dhe ka përcjellë kualitetin e ujit të pijshëm. Në fund të konferencës së sotme me gazetarë, drejtori i këtij dikasteri, Nexhat Hajrullahu, ka përmendur edhe punët që janë kryer në QKMF, AMF e QMF, sikurse edhe në Qendrën për Punë Sociale, të cilat priten të prezantohen në detaje nga përgjegjësit në ditët në vazhdim.



Komuna e Gjilanit ka investuar në Bresalc mbi 300 mijë euro

15
NËNTOR

Nën përkuqdesjen e kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, është mbajtur mbrëmë debati publik me banorët e Bresalcit, për t'i dëgjuar kërkesat e hallet e tyre. Takimin e ka hapur kryetari i Këshillit të fshatit, Haxhi Kurti, i cili tha se që nga paslufta Bresalci ka qenë i anashkaluar sa u përket investimeve, duke shtuar se nën qeverisjen e kryetarit Haziri, gjërat kanë ndryshuar dukshëm.

“Për tri vite janë ndërtuar më shumë se 4 kilometra asfalt, mbi 10 kilometra kanalizim, është investuar shumë edhe në ndriçimin publik. Shpresojmë se me këtë ritëm do të vazhdohet”, ka thënë Kurti. Ndërkaq, nënkryetari Rexhep Kadriu është shprehur se qëllimi i këtyre takimeve që po bëhen nën përkuqdesjen e kryetarit Haziri është që t'i marrim drejtpërdrejt kërkesat, me synim të ngritjes së mirëqenies së qytetarëve, duke filluar nga infrastruktura. “Bresalci është njëri nga fshatrat që është në përkuqdesje të vazhdueshme të qeverisë Haziri sa u

përket investimeve. E kemi bërë një zyre jashtëzakonisht të mirë, kemi bërë punë të jashtëzakonshme kryesisht në infrastrukturën nëntokësore që kapin shifrën e mbi 300 mijë eurove, kemi ndërtuar shumë rrugë. Këtu kemi ardhur që t'i marrim të gjitha kërkesat tuaja në mënyrë që t'i fusim në prioritet. Zotim i kryetarit është që Bresalcit t'ia kthej dinjitetin”, ka deklaruar para qytetarëve nënkryetari Kadriu. Me pyetje e kërkesa janë paraqitur Habib Sylja, Makfire Kurti, Ymer Muji, Bardhyl Sylja, Muhamet Ymeri, Gafurr Sylja etj., të cilat kryesisht kishin të bënin me ato infrastrukture, ndërkaq u është përgjigjur nënkryetari Kadriu, drejtori i Bujqësisë, Ramiz Ramadani, ai i Shërbimeve Publike, Naser Korça, drejtori i Shëndetësisë, Nexhat Hajrullari, i Kadastrit, Sadudin Berisha dhe drejtori i DZHE-së, Agim Zuzaku. Në fund të debatit, përfaqësuesit komunalë kanë paralajmëruar se shkolla e këtij fshati në verën e vitit 2017 do të hyjë në renovim total.

Kadriu: Në Gjilan vërshimet janë menaxhuar në mënyrën më të mirë



15
Nëntor

“Drejtorja për Mbrojtje dhe Shpëtim është në gjendje gatishmërie 24 orë me kapacitete të plota në raste të intervenimit, por gjithashtu në bazë të planit për preventivë dhe intervenim, kemi arritur që të jemi në çdo cep të Gjilanit në kohën optimale dhe gjithnjë në mbrojtje të jetës së qytetarit dhe gjithashtu në mbrojtje të pasurisë private e publike”, ka rrumbullakuar drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim, Ensar Kadriu, në konferencën e sotme për media.

Kadriu, para gazetarëve, ka bërë prezantimin e punës 9-mujore të kësaj Drejtorie, duke theksuar se reshjet e fundit janë menaxhuar në mënyrën më të mirë. “Aktiviteti i Drejtorisë gjatë reshjeve të fundit pos tjerash ishte organizuar edhe në parandalim të daljes së lumenjve nga shtrati i tyre, që përditë e më shumë kjo problematikë po eliminohet, falë pastrimit dhe investimit nëpër lumenjtë e Gjilanit që ka bërë komuna në vazhdimësi. Kjo është kryer në bazë të vlerësimit të rreziqeve që kemi prezantuar gjatë vitit të kaluar e të cilat në një masë të madhe janë eliminuar, megjithëse, mbetet ende punë për t’u bërë në këtë drejtim”, ka thënë drejtori Kadriu. Ai konfirmuar intervenimin që kanë bërë në disa raste si në fsha-

tin Shillovë, fshatin Velekincë dhe disa raste të vogla, mirëpo problemet po vazhdojnë të shkaktohen sipas tij kryesisht nga moskujdesi i disa qytetarëve në hedhjen e mbeturinave rreth lumenjve. Kadriu, në organizimin e punës në këtë dikaster, ka falënderuar gatishmërinë dhe bashkëpunimin që kanë me Forcën e Sigurisë së Kosovës, Policinë e Kosovës, “Hidromoravën”, Kryqin e Kuq e institucionet tjera relevante. “Edhe sa i përket zjarreve, është menaxhuar mjaft mirë me situatën falë kampanjave të shumta për parandalimin e përhapjes së zjarreve dhe ky vit është më mirë se sa viti i kaluar në këtë aspekt. Përfundimisht, kemi shënuar rënie të rasteve të zjarrit dhe sigurisht kjo është arritur me mbështetjen edhe nga shumë Drejtori të tjera që vlen të theksohet qëllimi i përbashkët i angazhimit për më pak zjarre”, ka thënë mes tjerash drejtori i DMSH-së. Drejtori Kadriu ka bërë të ditur edhe punën që është bërë në parandalimin e rrezikut për jetë që mund të shkaktohej nga objektet e vjetruara nëpër qytet, e që statika e tyre e qëndrueshmërisë është rrezik për qytetarin. “Falë identifikimit me kohë, tashmë është bërë eliminimi i disa objekteve të cilat kanë qenë rrezik për qytetarët”, përfundoi Kadriu.

Gagica: Kemi avancuar me projekte që nuk kanë ndodhur në historinë e Administratës së Gjilanit



14
NËNTOR

Administrata e Përgjithshme e Komunës së Gjilanit ka bërë hapa të mëdhenj në funksion të digjitalizimit dhe modernizimit të shërbimeve për qytetarët, gjë që deri më tani nuk mbahet mend në historinë e Gjilanit një ndryshim kaq i madh, me qëllimin e vetëm që qytetari të jetë i informuar për çdo gjë dhe për të gjitha procedurat që duhet ndjekur deri në marrjen e një shërbimi apo produkti të shtetit.

Kështu është shprehur drejtori i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme në Gjilan, Nazim Gagica, gjatë konferencës së sotme për media, ku ka paraqitur punën nëntë mujore. “Digjitalizimi i shërbimeve ka karakterizuar këtë nëntëmuor të Administratës së Përgjithshme, me projekte e programe të shumta në mbështetje të vazhdueshme edhe nga kryetari i Komunës, Lutfi Haziri. Pas projektit me produkte shpesh në E-kiosqe, produkteve online, hapjen e zyrave të shërbimeve të drejtpërdrejta, këtyre ditëve ka filluar implementimi i projektit “Gjilani Smart City”, dhe kështu deri në këtë kohë është projekti që qytetari i krijon lidhje të drejtpërdrejta me Komunën,

Drejtorinë, apo zyrtarin konkret. Gjithashtu, përmes këtij programi qytetari i jepet mundësia që dirket në një kohë optimale të shkruaj kërkesën, ankesën, informatën etj. Në adresë të komunës dhe e njëjta orientohet automatikisht në drejtorinë apo resorin përkatës”, ka thënë drejtori Gagica. Ai theksoi se për më pak se një javë pune të këtij programi në adresë të Komunës janë drejtuar 120 ankesa, 20 raportime, mbi 50 vlerësime për zyrtarët komunalë, ku mbi 80 për qind pozitive dhe mbi 200 shkarkime të këtij aplikacioni. Sipas drejtorit Gagica kjo periudhë karakterizohet pos tjerash edhe me ulje të shpenzimeve dhe njëkohësisht rritje të shërbimeve për qytetarët. “Në autoparkun e Komunës ka ulje të shpenzimeve për veturat zyrtare, si dhe rritje të shërbimeve. Është bërë e mundur me një menaxhim të monitoruar vazhdimisht që veturat zyrtare të përdoren gjithnjë me kujdes të shtuar dhe vetëm me qëllim të angazhimit në punë konkrete”, ka përfunduar ai, duke theksuar ndryshimet e mëdha që kanë ndodhur në përgjithësi në Administratën e Përgjithshme dhe komoditetin për qytetarët.

Gjilani fillon rikonstruktimin e varrezave të qytetit

14

NËNTOR

Komuna e Gjilanit ka nisur sot implemetimin e projektit të rikonstruimit dhe konservimit të varrezave të qytetit, i cili po bëhet me financim të Komisionit European dhe me implementim të UNDP-së. Nënkryetari i Komunës, Rexhep Kadriu, i cili mori pjesë në fillimin e punëve të këtij projekti, ka thënë se përveç tjerash, do të hiqen rrethojat e reja dhe me këtë po krijohet hapësira të varrimit edhe për dy vite.

“Sot po fillojmë implemetimin e projektit të rikonstruktimit dhe konservimit të varrezave të qytetit. Me anë të këtij projekti, do të heqen rrethojat e vjetra dhe do të vendosen rrethoja të reja, sikurse edhe shtigjet për vizitë të familjarëve për qytetarët që pushojnë këtu. Do të ketë hapësira gjelbëruese dhe porta hyrëse të domosdoshme. Po ashtu, do të eliminohet edhe kanali i ujërave atmosferik,

i cili ka shkaktuar probleme jashtëzakonisht të mëdha. Me rrethojën e re, ne do të krijojmë hapësirë të varrimit edhe për dy vite. Në emër të kryetarit Haziri e falënderoj Komisionin European, UNDP-në dhe kryetarin e Bashkësisë Islame për përkrahjen e madhe”, ka thënë Kadriu. Ndërkaq, kryetari i Bashkësisë Islame në Gjilan, Naim Aliu, ka thënë se së bashku me Komunën janë dakorduar që ky financim të bëhet pikërisht në varreza. “Vlerësimet tona janë se përfitues të këtij projekti janë bashkësitë fetare dhe Komuna. Ne si Bashkësi Islame e kemi gjetur bashkëpunim me Komunën e Gjilanit dhe jemi dakorduar që ky financim të jetë në varreza. E falënderojmë Komisionin European dhe UNDP-në për këtë projekt kaq të rëndësishëm”, ka thënë Aliu. Implementimi i këtij projekti kap shumën e mbi 150 mijë eurove, ndërkaq pritet të përfundohet deri në fund të këtij viti.





Rastet e uzurpimeve në Gjilan gjatë vitit 2016 janë minimale

11
NËNTOR

Drejtori i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Sadudin Berisha, ka thënë se ka pranuar rreth 6 mijë kërkesa nga qytetarët, ndërsa prej tyre janë kryer mbi 5 mijë e 800 lëndë.

Pos tjerash, sipas Berishës, ky dikaster i rëndësishëm ka kryer edhe punë të shumta sipas detyrës zyrtare, ndër- sa një lajm i mirë është se rastet e uzurpimeve këtë vit janë minimale dhe të gjitha janë tashmë kanë vendimet për procedurat administrative. Drejtori i Kadastrit ka thënë se ky resor sipas detyrës zyrtare ka lëshuar mbi 15 mijë certifikata, duke përfshirë ato të pronësisë, të gjendjes ekonomike, kopjeve të planit etj., por edhe punë dhe angazhime të shumta e që qytetari ka kërkuar zgjidhje zyrtare të kërkesave, lëndëve apo procedurave të ndryshme zyrtare. “Në këtë periudhë kohore janë lëshuar afro 10 mijë certifikata të pronësisë, rreth dy mijë certifikata të gjendjes ekonomike, mbi 2 mijë kopje të planeve, gjithashtu është bërë edhe përcaktimi i kufijve për t’u hapur rrugë projekteve të shumta të Gjilanit në infrastrukturë publike që nga shtretërit e lumenjëve, rrugëve, por edhe projekteve që parashohin ndërtimin e çerdheve, shkollave, institucioneve shëndetësore, por

edhe sociale. Angazhim në matje është bërë edhe në parcelimin e ngastrave për vendosjen e trafave elektrike, e me theks të veçantë matjeve të bëra në rrugët Gjilan - Prishtinë, pastaj Kompleksit të Dëshmorëve, si dhe nga ky dikaster janë ofruar informata të ndryshme edhe për institucionin e Policisë së Kosovës, Gjykatave nga nivele të ndryshme, institucioneve lokale dhe atyre qendrore në përgjithësi”, ka thënë Berisha, derisa numëronte punët e kryera dhe angazhimet e stafit të kësaj drejtorie. I pari i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Gjilan ka nënvizuar se kërkesa për mbi 22 mijë metra katror është dërguar në AKP për largimin e tyre nga procedurat e privatizimit, hapësira këto të ish-Ndërmarrjeve Shoqërore, me qëllimin e vetëm që të ruhet interesi publik para së gjithash, sepse tashmë aty janë të ndërtuara objekte dhe hapësira të ndryshme shëndetësore, arsimore, rekreative, sportive, kulturore etj. Po ashtu, drejtori Berisha ka bërë thirrje tek qytetarët që të aplikojnë për rregullimin e marrëdhënieve pronësore-juridike dhe njëkohësisht ka kërkuar prej tyre që t’i denoncojnë rastet e uzurpimeve, duke garantuar që KGJKP do të ndërmerr hapat e menjëhershëm për rikthimin e saj.

Gjilani me projekte milionëshe në arsim për vitin 2016



10
NENTOR

Drejtoria e Arsimit, respektivisht, U.D. e drejtorit, Shqipe Kastrati Haziri, ka mbajtur sot konferencë për media ku ka dhënë detajet rreth punës, angazhimeve dhe zhvillimeve që kanë ndodhur në këtë dikaster crucial për Gjilanin dhe të ardhmen.

Ajo në fjalën e saj ka përmendur projektet të cilat janë realizuar dhe janë në proces të realizimit në këtë dikaster, duke nisur që nga Partneriteti Publiko Privat, e deri tek investimet e qeverisë së Kosovës, donatorëve dhe mjeteve vetanake të Komunës së Gjilanit. "Projektet në fushën e drejtorisë së arsimit janë të shumtë dhe me një vlerë të lartë kapitale. Kompleksi i Shkollave të Mesme dhe investimi i rregullimit të kësaj hapësire ka bërë fillimi i këtij projekti të jap rezultate të prekshme në kuadër të planit të Drejtorisë. Gjithashtu, finalizimi i projektit të shkollës në fshatin Shurdhan me financim të Komisionit Europian. Pastaj, në proces të punimeve janë edhe shkolla e re e Arteve dhe e Muzikës, ndërtimi i dy sallave të edukatës fizike, që financohen nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë", ka pohuar U.D. Kastrati Haziri. Ajo një falënderim të veçantë ka drejtuar edhe ndaj donatorëve që janë fuqishëm prezentë në

Gjilan përmes investimeve milionëshe. "Falë mbështetjes së madhe që kemi nga donatorët e konkretisht nga USAID-i, është duke u ndërtuar aneksi i shkollës fillore në Ponesh, objekti i ri i çerdhes në lagjen "Dardania" si dhe janë ndërruar rekuizitat e jashtme në çerdhet "Ardhmëria II" dhe "Bozhur" në Shillovë. Poashtu, me donatorin tjetër Caritas-in e Zvicrës është bërë furnizimi me inventar për 8 klasat parashkollore në shkollat fillore të Gjilanit. Edhe donatori tjetër, organizata gjermane GIZ-i ka organizuar trajnimet për mësimdhënës të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta", ka thënë në fjalën e saj drejtoresha e Arsimit në Gjilan. Ajo ka përmendur edhe donacionet tjera të ardhura në shkollat e Gjilanit, përkatësisht nga Komuna e Bursës në Turqi, 456 projektorë dhe pajisje të tjera, sikur që është organizuar trajnimi për 15 nxënës të cilët tashmë kanë përfunduar trajnimin nga shkolla profesionale e teknikës. Drejtoresha e DKA-së në Gjilan, Shqipe Kastrati-Haziri, ka përmendur në prezantimin e saj edhe ndarjen e bursave për 69 studentë, sikur që bëri të ditur pajisjen për profilin e mehatronikës për shkollën e mesme teknike "Mehmet Isai", në një vlerë prej 120 mijë euro.

Ramadani: Gjilani ka subvencionuar mbi 4 mijë fermerë gjatë këtij viti



9

NËNTOR

Konferenca e radhës për sot ishte nga dikasteri i Bujqësisë së Gjilanit, respektivisht nga drejtori Ramiz Ramadani, i cili në prezantimin e tij ka thënë se angazhimi që nga stafi i Drejtorisë me kulmimin e mbështetjes së kryetarit Lutfi Haziri, ka bërë që sektori i bujqësisë si fushë e punësimit të jetë model për gjithë Kosovën.

Ai tha se vetëm gjatë këtij viti Gjilani i ka subvencionuar më shumë se 4 mijë fermerë. Që nga janari e deri më tani, projektet për sektorin e bujqësisë janë të pandalshme dhe që të gjitha në kuadër të zhvillimit të Gjilanit, që më së miri arrihet përmes investimit dhe përkushtimit në fushën e gjerë dhe mundësitë e mëdha që jep bujqësia, ka pohuar drejtori Ramadani, duke paralajmëruar, po ashtu, që projektet dhe programet për bujqësinë janë të vazhdueshme. “Pranverën e kemi filluar me projektin e mjedresës ku janë përzgjedhur 39 përfitues me sipërfaqe prej 10 hektarë, në një vlerë financiare prej 60 mijë euro. Pastaj subvencionimi i mbjelljeve pranverore në vlerë prej rreth 15 mijë euro”, ka bërë të ditur drejtori Ramadani. Më tej ai ka përmendur projektin e një rëndësie të veçantë, atë të ndërtimit të serrave, projekt i cili kap një shifër prej mbi 23 mijë euro. Drejtori Ramadani ka thënë se bashkëpunimi me donatorët vetëm në fushën e bujqësisë Gjilanit i ka sjellë mbi 100 mijë euro investime, duke nisur që nga mbështetja e 56 fermerëve me mekanizim bujqësor, prej organizatës gjermane “HELP”,

pasta “TIKA” me pajisje bujqësore, financimi i projekteve nga BE dhe Care International dhe shumë donatorë të tjerë, të cilët, janë partnerë të fuqishëm në rrugën e përbashkët të zhvillimit të bujqësisë. “Projekti i mbjelljes së mjedresës, serrat, mini-gradet për fermerë, pajisjet bujqësore, bimët aromatike, centrifugat elektrike, makinat elektrike, mekanizimi bujqësor janë disa nga aktivitetet e përbashkëta të realizuara me donatorët dhe fermerët. Dhe kur i shtojmë kësaj angazhimit për korrije shirje, financimin e mbjelljeve pranverore dhe atyre vjeshtore vlera rritet gjithnjë e më shumë”, ka shtuar drejtori Ramadani. “Të gjithë sektorët në Komunën e Gjilanit janë potencial i fuqishëm i zhvillimit. Pemëtaria dhe perimtaria, mbeten ende mundësi të mëdha për fermerin gjilanas. Kapacitetet e vlerësuara përpunuese dhe prodhuese dëshmojnë se mjedra dhe rritja e sipërfaqeve me vishnje, janë mundësi të mëdha për bujkun e kësaj Komune, që me mbështetjen e USAID-it, kjo do të jetë më e lehtë dhe mundësi shumë e madhe për një ndryshim të gjendjes në këtë drejtim”, ka thënë në fjalën e tij Ramadani. Ndryshe, të suksesshëm sipas drejtorit të Bujqësisë dhe Pylltarisë, janë treguar edhe sektori i Pylltarisë dhe sektori i Inspeksionit për Bujqësi dhe Veterinari. Vlerësimi dhe merita përfundimtare sipas drejtorit Ramadani, janë meritë e drejtpërdrejtë e kryetarit Lutfi Haziri, i cili është pjesë e projekteve të shumta të sjella në Gjilan dhe në tokën e fermerit të Gjilanit.



Zuzaku: Ardhja e projekteve milionëshe në Gjiçan, meritë e kryetarit Haziri


8

NËNTOR

Komuna e Gjiçanit, ka nisur sot ciklin e tretë të konferencave për këtë vit, ku për çdo ditë do të mbahen konferenca për media, si praktikë e drejtpërdrejtë e informimit të publikut në baza të rregullta, lidhur me punën që bëjnë organet komunale, duke përfshirë këtu ekzekutivin-drejtoritë komunal dhe legjislativin, përkatësisht përfaqësuesit e subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës.

I pari në këtë raund të konferencave ishte Agim Zuzaku, Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, i cili ka elaboruar punën e bërë në këtë dikaster duke përmendur projekte, programe e aktivitete të shumta që kanë ndodhur në Gjiçan. Zuzaku ka thënë se vetëm të hyrat nga jashtë, konkretisht përmes donatorëve, duke mos përfshirë këtu buxhetin e Komunës dhe Qeverisë së Kosovës, Gjiçanit i kanë dhënë dhe po i japin mbi 9.7 milionë euro dhe kur i shtohen edhe investimet e Komunës së Gjiçanit, dhe ato të qeverisë së Kosovës, kjo shifër pothuajse dyfishohet, ndërsa, numri i të punësuarve është mbi njëmijë në sektorë të ndryshëm. Sektori privat në Gjiçan është punëdhënësi më i madh për qytetarët e Gjiçanit dhe ky trend përditë e më shumë po shënon vlera pozitive dhe inkurajuese për angazhim në shërbim të rritjes së bizneseve. “Gjatë këtij viti kanë përfituar rreth 400 biznese në forma të ndryshme, pastaj janë realizuar 2 panairë me qëllim të promovimit dhe mbështetjes së bizneseve siç ka qenë panairi “Gjiçani 2016”, dhe panairi i makinave “Auto-Shou”, ku pjesës ishte një numër i konsiderueshëm i bizneseve dhe mërgimtarëve nga diaspora. Gjithashtu në kuadër të planifikimit të drejtorisë janë realizuar edhe dy forume B2B (Biznes me Biznes) me qëllim të promovimit të mundësisë së madhe për investime në

Gjiçan”, ka thënë drejtori Zuzaku. Ai më tej ka theksuar edhe bashkëpunimin me donatorë, që siç është shprehur ai projektet, programet dhe investimet e shumta të sjella në Gjiçan kanë vetëm një emërues të përbashkët, angazhimin maksimal të kryetarit Lutfi Haziri. “Politika e kryetarit Lutfi Haziri, vendosmëria e tij dhe angazhimi për një zhvillim të hovshëm të Gjiçanit, pos tjerash kanë rezultate konkrete. Kemi për këtë periudhë kohore investime të shumta, donator, programe e projekte të cilat që të gjitha janë për një zhvillim të qëndrueshëm, mbështetje të sektorit privat dhe krijim të kushteve më të mira për qytetarët dhe kjo është bërë falë punës dhe angazhimit maksimal të kryetarit Lutfi Haziri. Kështu nga organizata “Help” kanë përfituar rreth 50 biznese me grante të drejtpërdrejta, përmes Komisionit Evropian rreth 30 të tjera, pastaj përfitimi i nxënësve, studentëve dhe bizneseve me punë praktike dhe angazhim të tyre nëpër ndërmarrje të ndryshme, mbështetjen e ndërmarrjeve për gjenerim të qëndrueshëm të vendeve të punës etj”, pohoi drejtori Zuzaku duke qenë falënderues për të gjithë ata që Gjiçanit po i japin mbështetje. “Nuk mund të lë pa përmendur organizatën “Help”, programin e EURED financiar nga BE, ARDA-në (Asociacionin e Agjencive për Zhvillim Rajonal), pastaj KfE-në Gjermane, Partneritetin Publiko-Privat të shkollat e mesme, projektin “Gjiçani Riciklin”, programin Kosova e Bukur, angazhimin e madh me investime të USAID-it, TiK-as Turke, Caritas-it, mbështetjen e qeverisë së Kosovës, atë Austriake për kredinë afatgjatë për trajtim të ujërave të zeza, lumenjve dhe impiantit përmes programit “Soft Loan” dhe shumë projekte, programe dhe donator të pa ndarë të Gjiçanit”, ka përfunduar ai në këtë pjesë.



Komuna e Gjiçanit, prej sot edhe në IOS dhe Android

7 nëntor 2016 / Komuna e Gjiçanit njofton qytetarët se është funksionalizuar në tërësi programi Gjiçani Smart City, përmes të cilit mund t'i gjejnë të gjitha informacionet më të rëndësishme për dhe rreth Komunës. Prej të hënës, qytetarët mund ta shkarkojnë programin Gjiçani Smart City në dy sistemet operative, IOS dhe Android.

Ky projekt krijon një lidhje të drejtpërdrejt me qytetarin e komunës së Gjiçanit, e bënë pjesë të qeverisjes, duke e rritur kështu në shkallë të lartë transparencën dhe efikasitetin në Komunë.

Projekti përfshinë shërbimet komunale në fushën e ekonomisë, arsimit, sigurisë dhe shëndetësisë etj., ndërkaj të gjitha të dhënat qytetari i Gjiçanit i ka në xhepin e tij dhe do të raportoj direkt menaxhmentin e lartë të Komunës për ankesat e kërkesat e mundshme dhe natyrisht këto do të shkojnë direkt edhe te kryetari i Komunës, Lutfi Haziri. Përndryshe, projekti inovativ "Gjiçani Smart City" është i pari në rajon i kësaj natyre. Për më shumë klikoni në: www.gjilani-smartcity.com.



Haziri: Gjilani kaloi një muaj jashtëzakonisht të rëndë si pasojë e suspendimit të zyrtarëve të akuzuar nga prokuroria

5
NËNTOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, në konferencën e jashtëzakonshme me gazetarë, ka nënvizuar sfidat e mëdha që po përballen si pasojë e suspendimit të dhjetëra zyrtarëve, pas aktakuzës së fundit të prokurorisë, në të cilën janë të përfshirë 39 zyrtar së bashku me ish-kryetarin.

“Komuna e Gjilanit ka kaluar në një muaj jashtëzakonisht të rëndë sepse është ngritur një aktakuzë për krim të organizuar ndaj 39 zyrtarëve dhe ish-kryetarit. Si pasojë e vendimit të prokurorisë, ne është dashur të ndërmarrim veprime serioze e konkrete në mënyrë që suspendimi i zyrtarëve komunalë që janë shërbyes civilë, të mos krijoj zbrazëtira të mëdha. Dua të konfirmoj se dinamika e punës dhe objektivave tona, ka rënie deri në pikën që është dashur të mobilizojmë angazhim shtesë të ekipit që ta balancojmë këtë mungesë të numrit të madh të

punëtorëve. Po e ripërsëris, derisa nuk kemi vendim të gjykatës, ne i trajtojmë të gjithë të pafajshëm”, ka thënë Haziri. Ai paralajmëroi se javën e ardhshme pritet të plotësohen dhe të standardizohen disa nga pozitat, që administrata komunale do t’i zëvendësoj përkohësisht punëtorët, në veçanti tek prokurimi, urbanizimi dhe shërbimet publike.”Sidoqoftë, ligji është mbi të gjithë. Ne nuk mund ta lakojmë në asnjë mënyrë tjetër, pos ta respektojmë dhe të përballemi me realitetin. Kemi ndërmarrë hapa konkret. Kemi kërkuar nga Ministria përkatëse për të na e dhënë mundësinë dhe javën e ardhshme do të shpallim konkurs për plotësimin gradual të vendeve të punës në tre resorë të rëndësishëm”, tha ai. I pari i Gjilanit ka paralajmëruar se shumë shpejt do të ndodhë reformatimi i qeverisjes komunale për të përmirësuar efikasitetin.”Nëntë mujori si pjesë e punës është blloku ku

ne kemi marrë shënime, kemi bërë vlerësime dhe do të ndërmarrim veprime konkrete në përmirësimin e efikasitetit të shërbyesve civil dhe të drejtorëve drejtpërdrejt. Ndryshimet faktike do ta prekin bordin e drejtorëve pas ndryshimit të statutit”, ka thënë kryetari Haziri. Haziri ka përmendur sukseset në sektorin e bujqësisë, ku tha se mbi 4 mijë fermerë kanë përfituar grante nga Komuna në bashkëpunim me donatorët dhe Ministrinë e Bujqësisë, ndërkaq në administratë tha se janë dhënë mbi 10 mijë shërbime, duke përmendur edhe projektin e rëndësishëm “Smart City”, nëntë programet në kuadër të “E-ki-osqet”. Në sektorin e urbanizmit, kreu i Gjilanit tha se kemi të hyra rekorde nga lejet e ndërtimit, apo mbi 740 mijë euro, përderisa në Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë theksoi se për herë të parë është kryer rievimi i objekteve publike komunale në zonat rurale, si : shkolla, biblioteka, Qendra të Mjekësisë Familjare, zyre të ofiqarisë, qendra të kulturës, objekte sportive etj, për të vazhduar me punët në shërbimet publike.”Gjatë kësaj periudhe kemi mbi 5.2 milionë euro investime në infrastrukturë që përfshinë rrugët, kanalizimin, ujësjellësin, ndriçimin, trotualet, e parqet. Investimet I kemi bërë pa dallim, në fshatra e qytete. Shikojeni sot “Lagjen e Vishnjeve” se si e kemi ndryshuar rrënjësisht. Nga një lagje të harruar e për të cilën janë përdorë terminologji ofenduese, sot Komuna e ka standardizuar jetën e banorëve, e ka integruar atë lagje me pjesën tjetër të qytetit, duke mos lejuar asnjë lloj diskriminimi”, ka thënë Haziri. Kreu i Gjilanit tha se të hyrat vetanake gjatë këtij vitit janë impressive, apo 3.6 milionë euro. Për arsimin, kryetari i Gjilanit ka ripërsëritur se vazhdon të mbetet prioriteti i parë i qeverisjes, derisa ka përmendur ndarjen e bursave për 69 studentë, ndërtimin e kampusit të shkollave të mesme, ndërtimin e shkollës “Bajram Curri” në Shurdhan, ndërtimin dy sallave të edukatës fizike, “Abaz Ajeti” dhe “Liria” - Pogragjë, ndërtimin e aneksit të shkollës fillore në Ponesh, ndërtimin e çerdhes në lagjen Dardania etj.”Të gjitha këto dhe projekte tjera janë bërë me partneritet të shkëlqyer me Komisionin European, USAID, Caritasin zviceran, qeverinë e Austrisë e qeverinë gjermane, të cilët i falënderoj shumë për besimin e madh ndaj nesh”, është shprehur Haziri. Tek sektori i Zhvillimit Ekonomik, i pari i gjilanasve tha se kemi trend pozitiv në regjistrimin e bizneseve të

reja, përderisa theksoi se për nëntë muaj janë krijuar mbi 1 mijë vende të reja pune nga partneritete të ndryshme me donatorët, duke shtuar se më shumë se 400 biznese kanë përfituar në forma të ndryshme.”Është realizuar me sukses Panairi Regjional “Gjilani 2016”, Panairi i makinave “Auto-Shoë”. Në bashkëpunim me organizatën gjermane “Help”, 46 mikro-biznese janë përfitues të granteve, me nga 2 mijë euro, të cilët, janë kryesisht zejtarë të Gjilanit. Valorizimi i tregtisë tradicionale dhe potenciali socio - ekonomik, ky program ka shpërndarë 28 grante në vlerë prej 2 mijë euro për zejtarët. Nga marrëveshja me KfË, Komuna e Gjilanit përfiton mbi 1 milion euro, që do të investohen në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Gjilanit. Këtu duhet përmendur edhe ndërtimin e parkut në lagjen “Dardania”, i cili dëshmuar të jetë tejte i rëndësishëm”, ka deklaruar kryetari Haziri në adresimin para gazetarëve. Në konferencën e sotme të jashtëzakonshme për media, kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, tha se e bënë krenar fakti që pas mbrëmjes humanitare janë ndërruar 36 shtëpi për familjet në nevojë, 38 familjeve po ua paguajnë qiratë, derisa 40 familjeve po ua rinovojnë shtëpitë. Ai tha se gjatë kësaj periudhe janë rinovuar të gjitha qendrat shëndetësore, 1121 familjeve po i jepet asistencë sociale, duke shtuar se mijëra gjilanas që iu kanë drejtuar shëndetësisë primare, kanë marrë shërbime profesionale. I pyetur nga gazetarët lidhur me vendimin e gjykatës, e cila e hedhë poshtë aktakuzën ndaj tij, kryetari Haziri tha se “vendimet e gjykatës është mirë të mësohemi që të mos i komentojmë”. “Unë vetëm mund ta konfirmoj se deklarata ime se ato janë vetëm pretendime të prokurorisë, ka dalë të jetë e vërtetë sepse s’ka pasur asnjë fakt në ato pretendime sa i përket parkingjeve”, tha kryetari Haziri. Në fund të konferencës, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, tha se do të ketë tolerancë zero për të gjithë operatorët që nuk i kryejnë punët sipas dinamikës së paraparë.”Drejtorët komunalë do të zgjedhin mes meje dhe operatorëve. Ose do të vazhdojnë të hënën të punojnë nëse i zbatojnë detyrat drejtpërdrejt sipas kërkesës sime, ose duhet t’i lajmërojnë operatorët që kanë vonesa dhe të fillojmë zbatimin e detyrës ligjore- listat e zeza për operatorët e papërgjegjshëm”, ka përfunduar Haziri.



Lutfi Haziri e Jonuz Musliu takim për bashkëpunim ndërkuftar

4

NËNTOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur sot në një takim të rregullt pune kryetarin e Këshillit Kombëtar nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja, njëherësh edhe kryetar i Kuvendit të Komunës së Bujanocit, Jonuz Musliu, me të cilin kanë biseduar në kuadër të bashkëpunimit të rregullt, për kushtet e jetës që i kanë shqiptarët në Kosovën Lindore, për arsimin, shëndetësinë, sigurinë, punësimin, integrimin dhe vendimmarrjen në procese të ndryshme dhe me interes për komunitetin shqiptar atje.

“Komunikimi dhe angazhimi ynë është i përbashkët në të gjitha fushat që na lidhin Komunën e Gjilanit me Kosovën Lindore, si dhe mbështetjen e dhënë për banorët e asaj pjese të cilët tashmë janë në numër të konsiderueshëm, në biznes, arsim, shëndetësi dhe jetën kulturore e shoqërore në përgjithësi. Politikat qeveritare besojmë shumë që do të ndryshojnë sa i përket kërkesave që kanë qytetarët e asaj pjese, duke u dhënë më

shumë hapësirë dhe vëmendje në lëmi të ndryshme shqiptarëve tanë atje”, ka thënë kryetari Haziri, gjatë këtij takimi. Ai më tej ka potencuar edhe bashkëpunimin e mirë që është duke vazhduar sa i përket Zyrës për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc, por edhe bashkëpunimit në Kuvendin e Komunës ku përfaqësuesit me prejardhje nga ajo anë, përherë janë konstruktiv dhe në shërbim të zhvillimeve të gjithmbarshme në Gjilan. Kurse nga ana e tij kryetari Musliu, ka falënderuar kryetarin Lutfi Haziri për angazhimin e përhershëm në shërbim të interesit të shqiptarëve të Kosovës Lindore. “Kemi fatin që të kemi takime të shumta mbështetëse dhe këshilluese. Problem mbetet edhe më tutje në arsim, shëndetësi, buxhetim minimal të ndarë për zhvillimin ekonomik dhe infrastrukturor për këto tri Komuna. Presim që politika në Prishtinë dhe Tiranë karshi Beogradit, ta ketë në planin e saj çështjen e shqiptarëve të Kosovës Lindore”, tha Musliu.

Komisioni për Buxhet dhe Financa lavdëron Gjilanin për efikasitet



4

NËNTOR

Grupi Punues i Komisionit për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Republikës së Kosovës në përbërje të Safete Hadergjona – zëvendëskryesuese, Besa Gaxherri dhe Labinota Demi, kanë vizituar sot Gjilanin, ku janë pritur nga kreu i Komunës, Lutfi Haziri me bashkëpunëtorët. Qëllimi i takimit ka qenë për marrjen e komenteve nga komunat për plotësim/ndryshimin e Ligjit për Partneritetet Publike-Private.

Kryetari Lutfi Haziri i uroi mirëseardhje dhe i njoftoi për projektet të cilat janë investuar përmes partneritetit publiko privat në Komunën e Gjilanit. Haziri tha se këtë vit kemi realizuar një projekt përmes PPP-së për kampusin e shkollave të mesme përmes formës kontraktuale, që është një storie e suksesit për të gjitha komunat e

Kosovës, sikurse që ka përmendur edhe partneritetin në kuadër të "Ecohigjienës". Gjilani është në fazën përgatitore të studimit të fizibilitetit, ku në të ardhmen pritet të shpallen disa projekte investive të cilat do të ofrojnë shërbime më të mira për qytetarët si, stadiumi i qytetit, palestrat e sportit, parkingjet, çerdhet etj", tha Haziri. Nga ana e tyre, anëtarët e Grupit Punues i Komisionit për Buxhet dhe Financa, kanë falënderuar Komunën e Gjilanit, për siç thanë "kthimin e përgjigjeve në afat rekord". Drejtori për Zhvillim i Gjilanit, Agim Zuzaku, ka kërkuar nga Grupi Punues që me plotësim ndryshimin e ligjit të eliminohen procedurat burokratike, të merren parasysh investimet në tre nivele dhe të mos vlerësohen njësoj projektet multi milionëshe të qendrës me ato komunale, si bie fjala te Kampusi i shkollave të mesme.



Amandamentimi i ligjit për rininë, merret edhe mendimi i Gjilanit

3

NËNTOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, me bashkëpunëtor, ka pritur sot në një takim pune, Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, në përbërje nga Sali Morina, Ismail Kurteshi, deputet të Kuvendit të Kosovës, dhe Shoqëria Civile, Driton Selmanaj me bashkëpunëtor të tyre, ndërsa qëllimi i takimit ishte zbatimi i deritanishëm i ligjit për rininë, konkretisht fokusi në buxhetin, vullnetarizmin, aktivitetet dhe kërkesat eventuale për plotësim apo ndryshim të ligjit për rininë.

Kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, ka thënë se përkundër vështirësive të mëdha në aspektin buxhetor në nivelin lokal, përmes subvencioneve dhe projekteve të përbashkëta është arritur që të ketë një organizim të mirë të rinisë në Gjilan. "Ligji kur është miratuar në fillim, ka pasur qëllim funksionimin dhe organizimin e rinisë në nivelin lokal, në mënyrën më të mirë të mundshme. Gjithashtu edhe për KVRL-të është menduar në fillim të përgatitjes së këtij ligji së bashku edhe me përfshirjen e organizatave jo-qeveritare. Në Gjilan ka aktivitete të shumta që për bazë kanë fokusin ndaj rinisë dhe organizatave rinore, duke zgjeruar edhe më shumë angazhimin për përfshirjen edhe të rinisë shkollore dhe organizatave

studentore", tha kryetari Haziri. "Sot rinia ka objektin e vet për aktivitete, një objekt modern që i plotëson kushtet e rinisë, përfshirë këtu edhe sistemimin e KVRL-së, rrjetit rinor dhe po punohet që edhe organizatat shkollore dhe ato studentore të shfrytëzojnë atë hapësirë. Në aspektin e buxhetit kemi mbështetur projektet përmes subvencioneve konform kërkesave të Njesisë së Rinisë duke rritur buxhetin për vitin 2016 qind për qind. Ky ligj duhet të ndryshoj në precizimin e moshës dhe rritjen e saj, pastaj edhe KVRL-të duhet të bëhet një ndryshim në to, ngase është një organizim fiktiv shumicën e kohës, përpos momenteve dhe kohës së caktuar kur aktivizohen", ka thënë ndër të tjerash kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri. Ndërsa komisioni parlamentar është interesuar kryesisht dhe në përgjithësi për ligjin dhe zbatimin e tij, për vullnetarizmin, për aktivitetet e ndërmarra nga Njësia për Rini dhe Komuna e Gjilanit, për buxhetin, stafin, edukimin joformal, planifikimin vjetor dhe aktivitete të tjera që bien në domenin e rinisë dhe Komunës së Gjilanit. Për të gjitha zhvillimet përgatitjet dhe funksionimin ka dhënë përgjigje, përgjegjësi për Njësinë e Rinisë, Genc Mustafa, i cili ka përmendur të gjitha aktivitetet e mbajtura me rininë, aktivitetet me vullnetarët, bashkëpunimet me OJQ-të dhe organizatat e ndryshme ndërkombëtare.



Haziri: Po angazhohem që Teatri i Gjilanit të jetë identitet i teatrove në arenën ndërkombëtare

2

NËNTOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur sot në një takim falënderimi trupën profesionale të aktorëve nga drama “Jetë me qira” nga Teatri i Qytetit, të cilët kanë marrë çmimin kryesor nga festivali në Dibër, duke potencuar faktin se angazhimi i tij është që ky teatër të jetë identifikim i Kosovës në arenën rajonale dhe ndërkombëtare.

“Jam i gëzuar që është arritur vendi i parë nga Teatri i Qytetit të Gjilanit në festivalin e Dibrës. Kjo është bërë me një përgatitje sigurisht shumë të madhe të aktorëve, me përkushtim të vazhdueshëm dhe me një mbështetje simbolike nga ana e Komunës. Më tutje jam i angazhuar gjithnjë që teatri i Gjilanit të jetë identitet i teatrove të Kosovës në botën e jashtme, mirëpo kjo bëhet me shumë punë dhe me angazhim të sinqertë e profesional. Brenda këtij viti aktorët do të kenë hapësirë edhe më të madhe në teatër, sepse nga atje do të largohet biblioteka e cila do të vendoset në objektin e saj dhe hapësira do të jetë shumë më e madhe gjatë të ardhmes”, ka pohuar krye-

tari Haziri, duke potencuar mbështetje të vazhdueshme për kulturën e Gjilanit dhe sektorët e tjerë, por në veçanti për artin skenik. “Dërrasat e Teatrit nuk janë të lehta, ato kërkojnë shumë punë të aktorëve dhe stafit tjetër profesional e krijues që të jenë konkurrent dhe prodhues të mirëfilltë”, tha ai më tej. E nga ana tjetër, Bujar Haziri u.d. i drejtorit të teatrit të Gjilanit, ka thënë se përkushtimi i Komunës, e veçanërisht i kryetarit, është që aktorët të kenë përherë rrugën e hapur për pjesëmarrje në të gjitha festivalin, kudo që ato mbahen si dhe trajtimin më të mirë në Gjilan. Aktorët e shfaqjes në këtë takim i kanë dhuruar kryetarit Haziri plaketën e falënderimit për mbështetjen e pakursyer dhënë artit skenik në veçanti. Përndryshe, shfaqja “Jetë me qira”, me autor Rafet Abazin dhe me regji të regjisorit Ekrem Sopi, ka marrë çmimin kryesor në festivalin e mbajtur në Dibër, ku pjesëmarrës ishin teatro të ndryshme nga gjithë hapësira shqiptare. Ky çmim erdhi në vitin e 15-të jubilar të festivalit “Teatri shqiptarë në Maqedoni”, që mbahet në Komunën e Dibrës.

Haziri: KFOR-i turk ishte pjesë e jona dhe do të mbetet edhe më tutje



1
MENTOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur sot në një takim lamtumirës, komandantin e Ekipit Monitorues të Mbikëqyrjes, të KFOR-it turk, Mehmet Kaplan, i cili ka përfunduar detyrën në këtë mision, duke potencuar se bashkëpunimi me njësitet e KFOR-it turk, gjithnjë ka qenë konform interesit të përbashkët për një siguri të përgjithshme të qytetarëve të këtij regjioni.

Haziri në fjalën e tij nga ky takim ka thënë se angazhimi, puna dhe përkushtimi ushtarak e njerëzor i ushtarëve të KFOR-it turk është i nivelit të njëjtë sikur që është shërbimi dhe përkushtimi për shtëpinë dhe familjen e tyre. “Angazhimi juaj, përkushtimi, puna dhe miqësia e krijuar me qytetarët e Gjilanit është një mesazh më i miri i sigurisë. Afërsia e shërbimit tuaj ushtarak është e tillë që përkujdesja juaj ka qenë e njëjtë për qytetarët e Gjilanit, sikur të ishte për qytetarët, shtëpitë dhe familjet tuaja. Kurdo që do të ktheheni përsëri, qoftë si një vizitor, por qoftë edhe me detyrë

zyrtare, kudo në Ballkan, Gjilanin do ta keni një vend në të cilin do të gjeni miqësinë e madhe në shenjë falënderimi për mbështetjen dhe shërbimin tuaj këtu, për këtë kohë prej rreth 14 muajsh”, ka thënë kryetari Haziri, duke i dorëzuar në shenjë mirënjohjeje, letrën e falënderimit. E nga ana e tij Mehmet Kaplan, mes tjerash ka pohuar se gjithë shërbimin ushtarak që e ka kryer deri më tani kudo, asnjëherë në asnjë vend tjetër nuk ka qenë më i lumtur dhe me vullnet, se sa në Gjilan. Më tej Kaplan, ka shtuar se edhe atje ku do të shkoj tash e tutje në qytetin e Ankarasë, asnjëherë nuk do ta ketë një jetë dhe përshtypje sikur të shërbimit në Gjilan dhe në mes të një qyteti që ka bërë shumë ndryshime të mëdha. “Me Gjilanin dhe njerëzit e këtij vendi jam lidhur emocionalisht dhe mendimi për ndarjen nga ky vend po më jep emocion dhe po më krijon një zbrazëti të madhe”, ka thënë mes tjerash Kaplan, duke e falënderuar kryetarin Haziri, bashkëpunëtorët e tij dhe gjithë qytetarët e Gjilanit për bashkëpunimin e treguar me KFOR-in Turk.

Komuna e Gjilanit mban dëgjim publik për ndryshimet dhe plotësimet e statutit

31
TETOR

Kuvendi Komunal i Gjilanit ka mbajtur të hënën dëgjim publik për ndryshimet dhe plotësimet e Statutit të Komunës, si nevojë për riorganizimin e ekzekutivit, për t'iu dhënë mundësi edhe qytetarëve që t'i paraqesin sugjerimet, vërejtjet dhe propozimet e tyre, por interesimi i tyre nuk ka qenë i kënaqshëm.

Sadri Arifi, shërbimtar i Shërbimit të Kuvendit, ka thënë se kryetari i Komunës ka ndërmarrë nismën për ndryshimin e statutit ekzistues, si nevojë për rikthimin e dy drejtorive komunale - Drejtorisë për Kulturën, Rini e Sport dhe Drejtorisë së Inspeksionit. Është propozuar që në statutin e Komunës të parashihen edhe Grupi i përbashkët punues, Grupi punues për preventivë lokale kundër ekstremizmit

dhe radikalizmit si dhe Mekanizmi koordinues kundër dhunës në familje. Mehmet Dermaku, qytetar, ka thënë se dokumenti është mjaft përmbajtësor, por sipas tij, Komunës së Gjilanit i duhet një statut që krijon një administratë bashkëkohore në të ardhmen si dhe një sistem informativ modern. Shemsedin Mustafa tha se zyra e avokatit të popullit i monitoron të drejtat e njeriut dhe në këtë aspekt, sipas tij, komuna e Gjilanit qëndron mirë. Statuti është akti më i lartë juridik në nivel lokal, që rregullon organizimin e brendshëm të Komunës, si njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, e cila ushtron pushtetin në pajtim me ligjet në fuqi. Herën e fundit, Komuna e Gjilanit ka bërë ndryshime dhe plotësime në Statut, në nëntor 2014.

Komuna e Gjilanit shpërndan mekanizim për 70 familje bujqësore

31
TETOR

Komuna e Gjilanit, përkatësisht Drejtoria e Bujqësisë, ka shpërndarë sot mekanizim për 70 familje bujqësore, në vlerë prej 35 mijë euro. Drejtori i Bujqësisë në Gjilan, Ramiz Ramadani, ka thënë se subvencionimi me mekanizim në të gjitha sektorët, përkthehet me lehtësim të madh të bujqve në punimin e tokës.

“Është hera e dytë këtë vit dhe hera e pestë për këtë periudhë qeverisëse të udhëhequr nga kryetari Haziri që bujqit pajisen me mekanizim bujqësor. Me këtë politikë qeverisëse të kryetarit Haziri, po mëtojmë shfrytëzimin maksimal të tokës bujqësore, subvencionimin e bujqve pa përjashtim, qëndrueshmërinë në fermë si dhe hapjen e vendeve të reja të punës për fermerët në pronat e tyre dhe besoj se këtë po e arrijmë plotësisht”, ka deklaruar Ramadani. Fermerët gjilanas të përzgjedhur sot janë pajisur me 20 spërkatëse të grurit, 10 rotofreza, 10 pijatore, 10 kositëse rotative, 10 grumbulluese të sanës, 5 mbjellëse



të patates dhe 5 mbjellje të misrit. Ndërkaq, gjatë këtij viti, Komuna e Gjilanit ka mbështetur bujqit me serra komerciale, 39 bujq kanë përfituar nga mbështetja me mjedër, sikurse edhe që janë subvencionuar edhe mbjelljet pranverore dhe ato vjeshtore, ku nga kjo e fundit kanë përfituar 730 fermerë me farë gruri, apo 140 mijë kilogramë në total. Drejtori Ramadani ka folur edhe për projektet tjera të kësaj natyre në të ardhmen, duke konfirmuar partneritetet me donatorët ndërkombëtar. “Duke i vlerësuar kapacitetet përpunuese dhe ruajtëse, do t'i ngrisim procedurat për ngritjen e 75 hektarëve me vishnje, do të aplikojmë te agjencioni shtetëror turk TIKa për mekanizim bujqësor, ndërkaq kemi ndërtuar edhe partneritete me Caritasin e Luksemburgut. Po ndërtojmë partneritete strategjike edhe me Ministrinë e Bujqësisë, kompanitë vendore dhe donatorët ndërkombëtar, në mënyrë që prodhimtarinë bujqësore ta bëjmë të qëndrueshme dhe profitabile” ka thënë drejtori i Bujqësisë në Gjilan.



Gjilani, debat për avancimin e gruas në biznes

31

TETOR

Organizuar nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Qendra e Kosovës për Mbështetje të Biznesit, është mbajtur sot një debat me gratë e Gjilanit të cilat janë udhëheqëse të biznesit, me qëllim të mbështetjes së tyre dhe avancimit drejtë zgjerimit të biznesit dhe rritjes së numrit të grave në të bërit biznes.

Në fjalën e tij drejtori për Zhvillim Ekonomik, Agim Zuzaku, ka thënë se projekti “Fuqizimi Ekonomik i Gruas, Avancim i Shoqërisë Kosovare”, ka për qëllim fuqizimin socio-ekonomik të gruas afariste në Komunën e Gjilanit, përmes edukimit dhe angazhimit të saj në vendimmarrje lokale, me qëllim të krijimit të politikave lokale në favor të bizneseve në përgjithësi. “Kjo është një rrugë e cila kërkon angazhim shumë të madh, që të kemi rezultate dhe qëndrueshmëri të bizneseve të udhëhequra nga femrat. Problemet kryesore që femra ka sot në Kosovë është mungesa e pronësisë, pengesa në ushtrimin e veprimtarisë dhe pasiguria financiare, mirëpo gjithnjë përmes zyrës për mbështetje të bizneseve kemi punuar me prioritet që femrat të kenë të gjitha dokumentet e kompletuara kur ka qenë në pyetje aplikimi për fonde të ndryshme apo për zhvillim të bizneseve të udhëhequra nga femrat në përgjithësi. Inkurajoj të vazhdohet më tutje dhe problemet, pyetjet dhe temat e ndryshme të ngritën me kohë që të jetë e mundur të futen në strategji

jinë 2017-2020. Gjithashtu, inkurajoj të gjitha gratë biznesmene, që të aplikojnë në të gjitha programet për grantet dhe subvencionet që ndahen qoftë nga Komuna, ministritë apo organizatat tjera ndërkombëtare”, ka thënë drejtori Zuzaku. Ndërsa nga ana e tij drejtori i organizatës KCBS, Nazmi Pllana, ka thënë se jemi këtu për avancimin e gruas në biznes dhe trajnimin për avokim dhe promovim. Ai gjithashtu ka thënë se përmes këtyre debateve po tentohet që të bëjmë vetëdijësimin e grave afariste për rëndësinë dhe kontributin e tyre në zhvillimin e shoqërisë, pastaj rritjen e ndikimit të grave në biznes, përmes krijimit të rrjetit joformal avokues të grave në biznes dhe krijimin e strategjisë komunale për fuqizimin e pozitës së gruas në biznes, duke mos lënë anash asnjëherë promovimin e aktiviteteve të projektit në media lokale por edhe qendrore. Me fjalën e tyre janë paraqitur edhe Xhyllishene Berisha, Lindita Salihu e Arjeta Maka, të cilat kanë ngritur problemin e numrit të vogël të grave në biznes si dhe numrin e madh të papunësisë, e veçanërisht të grave pa punë. Kosovo Center for Business Support - KCBS, ka filluar implementimin e projektit “Fuqizimi Ekonomik i Gruas, Avancim i Shoqërisë Kosovare”, projekt ky i financuar nga Zyra e Bashkimit Europian në Kosovë përmes projektit “Skema e granteve për nismat e avokimit nga organizatat me bazë në komunitet”, zbatuar nga Fondacioni për Shoqëri Civile.



Lutfi Haziri impresionohet me rendimentet rekorde të mollës tek Moea

29
TETOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët, ka marrë pjesë sot në vjeljen e mollës tek kompania "Moea" në Kravaricë, e cila ka të mbjellura 30 hektarë, ku është pritë nga pronari Armend Malazogu. Së bashku me pronarin Malazogu, kreu i Gjilanit ka vizituar edhe fabrikën për përpunimin e lëngjeve "Frutomania", e cila është duke punuar kapacitet të plotë deri 30 tonë në ditë, ndërkaj vjelje është duke bërë rreth 60 tonë në ditë.

Kryetari Haziri është ndarë shumë i kënaqur, e i impresionuar me punën dhe rendimentet rekorde të mollës, sikurse edhe me cilësinë e prodhimit të lëngjeve vendore. "Ajo që pamë sot këtu, është vërtetë impresionuese. "Moea" e "Frutomania" janë storie e suksesit të prodhimit vendor dhe krenaria e Gjilanit, edhe sa i për-

ket sasisë, por edhe cilësisë. E përgëzoja menaxhmentin për angazhimin e madh, ndërkaj ia shfaqta zotimin e Komunës së Gjilanit në mbështetjen në aspektin e infrastrukturës, në mënyrë që të operojnë suksesshëm në këtë veprimtari. Këtu shumë familje gjilanasë e sugurojnë bukën e gojës dhe kjo është vërtetë mbreslënëse", ka thënë Haziri. Nga ana tjetër, pronari i kompanisë "Moea", në kuadër të së cilës operon edhe "Frutomania", Armend Malazogu, e ka falënderuar kryetarin Haziri për vizitën dhe mbështetjen e madhe të Komunës së Gjilanit në rregullimin e infrastrukturës. Ai ka informuar se në këto kompani janë të punësuar 70 punëtorë të rregullt, ndërsa ky numër dyfishohet gjatë sezonës. Ditët në vazhdim, kryetari i Gjilanit me bashkëpunëtorët do të vizitoj të gjithë agropërpunuesit që operojnë në Gjilan.



Haziri: Ndërtimi i QKMF-së dhe rrugës me katër krosi, do ta bëjnë Stacionin e Autobusëve qendër të madhe transportuese

28
TETOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, së bashku me drejtorët komunalë dhe bashkëpunëtorë të tjerë, ka vizituar Stacionin e Autobusëve në Gjilan, ku është interesuar për angazhimet konkrete në mbështetje të kësaj ndërmarrje, për ri-vitalizim dhe rritje të shërbimeve transportuese për qytetarë dhe njëkohësisht ka bërë vizitë edhe në lokacionin ku do të nis së ndërtuari Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare dhe hyrje-dalja e rrugës Gjilan-Ferizaj.

Përgjatë kësaj pjese priten zhvillime të ndryshme e të shumta infrastrukturore dhe shërbyese për qytetarët, duke nisur nga shërbimet shëndetësore, transportuese por edhe zhvillimore të hapësirës përreth, me kulminim e ndërtimit të objektit QKMF-së dhe rrugës me katër krosi, që do të kalojë në këtë pjesë përgjatë ndërmarrjes "Stacioni i Autobusëve", ka njoftuar kryetari Haziri. Ai gjatë qëndrimit në "Stacionin e Autobusëve", ka ofruar mbështetjen e fuqishme për zhvillim të mëtutjeshëm të kësaj ndërmarrje komunale, duke paralajmëruar ndryshime konform interesit të qytetarëve për shërbime më

të mira në këtë pjesë. "Kjo ndërmarrje po ec mirë, megjithëse ka nevojë për mbështetjen e Komunës që ajo të zhvillohet edhe më tutje, të jetë më funksionale si dhe të bëhet qendër modern me kushte dhe shërbime të shpejta e profesionale. Kjo ndërmarrje pos që është një qendër e madhe e Anamoravës, në një të ardhme të afërt do të frekuentohet edhe nga udhëtarë të shumtë të komunave të regjionit të Kumanovës. Njëkohësisht në këtë qendër shumë pranë do të fillojë ndërtimi i QKMF-së me standarde moderne dhe më rritje më të madhe edhe të shërbimeve shëndetësore për pacientë. Shërbimet shëndetësore, ato të transportit të udhëtarëve dhe hapja e rrugës hyrje-dalje në drejtim të Ferizajt do të ndikojnë pozitivisht edhe në zhvillimin dhe rritjen e shërbimeve për stacionin. Me një fjalë, përgjithësisht ky lokacion do të jetë pjesë e punimeve të mëdha e fillimit të ndryshimeve pozitive dhe rritjes së shërbimeve për qytetarët e Gjilanit, me të gjitha Komunitetet e këtij regjioni dhe të gjitha regjioneve për rreth", ka thënë kryetari Haziri. Njëkohësisht Haziri, ka bërë të ditur që investimet në stacion, në QKMF dhe në rrugën Gjilan-Ferizaj do të nisin së shpejti.



“Mollëkuqet”, me suksese të shumta në gara të ndryshme

28
TETOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka qenë nikoqir i fëmijëve nga Festivali I Këngës për Fëmijë “Mollëkuqet”, të cilët i ka uruar për sukseset e arritura, sikur që i ka inkurajuar për angazhim edhe më të madh gjatë të ardhmes, dhe mbështetjen institucionale për pjesëmarrje edhe në festivalet jashtë vendit.

Haziri ka uruar fëmijët për sukseset e shumta që kanë prekur përmes pjesëmarrjes në festival të ndryshme që nga Gjilani, qytete të ndryshme të Kosovës, pastaj pjesëmarrje në festivalin e fëmijëve në Shkodër, Dibër, Kërçovë, Preshevë dhe qytete të tjera. “Ju më keni impresionuar me energjinë e madhe dhe sukseset e arritu-

ra nga gara të ndryshme anë e këndë trojeve shqiptare. Mbështetja e Komunës do të jetë e përhershme dhe gjithnjë në funksion të krijimit të kushteve më të mira dhe më të lehta për pjesëmarrje nëpër festivale”, ka thënë kryetari, duke i uruar prindërit dhe mësuesit për punën që bëjnë me këta fëmijë dhe me sukseset, që janë krenari e familjeve dhe pse jo edhe e Gjilanit. Ndërsa, fëmijët, që në këtë rast kishte solistë, valltarë dhe instrumentistë, nën përcjelljen e mësueses Arta Haziri-Nuhii, kanë bashkëbiseduar me kryetarin Haziri, kryesisht për karrierën e tij politike, ngjitjen drejtë majave të sukseseve qeverisëse e politike por edhe për familjen e tij dhe angazhimin në shkollë që nga fëmijëria.



Kuvendarët e Gjilanit miratojnë me vërejtje të vogla raportin financiar janar-shator 2016

27
TETOR

Kuvendi Komunal i Gjilanit, të enjten, në seancën e radhës, të drejtuar nga kryesuesja Valentina Bunjaku-Rexhepi, ka miratuar raportin financiar janar-shtator 2016, kërkesën për rishqyrtimin e dy vendimeve, sipas sugjerimeve të MAPL - vendimi për qasjen e hartimit të Planit Rregullues të Hollësishëm "Qendra 1" dhe vendimin për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, pastaj Planin Rregullues të Hollësishëm "Fidanishte 2" si dhe raportin mbi dezinfektimin hapësinor dhe dezinfektimin e shkollave fillore, të mesme, çerdheve dhe institucioneve arsimore.

Raportin financiar për periudhën 9-mujore të këtij viti e ka prezantuar Zijadin Maliqi, drejtor për Buxhet, i cili ka thënë se të hyrat komunale janë realizuar afër 88 për qind në krahasim me planin vjetor, ndërsa në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, janë më të mëdha për rreth 31 për qind. Tatimi në pronë, që është një nga të hyrat kryesore vetanake, është tejkaluar për 12 për qind në krahasim me planin vjetor, derisa në krahasim me 9-mujorin e vitit të kaluar, është i lartë për 67 për qind. Sa

i përket shpenzimeve, Maliqi ka thënë se në këtë periudhë është shpenzuar 70 për qind e buxhetit vjetor. Raporti financiar, kryesisht është vlerësuar me nota pozitive nga grupimet politike në Kuvend, të cilat e kanë mirëpritur rritjen e të hyrave komunale. Avdyli Aliu (LDK) ka thënë se raporti është një pasqyrim real i ecurive buxhetore në komunë. Edhe Selami Xhemajli (AAK) i dha mbështetje raportit, duke nënvizuar si element inkurajues trendin e rritjes së të hyrave vetanake dhe uljen e shpenzimeve. Riad Rashiti (PDK) tha se në këtë periudhë ka zhvillime pozitive tek të hyrat, por sipas tij, kjo drejtori duhet të angazhohet që të arkëtojë edhe më shumë mjete, sidomos nga lejet ndërtimore, duke e ditur që ritmi i ndërtimeve është mjaft i lartë. Sa u përket investimeve, Rashiti ka thënë se nuk janë të kënaqshme, ndërkohë që shpenzimet për mallra dhe shërbime janë rritur, ka thënë ai. Rashiti ka kërkuar rritje të kontrollit të tatimit në pronë sa i përket lëshimit të vërtetimit për regjistrim të automjeteve, ku sipas tij, ka devijime. Krenare Latifi (VV) tha se te disa kategori buxhetore, ka pasur ngecje

në realizimin e të hyrave të planifikuara, duke përmendur si shembull Administratën e Përgjithshme, por edhe në disa sektorë të tjerë. Nevzad Isufi (VV) e ka ngritur çështjen e pagesës së punëtorëve me kontrata në vepër, duke kërkuar përgjigje se nga cili kod buxhetor kompensohen ata. Duke iu dhënë përgjigje interesimeve të anëtarëve të Kuvendit, Zijadin Maliqi ka thënë se ky është viti më i suksesshëm në këta 16 vjet sa i përket realizimit të të hyrave vetanake, ndërkaq në lidhje me shqetësimin e Rashitit për disa lëshime te sektori i tatimit në pronë, ai ka thënë se jemi duke bërë përpjekje maksimale që gjithçka ta kemi nën kontroll. Kurse sa i përket të hyrave te Drejtoria e Administratës, që janë më të vogla se planifikimi, Maliqi ka sqaruar se kjo varet nga kërkesat e qytetarëve për dokumente të gjendjes civile. Ai ka dhënë përgjigje edhe për punësimet me kontrata në vepër, duke thënë se numri i tyre është ulur në 37 raste nga 112 sa kanë qenë më herët dhe po shkohet nga ajo që prej vitit të ardhshëm të mos ketë asnjë rast. Anëtarët e Kuvendit, pozitë dhe opozitë, janë dakorduar që raporti i kryetarit të Komunës, të shtyhet për njërin nga seancat tjera, meqë siç ka sqaruar kryesuesja Valentina Bunjaku-Rexhepi, ai nuk ka mundur të jetë i pranishëm në seancë, për shkak agjendës që ka pasur. Sa i përket sugjerimit të MAPL-së për rishqyrtimin e dy vendimeve për planet rregulluese, përkatësisht hapësinore, Valon Shefkui, drejtor për Urbanizëm, ka sqaruar se vërejtja e vetme është te emërimi "revidim" i planit, ndërsa sipas ligjit të ri, duhet të jetë "hartim" i panit. Kuvendi e ka miratuar edhe vendimin për PRRU "Fidanishte", për të cilin, Shefkui ka thënë se i ka kaluar të gjitha procedurat e nevojshme, përfshirë edhe debatet dhe dëgjimin publik. Profillin e kësaj lagje, e ka prezantuar Ismail Baftijari nga kompania hartuese "INSI". Ai ka thënë se kjo zonë përfshin një sipërfaqe prej 107 hektarësh. Sipas tij, ka pasur vërejtje nga qytetarët, bizneset dhe grupet e interesit, në lidhje me katësinë, shtyllat e tensionit të lartë e zgjidhje të tjera dhe të gjitha janë analizuar dhe kanë marrë përgjigje. Baftijari ka thënë se qytetarët kanë qenë të përfshirë në proces maksimalisht. Shqetësimi më i madh që kanë ngritur këshilltarët komunalë, Nevzad Rushiti (LDK), Nevzad Isufi (VV), Ismet Hajdini (AKR), Bajram Hasani (këshilltar i pavarur), Leonora Bunjakurt (PDK), Shukrije Rapuca (PDK), kanë qenë për shtyllat e tensionit të lartë që kalojnë nëpër "Fidanishte 2" dhe pengojnë zhvillimin e një segmenti të kësaj zone, etazhitetin e ultë që nuk shkon më tepër se P+6, shpronësimet dhe infrastruktura, që kërkojnë mjete të konsiderueshme për zbatimin e planit, konsultat me pronarë, shpronësimet dhe të tjera.

Baftijari ka thënë se jemi munduar të bëjmë zgjidhjen sa më cilësore të mundshme. Ne e kemi dhënë propozimin tonë edhe për largpërçues, që duhet të futen nën tokë, kurse sa i përket etazhitetit, jemi bazuar te gjendja ekzistuese e zonës si dhe zonat përreth saj. Mjaft interesim ka nxitur edhe raporti mbi dezinfektimin dhe dezinfektimin, të cilin e ka paraqitur Nexhat Hajrullahu, drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Projekti dezinfektimit është kryer në tri faza, sikurse është bërë me kohë edhe dezinfektimi i institucioneve arsimore, ndërkaq për derratizim, sivjet nuk ka pasur kërkesa nga qytetarët, ka thënë ai. Në të ardhmen, shpresojmë t'i përfshijmë edhe disa zona rurale, ka thënë Hajrullahu. Jashar Jashari (LDK), kryesues i Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, ka thënë se dezinfektimi është bërë me kohë, në një sipërfaqe urbane prej 1000 hektarësh, përfshirë edhe zonat përreth shtretërve të lumenjve. Isa Agushi (LDK), Riad Rashiti (PDK), Ibish Ibishi (AAK), Nevzad Isufi (VV) dhe të tjerë kanë sugjeruar që në projektin e dezinskemit të përfshihen edhe fshatrat, sidomos ato përgjatë rrjedhës së lumit, Malisheva, Uglari e Pogradja, sepse pa të drejtë i vuajnë pasojat e ndotjes që ujit që ndodh në qytet. Ibishi ka thënë se vitin tjetër nuk duhet të harrohet dezinfektimi edhe i objekteve të banimit kolektiv, sepse ka pasur ankesa nga banorët për shfaqjen e insekteve. Fatbardha Selmani (PDK) ka pasur vërejtje për faktin se raportit i mungon kostoja financiare. Vërejtje për kosoton e lartë të projektit ka pasur edhe Riad Rashiti (PDK). Nexhat Hajrullahu ka thënë se nuk kanë pasur kërkesë nga qytetarët për dezinfektim në objektet e banimit kolektiv, sepse do ta kishin bërë, kurse sa iu përket fshatrave, ai e ka lënë të hapur mundësinë e rishikimit të mundësive në të ardhmen. Në pjesën jashtë rendit të ditës, pyetje për drejtorët komunalë kanë parashtruar Sahit Abazi (PDK), Arben Maliqi (LDK), Leonora Bunjaku (PDK), Riad Rashiti (PDK), Nevzad Isufi (VV), Bajram Hasani (KP) dhe të tjerë dhe kanë marrë përgjigje, në fund të seancës, nga drejtorët Naser Korça (DSHP), Valon Shefkui (DUM) dhe Shqipe Kastrati (DKA). Sahit Abazi (PDK) ka kërkuar rishikim të vendimit për zgjidhjen e problemit të ujërave të zeza përmes kredisë, sepse bëhet fjalë për një shumë të pa përballueshme për komunën e Gjilanit, ka thënë ai. Kryesuesja e Kuvendit, Valentina Bunjaku-Rexhepi, ka thënë se kjo pikë është miratuar nga Kuvendi në seancën e jashtëzakonshme, ku është nxjerrë për votim edhe propozimi i opozitës për t'i kërkuar qeverisë që ta marrë përsipër obligimin, por nuk ka kaluar dhe kjo konsiderohet çështje e përfunduar në aspektin procedural.

Në Gjilan nis takimi vjeshtor i Komiteteve të BE-së për Ballkanin Perëndimor

25
TETOR

Në Gjilan, ka nisur sot takimi i Komiteteve të Regjioneve të BE-së, ku kanë zbarkuar përfaqësuesit dhe udhëheqësit më të lartë të BE-së, me përfshirjen e kryetarëve të komunave të mikro-regjionit Gjilan-Kumanovë-Preshevë, me pjesëmarrje të përfaqësuesve të shumtë nga niveli lokal i qeverisjes së BE-së, Kosovës dhe shteteve për rreth.

Sesioni i parë i konferencës është progresi i Kosovës që nga muaji maj 2016, si shpallja e muajit të fillimit të reformave në përmirësimin e qeverisjes dhe përkushtimin në sistemin e drejtësisë dhe zbatim të ligjit, por edhe avancimi i forcimit të konkurrencës në zhvillimin ekonomik dhe rritjen e klimës së zhvillimit të sektorit priva me krijimin e kushteve më të volitshme në thithjen e investimeve të përbashkëta nga donator dhe kompani private të jashtme me theks të veçantë përgatitjet e deritanishme në rrugën e integritetit të Kosovës dhe Ballkanit Perëndimor drejtë BE-së. Me këtë rast kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, si nikoqir i këtij organizimi, në fjalën e tij ka thënë se mikroregjioni Gjilan-Kumanovë-Preshevë-Bujanoc, me përfshirjen e gjithsej 17 komunave sot përpos dëshmisë së vlerave të larta politike, kulturore, shoqërore, fetare dhe etnike, po dëshmon se është i angazhuar konkretisht në rrugën e cila nuk ka alternativë tjetër pos integritetit të përbashkët dhe angazhimit drejt familjes së madhe të BE-së. “Është një rrugë shumë e vështirë, por e domosdoshme. Integrimi në BE është angazhim i drejtë i Ballkanit Perëndimor. Zbarkimi i të gjitha autoriteteve relevante nga institucionet e pushtetit lokal me ekspertë të shumtë të pushtetit lokal, me udhëheqës të shumë regjioneve brenda BE-së, me mbështetjen e KE-së në Kosovë dhe me përkrahjen e madhe të ambasadave, korit diplomatik, por edhe të qeverisë së Kosovës po punohet që qeverisja lokale të jetë në hap me agjendën e Kosovës për integritet Evropian”, ka thënë Haziri. Ai më tej ka thënë se ky mikroregjion është i përbashkët, me një qëllim atë të përgatitjes së fuqishme për zhvillim ekonomik



ndërshtetëror në Ballkanin Perëndimor, lëvizje të lirë të qytetarëve dhe të mallrave dhe përgatitje të fuqishme për t'u bashkuar në këtë familje të madhe evropiane.” Gjithnjë po angazhohemi që të kemi një rrugë më të lehtë në integritet. Ajo është e arritshme vetëm përmes investimeve ndërkomunale e ndërshtetërore në këtë pjesë të Ballkanit ku janë të përfshira Komuna të shumta nga Kosova, Maqedonia, Serbia dhe Bullgaria. Lëvizja e lehtë e qytetarëve, e mallrave dhe zhvillimi i projekteve të përbashkëta, janë hallkat e para sikurse edhe reformat dhe ndryshimet që po ndodhin në nivelin lokal në Kosovë”, ka thënë kryetari Haziri. Gjithashtu nga ana e tij dr. Franz Schausberger, kryetar i Grupit Punues për Ballkanin Perëndimor, nën kryesimin e të cilit është mbajtur ky takim ka thënë se takimi që po marrin pjesë udhëheqës dhe përfaqësues të një niveli të lartë nga BE, dhe nga Komuna të ndryshme të Ballkanit Perëndimor, nga Kosova me nivelet lokale të përfaqësimit dhe me mbështetje edhe të ministrive të ndryshme në Kosovë, dëshmon për ndryshimet e mëdha dhe rrenjësores që kanë ndodhur në këtë vend nga pavarësimi në vitin 2008. “Është krenari që sot unë po shoh rezultate konkrete dhe të mëdha në të gjitha fushat në Republikën e Kosovës. Jemi të vendosur të mbështesim edhe më shumë Kosovën drejtë rrugës së integriteteve Evropiane. Ne jemi këtu që Ballkanin Perëndimor ta orientojmë me argumente të fuqishme qeverisëse, ligjore dhe të prosperimit ekonomik, por, edhe të bashkëpunimit ndërkufitar, drejtë rrugës të cilën e meriton natyrshëm, atë për në integritet Evropian”, ka thënë ndër tjerash ai në fjalën e tij. Ndryshe në këtë takim gjithashtu me fjalë hyrëse janë paraqitur edhe ambasadori i Austrisë në Kosovë, zv.ministri i Pushtetit Lokal, Bajram Gecaj, zv.ministri i Integriteteve Evropiane, Ramadan Ilazi, shefi i sektorit Politik Ekonomik dhe Integritetit në BE, Thomas Gnecchi dhe kryetar të Komunave të Mikro-Regjionit. Takimi po vazhdon me diskutime të pjesëmarrësve të shumtë në takimin vjeshtor të Komiteteve të Regjioneve të BE-së dhe përfaqësimit nga kryetarët e 17 Komunave.



Kryetari i Gjilanit, me mysafirë të shumtë, feston Darkën e Lamës

25
TETOR

Përgatitur nga fermerët, kultivuar në tokën e Gjilanit, dhe mbështetur nga Komuna, konkretisht Drejtoria e Bujqësisë, sot është organizuar “Darka e Lamës”, një aktivitet tashmë tradicional i falënderimit ndaj Zotit për bereqetin vjetor, me shijimin e produkteve dhe ushqimeve të ndryshme, në ambientin e hapur, nën shoqërimin e shumë miqve të Gjilanit dhe Kosovës.

Zyrtarisht hapja e “Darkës së Lamës”, është bërë nga kryetari i Gjilanit Lutfi Haziri, i cili para vetes kishte mysafir të shumtë, të cilët rastësisht iu bashkuan kësaj sofre duke nderuar fermerët dhe në përgjithësi Gjilanin, por njëkohësisht duke mbetur të impresionuar nga ushqimet tradicionale të ofruara. “Darka e Lamës”, është simbolikë e një kulture të gjatë të shqiptarët. Si aktivitet vjetor ka nisur të shënohet që nga koha e Presidentit të ndjerë Dr. Ibrahim Rugova, i cili gjithnjë ka promovuar produktet dhe bereqetin e sofrës Kosovare. Sot ne kemi miq të shumtë që po marrin pjesë në sofrën tonë të Gjilanit për këtë vit. Mikpritja është e përhershme për miq, ndaj kjo sofër është e madhe dhe mysafirët janë nga një përfshirje e gjerë territoriale që e bënë madhështore këtë ditë të bujkut të Gjilanit. Kemi

mysafir të shumtë nga 11 shtete të BE-së, pastaj kryetarë të 17 Komunave të Mikro-regjionit Gjilan-Kumanovë-Presevë, përfaqësues në nivel ministrash të qeverisë së Kosovës, përfaqësues të ambasadave të Kosovës, organizatave të shumta dhe mbi të gjitha kemi ata të cilët përditë na bëjnë krenar me angazhim të pa ndërprerë, pra, sot kemi këtu fermerë të shumtë që krenohen me bereqetin që u ka dhënë Zoti dhe ne krenohemi me punën që ata bëjnë”, ka thënë kryetari Haziri. Ai gjithashtu është zotuar se kjo sofër do të pasurohet edhe më shumë gjatë të ardhmes, ngase mbështetja e Komunës së Gjilanit do të jetë gjithnjë e më e madhe dhe rezultati do të jetë sipas tij zgjerimi i veprimtarisë dhe zhvillimi ekonomik njëkohësisht. “Sofra gjilanasë përherë ka qenë e begatë dhe kur asaj i është shtuar edhe mikpritja, atëherë ajo nuk ka se si të krahasohet. Në të ardhmen mbështetja e Komunës do të jetë edhe më e madhe dhe përpos nevojave tona të Gjilanit për konsum ditor, do të punohet edhe më shumë për tregun jashtë komunës dhe jashtë shtetit”, ka thënë ai ndër të tjerash para shumë të pranishmëve. Me fjalë rasti është paraqitur edhe zv.ministri i Bujqësisë, Vezir Januzi, i cili mes tjerash ka thënë se Gjilani përherë është dëshmuar me angazhime konkrete dhe me produkte të shumta në të

gjitha fushat, por, sofra Gjilanase "Darka e Lamës", është më e veçantë dhe po tregon bereqetin që është bërë në Gjilan. Ndërsa Ramiz Ramadani, Drejtor i Bujqësisë dhe Pyltarisë në Gjilan, ka falënderuar për angazhimin vjetorë që kanë bërë fermerët në punën e tyre të vazhdueshme por edhe kryetarin e Komunës Lutfi Haziri dhe Ministrinë e Bujqësisë për mbështetjen financiare. "Gjithçka që është shtruar sot para nesh dhe gjithçka që konsumojmë gjatë tërë vitit është ajo që prodhohet nga kultura e lartë e përkushtimit në punën shembullore të bujku gjilanas. S'ka më mirë se sa në sofrat tona të kemi produktet e tokës sonë. Njëkohësisht, nuk ka më mirë se sa të jemi krenar që kemi arritur të jemi pjesë e mbështetjes si institucion lokal për bujqësinë e Gjilanit. Bashkë me Ministrinë e Bujqësisë jemi koordinuar në një mbështetje më të madhe dhe në

numër më të madh të familjeve të mbështetura, dhe rezultatet asnjëherë nuk kanë munguar, urojmë që çdo vit ta pasurojmë sofrën tonë me prodhime të reja", ka thënë mes tjerash drejtori Ramadani duke i falënderuar të gjithë fermerët e pranishëm dhe ata të cilët për arsye të ndryshme nuk kanë mundur të jenë aty, duke i informuar se asistencë gjithnjë do të jetë më e madhe me buxhet dhe subvencione. E në emër të delegacionit të Regjioneve të Bashkimit Evropian, Franz Schausberger, kryetar i Grupit Punues për Ballkanin Perëndimor, ka thënë se ajo që ka parë sot në Gjilan dhe ajo që ofrohet në sofrën gjilanasë, është një veçanti e madhe dhe një llojllojshmëri begatie të kultivuara me gërshetimin perfekt si të ushqimeve moderne dhe atyre tradicionale.

Angazhim i përbashkët në rrugën Evropiane të Komunave

25
TETOR

Gjatë orëve të vona të pasdites sot ka përfunduar takimi i Grupit të Punës për Ballkanin Perëndimor, duke vizituar bashkërisht pikën kufitare në fshatin Stançiç, pikë e cila lidhë Gjilanin me Kumanovën konkretisht Kosovën me Maqedoninë dhe Komunat e Likovën, Kumanovë që pos tjerash është lidhje e shkurtimit të jashtëzakonshëm të rrugës së familjeve në dy anët e kufirit.

Gjithashtu gjatë vizitës së përbashkët është përsjellë nga afër puna që është duke u bërë në hapjen e rrugës si dhe është bërë informimi i saktë lidhur me investimin përmes programit të Komisionit Evropian, IPA2. Ky projekt detaj i pikës së përbashkët kufitare dhe i menaxhimit të përbashkët do të prezantohet gjatë nesër në qeverinë e Kosovës, ndërsa procedurat ligjore për ndërtimin e saj që kap një shifër prej mbi 1.2 milionë euro do të nisin menjëherë në fillimin e vitit të ardhshëm. Takim i sotëm në Gjilan ka mbledhur përfaqësuesit e 11 Regjioneve Evropiane, si dhe kryetarët e 17 Komunave të Ballkanit Perëndimor, respektivisht trekëndëshit Gjilan-Kumanovë-Preshevë. Kryetari Haziri në përmbledhje të këtij takimi ndër të tjerash ka thënë se ardhja e të gjitha autoriteteve nga nivelet lokale të shteteve të Bashkimit Evropian në Gjilan është një mesazh i qartë i mbështetjes së fuqishme për rëndësinë që ka lidhja e Ballkanit Perëndimorë mes vete si dhe nevoja e madhe që sipas tij ka në angazhimin konkret sipas agjendës Evropiane të integritimeve. Haziri ka thënë se gjithçka sot ka dëshmuar

për rëndësinë që ka mbështetja rajonale dhe Evropiane për Kosovën e në këtë rast për mikroregjionin e Anamoravës i përbërë nga 17 Komuna. Ai poashtu ka pohuar se aktivizimi i mikroregjionit me 17 Komuna, është hap më afër integritimit lokal evropian. "Pa integrimin e mirëfilltë lokal, nuk do të ketë asnjëherë integrim të mirëfilltë evropian për Ballkanin Perëndimor, prandaj është proces që duhet të punohet me vendosmëri në të gjitha drejtimet dhe në të gjithë sektorët", potencoi ai në fjalën e tij. Sipas Hazirit janë hedhur hapa të rëndësishëm dhe tashmë dihet qartë agjenda e bashkëpunimit ndërshtetëror të Komunave, por gjithashtu pritet mbështetje edhe nga institucione dhe organizata prestigjioze, për të investuar në projekte të përbashkëta, të cilat lidhin këtë mikro-regjion prej mbi 800 mijë banorësh. Ndërsa, nga të pranishmit është thënë se mbështetja dhe praktikat e mira të shteteve të ndryshme do të jenë në funksion të Komunave të Ballkanit Perëndimor që të ndjekin hapat e suksesit, duke mënjanuar problemet dhe sfidat që kanë kaluar shtetet e familjes Evropiane para integritimeve. Në këtë ditë gjatë këtij takimi pas sesionit të parë atij të marrëdhënieve të BE-së për përmirësimin e qeverisjes, sundimit të ligjit dhe zhvillimit të autoriteteve lokale, në sesionin e dytë të këtij takimi vjetor është debatuar për agjendën e Lidhjes për Ballkanin Perëndimor, me theks të veçantë krijimit të urave të fuqishme mes Komunave të këtij mikro-regjioni, por edhe mes komuniteteve që jetojnë në këtë pjesë të Ballkanit Perëndimor.



Pjesëmarrja e qytetarëve në debate, është pjesëmarrje në vendimmarrje

24
TETOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, në takimin që kishte me anëtarët e Grupit të Përbashkët Punues, lidhur me organizimin e debateve dhe dëgjimeve publike për vendimmarrje dhe bashkërendim të aktiviteteve së bashku edhe me qytetarët, ka falënderuar këtë trupë për angazhimin dhe njëkohësisht ka kërkuar që edhe më tutje të punohet në këtë drejtim, duke organizuar qytetarët dhe bashkërenduar aktivitetet me kalendarin e punës së drejtorive komunale.

Grupi, i cili, në përbërje ka kryetarë të këshillave të fshatrave, zyrtarë komunalë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të komuniteteve etj., kanë bërë organizimin e debateve në bashkëpunim me drejtoritë e ndryshme të Komunës së Gjilanit, nëpër zonat rurale dhe ato urbane dhe për vitin 2016. kanë përgatitur listën e prioriteteve për lokalitetet e ndryshme, të cilat janë futur menjëherë në agjendën e investimeve të Komunës së Gjilanit dhe një pjesë tjetër janë vendosur në prioritetet e vitit të ardhshëm. Në fjalën e tij në këtë takim kryetari Haziri e

ka shumë të rëndësishëm pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje dhe organizimin e debateve konform praktikës së informimit të të gjithë qytetarëve të një fshati a lagjeje. "Kërkoj angazhim të përbashkët edhe për të ardhmen, sepse vetëdijesimi i qytetarëve që mund të jenë pjesë e proceseve vendimmarrëse tashmë është praktika më e mirë e dëshmuar. Është e drejtë e secilit qytetar të Komunës së Gjilanit që të jetë pjesë e agjendës dhe ajo bëhet vetëm me pjesëmarrje aktive dhe vetëm atëherë kur debatohet dhe prezantohet problemi apo prioriteti me karakter të përgjithshëm, për një numër më të madh të qytetarëve, të një lokaliteti qoftë në qytet apo fshat", ka thënë kryetari Haziri. Ai më tej ka shtuar se vetëm bashkërisht gjithnjë do të caktohen prioritetet e lagjes, të fshatit apo të zonës, ndërsa zgjidhja më e mirë është kur në diskutim të hapur marrin pjesë sa më shumë qytetarë duke përmbushur kështu të gjitha nevojat që janë në hapësirën e Komunës, e të cilat kërkojnë kryesisht investime infrastrukturore dhe të përmirësimit të jetës së qytetarëve.

Gjilanin e viziton Recep Gurkan, kryebashkiaku i Komunës Edirne



24
TETOR

Në Komunën e Gjilanit në një vizitë pune ka qëndruar kryebashkiaku i Komunës Edirne, Recep Gurkan nga shteti i Turqisë, i cili është prit-ur nga nënkryetari i Komunës, Rexhep Kadriu, i cilin e ka informuar atë për zhvillimet në Gjilan, për popullsinë, zh-villimin ekonomik, historikun dhe trajtimin e komunitetit turk në përgjithësi.

Nga ana e tij nënkryetari Kadriu ka bërë një përshkrim të shkurtër të Gjilanit, bashkëpunimin që ka me Komuna të ndryshme në Turqi dhe gatishmërinë e treguar gjatë gjithë kohës në krijim të urave lidhëse dhe nevojat e mëdha për

thithje të investimeve dhe për shkëmbim të përvojave mes dy vendeve. Ai poashtu ka theksuar se pos tjerash një tra-jtim të veçantë kanë të gjitha komunitetet pakicë që jetojnë në Gjilan, mes tyre edhe për komuniteti turk i cili është mirë i inkuadruar në jetën shoqërore, kulturore e politike. Kurse Recep Gurkan, në fjalën e tij, ka falënderuar për bash-këpunimin dhe gatishmërinë që Gjilani ka treguar gjithnjë në çdo bashkëpunim dhe iniciativë qoftë regjionale apo ndërshtetërore. Gurkan ka thënë se gjithnjë do të jetë afër kësaj Komune dhe Komunave të tjera, me qëllimin e vetëm, ecjen përpara dhe zhvillimin e këtij vendi.

Kredia për ujërat e zeza, një nga vendimet më të rëndësishme të Kuvendit Komunal të Gjilanit



20
TETOR

Kuvendi Komunal i Gjilanit, të enjten, në një seancë të jashtëzakonshme, që e ka udhëhequr Valentina Bunjaku-Rexhepi, kryesuese, ka diskutuar për ujërat e zeza, gjendjen në kompaninë “Ecohigjiena” si dhe për planin aksional të veprimit për integrimin e komunitetit RAE për periudhën 2016-2018.

Kuvendarët, me shumicë votash, vendosën që Komuna e Gjilanit të hyjë në kredi te qeveria austriake, si nevojë për rregullimin e kanalizimeve dhe sistemimin e ujërave të zeza, ndërkaq rasti i kompanisë “Ecohigjiena” i mbetet kryetarit të Komunës që të angazhohet për të gjetur një zgjidhje. Bunjaku-Rexhepi kërkoi nga anëtarët e Kuvendit që të përqendrohen te pikat e parapara dhe të mos insistojnë në çështje të tjera, sepse në një seancë të jashtëzakonshme nuk mund të ndryshohet rendi i ditës. Lutfi Haziri, kryetar i Komunës, duke i inkurajuar kuvendarët që të mbështesin zgjidhjen e problemit madhor të kanalizimeve dhe ujërave të zeza, përmes një kredie të butë nga qeveria e Austrisë, në shumën afër 13 milionë euro, ka thënë se ky Kuvend Komunal po merr sot një nga vendimet më të rëndësishme. Ai është shprehur

optimist se në këtë fazë të projektit, që pritet të fillojë deri në fund të muajit dhe do të bëhet sipas standardeve më të larta, do të rregullohen kanalizimet dhe shtretërit e lumenjve, ndërkaq në fazën e dytë, që po punohet të realizohet në bashkëpunim me KE, do të ndërtohet impianti, për t'i dhënë zgjidhje përfundimtare problemit të ujërave të zeza. Detajet e projektit i ka prezantuar Agim Zuzaku, drejtor për Zhvillim Ekonomik, i cili ka thënë se kredia do të merret në përputhje me ligjin për borxhet publike, që u lejon Komunave të marrin kredi. Ai ka sqaruar se kredia merret për një periudhë 15 vjeçare dhe do të fillojë të kthehet pas 6 vitesh e gjysmë. Subjektet politike që përbëjnë koalicionin qeverisës i kanë dhënë mbështetje kësaj nisme, që parimisht është përkrahur edhe nga opozita, por me kushtin që t'i kërkohet qeverisë së Kosovës që ta marrë përsipër kredinë, gjë që nuk ka kaluar në Kuvend. Avdyll Aliu (LDK) ka thënë se sot po votohet projekti më i madh dhe më i rëndësishëm për Gjilanin, që është shumë i nevojshëm për qytetarët e kësaj komune. Mbështetje në emër të grupit, këtij projekti i dha edhe Selami Xhemajli (AAK). Edhe Sahit Abazi (PDK) tha se jemi për miratimin e projektit, por vërejt-

ja e tij ishte se kredia po u mbetet qytetarëve të Gjilanit që ta shlyejnë dhe jo MEF-it, siç është thënë më herët. Nevzat Isufi (VV) tha se është i kënaqur që pjesë e këtij projekti do të jetë edhe lumi Stanishorka, duke uruar që rregullimi i shtratit të saj të mos zgjas sa Mirusha, apo aq sa është afati për kthimin e kredisë. Ndërkohë, PDK ka lëshuar një komunikatë, ku thotë se propozimi i tyre për financimin e projektit nga qeveria e Kosovës, u votua kundër nga këshilltarët e LDK-së. Përndryshe, ata kanë thënë se e përkrahin këtë projekt, por ishin kundër futjes së Komunës në borxhe. Në debat janë përfshirë edhe anëtarët tjerë të Kuvendit. Isa Agushi (LDK) ka thënë se kredia po merret për të zgjidhur një problem madhor, jo për dreka e darka. Bajram Hasani, këshilltar i pavarur, tha se edhe borxhet e kaluara janë investuar diku. Sipas tij, më e mira do të ishte sikur të sigurohej një donacion për këtë projekt dhe jo të hyjmë në borxhe. Riad Rashiti (PDK) ka shprehur dyshime nëse kredia do të lejohet nga austriakët, duke përmendur problemin në "Ecohigjienë", ku partner është një kompani austriake, por edhe nëse ndodh, Komuna duhet të kërkojë nga qeveria që ta marrë këtë obligim, ka thënë ai. Ismet Hajdini (AKR) ka kërkuar të mos politizohen investimet. "Ne jemi këtu për të zgjidhur problemet e qytetarëve dhe jo për t'i politizuar projektet", ka thënë ai, duke shtuar se nuk ka nevojë të brengosemi për borxhin, sepse, siç ka thënë ai, sot nuk ka shtet në BE që nuk është në kredi. Edhe Fehmi Sylejmani (VV), i cili ka thënë se zgjidhja e problemeve me kredi nuk është për mburrje, është pajtuar me propozimin që kredia t'i lihet qeverisë. Arben Maliqi (LDK) e ka cilësuar projekt gjigant trajtimin e ujërave të zeza dhe ka kërkuar që këshilltarët komunalë të jenë bashkë, ndërkohë që Nevzat Rushiti (LDK) i ka rikujtuar ata se kredi për rregullimin e infrastrukturës kanë marrë edhe Prishtina, Peja, Gjakova dhe të tjera dhe Gjilani nuk është komuna e parë që merr hua. Kryesuesja Valentina Bunjaku-Rexhepi sqaroi se sipas marrëveshjes me qeverinë austriake, qeveria e Kosovës obligohet të garantojë pagesën e kredisë. Ajo e ka hedhur në votim edhe propozimin e opozitës për t'i kërkuar qeverisë që ta merr përsipër kredinë, por nuk i ka marrë votat e mjaftueshme. Sa i përket raportit të punës së Komisionit të Aksionarëve në "Ecohigjienë", ku po ashtu është zhvilluar debat i gjerë, kryetari i Komunës, Lutfi Haziri ka kërkuar që të mos politizohet gjendja në këtë kompani. "Sot, ne po e përmbushim një detyrë ligjore. Komisioni i Aksionarëve ka obligim që ta paraqes raportin dhe të gjeturat në kompani. Po ashtu, ne po i koordinojmë aktivitetet me Këshillin e Punëtorëve, në mënyrë që ta normalizojmë punën", ka thënë ai. Krye-

tari Haziri ka kërkuar nga asambleistët e Kuvendit që të ndihmojnë normalizimin e kompanisë, duke i rikujtuar ata se Kuvendi Komunal është bartës i kontratës. Xhelal Jetishi, kryesues i Komisionit të Aksionarëve në "Ecohigjienë" ka thënë se partneriteti publiko-privat nuk është kundërshtuar asnjëherë prej tyre, por çështja është se nuk janë përmbushur obligimet nga partneri privat. Gjendja në kompani është vlerësuar e rënduar edhe nga Avdyli Aliu (LDK), i cili ka sugjeruar që t'i jepet përkrahje kryetarit të Komunës që të angazhohet për zgjidhjen e problemit. Sipas Riad Rashitit (PDK), fajtorë për këtë gjendje në "Ecohigjienë" janë të dyja palët, sepse ka munguar bashkëpunimi i ndërsjellë. Selami Xhemajli (AAK) ka thënë se Komisioni i Aksionarëve ka konstatuar mos përmbushjen e obligimeve nga partneri privat dhe ne duhet të insistojmë që këto obligime të përmbushen, ka thënë ai. Nevzat Isufi (VV) ka thënë se mos përmbushja e obligimeve nga partneri privat, është problem serioz. "Duhet t'i kërkohej këtij partneri që brenda një afati të caktuar t'i përmbushë kushtet e kontratës, ose ndryshe kontrata duhet të rishikohet", ka thënë ai, duke sugjeruar që zgjidhja të kërkohej përmes një komisioni neutral. Isa Agushi (LDK) ka qenë më i ashpër. Sipas tij, gjendja në "Ecohigjienë" është e pa tolerueshme. Komisioni i Aksionarëve injorohet nga partneri privat, i cili quhet investitorë në marrëveshje, por në realitet nuk ka investuar asgjë, pos që i ka shitur asetet publike. Ai ka kërkuar që në këtë kompani të caktohet urgjentisht një ushtrues detyre i drejtorit ekzekutiv, sepse "Ecohigjienë" ka mbetur pa zot shtëpie, ka thënë Agushi. Ibish Ibishi (AAK) ka thënë se raporti i partnerit privat, shumë pak i përgjigjet realitetit, sepse vetëm 9 për qind të investimeve janë realizuar. "Ky nuk është partneritet", ka thënë ai. Edhe Leonora Bunjaku (PDK) ka thënë se nuk ka arsye për mos përmbushje të obligimeve. Fehmi Sylejmani (VV) ka propozuar që Kuvendi të formojë një komision për vlerësimin e gjendjes, i cili do të udhëhiqet nga opozita. Komision ka propozuar edhe Sahit Abazi (PDK), por ai e ka quajtur komision lehtësues, i cili do t'i ofronte palët në këtë kompani, për të punuar bashkërisht në tejkalimin e situatës së krijuar. Valentina Bunjaku - Rexhepi, kryesuese e Kuvendit Komunal ka thënë se ne i kemi aksionarët në këtë kompani dhe nuk kemi nevojë për komisione shtesë atje. "Kuvendi Komunal nuk është ai që vendos për prishjen e këtij partneriteti", ka thënë ajo dhe ka kërkuar nga grupimet politike në asamble që t'i lihet kohë kryetarit të Komunës ta zgjidh këtë situatë, në bashkëpunim me partnerin privat.



Shpërndahen 140 mijë kilogramë farë gruri për fermerët

14
TETOR

Falë planifikimit të Drejtorisë së Bujqësisë së Gjilanit dhe me mbështetje të kryetarit të Komunës, Lutfi Haziri, sot është bërë shpërndarja e farës, për mbjelljet vjeshtore për 730 fermerë, të cilët nuk kanë arritur t'i plotësojnë kriteret e Ministrisë së Bujqësisë.

Kushtet klimatike dhe përgatitja e fermerëve është mjaftë e mirë dhe në parametrat e kërkuar edhe profesional që të bëhet mbjellja vjeshtore, ka thënë gjatë shpërndarjes së farës, drejtori i Bujqësisë së Gjilanit, Ramiz Ramadani. "Së pari ndjehem shumë i kënaqur që kushtet klimatike janë jashtëzakonisht të mira për mbjelljet vjeshtore. Fara do të shpërndahet gjatë ditës së sotme dhe gjatë gjithë uikendit në mënyrë që bujqit të bëjnë mbjelljen e saj për kohë të mirë. Në këtë fazë po mbështesim nga buxheti i Komunës së Gjilanit 730 fermerë, me gjithsej 140 mijë kilogram farë gruri, që do të mbjellën rreth 600 hektarë, nga 3 mijë sa është e planifikuar të jenë gjithsej të mbjella në Gjilan. Kjo është arritur falë përkrahjes së plotë të kryetarit Haziri, i cili projektet për zhvillimin e bujqësisë dhe mbështetjen për fermerët përherë i aprovon në afatin më të shpejtë të mundshëm", ka deklaruar drejtori, Ramadani. Ai gjithashtu ka dhënë

edhe detajet tjera sa i përket cilësisë së farës, e cila sipas tij, është me një potencial të lartë të rendimenteve dhe shumë e përshtatshme për tokën e Gjilanit. "Këtë vit jemi përcaktuar për varietetet kroate të Institutit të Osjekut, që kanë një cilësi të lartë dhe potencial gjenetik të rendimenteve mbi 11 tonë për hektar. Këto varietete janë edhe në listën kombëtare të farërave dhe lehtë të adapteshme për tokën e Gjilanit. Rendimentet e vitit 2016 ishin rekorde, që përpos kushteve klimatike shumë të favorshme, një rol të madh ka luajtur edhe fara cilësore, mekanizimi bujqësor i përdorur dhe masat tjera që janë ndërmarrë nga fermerët", ka spikatur në fjalën e tij Ramadani. Drejtori i Bujqësisë, gjithashtu, ka paralajmëruar edhe projekte tjera gjatë këtij muaji dhe deri në fund të vitit për këtë sektor, ndërsa theksoi se planifikimet për vitin e ardhshëm janë edhe më të mëdha. Ndryshe, fusha e bujqësisë në Gjilan, nga Komuna e Gjilanit është duke u mbështetur gjithnjë e më shumë. Nga informacionet e drejtorit Ramadani, është bërë e ditur se pos farës së siguruar cilësore, fermerët janë pajisur në projekte të ndryshme edhe me material fidanor, konstruksione të serrave, pajisje për bletarët, makina mjelëse, rregullim të infrastrukturës rrugore, mekanizim bujqësor, etj.



Haziri e Kosumi, marrëveshje bashkëpunimi për dixhitalizim të Stacionit të Autobusëve dhe shkollave të mesme

13
TETOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, me bashkëpunëtorë kanë qëndruar sot në Universitetin e Gjilanit "Kadri Zeka", ku ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me rektorin e universitetit, Bajram Kosumi, për dixhitalizimin e shërbimeve në ndërmarrjen publike "Stacioni i Autobusëve" dhe dixhitalizim të shkollave të mesme, përmes ueb faqeve, në mënyrë që dy nivelet e institucioneve, në këtë rast Komuna dhe Universiteti të jenë përfituese. Kryetari i Komunës Lutfi Haziri, ka thënë se kjo marrëveshje u ofron qytetarëve informacione të mjaftueshme, ndërsa studentëve njohuri praktike se si të punohet praktikisht në profesionin e tyre.

"Ky program për digjitalizimin e të gjitha shërbimeve në Stacion të Autobusëve dhe të gjitha shkollave të mesme, është hapi i parë i madh i bashkëpunimit dhe i mbështetjes që rektorati përmes dekanatit dhe studentëve do t'i japë mbështetje ndërtimit të ueb faqeve, organizmit të shërbimeve dhe aspekte tjera në shërbim të Gjilanit dhe më gjerë. Gjilani tashmë është pjesë e "Smart City", program i cili mundëson teknologji të ndryshme si "IOS", "Android" dhe programe të tjera të qasen dhe të jenë pjesë e Komunës", ka thënë Haziri. Haziri tha se universiteti do të prodhojë kuadro që do ta zhvillojnë edhe vendin tonë. "Ky program kërkon edhe informacione shtesë, në

mënyrë që njerëzit kur e kërkojnë Gjilanin mund ta gjejnë përmes programeve të ndryshme një numër të madh të informatave. Shpresoj shumë që rektorati do të vazhdojë mbështetjen edhe në programe të tjera që janë në interes të Komunës, që ta arrijmë qëllimin tonë të përbashkët, që Gjilani dhe Anamorava ta zënë hapin e madh të zhvillimit të gjithmbarshëm jo vetëm në sektorin e arsimit, por, edhe në zhvillimin ekonomik ku shpresat kryesore janë këtu. Ky universitet do të prodhojë kuadro që do ta zhvillojnë edhe vendin tonë", ka thënë kryetari Haziri. Ndërsa, rektori i Universitetit "Kadri Zeka", Bajram Kosumi, ka thënë se kjo është një marrëveshje e cila po bëhet së pari me Komunën e Gjilanit dhe është e vetmja e kësaj natyre, duke potencuar se angazhimi do të jetë maksimal dhe gjithnjë në shërbim të përgatitjes së studentëve për tregun e punës. "Kjo marrëveshje është shumë e mirë, sepse si praktikë nuk është e shpeshtë në universitetet tjera. Por, kjo marrëveshje është e mirë edhe për studentët sepse përpos diplomës së notuar, prapa vetes ata do të marrin edhe një përvojë të mirë në realizimin e punëve të pavarura me një përgatitje të mirë profesionale për tregun e punës", ka thënë rektori Kosumi, duke pohuar se në këtë universitet është duke u punuar në cilësi të lartë.



Lutfi Haziri falënderon ambasadoren turke për mbështetjen për Gjilanin

12
TETOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur në takim ambasadoren e Turqisë në Kosovë, Kivilcim Kiliç, të cilën e ka falënderuar për bashkëpunimin dhe kontributin e shtetit turk në disa fusha për Gjilanin.

Në takim, kryetari Haziri ka folur për frymën e tolerancës dhe bashkëjetesës me të gjitha komunitetet në Gjilan, duke thënë se bashkëpunimi mes vete duhet vazhdohet me këtë shembull të mirë të ruajtjes së këtyre vlerave për të ardhmen e Komunës së Gjilanit. Kryetari Haziri vlerësoi

lartë prezencën turke që është në Gjilan është në tri nivele: atë diplomatik, ushtarak dhe ai i mbështetjes financiare në disa fusha përmes agjencionit shtetëror "Tika". Përndryshe, sot kryetari Haziri ka pritur edhe një delegacion nga Turqia, përkatësisht Ismail Haxhi Hasan Oglu, zyrtar për investime në Ministrinë e Arsimit të Turqisë dhe drejtorin e Arsimit në Komunën Osmangazi, Gyrhan Qokgezer, të cilët i ka falënderuar për donacionet e ofruara për disa shkolla të Gjilanit, që janë një sasi e konsiderueshme të projektorëve, tabela të mençura dhe pako me libra për dy shkolla.

Ministria e Punës dhe Komuna e Gjilanit në shërbim të zhvillimit ekonomik dhe punësimeve të reja



11
TETOR

Në organizim të Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komunës së Gjilanit, sot është mbajtur takim i përbashkët me bizneset të cilat kanë qenë bashkëpunuese në krijimin e vendeve të reja të punës, në regjionin e Gjilanit, që nga një projekt i vetëm janë siguruar vende të përhershme për një numër të konsiderueshëm të punëtorëve.

Në këtë takim i pranishëm ishte edhe ministri Arban Abrashi, zv.ministria Rita Hajzeraj, kryetari i Komunës, Lutfi Haziri dhe bashkëpunëtorë të tjerë, të cilët njëzëri kanë theksuar që urat lidhëse mes institucioneve, bizneseve dhe punëkërkuessve janë gjithnjë të mundshme kur është një disponim i përbashkët për orientim të politikave në funksion të zhvillimit ekonomik. Me këtë rast ministri Abrashi, ka potencuar se nëse bashkërisht dëshirohet një zhvillim ekonomik dhe punësim, atëherë në Kosovë duhet një orientim i veçantë dhe me përkushtim drejtë sektorit privat. "Sektori privat është çelësi i zhvillimit ekonomik. Mëse të nevojshme janë reformat në arsim dhe përgatitjet e kuadrit profesional për zhvillimin ekonomik, duke stimuluar nxënësit që të regjistrohen në drejtime të cilat gjithnjë janë të hapura për punësim në të ardhmen. Me subvencionimin e pagës kemi arritur që në kuadër të programit për punësim, sot të kemi një numër të vogël të të punësuarve, mirëpo kur kemi parasysh nevojat e mëdha për punësim, kjo shifër duhet të na shërbej si shpresë për të ardhmen. Shumë shpejtë do të nisim me fazën tjetër dhe me programin tjetër atë të mbështetjes së punës praktike në sektorin privat, që gjithashtu është një mundësi për punësim dhe krijim të kushteve më të mira", ka thënë ministri Abrashi në fjalën

e tij. Ndërsa kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, duke e ndërlidhur këtë takim me ditën e martë si ditë të hapur të takimit të qytetarëve me kryetarin, ka thënë se 90 për qind e rasteve që takojnë kryetarin, kërkesën e vetme kanë punësimin. "Sot është e martë dhe kjo ditë gjithnjë i është lënë e hapur ekskluzivisht qytetarëve që të takohen drejtpërdrejtë me kryetarin e Komunës. Për më pak se dy muaj në zyrën time kam pritur më shumë se 5 mijë e 200 qytetarë dhe prej tyre 90 për qind e rasteve janë me kërkesa të drejtpërdrejta për vende pune. Administrata e shtetit nuk është gjeneratori i punësimit, por ajo mundësi ekziston vetëm në sektorin privat i cili është me potenciale shumë më të mëdha, gjithnjë duke llogaritur mbështetjen e shtetit për to. Shpëtimi i vendit në fushën e punësimeve është vetëm përmes zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit më të madh, bizneseve private. Programet e ministrisë gjithnjë e më shumë janë lehtësuese sepse për kohë të caktuar krijohen vende pune sezonale por të shumtën e rasteve edhe vende të rregullta pune", tha kryetari Haziri. Ai më tej ka pohuar se ata që krijojnë sot një vend të ri pune në Kosovë, janë më meritoret për zhvillimin ekonomik. Ndërsa, Jakup Berisha, afarist nga Komuna e Gjilanit ka paraqitur si problem mungesën e kuadrove profesionale, ngase sipas tij sot mungojnë kuadrot si mekanik, elektrikist, përpunues të mishit dhe profesione të ngjashme. Më tej Berisha potencoi faktin që për fat të keq shumë të rinj të diplomuar duhet që sot të punojnë punë jashtë profesionit të tyre, si kamerier, shofer, punëtor ndërtimi apo diçka të ngjashme, ngase profesioni për të cilin janë diplomuar nuk gjeneron vende të përhershme të punës.



Gjilani me donatorë e bëjnë me shtëpi të re familjen Halili në Verbicë të Zhegocit

11
TETOR

Në Verbicë të Zhegocit në Gjilan, në prag të dimrit sot është bërë përrurimi i shtëpisë së re për familjen Halili, e cila ka pesë anëtarë të familjes dhe ka jetuar në kushte të rënda ekonomike dhe sociale, gjithnjë e përcjellë me skamje të madhe, me lagështi e të ftohtë, sepse ajo në të cilën jetonte kjo familje deri para pak kohësh, ishte gjithçka tjetër por shtëpi e cila plotësonte as kushtet elementare.

Sot, në orët e pasdites kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, nën shoqërimin e donatorit Basri Hyseni, kanë bërë përrurimin e shtëpisë së re për këtë familje e cila tani e tutje do të ketë një jetë shumë më të mirë. Me fjalët e përgëzimit për familjen, kryetari ka thënë se ndërtimi i kësaj shtëpie është mesazhi më i mirë i solidaritetit ndaj familjeve në nevojë dhe mbështetjes. “Përrurimi i kësaj shtëpie më gëzon jashtëzakonisht shumë, sepse familja deri më tani kanë jetuar në kushte të rënda të banimit. Sot u bë rasti i 38 me radhë, i përfituesit në kuadër të aksionit të banimit social “Pak nga ne shumë për ata” dhe po vazhdojmë të mbështesim çdo familje që është në nevojë dhe me prioritet, sikur që jemi edhe në programe tjera për renovime dhe rindërtime të shtëpive për këtë kategori. Falënderoj sinqerisht donatorin, në këtë rast familjen Hyseni me angazhim dhe punë në diasporë, e cila ka ndarë mjetet nga kursimet e tyre që ta ndihmojnë një familje të tillë në vendlindjen e

tyre”, ka pohuar kryetari Haziri, derisa ka kërkuar që shembuj të tillë të ndiqen edhe nga të tjerët, sepse Gjilani ka ende shumë nevoja në këtë drejtim. Ndërsa, i gëzuar me shtëpinë e re, Përparim Halili, përfitues, ka thënë që është kjo hera e parë që dimri po vjen më i ngrohtë se herave tjera. “Për herë të parë dimrin familja ime do ta pres me ngrohtësi dhe pa lagështi, pa të ftohtë, pa rrjedhje të shiut e borës brenda e me kushte krejt tjera. Fëmijët e mi sot po shkelin në kushte krejt tjera nga ato që kishim dje. Kjo është bërë falë mbështetjes së kryetarit dhe të donatorit, të cilët nuk kam fjalë që t’i falënderoj”, tha i emocionuar Halili, duke falënderuar edhe të gjithë të tjerët që kanë kontribuar për këtë që ai sot ka. Ndërsa donatori, Basri Hyseni, ka pohuar se ndjehet krenar që falë atij dhe familjes së tij, kjo familje sot është e lumtur. “Kur shoh gëzimin e familjes, të fëmijëve të kësaj shtëpie, të prindërve të tyre, sa ndjem krenar, gjithashtu kam edhe shumë emocione, sepse fatmirësisht që nga sonte kemi një rast më pak që jeton pa kulm mbi kokë. Kjo familje shpresojmë të shtohet, të përparojë dhe kushtet e saj të jenë gjithnjë e më të mira. Do të jemi gjithnjë pranë kësaj familje dhe të tjerave gjithandej. Lus të gjithë njerëzit e vullnetit të mirë dhe ata që kanë mundësi që të ndjejnë atë që sot ne po ndjejmë, sepse vërtetë është shumë mirë të jemi ata që bëjmë me shtëpi dikë tjetër”, ka përfunduar Hyseni, duke falënderuar familjen e tij për mbështetjen.



Lidhja Shqiptare në Botë katër shtete i bënë bashkë në Gjilan

8
TETOR

Lidhja Shqiptare në Botë ka mbledhur sot në Gjilan përfaqësues nga të gjitha trojet shqiptare, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi e Kosova, në Kuvendin e tretë për zgjedhjen e kryetarit të saj në Kosovë. Të pranishmit, në emër të kryetarit Lutfi Haziri, i ka përshëndetur nënkryetari Rexhep Kadriu, i cili ka thënë se jeni një grup i veçantë që nëtë pesë kontinentet e botës shpërfaqni atdhedashuri për kombin, për vendin dhe popullin shqiptar.

“Gjilani është krenar që sot ju ka juve mysafirë këtu. Por, ju e dini se jeni në shtëpinë tuaj. Ju e dini se jeni në vendin tuaj. Ju, përkrahës dhe kontribuues të aktiviteteve të Lidhjes Shqiptare në Botë jeni edhe një zë i çmuar i kauzës sonë kombëtare. Jeni punonjës të së mirës dhe qëllimeve tona të përbashkëta. Jeni një grup i veçantë që në të pesë kontinentet e botës shpërfaqni atdhedashuri për kombin, për vendin dhe popullin tonë shqiptar”, ka thënë Kadriu. Kryetari i Lidhjes Shqiptare në Botë, Simon Kuzhnini, ka shprehur kënaqësinë e përzemërt që po merr pjesë në këtë eveniment me përfaqësues nga të gjitha trojet shqiptare. “Është kënaqësi e përzemërt që jam në mesin tuaj. Platforma kombëtare e LSHB-së ka në gjirin e saj të gjitha partitë politike e shoqatat. Qël-

limi ynë është që t'i afrojmë shqiptarët, të ndihmohemi mes vete dhe ta duam njëri tjetrin. Duhet të besatohemi e të punojmë shumë që të mos ketë vëlla vrasje sepse kjo nuk i shkon shqiptarëve”, ka thënë Kuzhnini. Ai ka paralajmëruar në fund të fjalimit të tij që në kuadër të Lidhjes Shqiptare në Botë do të krijohet një fondacion, i cili i dedikohet kryesisht arsimit e shëndetësisë, ku do të ndihmohen studentët e ekselencës dhe njerëzit që kanë nevojë për shërim jashtë vendit. Kuvendi i Lidhjes Shqiptare në Botë po i vazhdon punimet në Kuvendin e tretë për zgjedhjen e kreut të saj në Kosovë.



Mayors for Peace

平和市長会議



Gjilani anëtarësohet në organizatën ndërkombëtare Mayors for Peace

6

TETOR

Komuna e Gjilanit ka marrë sot konfirmimin e anëtarësimit në organizatën ndërkombëtare “Mayors for Peace”, me seli në Hiroshima të Japonisë. Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, e ka vlerësuar tejet të rëndësishëm anëtarësimin në këtë organizatë, duke thënë se kjo i jep mundësi bashkëpunimi me këtë rrjet të madh të qyteteve, jo vetëm në aspektin e paqes, por edhe atë socio-kulturor.

Misioni i organizatës “Mayors for Peace”, e cila kryesohet nga kryetari i Hiroshimës, Kazumi Matsui, është shtrirja e paqes në aspekt global me bazë kundër armëve nukleare. Organizata është e themeluar në vitin 1982. Bënë shkëmbime mes administratave komunale për përvoja të reja dhe është rrjet që ka mbi 7 mijë qytete anëtare nga e mbarë bota.

Bunjaku-Rexhepi: Gratë kanë nevojë të ndërgjegjësohen sa më shumë për rrezikun që paraqet kanceri i gjirit

4
TETOR

Kanceri i gjirit prek sot mijëra gra në botë, pa përjashtuar as Kosovën. Për të rritur shkallën e ndërgjegjësimin ndaj luftës kundër kësaj sëmundje, Shoqata e Onkologëve të Kosovës, gjatë këtij muaji do të mbajë ligjërata me gratë në terren. Ciklin e ligjëratave, kjo shoqatë e ka hapur të martën në Gjiilan, për të vazhduar edhe në qendrat tjera, gjatë ditëve të ardhshme. Valentina Bunjaku-Rexhepi, kryesuese e Kuvendit Komunal dhe njëherësh, kryetare e Forumit të Gruas së LDK-së në këtë qytet, ka thënë se gratë kanë nevojë jo vetëm për ligjërata të këtilla, por qoftë edhe për një këshillë të mirë, për të ngritur njohuritë e tyre mbi rrezikun që paraqet kjo sëmundje.

Ajo tha se numri i grave pjesëmarrëse, do të ishte më i madh, sikur ligjërata të mbahej të shtunën, ose jashtë orarit të punës, meqë në këtë kohë (ora 13:00), shumica e tyre janë nëpër vende pune. Por, ajo premtoi se broshurat me këshilla për mbrojtje nga kanceri i gjirit, do të shpërndahen në terren, tek çdo familje. Përndryshe, Bunjaku-Rexhepi u shpreh e gatshme për të ndihmuar në organizimin

edhe të ndonjë tryeze tjetër, nëse vlerësohet e nevojshme, me shpresë që gratë të mos preken kurrë nga kanceri i gjirit. Kurse Nafije Latifi, themeluese e Qendrës kosovare për luftimin e kancerit të gjirit, ka thënë se qëllimi i këtyre ligjëratave është për t'i vetëdijësuar gratë se sëmundja e kancerit është në mesin tonë dhe kërcënon një numër të madh të tyre. Ajo i ka porositur gratë në Gjiilan që të bëjnë vetëkontroll të trupit dhe për çdo ndryshim që vërejnë, të paraqiten sa më parë te mjeku, duke nënvizuar se zbulimi i sëmundjes në fazën e hershme, trajtohet me lehtë dhe kërkon më pak shpenzime. Përndryshe, mjekët onkologë, në ligjëratat e tyre, kanë nënvizuar faktin se tetori, në të gjithë botën është muaji i ndërgjegjësimin për kancerin e gjirit, si nevojë për të rritur vëmendjen dhe mbështetjen për sensibilizimin, zbulimin e hershëm dhe trajtimin e kësaj sëmundje vrasëse.

Sipas tyre, nga kanceri i gjirit mund të preket çdo femër, por rreziku rritet më tepër me shtimin e viteve të jetës. Zakonisht preken moshat mbi 50-vjeç, por një kancer, sipas tyre, mund të shfaqet edhe tek moshat fare të reja.





Gjilani promovon projektin Smart City i pari në rajon

30
SHTATOR

30 shtator 2016 / Komuna e Gjilanit, përkatësisht Drejtoria e Administratës ka promovuar sot projektin e radhës inovativ “Gjilani Smart City”, të parin në rajon të kësaj natyre, i cili krijon një lidhje të drejtpërdrejtë me qytetarin, e bënë atë pjesë të qeverisjes, duke e rritur kështu në shkallë të lartë transparencën dhe efikasitetin në Komunë. “Gjilani tash po kalon në hapin e gjashtë të programeve që e dërgojnë drejt qytetit Smart City, apo qytetit të mençur, duke aplikuar forma të shërbimeve online dhe në kohë rekorde. Epiteti Smart City neve na bënë nder për shkak se numri më i madh i qytetarëve të Kosovës është shfrytëzues i teknologjisë informative. Përmes këtij shërbimi, është avancuar jashtëzakonisht shumë roli i qytetarëve”, ka thënë kryetari i Komunës, Lutfi Haziri.

“Edhe kësaj here Gjilani prin në këto procese dhe neve na bënë edhe më të përgjegjshëm dhe më reagues ndaj kërkesave të qytetarëve, duke përfshirë edhe denoncime, lajmërime, njoftime dhe parandalime eventuale që mund të shkojnë në siguri, arsim e shëndetësi. Besojmë që kjo e premte e madhe e Gjilanit dhe ky program do të jetë shembull jashtëzakonisht i mirë për Komunën tonë dhe qytetarët”, ka shtuar Haziri. Drejtori i Administratës, Nazim Gagica, ka njoftuar se ky është projekti i gjashtë që po realizohet, pas Home-Komuna dhe E-kiosqet, për të vazhduar me One Stop Shop, Telework dhe Regjistrin Online të Procedurave Administrative. “Ky është projekti inovativ, i cili po impelentohet për herë të parë në

rajon. Projekti krijon një lidhje të drejtpërdrejt me qytetarin e komunës së Gjilanit, e bënë pjesë të qeverisjes, duke e rritur kështu në shkallë të lartë transparencën dhe efikasitetin në Komunë. Kjo ka të bëjë me shërbimet komunale në fushën e ekonomisë, arsimit, sigurisë dhe shëndetësisë. Të gjitha të dhënat, qytetari i Gjilanit i ka në xhepin e tij dhe do të raportoj direkt menaxhmentin e lartë të Komunës për ankesat e kërkesat e mundshme dhe natyrisht këto do të shkojnë direkt edhe te kryetari i Komunës”, ka thënë Gagica. Në promovimin e këtij projekti ka marrë pjesë edhe drejtoresha e Divizionit për Transparencë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Nazmije Krasniqi, e cila e ka përgëzuar Komunën e Gjilanit, duke shfaqur shpresën se edhe komunat tjera do ta bëjnë një gjë të tillë. E falënderoj kryetarin Haziri që e ka realizuar një projekt të tillë dhe besoj që edhe komunat tjera do ta kenë këtë mundësi. Ne e monitorojmë transparencën nëpër komuna rregullisht dhe sipas raportit të fundit të MAPL-së, Komuna e Gjilanit ka dalë ndër komunat e para për transparencë në nivel vendi”, tha Krasniqi. Po ashtu, Komuna e Gjilanit është në fazën e implementimit të kamerave nëpër vendet publike në qytet dhe përmes Smart City, qytetarët mund t'i shohin direkt pamjet në secilën pjesë të qytetit. Aplikacioni është shfaqur në android dhe së shpejti pritet të shfaqet edhe në app store. Qytetarët e mund t'i qasen këtij shërbimi duke shënuar www.gjilani-smartcity.com, e cila është publikuar edhe në ueb faqen zyrtare të Komunës. Projektin do ta implementoj Zyra për Informim Publik.



Haziri takon Grupin e Përbashkët Punues për përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje

30
SHTATOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri priti sot në takim përfaqësuesit e projektit të AKT/USAID së bashku me Grupin e Përbashkët Punues, për të prezantuar angazhimet dhe rezultatet e arritura të punës një vjeçare. Kryetari Haziri, në këtë rast, ofroi mbështetje edhe pas përfundimit të projektit të AKT/USAID/RTC, që ky Grup të vazhdojë më tej si urë lidhëse dhe mekanizëm efektiv për përfshirje më cilësore dhe demokratike të qytetarëve në vendimmarrje.

Grup i Përbashkët Punues i themeluar enkas nga kryetari Haziri për përfshirjen më të gjerë të qytetarëve në

vendimmarrje komunale, paraqiti objektivat e arritura duke bërë të mundshme që këtë vit të rris pjesëmarrjen në debate publike dhe dëgjime buxhetore në rreth 30 për qind krahasuar me vitin e kaluar dhe 20 për qind rritje të pjesëmarrjes më të madhe të rinisë, komuniteti joshumicë etj. Kryetari Haziri ka ofruar mbështetje që ky Grup të vazhdojë më tej si urë lidhëse dhe mekanizëm efektiv për përfshirje më cilësore dhe demokratike të qytetarëve në kërkesat e tyre.

Haziri: Askush nuk është duke zier çorba në Prishtinë për Gjilanin, por pikërisht në Gjilan është zier çorba!

29
SHTATOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, në seancën e sotme të Kuvendit Komunal të Gjilanit, u është përgjigjur të gjitha interesimeve të asambleistëve të opozitës, lidhur me ndryshimet në statutin e Komunës, sikur edhe rreth aktakuzave të fundit të prokurorisë ndaj ish-udhëheqësve komunalë dhe pretendimet e prokurorit ndaj kontratës së parkingjeve. Fillimisht, kryetari Haziri ka folur për protestën e sotme të punëtorëve të kompanisë “Ecohigjiena”, duke thënë se është angazhuar drejtpërdrejt në zgjidhjen e problemeve të tyre.

“Protesta e sotme e punëtorëve të kompanisë “Ecohigjiena” është bërë për të sensibilizuar Kuvendin Komunal sepse ata për çdo ditë protestojnë një orë dhe ne çdo ditë kemi takime pune me këshillin e punëtorëve. Unë jam duke punuar drejtpërdrejt edhe me kryetarin e bordit dhe aksionarin e madh të kompanisë në mënyrë që t’i zgjidhim problemet e menaxhmentit dhe kompanisë”, ka thënë Haziri. Ndërsa, duke folur për ndryshimet e statutit, kreu i gjilanasve ka pohuar se pritjet e NJKRS-së kanë qenë më të mëdha se rezultatet e deritanishme, derisa për Drejtorinë e Inspeksionit tha do të funksionoj pa inspektorët e ndërtimit, pasi këta të fundit janë të obliguar me ligj të mbeten ne resorin përkatës. “Ndryshimi i statutit nuk ka të bëjë as me kërkimfalje, dështim e kataklizma. Sa i përket Njesisë për Kulturë, Rini dhe Sport, pritjet kanë qenë më të mëdha sepse kam dashur ta dekoncentroj detyrën dhe buxhetin për ta, ua kemi dhënë mundësinë gati dy vjet dhe dua të them se nuk po mund të dalin nga shablloni i vjetër sepse është shkaktuar varësi kronike në subvencion. Ndërkaq, te inspeksioni, ligji e thotë që inspektorët e ndërtimit duhet të jena brenda resorit përkatës, pra urbanizimit dhe unë këtë do ta respektoj”, u shpreh Haziri. “Sa i përket aktakuzave, është lajm dhe kronikë e zezë për Gjilanin, pasi qyteti jonë është njohur gjithmonë si qytet i paqes, i qetë dhe qytet në të cilin nuk ka krim. U bënë gati tre vite dhe asnjë vrasje për motive të ulëta dhe politike. Pretendimet e prokurorit kundër meje në rastin e kontratës së parkingjeve, i njëjti organ i ka hedhur si të pa baza më herët, por kjo është rikthyer me denoncim të grupit të këshilltarëve të PDK-së në emër të Riad Rashitit.



Pretendimi në këtë rast është i paragjykuar”, tha ai. “Sa i përket vetës sime, unë e them publikisht që çfarëdo që vendosë gjykata unë i përgjigjem plotësisht verdiktit dhe vullnetit të tyre. Por, ajo që dua të them është se nuk është duke “zier” çorba askush në Prishtinë për Gjilanin, por përkundrazi çorba është zier në Gjilan. Gjithmonë është ajo që thotë populli, por që Beqir Musliu më së miri e ka përshkruar në librin e tij që ka të bëjë më përshkrimin e njerëzve të Anamoravës, e ka thënë se “njerëzit e Anamoravës e kanë durimin deri në qiell, por e sosin jorganin për një plesht”, tha Haziri. “Ndërkaq, pretendimet e prokurorit për krim të organizuar si vepër karshi ish-kryetarit dhe 39 zyrtarëve tjerë është shqetësim dhe është aktakuzë që peshon. Konfirmoj publikisht se sa i përket aktakuzës ndaj ish kryetarit, asnjë letër dhe asnjë dosje nuk ka shkuar në prokurori as prej meje, e as nga stafi im. Nëse gjen dikush që një drejtor i Komunës ka iniciuar këtë punë, unë japë dorëheqje. Ju lutem, mos i politizoni rastet, por t’i lëmë gjykatat që të bëjnë punën e tyre”, theksoi kryetari i Gjilanit. “Unë kam kërkuar interpretim në zyrën ligjore në qeveri sepse mungesa e 30 personave në administratë është shumë e madhe, në mënyrë që ta gjejmë një zgjidhje për ta përballuar situatën. Shërbyesit civil që kanë aktakuza, sipas ligjit do të suspendohen me 50 për qind të pagesës pasi të kemi pranuar aktakuzat nga prokuroria. Të gjithë duhet të trajtohen si të pafajshëm, derisa gjykata nuk e thotë të kundërtën”, ka thënë, ndër të tjera, kreu i Gjilanit, Lutfi Haziri në seancën e sotme të Kuvendit Komunal të Gjilanit. Ndryshe, Kuvendi Komunal i Gjilanit po i vazhdon punimet me pika të rëndësishme të rendit të ditës.



Kuvendarët e Gjilanit bashkojnë votat te nisma për ndryshimin e statutit, por jo edhe te buxheti

29

SHTATOR

Kuvendi Komunal i Gjilanit, të enjten, në seancën e radhës, të udhëhequr nga Valentina Bunjaku-Rexhepi, kryesuese, ka miratuar iniciativën e kryetarit Lutfi Haziri për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të Komunës, rregulloren për tatimin në pronë për vitin 2017, buxhetin 2017, raportin e punës janar-qershor 2016 të Komisionit të Aksionarëve të NPL "Stacioni i Autobusëve", planin e veprimit për energji të qëndrueshme, vendimin për lejimin e shfrytëzimit të dy pronave komunale, njëra për nevoja të kishës ortodokse në fshatin Cërrnicë dhe tjetra për nevoja të ndërtimit të një xhamie në fshatin Nasalë.

Kuvendi diskutoi edhe për raportin e auditimit të pavarur për vitin 2015 si dhe u informua për fillimin e vitit të ri shkollor, përkatësisht për përfundimin e korrje-shirjeve të sivjetme. Kurse raporti i Komisionit të Aksionarëve të kompanisë "Ecohigjiena", përkatësisht debati për gjendjen në këtë kompani, ku ka edhe greva të punëtorëve, u shty për një seancë të veçantë. Paraprakisht, Kuvendi votoi për përjashtimin nga seanca të këshilltarit Srgjan Mitrovic, për shkak se ai udhëheq strukturat paralele serbe. Kryesuesja Valentina Bunjaku-Rexhepi, tha se Mitrovic duhet të deklarohet se është vetëm anëtar i Kuvendit

Komunal dhe se këtu mbron interesat e komunitetit serb dhe nuk përfaqëson interesa të strukturave paralele në Kosovë, të cilat janë ilegale. Propozimin-buxhetin për vitin 2017, ku një pjesë e opozitës votoi kundër, e ka prezantuar Zijadin Maliqi, drejtor për Financa, i cili ka thënë se buxheti i vitit të ardhshëm do të jetë 22.657.746 euro ose 6.1 për qind më i madh se i vitit 2016, përkatësisht 1.3 milion. Maliqi tha se për të arritur deri ë Kuvend Komunal, propozim-buxheti ka kaluar nëpër një proces të gjatë, përfshirë edhe 13 dëgjime publike me qytetarë, për t'i dëgjuar kërkesat e tyre dhe për t'i projektuar ato në prioritetet e vitit të ardhshëm. Në dy vitet tjera, buxheti do të ketë një rritje të lehtë prej 2 për qind më 2017, përkatësisht një për qind më 2018, në krahasim me vitet paraprake. Të hyrat vetanake do të jenë më të larta për 15 për qind, përkatësisht do të jenë 4.6 milionë, kurse investimet kapitale shënojnë një rritje prej 22 për qind, ka thënë Maliqi. Ngarkesë shtesë për buxhetin e Komunës, sipas Maliqit, paraqet granti për arsim, i cili sipas formulës që zbaton MASHT-i nuk i plotëson nevojat e kësaj Komune, ku mësimi zhvillohet në katër gjuhë mësimore, prandaj duhet të merren mjete nga granti i përgjithshëm dhe të hyrat vetanake, por kjo i dëmton investimet kap-

itale. Avdyli Aliu (LDK) tha se grupi i këshilltarëve të këtij subjekti i jep përkrahje këtij propozim buxheti. "Shifrat kam pasur rast t'i dëgjoj edhe nëpër debate publike dhe me rëndësi është që kërkesat e qytetarëve janë marrë parasysh", ka thënë ai. Projekt-buxheti ka marrë përkrahje edhe nga grupi i këshilltarëve të AAK-së. "Ne mirëpresim veçmas rritjen e investimeve kapitale dhe uljen e shpenzimeve komunale, ka thënë Selami Xhemajli. Këshilltarët e opozitës kanë pasur vërejtjet e tyre. Riad Rashiti (PDK), në emër të grupit të këshilltarëve të këtij subjekti, e ka vlerësuar të papranueshëm projekt-buxhetin, duke thënë se nuk i plotëson nevojat e qytetarëve dhe nuk ofron perspektivë për zhvillim. Kurse Krenare Latifi, në emër të grupit të këshilltarëve të VV, po ashtu në opozitë, ka thënë se ky buxhet nuk është për t'u lavdëruar. "Nëse kjo qeverisje ka problem për t'i inkasuar të hyrat vetanake, atëherë është dashur të planifikohet një rritje më e vogël", ka thënë Latifi. Në debatin për buxhetin kanë marrë pjesë edhe Fatbardha Selmani (PDK), Nevzad Isufi (VV), Sahit Abazi (PDK), Nevzad Rushiti (LDK) dhe të tjerë, të cilët kanë ngritur edhe çështje konkrete. Lutfi Haziri, kryetar i Komunës, ka thënë se ky buxhet nuk është i mjaftueshëm, aq më pak kur duhen rreth 3 milionë euro për t'i mbuluar mungesat e mjeteve të disa kategori, siç është arsimit, por kaq janë mundësitë buxhetore të Kosovës. Haziri ka thënë se investimet e mëdha, siç janë ujërat e zeza, uji i pijes, rrugët regjionale, autostrada dhe projekte të tjera, nuk bëhen nga buxheti i Komunës, por me ndihmën e donatorëve, përkatësisht qeverinë e Kosovës, duke shtuar se nga tetori e tutje, në Gjilan do fillojnë projekte të mëdha. Nismën për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të Komunës, si nevojë për rithemelimin e drejtorive të Kulturës dhe të Inspeksionit, të cilin e ka arsyetuar kryetari i Komunës, Lutfi Haziri e ka përkrahur edhe opozita (PDK e VV), duke rikujtuar se ata kanë qenë kundër riorganizimit të këtyre dy sektorëve, para tri vitesh. Lutfi Haziri, kryetar i Komunës, ka thënë se dekoncentrimi i këtyre sektorëve, nuk i ka arsyetuar pritjet e tij. Ai ka dhënë sqarime edhe për anulimin e konkursit për drejtor të Teatrit, duke thënë se ka qenë i detyruar ta bëjë këtë për shkak të anomalive që ka bërë komisioni gjatë poentimit të kandidatëve. Disa janë poentuar me maksimumin e pikëve, disa të tjerë me zero pikë, ka thënë Haziri. Sahit Abazi (PDK) tha se opozita e kishte konsideruar gabim shuarjen e dy drejtorive, ndërkohë që ka pyetur se çka do të ndodh me

"task-forcën" në kulturë, pasi drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të themelohet përsëri. Nevzad Isufi (VV) tha se nismës është dashur t'i bashkëngjitet edhe një propozim i arsyetuar për nevojën e rikthimit të këtyre sektorëve në nivel drejtorish, ndërsa Fehmi Sylejmani vlerësoi se shpërndarja e këtyre dy drejtorive është pasuar me dështime në sektorin e Kulturës dhe të Inspeksionit. Nevzad Rushiti (LDK) vlerësoi se gjendja në këta sektorë është stabilizuar mjaft mirë, në krahasim me gjendjen e mëhershme. Sa i përket "task-forcës" Haziri tha se ajo do të shuhet pasi të themelohet drejtorja e Kulturës, sepse nuk e ka arsyetuar punën e vet. Valentina Bunjaku-Rexhepi, kryesuese e Kuvendit Komunal, duke i ftuar këshilltarët për votim, ka thënë se sot nuk miratohen ndryshimet në statut, por vetëm nisma për t'i bërë këto ndryshime dhe plotësime, të cilat do t'i përgatis komisioni. Sa i përket projekt-rregullores mbi tatimin në pronë, që sipas Zijadin Maliqit, drejtor për Buxhet, mbetet kryesisht e njëjtë me vitin e kaluar, Nevzad Isufi (VV) ka thënë se mungon një analizë e mirëfilltë, për t'i parë të metat e kësaj rregullore dhe për t'i marrë parasysh edhe vërejtjet e qytetarëve. Sipas tij, të disa kategori duhet të aplikohen norma stimuluese. Kuvendi diskutoi edhe për raportin e auditimit të pavarur për vitin 2015. Haziri kërkoi që raporti të lexohet drejt dhe të mos përdoret nga opozita për të sulmuar qeverisjen. "Ne i kemi pranuar rekomandimet e auditorit dhe shumicën e tyre i kemi realizuar", ka thënë kryetari Haziri. Planin e veprimit për energji të qëndrueshme e ka prezantuar Agim Zuzaku, drejtor për Zhvillim Ekonomik, i cili ka thënë se qëllimi i kësaj strategjie është kursimi i energjisë elektrike dhe reduktimi për 20 për qind i CO₂. Informatën për fillimin e vitit të ri shkollor e ka dhënë Shqipe Kastrati-Haziri, ushtruese e detyrës së drejtorit, duke thënë se falë përgatitjeve të duhura dhe me kohë, mësimi ka nisur mirë dhe mbarë në të gjitha shkollat. Shqetësimeve të opozitës për kampusin e shkollave të mesme dhe disa probleme të tjera në arsim, që i kanë ngritur Leonora Bunjaku (PDK), Nevzad Isufi (VV), Bujar Nezati (PDK) dhe të tjerë, u ka dhënë përgjigje Lutfi Haziri, i cili ka thënë se ideja nuk ka qenë që të ndahen nxënësit dhe të kufizohet personeli, por për të krijuar një hapësirë unike që e ndan shkollën nga pjesa tjetër e qytetit. Sa u përket ankesave për kufizim të lëvizjes, ai ka thënë se këto reagime janë të nxitura nga kafiteritë jashtë shkollës, për interesa të tyre.



Në Gjilan nis konferenca e kryetarëve të 17 komunave për bashkëpunim rajonal evropian

28

SHTATOR

Nën organizimin e kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka nisur sot konferenca e kryetarëve të Komunave për Bashkëpunim Rajonal Evropian, në të cilën po pjesë 17 komuna të mikroregjionit evropian nga Kosova, Serbia, Maqedonia e Bullgaria. Në hapjen e kësaj konference, kryetari Haziri tha se e ka marrë këtë nismë me qëllim të bashkëpunimit dhe angazhimit të përbashkët rajonal drejt synimit dhe përgatitjes për integritet evropiane.

“Qëllimi kësaj konference është bashkëpunimi dhe angazhimi i përbashkët rajonal drejt synimit dhe përgatitjes për integritet evropiane. Dua të theksoj se kontributi në bashkëpunim ka dhënë edhe Ministria e Pushtetit

Lokal dhe ajo e Integriteteve Evropiane. Funksionalizimi i mikroregjionit tonë, përveç fushës së arsimit, shëndetësisë etj., do të ndikojë në përmirësimin edhe të infrastrukturës sonë rrugore dhe hapjen e pikave të reja kufitare për qarkullimin e njerëzve”, ka thënë Haziri. Ai theksoi se zhvillimi i një komune të këtij mikroregjioni e gëzon secilën nga 17 komunat të Ballkanit Perëndimor. “Ne jemi evropian të Ballkanit Perëndimor dhe si të tillë do të vazhdojmë bashkëpunimin tonë të sigurtë, në mënyrë që t’i arrijmë qëllimet tona konkrete. Zhvillimi i një komune të këtij mikroregjioni, e gëzon secilën nga 17 komunat të Ballkanit Perëndimor”, është shprehur kryetari i Gjilanit. Konferenca po i vazhdon punimet, ndërsa gjatë ditës do të dilet me konkluzionet të përbashkëta.

Lutfi Haziri: Problemet e mikro-regjionit tonë duhet t'i zgjidhim në frymën europiane

28

SHTATOR

Me ide e rekomandime tejet të rëndësishme, ka përfunduar sot konferenca e kryetarëve të Komunave për Bashkëpunim Rajonal Europian, në të cilën morën pjesë 17 komuna të mikro-regjionit europian nga Kosova, Serbia, Maqedonia e Bullgaria, e cila është organizuar nga kreu i Gjilanit, Lutfi Haziri. Pos Gjilanit, në këtë konferencë kanë marrë pjesë kryetarët dhe përfaqësuesit e Komunës së Kamenicës, Vitisë, Parteshit, Ranillugut, Novobërdës, Preshevës, Krival Palankës (Maqedoni), Kumanovës (Maqedoni), Likovës (Maqedoni), Rankovcit (Maqedoni), Cucer Sandevo (Maqedoni), Staro Negoricane/Klecovc (Maqedoni), Kystendil (Bullgari) dhe kryetari i Bosilegrad (Serbi).

Kryetarët e komunave përkatëse kanë falënderuar kryetarin Haziri për këtë organizim, ndërsa u theksua fakti që këto konferenca janë të fuqishme dhe me mundësi më të mëdha edhe në raport të thithjes së investimeve dhe projekteve të interesit të përbashkët ndërkomunal dhe ndërshtetëror. Po ashtu, pjesëmarrësit e kësaj konference thanë se gjenerata e tanishme tashmë e ka kuptuar që duhet dhe është domosdoshmëri e bashkëpunimit për të shënuar prosperim dhe lëvizje të proceseve për jetën më të mirë të përbashkët në Ballkanin Perëndimor dhe me mbështetje të njëra-tjetrës. Gjatë kësaj konference u potencua se takimet e përbashkëta janë një gjetje ideale për të qenë një zë i fuqishëm në arenën ndërkombëtare, në mënyrë që zhvillimi dhe investimet të drejtohen në këtë regjion të Ballkanit Perëndimor. Kryetarët e Komunave



të mikro regjionit europian, kanë kërkuar nga MAPL dhe të gjitha ministritë e linjës në Kosovë, Maqedoni, Serbi, e Bullgari, që tani duhet të kenë një qëndrim tjetër dhe më pozitiv për komunat e këtij mikro-regjioni, duke thënë se ky është një trup i fuqishëm i bashkuar, u cili prekë katër shtete. Kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, tha se përmes takimeve të përbashkëta, 17 komunat e këtij mikro-regjioni bëhen shembull i bashkëpunimit, pa dallime partiake, etnike, gjuhësore. "Le të merret dita e sotme jo vetëm si rikthim i GJKPT-së, por që të jemi shembulli më i mirë i bashkëpunimit të Ballkanit Perëndimor. Telashet që i kemi në aspiratën dhe rrugën tonë, na çojnë në qëllimin që edhe ne si të zgjedhur lokal ta japim kontributin tonë, të bëhemi shembull i mirë i bashkëpunimit, pa dallim partiak, etnik, gjuhësor dhe në interes të komunitetit, të njerëzve dhe në frymën europiane t'i zgjedhim problemet në komunat tona, që jemi afro 700 mijë banorë së bashku", ka thënë Haziri. "Unë llogaris që ky bashkëpunim neve na afron edhe më shumë në çdo aspekt dhe në të ardhmen do të bëjmë vizita të ndërsjella, në mënyrë që të bëjmë shkëmbime, ndërhyrje të vogla e të shpejta për të zgjidhur problemet e përbashkëta në mënyrë që vërtetë t'i japim gjak procesit të bashkëpunimit. Kërkoj na qeveria dhe shoqëria civile që të na japin mbështetje në këtë proces të GJKPT-së. Për fund dua të them me bindje të plotë që është e pamundshme që të ndalet ky sukses i mikroregjionit tonë", ka theksuar në fund të kësaj konference kryetari i Gjilanit.



Gjilani intensifikon mbikëqyrjet për projektet madhore

20
SHTATOR

Komuna e Gjilanit ka intensifikuar mbikëqyrjet në projektet të cilat janë duke u realizuar në qytet dhe fshatra, që përfshinë përgatitjet për zbatimin e projektit të kanalizimeve dhe ujërave të zeza, zgjerimit e rrugëve, Gjilan-Ferizaj e Gjilan-Prishtinë, banimin social, ndërtimin e pesë shtëpive dhe rehabilitimin e 25 të tjerave. Kështu u bë e ditur sot në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të Komunës së Gjilanit, e cila është udhëhequr nga kreu i Komunës, Lutfi Haziri.

Haziri tha se tashmë ekipet komunale po punojnë në terren edhe me kujdestari, në mënyrë që të përfundohen sipas afatit dhe planit dinamik. Në këtë mbledhje u diskutua edhe për parapërgatitjet për mbledhjen e radhës së Kuvendit Komunal, përkatësisht për buxhetin 2017, ku u vlerësua mbajtja e 12 dëgjimeve buxhetore, derisa është paralajmëruar edhe mbajtja e 10 takimeve publike

në tetor në qytet dhe fshatra me qytetarët e komunës së Gjilanit. Gjithashtu, në këtë mbledhje u dha informata se së shpejti pritet të nis ndërtimi i objektit të ri i shkollës fillore në fshatin Haxhaj, pasi që objekti aktual i shkollës është tejte i degraduar, ndërsa nxënësit do të zhvendosen në objekt alternativ në këtë fshat si zgjidhje e përkohshme. "Nuk do të lejojmë që asnjë fëmijë t'i rrezikohet jeta si pasojë e degradimit të objektit të kësaj shkolle", ka thënë Haziri. Lidhur me ngritjen e aktakuzës së fundit nga ana e prokurorisë, kryetari Haziri kërkoi që të mos politizohet rasti, duke nënvizuar se nuk kanë të drejtë partitë politike dhe askush të ndërhyjnë në organet e drejtësisë. "Drejtësia le të flet për të gjithë ata që prokuroria ka pretendime për krim të organizuar dhe abuzim me detyrën. Deri atëherë, Komuna e Gjilanit do të punojë me masa të jashtëzakonshme dhe në përputhje vetëm me ligjin", ka thënë Haziri, në fund të mbledhjes.



Gjilani shënon 17-vjetorin e rivarrimit të dëshmorëve të kombit

17 shtator 2016 / Komuna e Gjilanit ka shënuar sot 17-vjetorin e rivarrimit të dëshmorëve të kombit në varrezat e dëshmorëve. Me këtë rast, nënkryetari i Gjilanit, Rexhep Kadriu, i shoqëruar nga drejtorët komunalë, ka bërë homazhe në varrezat e dëshmorëve, ndërkaq tha se heronjtë, dëshmorët dhe martirët e Gjilanit u sakrifkuan për sjellë lirinë e popullit dhe mbrojtjen e vendit.

“Ata këtë vepër të shenjtë e bënë, jo për të sulmuar dikë, por për të garantuar lirinë e brezave që do të vinë edhe

pas nesh. Vargu i shqiptarëve të rënë në luftën për liri, është shumë i gjatë dhe i vazhdueshëm deri në kulmim të organizimit ushtarak të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Gjaku i derdhur për liri, na obligon të gjithëve që të punojmë më shumë dhe më me ngulm në jetësimin e amanetit të tyre, ndërtimin, zhvillimin dhe përparimin e vendit”, ka deklaruar Kadriu.



Haziri: Fetije Ramadani ia dha kombit Agimin, e ky i fundit ia dha kombit të tij lirinë

13
SHTATOR

Mijëra njerëz nga e mbarë Kosova kanë marrë pjesë sot në varrimin e nënës së Heroit të kombit Agim Ramadani, Fetije Ramadani, në fshatin Zhegër të Gjilanit, në mesin e të cilëve kryetari Lutfi Haziri, sikurse edhe përfaqësues të institucioneve qendrore e lokale. Në fjalën e tij para të pranishmëve, kryetari Lutfi Haziri ka thënë se zonja Fetije ia dha kombit Agimin, e ky i fundit ia dha kombit të tij lirinë.

“Kjo ceremoni e varrimi është e dhimbshme, por po aq sa është e dhimbshme, është edhe e dinjitetshme, e një nëne, motre e gjyshe, e cila së bashku me bacën Hysni si bashkëshort dhe udhëheqës të kësaj familje të madhe Ramadani dhe Haliti, kanë dhënë shtatë fëmijë, e nipa e mbesa dhe këtij vendi nga kjo radhë ka lindur edhe heroi i kombit Agim Ramadani, i cili si lider lufte, bashkoi shqiptarët kudo që janë. Zonja Fetije ia dha kombit

Agimin, e ky i fundit ia dha kombit të tij lirinë, me sakrificën e tij dhe me luftën e tij”, ka thënë Haziri. Ai tha se të gjithë të pranishmit duhet të marrin diçka nga urtësia e saj, duke thënë se ky atribut është sinonim i një nëne shqiptare. “Të gjithë e kemi parë veçorinë e saj të veçantë, që është urtësia e saj. Ajo ka qenë nënë e urtë, nënë me pak fjalë. Dëshiroj të kërkoj që të gjithë ne, që nga urtësia e kësaj nëne të madhe që u nda nga jeta, të marrim diçka nga ajo dhe të mos kthehemi bosh në shtëpitë tona. Urtësia e saj është sinonim i një nëne shqiptare”, ka potencuar Haziri. Në emër të familjes Ramadani, ka folur edhe djali Jashar Ramadani, i cili ka falënderuar të pranishmit për nderin dhe respektin e treguar sot me masovitet në këtë ceremoni varrimi. Fjalë përshëndetëse në këtë ceremoni varrimi pati edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj dhe Hysen Berisha nga “Brigada 138 Agim Ramadani”.



Gjilani fillon hartimin e strategjisë lokale për zhvillim socio-ekonomik

8

SHTATOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, priti sot në takim përfaqësuesit e Institutit Riinvest, të kryesuar nga Visar Vokri. Kryetari Haziri u njoftua nga z. Vokri për fillimin e projektit të financuar nga Fondi për Zhvillimin e Komunitetit (CDF), përkatësisht donatorin kryesor të Komunës, Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) për hartimin e strategjisë lokale për zhvillim socio-ekonomik të Komunës së Gjilanit, që do ta implementoj Institut Riinvest.

Kryetari Haziri, fillimisht falënderoj donatorin USAID dhe i dha mbështetjen e Komunës së Gjilanit për hartimin e

kësaj strategjie të nevojshme dhe shumë të rëndësishme për Komunën e Gjilanit, e cila do të shërbej si një udhërrëfyes për zhvillimin socio-ekonomik lokal. Kryetari Haziri theksoi faktin se në fillim të këtij viti ka formuar Grupin Punues i cili do të punojë në këtë strategji, ku do t'i prijë drejtori i Zhvillimit Ekonomik, Agim Zuzaku. Ndryshe, ky grup punues është i përbërë nga të gjitha subjektet politike më të mëdha në Gjilan, sikurse komunitetet pakicë, ndërkaq rëndësi i ka dhënë barazisë gjinore.

46 mikro-biznese gjilanase përfitojnë grante



7

SHTATOR

Komuna e Gjilanit, në bashkëfinancim me organizatën gjermane "Help" ka nënshkruar sot kontratat me 46 mikro-biznese, përfitues të granteve, të cilët janë kryesisht zejtarë të Gjilanit, në kuadër të projektit "Mbështetje stabilitetit socio-ekonomik përmes fuqizimit të mikro-bizneseve në Kosovë - Parandalimi i Migracionit dhe Stabilizimi".

"Kjo është një ditë jashtëzakonisht e rëndësishme për Gjilanin sepse iniciativa e Help-it në bashkëpunim Komunën dhe me përkrahjen e fuqishme të kryetarit Haziri, ka bërë të mundur që të përzgjidhen 46 përfitues, në mënyrë që bizneset e tyre të funksionojnë suksesshëm dhe kjo ndikon direkt në gjenerimin e vendeve të reja të punës. E falënderoj shumë koordinatoren e kësaj organizate për punën e madhe që e kanë bërë. Në emër të kryetarit Haziri i uroj suksese përfituesve", ka thënë nënkryetari i Komunës së Gjilanit, Rexhep Kadriu, në hapjen e kësaj ceremonie. Shqipe Breznica, koordinatore e projektit të organizatës gjermane Help, ka falënderuar

kryetarin Haziri për bashkëpunimin dhe zotimin e participimit të Komunës së Gjilanit. "Projekti ka në fokus zhvillimin ekonomik, përmes përkrahjes së mikrobizneseve me grante në formë të pajisjeve në shumë prej 2 mijë eurosh. Nga 233 aplikacione, janë përzgjedhur 46 përfitues dhe mund të them që numri i granteve që ne japim është i vogël krahasuar me kërkesat. Por, besoj shumë që Komuna e Gjilanit do t'i marrë për bazë këtë. Ju informoj se deri në fund të vitit ne duhet të përfundojmë me shpërndarjen e pajisjeve. I uroj shumë suksese bizneseve përfituese", ka deklaruar Breznica. Drejtori për Zhvillim Ekonomik, Agim Zuzaku, ka shprehur falënderim për organizatën gjermane Help për bashkëpunim të mirë, duke shfaqur shpresën që "kjo energji të na përcjellë edhe më tutje, me projektet të ngjashme të cilat po ndihmojnë në rritjen dhe zhvillimin ekonomik lokal". Projekti financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme Gjermane, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e Republikës së Kosovës dhe me participim të Komunës së Gjilanit.



Gjilani përruron kompleksin e shkollave të mesme, i pari në Kosovë

5

SHTATOR

Në ora shtatë të mëngjesit, pikërisht në ditën e fillimit të vitit të ri shkollor, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri me bashkëpunëtorë, ka bërë përrurimin e fazës së parë të kompleksit të shkollave të mesme, ku aktualisht janë pesë shkolla të mesme, me 4.850 nxënës dhe 330 mësimsdhënës. Planifikohet që në të ardhmen, edhe shkolla e Bujqësisë të tërhiqet brenda kësaj hapësire, ndërsa Universiteti "Kadri Zeka" të zhvendoset në një lokacion tjetër.

"Në radhë të parë unë uroj të gjithë nxënësit dhe arsimtarët për fillimin e vitit të ri shkollor. Ky vit dallon nga vitet tjera, për shkak se në Gjilan për herë të parë në Republikën tonë ndërtohet kampusi i shkollave të mesme. Ky kampus krijon ambient krejt të ri për nxënësit, mësimsdhënësit dhe të gjithë ata që janë të lidhur me shkollat e mesme në Gjilan. Kampusi është do të merret si model edhe për projektet tjera të kësaj natyre në nivel Republike", është shprehur kryetari Haziri. Haziri tha se qëllimi udhëheqjes komunale është që kuadër të këtij kampusi të integrohet edhe shkolla e bujqësisë dhe ajo e arteve."Qëllimi është që të shkolla e Bujqësisë dhe shkolla

e Arteve gradualisht të integrohen brenda kampusit dhe të njëjtën kohë të fillojmë planifikimin edhe të zhvendosjes së Universitetit "Kadri Zeka" në kampusin e tyre që është i planifikuar prej 7.2 hektarëve në tokën e kazermsë së FSK-së", u shpreh Haziri. Në kuadër të kampusit, aktualisht janë pesë shkolla të mesme, me numër të nxënësve prej 4850 dhe 330 mësimsdhënës.





Haziri: Arsimi, prioritet i veçantë për mua

3

SHTATOR

Para fillimit të vitit të ri shkollor, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, është takuar me drejtorët e shkollave të Komunës së Gjilanit, të cilët i ka falënderuar për angazhimin e deritanishëm nëpër shkolla dhe ka kërkuar që të jenë, “zot shtëpie” të suksesshëm edhe në shkollë dhe me përkushtim, bashkëpunim e komunikim të bëjnë zgjidhjen e problemeve, në mënyrë që cilësia në arsim, të jetë përherë e më e mirë dhe shembull për të tjerët.

“Në emër të të gjithë drejtorëve të shkollave fillimisht falënderoj drejtorin e deritanishëm të arsimit, Nazmi Musa, i cili ka punuar së bashku me ju, për ngritjen, zhvillimin, mbështetjen dhe cilësinë në arsimin e Gjilanit. Ai është liruar nga detyra e drejtorit, për shkak të pensionimit dhe i dëshirojmë shëndet gjatë jetës në vazhdim. Ka qenë i përkushtuar, por edhe i vendosur për të mirën e arsimit të Gjilanit”, ka thënë, në fillim të takimit, kryetari Haziri. Lidhur me fillimin e vitit të ri shkollor, kryetari i ka uruar të gjithë mësimmshënësit, nxënësit dhe prindërit, duke i garantuar se fusha e arsimit është prioritet i veçantë i qeverisjes së udhëhequr nga ai. “Në këtë mbledhje të përbashkët, qëllim kryesor është t’u uroj për vitin e ri shkollor, duke ju garantuar mbështetje të vazhdueshme në rrugëtimin tonë menaxhues me institucionet shkollore dhe arsimin në përgjithësi si proces në Gjilan. Nga ju si drejtorë shkollash kërkoj të jeni “zot shtëpie” edhe në shkollë për qëllimin e vetëm që arsimi në përgjithësi të ketë bazat e fuqishme dhe premtuese për kohë të gjatë”, tha kryetari i Gjilanit Lutfi Haziri. Investime shtesë në arsim dhe riorganizim të profileve pro-

fesionale tha se do të bëhet përmes një komunikimi të gjerë, në mënyrë që karshi investimet të përgatiten kuadro për nevojat e tregut. “Me fillimin e vitit të ri shkollor, në kompleksin e shkollave të mesme, do të përrurohet faza e parë e punimeve që janë bërë në këtë pjesë. Në këtë kompleks tashmë gjithçka është ndryshe nga ajo pamja që kishim gjatë muajit qershor të këtij viti. Do ta bëjmë kërkesën në Ministrinë e Arsimit edhe për kampusin e Universitetit “Kadri Zeka” dhe kështu pastaj do ta kemi një zgjidhje afatgjate. Gjithashtu, bashkërisht do të debatojmë edhe për drejtimet në shkollat profesionale. Kjo për arsyen e vetme që kuadrot profesionale dhe kërkesat e tregut të jenë të balancuara. Sot kemi në drejtime në mjekësi, në ekonomi, apo teknikë që janë kuadro që ndoshta nuk do të mund ta gjejnë veten në profesion as pas 20 vjetësh. Prandaj, për këtë kërkohet që të kemi drejtime të kërkesave të tregut”, ka thënë mes tjerash ai. Edhe ushtruesja e detyrës në Drejtorinë e Arsimit, Shqipe Kastrati, ka thënë se kanë bërë të gjitha përgatitjet që mësimi të nis sipas planifikimit në shkollat e Komunës së Gjilanit. Ajo gjithashtu ka falënderuar kryetarin për mbështetjen e dhënë dhe drejtorët e shkollave për punën e madhe që kanë bërë në përgatitjen e objekteve të shkollave për fillimin e vitit të ri shkollor. Ndryshe, në këtë takim drejtorët e shkollave kishin kërkesa të ndryshme për investime, për të cilat kryetari Haziri ka thënë se shkolla e Bresalcit, Përlepnicsës dhe një numër i madh i shkollave në qytet e fshatra do të rinovohen pjesërisht dhe tërësisht, sipas nevojave, sikur që ka paralajmëruar se do të bëhet zgjidhje adekuate edhe për Institucionin Parashkollor “Ardhmëria 1”.



Gjiçani, brenda 10 ditësh mban 12 dëgjime për planifikim të buxhetit 2017

30
GUSHT

Komuna e Gjiçanit, përkatësisht Drejtoria për Buxhet dhe Financa, ka mbajtur sot dëgjimin e fundit buxhetor për planifikimin e buxhetit për vitin 2017 me grupin e grave të Gjiçanit, e që është i 12-ti brenda dhjetë ditëve. "Ky është takimi i fundit për planifikimin e buxhetit dhe jemi të nderuar që po e përmbyllim me juve. Qëllimi është që t'i marrim kërkesat dhe nevojat tuaja dhe të shikojmë mundësitë që t'i inkorporojmë në buxhetin e vitit 2017", ka thënë me këtë rast drejtori për Buxhet dhe Financa, Zijadin Maliqi.

Ai ka njoftuar se në bazë të kufijve buxhetor të përcaktuar nga Ministria e Financave, buxheti i Gjiçanit për vitin 2017 do të jetë 22.657.750 euro dhe krahasuar me vitin e kaluar është 6 për qind më i lartë. Maliqi tha se tek kategoria e investimeve kapitale për herë të parë ka llohet shifra mbi 4 milionë (22.4 për qind krahasuar me vitin 2016), ndërsa për kategorinë e subvencioneve janë paraparë 554 mijë euro. Ai ka njoftuar se jashtë këtij buxheti, Komuna e Gjiçanit falë angazhimit të kryetarit Haziri, planifikon të ketë investime nga ministrisë dhe donatorët

e huaj mbi 20 milionë euro. Gjatë këtij takimi për planifikimin e buxhetit ka folur edhe anëtari i Komitetit për Politikë dhe Financa, Avdy Aliu, derisa kanë kontribuar me kërkesa, pyetje e interesime edhe përfaqësueset e disa organizatave të Gjiçanit. Festa Demiri, koordinatore e qendrës "Pema" ka kërkuar informacione lidhur me subvencionet për këtë organizatë, Shahadije Rexhepi, drejtore e "Agro-Eko" ka kërkuar kod të veçantë buxhetor për organizatat që merren me kategori të ndjeshme të shoqërisë, ndërkaq Shpresa Hajdari, përfaqësuese e organizatës "Gruaja Hyjnore" ka shfaqur shpresën që Gjiçani, në planifikim të buxhetit të jenë përfituese dy gjinitë. Kërkesave të tyre i është përgjigjur drejtori Maliqi, i cili tha se kategoria e subvencioneve është paraparë edhe subvencionimi i organizatave që merren me kategori të ndjeshme të shoqërisë. Përndryshe, gjatë këtyre ditëve, Komuna e Gjiçanit ka mbajtur dëgjime buxhetore edhe në Kmetoc, Malishevë, Cernicë, Livoç i Ulët, Llashticë, Bresalc, Ponesh, Pogragjë, Dobërçan, Dheu i Bardhë dhe Velekincë.

Në Gjilan mbahet forumi me autoritetet komunale të regjionit mbi procesin e planifikimit buxhetor 2017-2019

26
GUSHT

Nën organizimin e Ministrisë së Financave dhe në bashkëpunim me misionin e OSBE-së dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës, sot në Gjilan është mbajtur Forumi me autoritetet e Komunave Gjilan, dhe komunave të këtij regjioni mbi zhvillimin e procesit të planifikimit buxhetor komunal 2017-2019.

Gjatë këtij forumi zv.ministri i Ministrisë së Financave, Agim Krasniqi, por edhe udhëheqësit e komunave pjesëmarrëse kanë diskutuar për sfidat kryesore, pastaj çështjet e komunave që lidhen me procesin buxhetor, për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi financat e pushtetit lokal, për komunikimin dhe bashkëpunimin e Ministrive të linjës me Komuna, si dhe për mbështetjen e organizatave-institucioneve ndërkombëtare. Zv.ministri Krasniqi, ka thënë në fjalën e tij se parimet mbi të cilat janë bazuar projeksionet buxhetore 2017-2019 janë bërë duke marrë për bazë buxhetin e vitit paraprak, por gjithashtu ka kërkuar nga komunat që të bashkëpunojnë në zhvillimin e konceptit për një zhvillim ekonomik lokal të qëndrueshëm në dritën e ndryshimeve të pritura sa i përket ligjit të financave të pushtetit lokal. Ai gjithashtu ka potencuar edhe vendimin e qeverisë së Kosovës për buxhet shtesë për Komunat të cilat kanë numër të banorëve deri në 22 mijë banor, në mënyrë që të kenë më të lehtë funksionimin dhe dhënien e shërbimeve më të mira për qytetarët e tyre, por edhe mirëmbajtje të projekteve të realizuara. Ndërsa nga ana e tij përfaqësuesi i OSBE-së, misioni në Kosovë, ka thënë se OSBE është mbështetëse dhe përkrahëse e planifikimit të buxhetit, duke potencuar se është shumë i rëndësishëm buxheti, ku ekziston planifikimi për shërbime të mira të qytetarëve, pastaj buxhetim gjinor, planifikim për mbështetje të projekteve në lokalitetet me pakica etnike dhe buxhetim për zhvillim të komunave në fushën e shëndetësisë, arsimit, bujqësisë dhe infrastrukturës publike. Nga ana e tij nënkryetari i Komunës së Gjilanit



Rexhep Kadriu, ka thënë se Komuna e Gjilanit buxhetin është duke e planifikuar konform kërkesave dhe përshkrimit të qeverisë së Kosovës, duke respektuar kriteret dhe kufijtë buxhetor, mirëpo në të njëjtën kohë Kadriu ka thënë se planifikimi është bërë edhe me dëgjime publike të cilat ende janë duke vazhduar nëpër fshatra dhe lagje të qytetit, në mënyrë që kërkesat e qytetarëve të jenë të përfshira në buxhetin e vitit 2017 dhe planifikimit të hershëm për vitin 2018 dhe 2019. Kadriu pos tjerash ka thënë se është e nevojshme edhe më tutje një pavarësi më e madhe për Komunat në bartjen e mjeteve nga një kod në tjetrin kod buxhetor, por edhe mundësinë që të rritet edhe më tutje ky buxhet dhe grantet qeveritare, ngase nevojat dhe kërkesat e qytetarëve të Gjilanit dhe të Komunave në përgjithësi janë shumë më të mëdha se sa buxheti aktual. Edhe udhëheqësit e Komunave të tjera janë paraqitur me fjalë rasti në këtë forum, duke kërkuar buxhet shtesë, kryesisht për mirëmbajtje të projekteve të realizuara, por edhe dhënie më të mirë të shërbimeve për qytetarët e tyre. Ndryshe gjatë muajit shtator, Komunat e Kosovës aprovojnë buxhetin për vitin 2017 dhe të njëjtin e dërgojnë në Ministri të Financave për zyrtarizim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.



Gjilanasit mund të marrin nëntë shërbime në e-kiosk

26 gusht 2016 / Nga sot, qytetarët e Gjilanit mund t'i marrin nëntë shërbime në e-Kioskun para Drejtorisë së Administratës për disa sekonda, përfshirë ekstraktin e lindjes, certifikatën e lindjes, certifikatën e vendbanimit, certifikatën e shtetësisë dhe certifikatën e martesës. Në promovimin e këtyre shërbimeve, drejtori i Administratës së Përgjithshme, Nazim Gagica, ka falënderuar kryetarin Haziri për mbështetjen e madhe në realizimin e projektit, ndërsa ka thënë se përveç shërbimeve të sipërpërmendura, e-Kiosku mundëson edhe paraqitjen e kërkesave, paraqitjen e ankesave dhe gjendjen e tatimit në pronë.

“Deri tani, e-Kiosku ka shërbyer vetëm me ekstrakt të lindjes, ndërsa nga sot qytetarët mund të marrin nëntë shërbime. Është një avancim i sofwerit dhe ne jemi shumë të kënaqur që e bëmë edhe testin e parë me qytetarët tanë. Komuna e Gjilanit mbetet e përkushtuar që të avancojë shërbimet, duke ngritur cilësinë e tyre, andaj në vazhdimësi do t'i bëjë ato, në mënyrë që qytetarët të shërbehen sa më mirë”, tha Gagica. Gagica ka paralajmëruar që shumë shpejt qytetarët e Gjilanit do të mund t'i marrin këto shërbime edhe në dy e-Kiosqe të tjera, për të vazhduar edhe me e-kiosqe në lokalitetet më të mëdha të

Gjilanit sipas kërkesës së kryetarit Lutfi Haziri. Qytetari i parë që e nxori certifikatën e martesës ka qenë Halim Halimi, i cili u nda shumë i kënaqur që brenda pak sekondash e mori dokumentin e tij pa pritje në radhë. Po ashtu, në e-Kiosk mund të nxirren certifikatat edhe për anëtarët e familjes, gjegjësisht prindi mund të nxjerrë certifikatën për bashkëshorten/in dhe për fëmijët, ndërsa parakusht për t'u shërbyer me këto certifikata është letërnjoftimi. Përndryshe, Komuna e Gjilanit e ka hapur zyrtarisht projektin e-Kiosqeve në janar të këtij viti, derisa ka implementuar edhe projekte të tjera në administratë, si nxjerrjen e certifikatave përmes aplikimit online (Home-Komuna), regjistrin online të procedurave administrative, shërbimet e tipit të të gjitha llojeve të pagesave përmes zyrave të hapura, e Puna në Distançë, derisa është duke u punuar në implementimin e programit Smart City për komunikimin e drejtpërdrejt të qytetarit me zyrtarët komunalë. Ndërkohë, duhet theksuar në kuadër të projektit të Komunës së Gjilanit të financuar nga Komisioni Europian, janë vendosur edhe dy kiosqe të interaktivitetit, në të cilën gjendjen informata të rëndësishme për zejtarët, biografitë e tyre dhe numrat kontaktues.

Gjilani dhe Austria, bashkëpunim të gjatë në fusha të ndryshme



25
GUSHT

Në pritjen që kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka bërë sot për ambasadorin e Austrisë në Kosovë, Gernot Pfandler, i cili shoqërohej edhe nga përfaqësuesja e Odës Ekonomike të Austrisë në Kosovë, Vjosa Huruglica dhe bashkëpunëtor të tjerë, njëzëri thanë se bashkëpunimi mes dy institucioneve të Komunës në këtë rast dhe Ambasadës, do të jetë gjithnjë e më të shpeshta e konkrete në fusha të ndryshme, si në projektet kapitale, në fushën e Bujqësisë, në Arsim, por edhe në bashkëpunimin që është krijuar përmes Partneritetit Publik dhe Privat.

Në fjalën e tij kryetari Haziri në këtë takim ka garantuar Ambasadorin se Komuna e Gjilanit ka qenë dhe mbeten edhe në të ardhmen në nivelin më të lartë të përkushtimit për bashkëpunim në të gjitha fushat me shtetin mik Austrinë. “Komuna e Gjilanit edhe gjatë të ardhmes do të jetë bashkëpunuese e fuqishme me Ambasadën e Austrisë në Kosovë dhe përmes saj edhe me shtetin mik të Austrisë. Jemi të angazhuar në disa programe dhe projekte të përbashkëta që janë mëse të domosdoshme për qytetarët e Gjilanit. Programi “Soft Loan”, pastaj bashkëpunimi në bujqësi dhe arsim, Partneriteti Publiko Privat, janë vetëm disa fusha në të cilat jemi së bashku për kushte dhe jetë më të mirë për qytetarët e Komunës së Gjilanit”,

ka thënë kryetari Haziri. Ai ka falënderuar Ambasadorin për bashkëpunimin e deritashëm, por edhe për angazhimet tjera në të ardhmen si dhe për gatishmërinë e tij që projekte kapitale të të rëndësishme për një regjion të tërë të orientohen kah Gjilani si një Komunë e cila ka nevojë të mëdha për investime në infrastrukturë. E nga ana e tij Ambasadori Austriak, Gernot Pfandler, ka falënderuar për bashkëpunimin e mirë të një qyteti, kur kemi parasysh një Komunë e cila është duke bërë ndryshime të mëdha në jetën e qytetarëve të saj, në përgjithësi, për një të ardhme larg më të mirë se sot. “Falënderim i veçantë për përkrahjen që i është dhënë iniciativës së ambasadës e posaçërisht mbështetja e kryetarit të Komunës për projektin e PPP-së. Së bashku do ta bëjmë shembullin më të mirë të partneritetit në Kosovë. Gjithashtu, tashmë Austria dhe Kosova do të jenë në një marrëveshje afatgjate sepse “Soft Loan”, rregullimi i shtratit të lumenjve dhe rrjetit tjetër të kanalizimit por dhe projekteve në fusha të tjera si në arsim dhe bujqësi”, ka thënë ai ndër të tjerash. Ambasadori Pfandler, ka pohuar gjithashtu edhe mundësinë e bashkëpunimit në fusha të tjera gjatë të ardhmes krahas këtyre programeve dhe projekteve në të cilat është e përfshirë drejtpërdrejtë qeveria e Austrisë apo kompani të fuqishme nga shteti Austriak.



Gjilani mban dëgjim publik për planifikim të buxhetit në Cernicë, Livoç dhe Llashticë

24
GUSHT

Në vazhden e planifikimit të buxhetit për vitin 2017 dhe vlerësimet e hershme 2018-2019, Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Gjilanit së bashku me Komitetin për Politikë dhe Financa, ka mbajtur dëgjim publik në fshatrat, Cërnicë, Livoç i Ulët dhe Llashticë.

Pas prezantimit të buxhetit të Komunës për vitin 2017 nga ana e drejtorit për Buxhet dhe Financa, Zijadin Maliqi, qytetarët e këtyre fshatrave kanë paraqitur kërkesat për investimet kapitale, të cilat mungojnë në lokalitetet

e tyre. Maliqi ka shprehur zotimin se të gjitha kërkesat e qytetarëve do të shqyrtohen me kujdes, në mënyrë që të futen në implementim sipas mundësive buxhetore. Drejtori Maliqi ka bërë të ditur se do të vazhdohet me dëgjimet publike në Bresalc dhe Ponesh të mërkurën (sonte), derisa ditëve tjera në Dobërqan, Pogragjë, Zabel të Sahit Agës dhe Dheu i Bardhë. Në këto dëgjime buxhetore po asiston edhe Zyra Regjionale e OSBE-së në Gjilan. Më herët janë mbajtur dëgjime publike për buxhetin edhe në fshatin Kmetoc dhe Malishevë.



MPB: Gjilani, shembulli më pozitiv në trajtimin e problemeve akute të shoqërisë

22
GUSHT

Nën organizimin e forumeve të sigurisë nga komunat e regjionit të Gjilanit në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme, është mbajtur sot debati me temën “Trafikimi me qenie njerëzore, përdorimi i drogave, parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm”. Në debat ka marrë pjesë kreu i Gjilanit, Lutfi Haziri, ministri i Punëve të Brendshme, Skënder Hyseni, kryetarë të komunave të regjionit, përfaqësues nga policia, FSK, nga Bashkësia Islame, Kisha Katolike si dhe anëtarët e KKSB-së, EVS dhe KLSP.

Në fjalën e tij, kreu i Gjilanit, Lutfi Haziri, ka falënderuar ministrin Hyseni për mbështetjen në aspektin e sigurisë në Gjilan, derisa ka thënë se është e domosdoshme që të vazhdohet të punohet në kuadër të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, duke e vlerësuar si mekanizëm shumë efikas. Kryetari Haziri ka përmendur rastin e dëmtimit të minares së xhamisë së fshatit Velekincë ditë më parë nga një pjesëtar i komunitetit serb, duke thënë se ky është një rast i izoluar. “Falë ndërhyrjes së policisë dhe

në kuadër të bashkëpunimit të mirë me qytetarët dhe me Bashkësinë Islame, kemi arritur ta përballojmë këtë situatë. Me këtë rast, dua ta falënderoj kryetarin e Parteshit, Dragan Nikolic, i cili ka reaguar i pari, duke e dënuar aktin dhe duke na njoftuar për personin, i cili, ka prapa vetit background kriminal. Është rast i izoluar, por nuk lejojmë që të përsëritet, në mënyrë që të mos lejojmë të prishet harmonia ndërfaqetare dhe ndëretnike në Gjilan”, ka thënë Haziri. Ndërkaq, ministri i MPB-së, Skënder Hyseni, ka falënderuar kryetarin Haziri për punën e madhe në aspektin e sigurisë, duke e vlerësuar Gjilanin si shembullin më pozitiv në trajtimin e problemeve akute të shoqërisë. “Në Gjilan ka përpertime në shumë fusha. Gjilani është qyteti i parë që është bërë anëtar i Strong City Network në programin që është lansuar në New York, gjatë samitit që e kryesonte presidenti Obama. Po ashtu, në Gjilan është themeluar edhe Mekanizmi Referues dhe kjo flet për shembullin më pozitiv të mundshëm që e shquan Komunën e Gjilanit se me sa seriozitet i është qasur këtyre problemeve akute të shoqërisë sonë”, ka thënë ministri Hyseni. Hyseni ka theksuar se nuk ka asgjë më efektive

në luftimin e trafikimit, përdorimit të drogave dhe parandalimin e ekstremizmit sesa shfrytëzimi i mekanizmave dhe forumeve të sigurisë në nivel komunal."Kjo duhet të bëhet që ta ngrehin vetëdijen kundër këtyre fenomeneve, të kemi ndikim parandalues dhe të kërkojmë nga qytetarët që të tregojnë një sens edhe më të fuqishëm bashkëpunimi me Policinë e Kosovës, me organet e rendit dhe t'i denoncojnë tregtarët me njerëz, trafikantët, organizatorët e prostitucionit sepse kështu do të shpëto-

jmë shumë jetë e shumë familje dhe do ta parandalojmë fuqizimin e krimit edhe financiarisht edhe në pikëpamje tjera", ka thënë ministri Hyseni. Në debat ka kontribuar edhe komandati i Policisë Regjionale në Gjilan, kolonel Elmina Mahmuti, kryetari i Bashkësisë Islame në Gjilan, Naim Aliu, drejtori i DKA-së, Nazmi Musa, kryetari i Komunës së Parteshit, Dragan Nikolic, Mensur Hoti, drejtor i Departamentit për Siguri Publike dhe anëtar të tjerë të forumeve të ndryshme të sigurisë.

Komuna e Gjilanit dënon rastin e dëmtimit të Xhamisë në fshatin Velekincë

14

GUSHT

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka dënuar rastin e dëmtimit të objektit të xhamisë në fshatin Velekincë, nga një banorë i etnicitetit serb, i cili deri më tani nuk dihet se me çfarë motive e ka kryer veprën edhe pse sipas dyshimeve të para të policisë, i dyshuari ka probleme psikike.

Kryetari Lutfi Haziri, në komunikimin publik, ka falënderuar Policinë e Kosovës të Komunës së Gjilanit, për aksionin e kryer me sukses në parandalim dhe arrestimin e të dyshuarit, sikur që ka falënderuar edhe kryetarin e Bashkësisë Islame, Naim Aliu, imamin e xhamisë, Remzi Halimi dhe banorët e Velekincës. "Rasti që ka ndodhur në fshatin Velekincë në dëmtimin e kupolës së xhamisë, është një rast që Komuna e Gjilanit e dënon ashpër, sepse raste të tilla nuk i shërbejnë aspak klimës së krijuar për shumë vite në sigurinë publike në Gjilan. Me këtë rast falënderoj Policinë e Kosovës, të gjitha njësitet që kanë intervenuar në këtë rast, për profesionalizmin e treguar dhe për rikthimin e gjendjes nën kontroll dhe krijimin e sigurisë për qytetarët e këtij fshati. Poashtu

përkushtimi dhe sjellja e lartë qytetare e civilizuese e kryetarit të Bashkësisë Islame, Naim Aliu, e imanit të xhamisë Remzi Halimi dhe e bashkëpunëtorëve të tjerë, por edhe e banorëve, është për t'u falënderuar, në këto momente të vështira për fshatin dhe për Gjilanin në përgjithësi", ka thënë kryetari Haziri, duke apeluar për qetësi dhe gjakftohtësi nga të gjithë qytetarët e Gjilanit. Ndërsa, në njoftimin e shkurtër të komandantit të Stacionit Policor në Gjilan, Remzi Azemi, thuhet se pas informatës së pranuar, Policia e Kosovës me njësitet e saja, ka dalë në vendin e ngjarjes dhe ka kryer punën profesionale për krijim të sigurisë. Është arrestuar një qytetarë i dyshuar, që është nga komuniteti serb, i cili sipas Azemit ka aritur që ta dëmtoj kupolën e xhamisë për motive ende të pa njohura. Azemi ka falënderuar të gjithë për bashkëpunimin, ndërsa ka bërë të ditur se prokurori ka dalë menjëherë në vendin e ngjarjes dhe rasti është duke u hetuar. Ai ka falënderuar Policinë e Kosovës të gjitha njësitet intervenuese, e posaçërisht Njësinë Speciale të Stacionit të Gjilanit, për intervenimin profesional dhe arrestimin e të dyshuarit.



“Dardania” po bëhet me çerdhen më të madhe e më moderne në regjion

11

GUSHT

Në Komunën e Gjilanit, një kujdes i veçantë është duke iu kushtuar investimit në arsim në përgjithësi dhe kujdesit në shtimin e infrastrukturës në Institucionet Parashkollore në veçanti, duke ndërtuar çerdhe të reja e moderne, rinovuar hapësirat të cilat janë të njëjtat që nga vitet e 70-ta dhe duke modernizuar ambientet përreth.

Në kuadër të vizitave që kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, po i bënë në terren, pas vizitës në sektorin e shëndetësisë, sot ka përcjellë nga afër punimet që janë duke u kryer në ndërtimin e çerdhes më të madhe dhe më moderne në regjion, asaj në lagjen “Dardania”, me investim të përbashkët me USAID-in. “Pas përfundimit të punimeve të parkut “Dardania”, jemi duke punuar në projektin tjetër me rëndësi të madhe me financim të përbashkët nga Komuna e Gjilanit dhe Qeveria Amerikane, përmes partnerit implementues USAID-Kosova, përmes programit Qeveria për Qeverinë. Sot jemi në inspektim të punimeve dhe në përcjellje të dinamikës së punëve, sepse jemi të interesuar, që të mos humbim fare kohë. Kjo është çerdhja më e madhe në regjion sa i përket hapësirës ku do të ketë edhe numrin më të madh të fëmijëve duke trajtuar moshën nga zero deri në gjashtë vjet. Vlera e përgjithshme e projektit është 400 mijë euro dhe participimi është 50 për qind buxhet i Qeverisë Amerikane dhe 50 për qind buxhet i Komunës së Gjilanit”, ka thënë krye-

tari Haziri. Ai ka potencuar se nga buxheti vetanak në një të ardhme të afërt do të ndërtohet edhe biblioteka për fëmijë me infrastrukturën përcjellëse, pikërisht afër çerdhes dhe po në këtë lagje. Sa i përket lagjes “Dardania”, Haziri ka dhënë edhe lajmin tjetër të mirë dhe në interes të kësaj lagjeje, duke potencuar investimin nga buxheti komunal i terrenit sportive për grupmosha të caktuara, që përfshinë infrastrukturë të mjaftueshme dhe me standarde të larta, por edhe rregullim dhe investim të fushave të ndryshme sportive dhe fushat e lojës së tenisit. Ai ka njoftuar se Komuna e Gjilanit së bashku me USAID-in është duke punuar edhe në tri programe që janë në interes të komunitetit, qytetarëve dhe të Komunës së Gjilanit në përgjithësi. Ndryshe kryetari Haziri, ka vizituar edhe dy Institucionet tjera Parashkollore, “Ardhmëria II” dhe “Integj”, ku ka njoftuar që do të bëhet intervenime në renovime në të dy këto institucione dhe në funksion të krijimit të një ambienti më të mirë për fëmijët si brenda ashtu edhe jashtë tyre, në të gjitha fushat, në inventarizime, kopshte, këndin e lodrave, rrethojave, investimin e brendshëm në modernizim të objekteve, por e gjithë kjo me një përlogaritje të mirë nga profesionistët e këtij lëmi në kuadër të Komunës së Gjilanit. “Pos renovimeve jemi duke bërë përgatitjet për investimin e ndërtimit edhe të një çerdheje në lagjen “Arbëria” që është shumë e domosdoshme për t’u kujdesur për një numër më të madh të fëmijëve.

Haziri: Mërgata ka merita të papërshkrueshme në shtetësinë dhe ndërtimin e Kosovës

10
GUSHT

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, në kuadër të muajit të mërgimtarëve, ka pritur sot në një takim deputeten shqiptare, Naile Azizi, nga Komuna Gislaved e Suedisë të cilët kanë biseduar lidhur me zhvillimet në Gjilan dhe Kosovë por edhe për trajtimin dhe gjendjen e shqiptarëve në mërgatë e konkretisht në Suedi.

Kryetari Haziri, në këtë takim ka potencuar se meritat që i kanë mërgimtarët në përgjithësi për pozitën gjithnjë e më të mirë të vendin sot, e veçanërisht meritat që kanë mërgata nga Gjilani, janë shumë të mëdha, ndaj, "për këtë Komuna e Gjilanit ka shpallur muajin e mërgimtarëve, që do të jetë gjithnjë gjatë kohës së pushimeve si muaj në të cilin janë përgatitur dhe do të përgatiten aktivitete të shumta kulturore, sportive, por edhe argëtuese dhe rekreative, me qëllim të plotësimit sadopak të mallit për vendlindjen" ka thënë në fjalën e tij i pari i Gjilanit Lutfi Haziri. Ai më tej ka thënë se të gjitha shërbimet në



Komunë janë në funksion të mërgimtarëve, në mënyrë që ata të marrin shërbime të shpejta, në Administratën Komunale, duke mos humbur kohë të gjatë para sportelëve, sepse edhe ashtu koha e lirë e tyre është e limituar dhe shumë e vlefshme. Ndërsa, deputetja Azizi, ka informuar kryetarin për gjendjen e shqiptarëve në Suedi, me theks të veçantë integrimin në shoqëri që tashmë prej vitesh është i tejkaluar dhe sot atje fëmijët shqiptarë, të rinjtë në përgjithësi kanë jetën e njëjtë sikur të komunitetit suedez. "Atje të rinjtë janë duke shënuar suksese në të gjitha fushat. Sot në Suedi ka shqiptarë nga Kosova me një numër të konsiderueshëm dhe nga gjenerata e punëtorëve të krahut që ishte në filllet e mërgatës, tani gjendja ka ndryshuar dhe kemi udhëheqës bizneseve, mjek, profesor, inxhinier dhe profesionist të fushave të ndryshme e të shumta", ka thënë ajo duke shtuar se gjendja dhe trajtimi që bëhet nga shteti i Suedisë është i barabartë karshi edhe të gjitha etnive tjera që jetojnë në Suedi.



Gjilani, kryeqendër e mikroregjionit evropian në Ballkanin Perëndimor

10
GUSHT

Në kuadër të bashkëpunimit të mikroregjionit Evropian të Komunave të lindjes së Kosovës dhe komunave fqinje nga Kosova Lindore dhe komunave tjera të kësaj pjese, sot kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri, ka pritur në një takim pune kryetarin e Preshevës Shqipërim Arifi dhe kryetarin e Bujanocit Shaip Kamberi, me të cilët kanë koordinuar aktivitetet për të ardhmen dhe funksionalizimin e partneriteteve.

Në fjalën e tij kryetari i Komunës Lutfi Haziri, ka thënë se jemi duke punuar në koordinim të përbashkët që të gjenden aktivitete dhe forma për plasim jashtë regjionit tonë. "Interesi ynë është që të punojmë më shumë me Brukselin dhe me Strazburgun si dy qendrat kryesore të BE-së, por edhe me partneritete të drejtëpërdrejta komunale në mënyrë që të ndikohet në zhvillimin e politikave lokale. Jemi të thirrur për të punuar në interesin e komunitetit tonë dhe qytetarëve nëpër komunat tona për zgjidhjen e problemeve, por për shkak të buxheteve të kufizuara, neve na duhet punë shtesë, fonde dhe investime shtesë, edhe nga partnerët dhe fondacionet e ndryshme. Prandaj, duke kërkuar së bashku dhe duke paraqitur kërkesat tona së bashku do të arrijmë

që kërkesat tona ti zgjidhim më shpejtë dhe më drejtë gjithnjë në kuadër të zhvillimit", ka thënë në paraqitjen para gazetarëve, kryetari, Lutfi Haziri. Ai ka thënë se në bazë të të gjitha parametrave, Gjilani është kryeqendër e këtij mikroregjioni dhe do të jetë një shtytës i fuqishëm i proceseve përpara. Ndërsa nga ana e tij, kryetari i Bujanocit, Shaip Kamberi, ka thënë se ky bashkëpunim, për rinisjen e funksionimit të mikroregjionit Evropian, është një hapë i rëndësishëm, sepse ndikon në pozitën më të mirë të shqiptarëve atje, por edhe mundësi më e madhe për të bërë investime në infrastrukturë në përgjithësi, që është pritje e madhe e qytetarëve. Shqipërim Arifi, kryetar i Preshevës ka thënë se është mundësi e madhe që kapacitetet e kufizuara ti kthejmë në veprime krejtë ndryshe në atë të zhvillimit dhe bashkëpunimit për thithje të donacioneve dhe investimeve, sepse siç ka thënë ai "vetëm në këtë formë mund të arrihet përmbushja e objektivave, synimeve dhe politikave zhvillimore të Komunave tona". Ndryshe, mikroregjioni evropian do të ketë 20 Komuna të përfshira dhe qëllim është bashkëpunimi në kuadër të kësaj iniciative, për shvillim ekonomik, kulturor, social dhe bashkëpunime të tjera të rëndësishme në interes të këtyre Komunave.

Në shëndetësinë primare janë investuar rreth 200 mijë euro

9

GUSHT

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i shoqëruar edhe nga stafi i tij udhëheqës me shëndetësinë primare, dhe bashkëpunëtorët e tjerë, ka vizituar sot Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, "Nagip Rexhepi", pastaj Qendrën e Mjekësisë Familjare në fshatin Përlepnice dhe QMF-në "Ramiz Cërrnica", institucione në të cilat është bërë renovim dhe investime në kuadër të përgatitjes për një infrastrukturë më të mirë shëndetësore në shërbim të qytetarëve.

Në fjalën e tij në inaugurimin e renovimit të QMF-së në fshatin Përlepnice kryetari Lutfi Haziri, ka thënë se investimet e bëra në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Përlepnice, në QMF "Ramiz Cërrnica dhe QMF të tjera, janë shembulli më i mirë i krijimit të kushteve më të mira për pacientët dhe për stafin mjekësor. "Kualiteti i shërbimeve tash është sigurisht shumë më i mirë se sa para asaj periudhe. Ne kemi mbyllur ciklin e investimeve në sektorin e shëndetësisë primare, sa i përket renovimeve, rindërtimeve dhe investimeve të tjera si në qytet por edhe në të gjitha fshatrat. Kemi plotësuar kapacitetet edhe profesionale me mjekë dhe me staf tjetër teknik. Jemi duke punuar dhe po përgatitemi, për fillimin e punës në ndërtimin e objektit të ri të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare që është planifikuar përballë Spitalit Regjional, që është investim i Ministrisë së Shëndetësisë dhe i Komunës së Gjilanit, në një vlerë prej rreth 1.5 milionë euro", ka thënë kryetari Lutfi Haziri gjatë vizitës në fshatin Përlepnice. Haziri poashtu ka potencuar se ne këto investime që janë në proces dhe atyre që janë realizuar, Gjilani e realizon programin sa i përket investimeve në infrastrukturë shëndetësore. Ndërsa nga ana e

tij drejtori i QKMF-së, Fejzulla Berisha, ka thënë se falë mbështetjes së kryetarit Haziri, është arritur që në këtë pjesë të vitit të investohet mjaft shumë në shëndetësinë primare kryesisht në renovime, rindërtime dhe investime të tjera, që vlera totale është rreth 200 mijë euro. Berisha, poashtu ka lënë të kuptohet se investime të tilla ka edhe në QMF-të dhe AMF-të e tjera në qytet dhe në fshatra dhe gjenda teknike dhe funksionale e objekteve të shëndetësisë primare sipas tij, tash, është shumë më e mirë se që ishte para intervenimit dhe kushtet për dhënien e shërbimeve janë shumë më të mira dhe gjithnjë në shërbim të qytetarëve-pacientëve. "Sot është qendra e 12 e cila po merr investimet nga Komuna e Gjilanit, kështu është arritur të përmbyllet cikli i domosdoshëm i renovimeve, krahas edhe shumë punëve të tjera që janë bërë deri më tani në sektor të ndryshëm të shëndetësisë primare", ka thënë ndër të tjerash drejtori Fejzullah Berisha. Ndërsa në fjalën e tij rreth investimeve, ka folur nënkryetari Rexhep Kadriu i cili tha se në fshatin Përlepnice janë bërë edhe shumë investime të tjera si në infrastrukturë publike ashtu edhe në atë kulturore dhe njëkohësisht është duke u punuar edhe më tutje në përgatitje të investimeve shtesë. "Janë bërë investime të shumta në këtë drejtim, si në kanalizim, rrugë, shtëpi të kulturës, në këtë qendër shëndetësore dhe jemi në fazën e dytë përgatitore për asfaltimet e reja, si dhe përgatitjet për zgjerimin e rrugës nga fshati në drejtim të rrugës Gjilan - Bujanoc, që parashihet zgjerimi, trotualet, ndriçimi dhe gjithë infrastruktura përcjellëse, krahas edhe Autostradës e cila do të kalojë përkaj këtij fshati", përfundoi ai në fjalën e tij.

Shillova e Muhaxhirëve bëhet me shesh

6

GUSHT

Me investimin e Komunës së Gjilanit, sot, edhe solemnisht është përruar sheshi në qendër të fshatit Shillovë e Muhaxherëve, si dhe është bërë sbulimi i pllakës përkujtimore në kujtim të shpërnguljes së madhe të shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit, respektivisht nga fshati Pllanë dhe Mehanë, në vitin 1878 gjatë sundimit të Perandorisë Osmane.

Në emër të kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka folur shefi i Grupit të Këshilltarëve Komunal të LDK-së, Avdyl Aliu, i cili pas urimit për sheshin, banorëve të këtij fshati u ka dhënë edhe garancionin tjetër zyrtarë, për vazhdim të projekteve të tjera në infrastrukturën publike me përcaktim dhe vendosmëri të kryetarit Lutfi Haziri. "Kryetari Haziri, në programin dhe politikën qeverisëse me Gjilanin, përherë fshatin dhe qytetin i ka një dhe të bashkuar sa i përket prioritetëve të investimeve. Qeverisja komunale nuk ka në tavolinë opsionin e ndarjeve dhe diskriminimeve. Investimet janë të barabarta sa i përket prioritetëve, sikur që është i rëndësishëm një investim në qendër të Gjilanit, është poashtu i rëndësishëm edhe në fshatin më të largët të Komunës së Gjilanit. Deri më tani kemi punuar sipas prioritetëve dhe kështu do të vazhdohet edhe më tutje, deri në përmirësimin

e plotë të kushteve infrastrukturore. Shillova edhe pas këtij projekti do të marrë meritueshëm investime, si në rrugë, kanalizim, ujësjellës, ndriçim dhe projekte të tjera në sport dhe rekreacion", ka thënë shefi i GK të LDK-së, Avdyl Aliu. "Shillova e Muhaxhirëve paska marrë pamje tjetër me këtë projekt, porosisim bashkërisht që ta ruani dhe mbani si duhet", ishte apeli i Aliut në fund të fjalës së tij. Në emër të fshatit, Fadil Kajtazi, ka bërë një përshkrim të historikut të fshatit, që nga vendosja këtu e dy familjeve nga krahina e Toplicës, respektivisht nga fshati Pllanë dhe nga Mehanë, duke qenë falënderues i gjithë fshatit për këtë projekt. "Shpërnguljet e mëdha të shqiptarëve nga trojet e tyre nga Sanxhaku i Nishit, kanë prekur edhe të parët tanë, të cilit ishin nga fshati Pllanë dhe Mehanë të krahinës së Toplicës. Kështu nga ajo kohë, dy familje, nip e dajë u vendosën këtu dhe sot është një fshat i tërë i mbushur me shtëpi. Falë investimit të Komunës, sot ky fshat ka marrë edhe një kuptim tjetër që të gjithëve na bënë të ndjehemi mirë dhe krenarë për këtë shesh, i cili është në qendër të fshatit dhe shumë i mirëseardhur, në të cilin në formë simbolike po ruhet edhe prejardhja jonë e vërtetë përmes pllakës përkujtimore", ka thënë ndër të tjerash Kajtazi duke falënderuar kryetarin Haziri për këtë investim dhe shumë të tjera.



Në Gjilan u mbajt forumi i bizneseve nga diaspora dhe atyre vendore

1

GUSHT

Komuna e Gjilanit sot ka organizuar forumin me temën “Mundësitë për investime në Komunën e Gjilanit” dhe takimi Biznes me Biznes (B2B) në mes bizneseve nga diaspora dhe bizneseve nga Komuna e Gjilanit, në të cilin takim ishte i pranishëm edhe ministri i Diasporës Valion Murati dhe biznesmen nga diaspora dhe Gjilani.

Nga matjet ndërkombëtare, ka dalë se vetëm Komuna e Gjilanit ka në botën e jashtme të paktën 32 % të popullatës së saj, kështu që edhe përkushtimi dhe angazhimi i qeverisjes komunale është gjithnjë në funksion të kësaj, duke bërë që muajt e pushimeve të verës të jenë muaj të cilët do të dominohen nga qytetarët tanë në diasporë. Gjilani ka krijuar lehtësira të shumta dhe njëkohësisht ka krijuar ambient të veçantë në aspektin e mbështetjes dhe përkushtimit ndaj kësaj kategorie që mban gjallë zhvillimin ekonomik dhe fuqizimin e afarizmit të vogël të mesëm dhe atij industrial. “Në diasporë po rritet gjenerata e katër e familjarëve tanë të cilët kanë nisur këtë rrugë që nga vitet e ‘50-ta. Gjenerata që jeton sot ne botë e posaçërisht mërgata shqiptare sot rrit gjeneratën e katërt të brezit familjar dhe më nuk është gjenerata e banimeve kolektive dhe e koreve të bukës, por është gjeneratë e cila ka në familje luksin dhe gjendjen ekonomike më të mirë se asnjëherë me parë, sot është gjeneratë e “Llamborginave”, gjeneratë e cila është nëpër studime universitare dhe pozita të tjera shumë të larta gjithandej nëpër botë”, ka potencuar kryetari Haziri. “Jemi Komuna e cila kemi ulur tarifat deri në pikën

zero, sa i përket fushës së bizneseve dhe kështu falë angazhimit të përbashkët kemi klimë të mirë të mirëbesimit. Ky forum me temën “Mundësitë për investime në Komunën e Gjilanit” dhe takimi Biznes me Biznes (B2B) në mes bizneseve nga diaspora dhe bizneseve nga Komuna e Gjilanit është i mirëseardhur në çdo moment, sepse nevoja për t’u njohur dhe nevoja për të komunikuar, gjithnjë është shumë e madhe”, ka thënë kryetari Haziri, duke inkurajuar të gjithë biznesmenët e diasporës që të investojnë në Gjilan, sepse kanë mundësi të shumta dhe kuadro të përgatitura për të gjitha profesionet. Në fjalën e tij, ministri i Diasporës, Valon Murati, ka thënë se diaspora është shtylla kryesore e të hyrave të deritanishme në Kosovë. “Ky forum ka për qëllim arritjen e objektivave bazë, si fuqizimin e bashkëpunimit dhe komunikimit me diasporën, promovimin e bizneseve nga diaspora dhe mundësitë e investimeve në Komunë për bizneset e diasporës, pastaj krijimin e lidhjeve të qëndrueshme në mes institucioneve komunale dhe diasporës dhe promovimin e lehtësirave, të cilat Komuna i ofron për bizneset që operojnë në Gjilan, por edhe promovimin e projekteve ku mund të investohet. Roli dhe rëndësia e mërgatës për investimet në Kosovë është kruciale dhe shumë e nevojshme edhe më tutje, sepse mërgata është ajo që vazhdon të mbështesë Kosovën në të gjitha sferat”, ka thënë ministri Murati. Në këtë forum, me fjalë përshëndetëse dhe përshkrim të sfidave dhe qëllimeve që kanë janë paraqitur udhëheqës të bizneseve nga Gjilani dhe nga diaspora, duke potencuar entuziazmin e madh për zhvillim ekonomik dhe zhvillim edhe të vendit njëkohësisht.



Haziri: Kjo gjeneratë e mërgimtarëve na ka bërë krenarë me sukseset e saj

31
KORRIK

Në kuadër të “Muajit të Mërgimtarëve”, që po mbahet në Gjilan, nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës, Lutfi Haziri, të dielën është organizuar panairi i makinave “auto-shou”. Aktivitetin e sotëm, të fundit për sivjet, e ka hapur drejtori i Zhvillimit Ekonomik, Agim Zuzaku, ndërkaq një fjalë rasti para mërgimtarëve dhe pjesëmarrësve tjerë në këtë panair të makinave e ka mbajtur kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri. “Kjo gjeneratë ka mbërri shumë me punën e saj dhe na kanë bërë krenarë edhe neve”, ka thënë kryetari Haziri.

Haziri ndër të tjera ka theksuar se “auto-shou” ka hyrë në program me kërkesën e mërgimtarëve dhe u shpreh i befasuar me pjesëmarrjen e madhe të veturave si dhe të auto serviseve që merren me rregullimin e veturave të shtrenjta, të vjetra dhe të reja. Duke nënvizuar se edhe ai është njëri prej atyre që është rritur dhe po plakët me paratë e kurbetit, ku kanë punuar prindërit dhe familjarët e tij dhe për një kohë e ka provuar edhe vetë atë jetë të

rëndë, Haziri ka thënë se kjo gjeneratë që po jeton sot në Zvicër, Gjermani, në Evropë, janë gjeneratë e artë. “Kjo gjeneratë ka mbërri shumë me punën e saj dhe na kanë bërë krenarë edhe neve. Simbolikën më të madhe në sport e kemi Xherdan Shaqirin, por edhe në biznes dhe degë të tjera kemi nga një yll që po rritet me punë në Evropë dhe që po na bën krenarë të gjithë neve me suksesin e tyre”, ka thënë Haziri. Haziri i uroi mërgimtarët që të kalojnë sa më mirë këto ditë të pushimeve në Gjilan, duke theksuar se për hir tuajin këto ditë kemi hapur më shumë punë, që vitin e ardhshëm kur të vini me këto vetura, të mos gjeni asfalt të vjetër dhe rrugë me gropa, por një qytet të standardizuar dhe me hyrje-dalje të reja, ka thënë ai. Granit Zylfiu, ideator i këtij panairi, ka falënderuar autoritetet komunale në Gjilan dhe veçmas kryetarin Lutfi Haziri që i ka dhënë mbështetje kësaj nisme dhe e ka bërë pjesë të “Muajit të mërgimtarëve”. Panairi i veturave “auto shou” ka qenë aktiviteti i fundit i “Muajit të Mërgimtarëve”.

Në Gjilan prezantohet projekti për rregullimin e lumenjve dhe rrjetit të ujërave të zeza

29
KORRIK

Komuna e Gjilanit ka hyrë në fazën përfundimtare të procesit për fillimin e implementimit të projektit "Rehabilitimi dhe instalimi i kanalizimeve të ujërave të zeza, si dhe rregullimi i shtratit të lumit Mirusha dhe Stanishorka" që do të financohen përmes programit të kredisë së butë, "Soft Loan" të Qeverisë Austriake.

Lutfi Haziri, kryetar i Komunës së Gjilanit në fjalën e tij në këtë prezantim publik ka falënderuar qeverinë e Austrisë dhe Kosovës për mbështetjen duke potencuar se ky projekt në vete ngërthen infrastrukturën kryesore për rregullim të rrjetit të kanalizimeve, ujërave të zeza dhe rregullimit të shtratit të lumit "Mirusha" e "Stanishorka" dhe lumit "Baja". Ky projekt është thelbësor për qytetin në përgjithësi dhe shpëtim në të njëjtën kohë edhe për qytetarët e Gjilanit të cilët prej vitesh përballen me probleme të shumta që vijnë nga këta lumenj dhe ujërat e zeza. Në afërsi të këtyre lumenjve dhe përgjatë tyre, sot kemi kundërmim të rëndë dhe shpeshherë edhe deponi të mbeturinave, kryesisht për shkak të degradimit total të lumenjve. Më tre gusht ky projekt do të arsyetohet edhe para qeverisë dhe ministrave, sepse jemi të përfshirë në kuadër të programit "Soft Loan" që e ka realizuar ministria e Financave dhe është ratifikuar në Kuvend", ka thënë kryetari Lutfi Haziri. Ai gjithashtu ka vazhduar më tej me detajet tjera duke potencuar se "tretmani i ujërave të zeza në Gjilan e ka fillimin e fundit të realizimit. Është projekt që ka kosto 13.2 milionë euro, për ta integruar dhe rregulluar gjithë sistemin e ujërave të zeza në Komunën e Gjilanit dhe në disa fshatra në fqinjësi, sepse



ato janë të lidhura gjeografikisht me Komunën e Gjilanit. Presim që Ministria e financave në fazën e parë të ndaj një buxhet prej 7.2 milionë euro për këtë qëllim. Është e paraparë që programi të nis dhe mbarojë brenda një periudhe 24 mujore, si afat jashtëzakonisht optimal", ka thënë kryetari Haziri, duke potencuar se këta tre lumenj në qytetin e Gjilanit, janë burimi kryesor i problemeve me ujërat e zeza. Ndërsa në fjalën e tij, Mendim Rugova, zëvendës ministër për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, ka dhënë mbështetje këtij projekti duke potencuar që është me rëndësi të veçantë fillimisht për infrastrukturën e qytetit por në përgjithësi për të gjithë qytetarët e Gjilanit dhe më gjerë përgjatë gjithë kësaj rrjedhe. Qeveria e Kosovës, sipas tij, është e angazhuar konkretisht në mbrojtjen nga ndotja dhe degradimi i lumenjve, andaj siç ka potencuar ai, nisma e Gjilanit është për t'u mbështetur gjithmonë, sepse po bënë zgjidhjen e një problemi në zemër të qytetit. Ndërsa, Milovan Mostkoijov, përfaqësues nga OSTAP, partner implementues i këtij programi, ka thënë se përkushtimi për zgjidhjen e problemeve që ka qyteti dhe qytetarët me këta lumenj, është përkushtim i kujdesit për të ardhmen e një vendi apo të një komune, në këtë rast dhe, qytetarëve të saj. Gjithçka do të vazhdojë në koordinim të plotë dhe sipas marrëveshjes që kanë qeveritë e dy vendeve, ajo e Kosovës dhe Austrisë, në koordinim të vazhdueshëm me Komunën e Gjilanit. Ndryshe, prezantimi i projektit detal teknik është bërë nga Skender Bublatku, përkatësisht nga drejtori i Zhvillimit Ekonomik, Agim Zuzaku, ku të pranishëm ishin kryetarët e këshillave të lagjeve dhe të fshatrave si dhe njohës të këtij lëmi.

Gjilani ka vendosur barazi në investimet qytet-fshat

28
KORRIK

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, në secancën e sotme të Kuvendit Komunal, ka paraqitur para asambleistëve raportin gjashtë mujor të punës për periudhën janar-qershor 2016. Në vitin e tretë të qeverisjes sonë të mirëfilltë dhe efektive, Gjilani është kthyer në një qytet meritore për qytetaret e vet. Këto suksese tonat të deritanishme nuk kanë qenë pa sfida dhe pa barriera, ka thënë Haziri. (Kjo është fjala e plotë e kryetarit Haziri para anëtarëve të Kuvendit Komunal):

“Kam nderin dhe kënaqësinë që sot të paraqes para juve Raportin gjashtëmujor të punës për periudhën Janar-Qershor 2016. Tani në vitin e tretë të qeverisjes sonë të mirëfilltë dhe efektive, Gjilani është kthyer veçse në një qytet meritore për qytetaret e vet. Mirëpo, sukseset tona të deritanishme nuk kanë qenë pa sfida dhe pa barriera. Besoj se suksesi ynë më i madh i përbashkët ka qenë tejkalimi i këtyre sfidave e barrierave në favor të qytetarit Gjilanas. Me bashkëpunim të ndërsjellët, me mirëkuptim dhe punë të palodhur ne kemi arrit që në këtë gjashtëmujor të parë të vitit 2016 të realizojmë me sukses një sërë projektesh e aktiviteteve të rëndësishme të veçantë për Komunën tone. Raporti që po e prezantojmë sot përfshinë detaje nga këto të arritura dhe suksese të qeverisjes sonë. Andaj, në vijim, unë do të përmend vetëm disa nga pikat kyçe të punës sonë në gjashtë muajt e kaluar. Në aspektin e ofrimit të shërbimeve administrative për qytetarët, Komuna e Gjilanit është bërë kampion i efikasitetit në Kosovë dhe shembull në rajon përmes funksionalizimit dhe përdorimit të E-Kioskave, si dhe përgatitjeve për realizimin e projektit madhor modernizues për administratën tone publike lokale, –Gjilani Smart City. Në linjë me qëllimet dhe premtimet tona, ne kemi ulur ne vazhdimësi shpenzimet komunale – psh. shpenzimet për derivate janë ulur në krahasim me vitin paraprak, kurse të hyrat nga administrata e përgjithshme janë rritur për mese 23% në krahasim me gjysmë vjetorin e parë të vitit 2015. Në sektorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale kemi vazhduar me investime kapitale. Në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, kemi nënshkruar memorandumin e bashkëpunimit për ndërtimin e objektit të ri e mod-



ern të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare; gjersa në bashkëpunim me UNICEF-in dhe organizata tjera ndërkombëtare kemi vazhduar me ofrimin e vizitave mjekësore nëpër shtëpi për të gjitha ato familje që nuk e kanë të lehtë qasjen në mjekësinë familjare që ofrohen këtu. Edhe në aspektin humanitar, Gjilani vazhdon të jetë shembull i bamirësisë. Kemi përfunduar më se 30 shtëpi për nevojtarë, dhe kemi subvencionuar në vazhdimësi një numër të konsiderueshëm të nevojtarëve për barëra e përkujdesje mjekësore, si dhe kemi vazhduar me përkrahje të pa rezervë, por brenda mundësive tona, për shoqatat e ndryshme humanitare që ofrojnë përkujdesje për qytetaret tanë me nevoja të veçanta. Përveç përkujdesjes për shëndetin dhe mirëqenien e qytetarëve tanë, ne kemi shënuar suksese edhe në fushën e arsimit fillor dhe të mesëm që menaxhohet nga Komuna. Ne bashkëpunim me GIZ-in, kemi arritur t'i certifikojmë më se 400 mësimdhënës gjilanas të klasave 1-9 në fushën testimeve dhe të matematikës. Ndërkohë, nxënësit tanë kanë shkëlqyer nëpër gara rajonale, republikane, e ndërkombëtare duke sjellë një numër të konsiderueshëm të medaljeve, mirënjohjeve, e çmimeve kryesore në Gjilan. Përkundër pamundësive financiare, ne kemi investuar në disa nga këta talente të reja, duke iu ndarë bursa akademike për shkollim të mëtutjeshëm në universitetet dhe kolegjet tona. Tutje, Gjilani ka pasur fatin dhe nderin që këtë vit të jetë nikoqir edhe i Festës së Abetares, ngjarje kjo që është realizuar me sukses të plotë. Edhe ne aspakëtin infrastrukturor, arsimit në Gjilan vazhdon të jetë prioritet-përmes ndërtimit të shkollave të reja, si p.sh. përrurimi i Shkollës “Bajram Curri” më 20 maj, rinovimet në shkolla tjera, ndërtimet e çerdheve të reja në lagjet Dardania dhe Arbëria etj. Përveç infrastrukturës arsimore e shëndetësore, Gjilani ka bërë investime të vrullshme edhe në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizime dhe planifikim urban. Janë proceduar me sukses planet urbane për Lagjet Zabeli 1, Qendra 4 dhe Fidanishtja 2. Ndërkohë, që janë shtruar ose janë në shtrim e sipër shumica e rrugëve nëpër pjesët rurale të Komunës, nëpër fshatra (Dobërqan, Cërrenicë, Përlepnice, Shillove), thuajse janë asfaltuar krejtësisht të gjitha rrugët e fshatit e ngjashëm është vepruar e po veprohet edhe nëpër të gjitha fshatrat

tjera. Edhe nëpër qytet kemi riparuar, rishtruar shumicën e rrugëve dhe trotuareve, gjersa po vazhdojmë me intensitet të shtuar edhe të ndërtimit i rrugëve me katër krosi në hyrje të Gjilanit nga lindja. Falë punës serioze të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, dhe Banimit, si dhe Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mjedisit, përveç investimeve kapitale të cekura më lartë, janë bërë përgatitjet e duhura dhe janë në proces të finalizimit edhe kontratat për sanimit e ndriçimit publik të qytetit, sinjalizimit vertikal e horizontal, si dhe mirëmbajtjes së rrugëve. Edhe për bujqit dhe fermerët, Gjilani ka dhënë dhe po jep maksimumin e përkrahjes - qoftë përmes subvencioneve vetanake nga buxheti komunal, qoftë përmes bashkëpunimeve të shumta me organizata ndërkombëtare dhe me organet tjera përgjegjëse të Qeverisë së Kosovës - duke iu dhuruar pajisje e makineri bujqësore. Përveç përkrahjes së kulturave tanimë tradicionale në Gjilan, si dhe mjedres kohëve të fundit, ne po angazhohemi që ta kthejmë edhe kulturën e kultivimit të duhanit në Gjilan, dhe në këtë gjashtëmujor kemi punuar edhe me komisionin përkatës të Kuvendit të Kosovës si dhe Ministrinë e Linjës që ta çojmë përpara këtë projekt madhor jo vetëm për Gjilani por për gjithë Anamoravën dhe Kosovën. Përkundër disa fatkeqësive natyrore që kanë goditur komunën tone, veçanërisht reshjet e mëdha të shiut dhe vërshimet si pasojë e tyre, ne kemi bërë përpjekje maksimale që të minimizojmë këto pasoja dhe të ndërmarrim hapat e duhur për të bërë gjithçka që është e mundur për parandalimin e tyre në të ardhmen. Vërshimet më të ndjeshme ishin ato të Janarit dhe Marsit 2016, por pas angazhimit të Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Shpëtimit si dhe Drejtorive tjera përkatëse, kemi arrit t'i sanojmë pasojat dhe jemi në proces të gjetjes së zgjidhjeve më afatgjate - në bashkëpunim edhe me Ambasadën Zvicerane dhe Rregullatorin e Ujërave të Kosovës. Falë gjithë këtij angazhimi të përbashkët, Gjilani po vazhdon të atraktojë biznese të reja. Sipas të dhënave të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, ky gjashtëmujor shënon një ngritje të konsiderueshme të numrit të regjistrimit të bizneseve dhe vendeve të punës në krahasim me gjashtëmujorin e vitit paraprak. Deri më tani, gjatë këtij viti, në Gjilan janë regjistruar mase 260 biznese të reja duke sjellë mbi 440 vende pune. Në aspekt, përmes bashkëpunimit me KfE (Bankes Gjermane), Ministrinë së Financave, Komuna e Gjilanit ka përfutur edhe mbi 1 milion euro nga projekti i efciences së energjisë. Përveç këtij projekti, Komuna jonë ka përfutur edhe nga programi BE-EURED për zhvillimin e agrobiznesit, si dhe nga projekti BE-se për bashkëpunim ndërkufitar, ku p.sh. mbi 28 biznese të vogla kanë përfutur grante nga rreth 2,000 euro secili. Gjatë këtij gjashtëmujori, ne kemi arritur të rrisim edhe inkasimin e tatimit në prone,

që sipas raportit të Drejtorisë për Buxhet e Financa, ka shënuar rritje prej 32% në krahasim me gjashtëmujorin e vitit paraprak. Edhe në sektorin e lejeve të ndërtimit, të hyrat janë rritur në 194%. Mirëpo, kjo rritje e efikasitetit të punës në këto dikastere, është përcjellë edhe me faljen e borxheve sipas Ligjit për Faljen e Borxheve Publike, ku në këtë periudhë raportuese janë falur mbi 39,000 euro, dhe rritjen e efikasitetit të shpronësimit, proces ky që ka mundësuar përdorimin e mbi 10,000 m² tokë për nevojat e rrugëve, shkollave, çerdheve, etj. Pagesat nga këto shpronësime kapin vlerën e rreth 260,000 eurove. Gjilani ka shënuar suksese edhe në sferën e kulturës, rinisë, dhe sportit në këtë gjashtëmujor. Ne kemi qenë nikoqir të Panairit të Sportit në bashkëpunim me Komitetin Olimpik të Kosovës, si dhe kemi realizuar me sukses edhe manifestimin tradicional, të 25-in me radhë, të Flakës së Janarit, duke e kthyer Gjilani në një kryeqendër të kulturës e artit kombëtar. Po ashtu, në linjë me këto aktivitete dhe për të rritur mundësinë e organizimit dhe veprimtarisë për rininë, ne kemi promovuar edhe objektin e ri të Qendrës Rinore. Për shkak të pozitës gjeografike dhe lidhjeve natyrore e familjare me shqiptarët në Luginën e Preshevës, ne kemi themeluar Zyrën për PMB dhe jemi të lumtur me punën dhe angazhimin e saj. Kjo zyrë po vazhdon të kryej misionin e vet dhe të ofrojë shërbime për qytetarët e Luginës që jetojnë në komunën tonë. Ne vazhdojmë të jemi lider në aspektin e bashkëpunimit komunal me organizata dhe investitorë të huaj - duke qenë partner dhe nikoqir i shumë projekteve investuese dhe granteve përkrahëse nga USAID, BE, KfE, UNDP, si dhe Ambasadat e Qeveritë e vendeve mike si Austria, SHBA, Gjermania, Turqia, Zvicra, etj. Falë solidaritetit dhe përkrahjes edhe të mërgimtarëve tanë, Gjilani po vazhdon të atraktojë edhe investitorë potencialë private që po vijnë për të pare mundësitë e investimeve dhe kushtet e të bërit biznes në komunën tone. Përveç këtyre që u thane më lartë, ky raport 6-mujor përfshinë edhe aktivitetet kyçe të zyrave dhe njësive tjera pranë Zyrës së Kryetarit, si dhe elaborime më të detajshme të punëve të secilës drejtori. Për të mos ju lodhur më shumë, unë ndava me ju vetëm disa nga pikat kyçe të punës së të përbashkët, duke ju lënë mundësinë që Raportin në fjalë ta lexoni e ta shqyrtoni sipas nevojave tuaja. Ajo që dua ta nënvizoj me këtë rast është se ne kemi vendosur barazi në investime, në qytet dhe fshatra dhe mendoj që kjo është shumë e rëndësishme. Si gjithëherë, ju falënderoj të gjithëve për punën, angazhimin, dhe kontributin tuaj në të mirë të Komunës sonë dhe qytetarëve tanë. Për çfarëdo pyetje shtesë që mund të keni, ju lutem t'i adresoni ato tek ne dhe drejtoritë përkatëse për përgjigje ose shpjegime shtesë", ka përfunduar kryetari Haziri.

Kuvendi miraton raportin e kryetarit të Komunës për periudhën janar-qershor

28

KORRIK

Kuvendi Komunal i Gjilanit, të enjten, në seancën e fundit për pjesën e parë të vitit, të cilën e ka drejtuar Valentina Bunjaku-Rexhepi, ka miratuar raportin e punës së kryetarit të Komunës për periudhën janar-qershor 2016, raportin financiar për të njëjtën periudhë, pastaj nismën dhe vendimin për autorizimin e kryetarit të Komunës për bashkëpunim me komunën e Novobërdës, në fushën e infrastrukturës rrugore, ndriçim publik, kanalizime dhe ujësjellës, me komunën e Lipjanit - për ndërtimin e rrugës Vërbicë e Zhegocit-Sillovi dhe me komunën Samsun të Turqisë, në fushën administrative dhe teknike.

Kuvendi po ashtu ka miratuar kërkesën e Teatrit për ndarjen e një shumë prej 70 mijë euro, për nevoja të funksionimit të këtij institucioni, që e paraqiti Shpresa Kurteshi (LDK), si dhe me kërkesën e Riad Rashitit (PDK) ka diskutuar për gjendjen në kompaninë Ecohigjiena, përkatësisht për projektin e kompleksit të shkollave të mesme, të cilën e kërkoi Fehmi Sylejmani (VV). Kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, duke e prezantuar raportin e punës, ka thënë se qeverisja e tij karakterizohet me suksese dhe sfida. Në këtë gjashtëmujor, kemi arritur të realizojmë një sërë projektesh të rëndësishme për Komunën tonë, ka thënë Haziri, duke nënvizuar se Gjilani është kthyer në një qytet meritë për banorët e tij. Duke iu përgjigjur disa akuzave të opozitës, Haziri ka thënë se 81 për qind e qytetarëve të Gjilanit, janë të kënaqur me këtë qeverisje. Ai ka kërkuar bashkëpunim në Kuvend Komunal për të mirën e qytetarëve të kësaj Komune. "Është normale të kemi dallime me opozitën, por nuk do të doja që opozitën ta shoh si divizion të ndarë", ka thënë Haziri. (Më gjerësisht shih: <http://kk.rks-gov.net/gjilan/News/Lutfi-Haziri-Ne-Gjilan-kemi-vendosur-barazi-ne-investime>). Raporti është përkrahur dhe mirëpritur nga LDK e AAK si partnerë të koalicionit, ndërkaq është kritikuar nga partitë opozitare - PDK e VV. Avdyli Aliu (LDK) ka thënë se edhe kjo periudhë raportuese karakterizohet me qeverisje të mirë dhe transparente në shërbim të qytetarëve, duke përmendur ndërtimin e shtëpive për nevojtarë, ku deri tani kanë përfutur mbi 30 familje. Sahit Abazi (PDK) nuk e mohoi që në Gjilan ka edhe zhvillime pozitive, por tha se gjendja nuk është krejt e bardhë

siç përshkruhet në raportin e kryetarit. Ai është shprehur i pakënaqur me ngecjet në projektin e lumit Mirusha, shkallën e lartë të papunësisë, cilësinë e punimeve në infrastrukturë, që siç tha ai, është bërë fenomen kosovar në këto 17 vjet dhe kërkoi një komisionin për vlerësimin e cilësisë së projekteve rrugore. Selami Xhemajli (AAK) ka thënë se raporti përmban të dhëna të mjaftueshme mbi punët, projektet dhe zhvillimet e kësaj periudhe, duke lavdëruar te kjo qeverisje reduktimin e shpenzimeve dhe transparencën. Nevzad Isufi (VV) ka thënë se raporti duhet të bazohet te planet e punës së drejtorive, që për fat të keq, shumica e tyre nuk i kanë fare, ose kanë plane jo serioze. Planit të punës nuk i është përmbytur as Kuvendi Komunal, ka thënë ai. "Raporti pasqyron atë që quhet sukses i një qeverisjeje, por i mungojnë sfidat dhe dështimet", ka thënë Isufi. Lumi Mirusha ka qenë çështja më e përmendur në debatin e anëtarëve të Kuvendit. Bujar Nevzati (PDK), ka thënë se ai ka qenë mjaft i zëshëm në Kuvend dhe këtë e ka bërë, siç ka theksuar ai, për interesa të Gjilanit dhe jo pse ka diçka personale me këndo qoftë këtu. Arjeta Rexhepi (VV) e ka analizuar punën e Drejtorisë së Kadastrës, si pjesë e raportit të kryetarit të Komunës, ndërsa Fehmi Sylejmani (VV) ka thënë se raporti është lavdëruar, ndërkohë që ka analizuar gjendjen në arsim, kulturë dhe sport. Lutfi Haziri, kryetar i Komunës, ka thënë se Mirusha është një problem që e ka trashëguar dhe nuk ka lejuar të punohet me improvizime. Mirusha dhe Stanishorka, që është një problem edhe më i madh për qytetarët e Gjilanit, do të zgjidhen në kuadër të projektit të madh për sistemimin e ujërave të zeza dhe atmosferike, që financohet nga qeveria austriake, ka thënë ai. Mirusha duhet të mbyllet sepse nuk ka rrjedhë natyrore të ujit dhe Gjilani nuk e ka mundësinë të krijojë një "Dubai story", duke sjellë ujë nga pjesët tjera. Ndërkaq sa i përket cilësisë së punimeve në rrugë, të cilën e ngriti Sahit Abazi, kryetari Haziri ka thënë se pajtohet plotësisht, por ka shtuar se kjo është përgjegjësi e ekspertëve që e vendosin nënshkrimin e tyre në përfundim të projektit. "Unë nuk jam ai që e kontrolloj cilësinë e asfaltit", ka thënë Haziri. Pasi ka përmendur shumë projekte që janë realizuar ose që janë në proces e sipër, Haziri ka thënë se interesimi ynë është që Gjilani të

kalojë në një infrastrukturë tjetër nga ajo e viteve të 70-ta, e cila është ndërtuar nga baballarët tanë. Sa i përket futjes së pikave të rendit të ditës jashtë planit të punës së Kuvendit, Valentina Bunjaku-Rexhepi, kryesuese, ka thënë se të gjitha gjerat nuk mund të planifikohen në fillim të vitit dhe ka sqaruar se ekzekutivi ka të drejtë të propozojë futjen e një çështje të caktuar në rend dite kurdo që e sheh të nevojshme. Ndërkaq, raportin financiar për këtë periudhë e ka paraqitur drejtori i Buxhetit, Zijadin Maliki. Ai ka thënë se buxheti i vitit 2016, është 22.564.595 euro. Nga kjo shumë, për paga dhe mëditje janë paraparë 14.326.792 euro, për mallra dhe shërbime - 2.745.108 euro, për shpenzime komunale - 583.704, për subvencione - 803.411, për shpenzime kapitale - 4.105.578 euro. Ky buxhet realizohet nga granti i përgjithshëm - 17.354.701 euro, si dhe nga të hyrat vetanake - 4.000.000. Të hyra vetanake nga viti paraprak janë bartur 1.004.614 euro, kurse 205.280 euro janë participime të qytetarëve, ka thënë Maliki. Në këtë periudhë, janë shpenzuar 10.591.044 euro, ose 47 për qind e mjeteve të planifikuara. Rreth 1.5 milionë euro, janë investime kapitale, kurse subvencione janë 341 mijë euro. Ndërkaq, sa i përket kompleksit të shkollave të mesme, që po re-

alizohet në partneritet publiko-privat, Haziri ka thënë se nuk ka shmangie të madhe nga projekti fillestar, por disa ndryshime të arsyeshme është dashur të bëhen. Operatori është i obliguar t'i përmbahet marrëveshjes qind për qind, ka thënë ai. Kurse te rasti i kompanisë "Ecohigjiena", ku janë përfshirë në debat Riad Rashiti e Isa Agushi, me qëndrime për dhe kundër partneritetit publiko-privat, kryetari Haziri ka kërkuar që rasti të mos politizohet, por ka thënë se shqetësimi ynë atje janë investimet e pa realizuara dhe largimi i disa punëtorëve. Sa i përket kthimit në vend pune të dy ish-punëtorëve të kompanisë, ai ka thënë se vendimi i gjykatës duhet të respektohet, sepse është përfundimtar. Përndryshe, Haziri ka thënë se Komuna nuk ka qasje negative ndaj kësaj kompanie dhe shpreson se gjendja e krijuar atje do të zgjidhet në mënyrë racionale. Kuvendi Komunal i Gjilanit e ka filluar seancën e sotme me një minutë heshtje për veprimtarin Nuri Idrizi, në shenjë nderimi e respekti për ndihmën dhe kontributin që ka dhënë ai në zhvillimet e përgjithshme politike dhe kombëtare të vendit. Shtëpia e tij në lagjen "Dardania" para dhe gjatë luftës, ka qenë seli dhe strehë e aktivistëve dhe veprimtarëve politikë të LDK-së dhe të tjerëve.

Gjilani rikonfirmoi se është kryeqytet kulturor i shqiptarëve



26
KORRIK

Nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Gjilanit, në kuadër të Muajit të Mërgimtarëve, mbrëmë është dhënë premiera e shfaqjes “Vdekja aksidentale e një anarkisti”, nga Dario Fo, me regji të Erson Zymberit, e cila zgjoi interesim të madh të publikut. Pas premierës, kryetarit i Gjilanit, Lutfi Haziri, vlerësoi se me pjesëmarrjen masovike të publikut gjilanas, u dëshmuar sërish se Gjilani vazhdon të jetë kryeqytet kulturor i shqiptarëve.

“Komuna e Gjilanit tashmë e ka kthyer traditën e përcjelljes së shfaqjeve, edhe atë me interesim të jashtëzakonshëm të publikut. Pas dhënies së shfaqjes nga aktorët e teatrit të Gjilanit dhe me pjesëmarrjen rekorde të publikut, u rikonfirmua se Gjilani vazhdon të jetë kryeqytet kulturor i shqiptarëve”, ka thënë Haziri. Regjisori i shfaqjes, Erson Zymberi, ka thënë se “Vdekja aksidentale e një anarkisti”, në shtjellimin e saj konceptual dhe artistik, prekë dhe njëkohësisht tenton t’u përgjigjet trajtimit të problemeve aktuale të ligjit, korrupsionit, sistemit gjyqësor, dosjeve,

akuzimeve, vrasjeve, etj. Kjo shfaqje u realizua nga regjisori Erson Zymberi, i ndihmuar nga asistentja e regjisë Emine Toska, me aktorët: Ernest Zymberi, Alban Shahiqi, Avni Shkodra, Gani Rrahmani, Njomëza Kalaveshi dhe Tringa Hasani. Reprizat e shfaqjes “Vdekja aksidentale e një anarkisti” parashihen të jepen po në Teatrin e Gjilanit, për ata që nuk patën mundësi të ishin pjesë e premierës.





Debat: Sfidat e të rinjve në Kosovë dhe Mërgatë

26

KORRIK

Njësia për Rini e Komunës së Gjilanit, për nder të mërgimtarëve, ka organizuar sot një debat me temën: Sfidat e të rinjve në Kosovë dhe në mërgatë, ku morën pjesë një numër i konsiderueshëm i të rinjve nga Gjilani dhe mërgata. Debatin e ka përshëndetur shefi i Kabinetit të kryetarit Haziri, Arbër Ismajli, i cili ka thënë se Komuna e Gjilanit në mënyrë permanente i ka mbështetur të rinjtë gjilanas, përfshirë nxënësit, studentët e organizatat rinore me anë të bursave e subvencioneve.

Ndërkaq, Genc Mustafa, udhëheqës i Njesisë për Rini, ka thënë se Komuna e Gjilanit ofron programe të ndryshme, përfshirë vullnetarizmin rinor, ngritjen e kapaciteteve të të rinjve etj., derisa ka përmendur faktin se tashmë me objektin e ri modern, është lehtësuar puna për funksionimin e të rinjve në këtë Komunë. Në debat kanë dhënë kontributet e tyre interesante edhe Diar Ramadani, Alora Hyseni, Valdrin Halimi, Indira Rexhepi, Arlind Ajvazim, Fatlum Agushi etj. Ndërkohë, në kuadër të Muajit të Mërgimtarëve, sot në ora 17:00 mbahet aktiviteti sportiv gjimnastikë-akrobacione, para platosë së teatrit të qytetit.



Rruga Gjilan–Pogragjë ua ktheu dinjitetin qytetarëve të kësaj ane

24
KORRIK

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i shoqëruar nga drejtori i Shërbimeve Publike, Naser Korça, kanë parë nga afër sot finalizimin e punimeve në asfaltimin e rrugës Gjilan-Pogragjë. Kryetari Haziri, asfaltimin e kësaj rruge e ka vlerësuar si projektin më të rëndësishëm të rindërtimit të rrugëve me buxhet komunal, ndërkajë është shprehur se tashmë banorëve të kësaj i është kthyer dinjiteti.

“Nëse dikur janë ndier të anashkaluar qytetarët Malishevës, Uglarit e Pogragjës, tashmë kjo mbetet e një kaluar. Me asfaltimin e rrugës 14.6 kilometra, banorëve

të këtyre fshatrave iu është kthyer dinjiteti dhe kujdesi i Komunës së Gjilanit. Jam jashtëzakonisht i lumtur që e finalizuam këtë projekt të rëndësishëm në mënyrën më të mirë”, ka thënë Haziri. Ai konfirmoi se katërshja e prioritetëve infrastrukturore vazhdon të mbetet prioriteti i parë i qeverisjes, duke shtuar se deri në fund të mandatit të tij në udhëheqjen e Komunës, gjilanasit nuk do të kenë më probleme me rrugë, kanalizim, ujësjellës e ndriçim publik. Asfaltimi i rrugës Gjilan-Pogragjë, me gjatësi 14.6 kilometra, është realizuar me buxhet komunal dha kap shifrën e afro 300 mijë euro.

Në Gjilan hapet Panairi regional i prodhimeve vendore

22
KORRIK

Komuna e Gjilanit ka bërë sot hapjen e panairit regional "Gjilani 2016", i cili organizohet me qëllim që të promovohen produktet vendore të kësaj Komune. Panairin e ka shpallur të hapur kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, i cili tha se ky është viti i tretë që po organizohet dhe për çdo vit po merr formë.

"Është viti i tretë që po e organizojmë Panaxhyrin e Gjilanit dhe çdo vit e më shumë po merr formë. Ky tashmë është profilizuar dhe organizohet në kuadër të Muajit të Mërgimtarëve. Sot edhe nesër do të keni mundësinë të shihni vetëm një pjesë të prodhimeve vendore që janë në Gjilan, kryesisht agrokultura dhe sektorët e saj, por nuk përfshinë edhe degët e industrisë dhe degët tjera që Gjilani tashmë i ka të profilizuar dhe i ka aktivitet ekonomik", ka deklaruar kryetari Haziri, duke iu referuar prodhuesve të Gjilanit si shembull i punës dhe mundit. "Duke dashur që të shkëmbehet përvoja dhe me qenë më afër bashkatdhetarëve, unë iu dëshiroj në veçanti ndërmarrjeve dhe prodhuesve që kanë ardhur në këtë panair që të

vazhdojnë të punojnë dhe ne ju referohemi si shembull të mirë të punës e mundit, jo vetëm si biznes familjar, por si biznes që është zhvilluar më shumë me mundësi që njerëzit të punojnë dhe të jetojnë këtu. Ju uroj suksese", pohoi Haziri. Zëvendësministri i Diasporës, Sahit Krasniqi, pasi ka përgëzuar Komunën e Gjilanit për organizimin, tha se ky panair i produkteve vendore i ka dy mesazhe. "Mesazhi i parë është për t'iu treguar të gjithë qytetarëve tanë se edhe prodhimet tona vendore janë produkte cilësore që mund të konsumohen brenda Kosovës dhe të eksportohen. Dhe mesazhi dytë është se organizohen për nderë të ardhjes së mërgimtarëve tanë", ka thënë Krasniqi. Ndërkaq, Drejtori për Zhvillim Ekonomik, Agim Zuzaku, resori i të cilit e ka organizuar këtë panair me përkrahjen e kryetarit Haziri, tha se në këtë panair do të shfaqen të gjitha kapacitetet e Komunës sonë dhe ato që duhet të njihen nga të gjithë qytetarët që jetojnë në Gjilan dhe mërgatë. Panairi do të qëndrojë i hapur për dy ditë me radhë.



AIP: Gjilani prin në rajon për aplikimin e teknologjisë së informimit dhe komunikimit


22
KORRIK

Komuna e Gjilanit, në bashkëpunim me Archis Inventions Prishtina si pjesë e projektit të Institutit për Zhvillim të Habitatit "Co-Plan" me seli në Tiranë, dhe Institutit për Zhvillim Urban Ndërkombëtar "I2UD" me seli në SHBA, kanë organizuar sot punëtorinë me temën "si të përmirësojmë komunikimin, pjesëmarrjen dhe transparencën nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informimit dhe komunikimit", ku kanë marrë pjesë përfaqësues nga shoqëria civile e nga organizatat rinore.

Lutfi Haziri, kryetar i Komunës, ka falënderuar partnerët për ndihmesën në këtë punëtori me qëllim përmirësimin e transparencës, llogaridhënies dhe të komunikimit të përbashkët. Ju lus që të bashkëpunoni dhe të punoni edhe në grupe punuese sepse koordinimi i të gjitha aktiviteteve që çojnë drejt një përmirësimi të transparencës, llogaridhënies dhe të komunikimit të përbashkët, është diçka që ne kemi investuar që nga paslufta e deri këtu. Në Gjilan është një hap i domosdoshëm që duhet ta ndërmarrim, ta vendosim edhe këtë kulturë të punës e cila na e mundëson më shpejt dhe më drejt t'i kryejmë obligimet tona dhe në të njëjtën kohë garanton llogaridhënie dhe transparencë. I falënderoj partnerët

për bashkëpunimin dhe vlerësimin e drejtë, i cili është në interes të Komunës sonë", ka thënë Haziri. Ndërsa, Sandra Kdolsky, specialiste e zhvillimit social nga Banka Botërore, ka thënë se qëllimi i Programit të Partneritetit Urban II, është që të krijojë qytete më të jetueshme dhe të qëndrueshme në Europën Juglindore, të cilat ofrojnë cilësi më të lartë të jetesës për qytetarët. Në këtë punëtori është prezantuar edhe një raport i gjetjeve për Komunën e Gjilanit nga ana e Mrinë Godanca dhe Florina Jerliu nga Archis Inventions Prishtina, ku ndër të tjera u theksua se Gjilani në nivel vendi, por edhe në rajon, prin për nga aplikimi i teknologjisë së informimit dhe komunikimit. "Dua të konfirmoj se Gjilani në nivel vendi, por edhe sa i përket një pjese të Shqipërisë dhe Maqedonisë prin për nga aplikimi i teknologjisë së informimit dhe komunikimit. Është e pabesueshme se sa shumë informata mund të gjeni në faqen e Komunës së Gjilanit në Facebook. Por natyrisht, ajo që do të donin qytetarët është që t'i marrin më të gatshme dhe më të strukturuar", ka thënë përfaqësuesja e AIP, Florina Jerliu. Ky program është financuar nga Instituti i Bankës Botërore me seli në Vjenë.

Përmbyllet shfaqja e filmave në ambient të hapur, interesim i jashtëzakonshëm i mërgimtarëve



21
KORRIK

Me shfaqjen e filmave shqiptarë “Kolona” dhe “Vëllau Jem” në natën e tretë, është përmbyllur shfaqja e filmave shqiptarë dhe të huaj për mërgatën, organizuar nën përkujdesjen e kryetarit Lutfi Haziri. Për tri net me radhë u shfaqën disa filma shqiptarë dhe të huaj në ambient të hapur, në amfiteatrin e lagjes “Dardania”.

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, e ka vlerësuar të suksesshme këtë ngjarje kulturore, ku interesimi i mërgimtarëve për të përcjellë filmat ka qenë i jashtëzakonshëm. “Pasi ndërnuam parkun modern në lagjen “Dardania”, me amfiteatër në ambient të hapur,

u pa sa i rëndësishëm ka qenë ky projekt për qytetarët. Pjesëmarrja masive e mërgimtarëve tanë në shfaqjen e filmave, në veçanti e fëmijëve, më bënë krenar dhe po dëshmohej përditë se Gjilanin e kemi bërë kryeqendër kulturore të shqiptarëve”, ka thënë Haziri. Përndryshe, në natën e parë u shfaq filmi për fëmijë “Na ishte njëherë një vajzë”, në natën e dytë u shfaqën filmat “Çlirimi” dhe “Veç kuq”, ndërkaj të mërkurën qytetarët e Gjilanit patën rastin t’i shohin filmat “Kolona” dhe Vëllau Jem”. Të enjten do të mbahet koncerti për fëmijë para teatrit të qytetit, ora 12:00, përderisa në mbrëmje mbahet gala koncerti Rock & Popullore, ora 19:00, para platosë së teatrit të qytetit.

Bursa e Turqisë ndihmon shkollat e Gjilanit me mjete teknike

21
KORRIK

Drejtorja e Arsimit e Komunës së Gjilanit në bashkëpunim me kryetarin e Shoqatës Kulturore "Kosova Shkupi", Rexhep Gyndyz, sot u ka shpërndarë drejtorëve të institucioneve edukative arsimore të Komunës së Gjilanit, mjete teknike, 456 projektorë, 4 tabela interaktive, perde të projektorëve si donacion i dhuruar nga Drejtoria e Arsimit të Bursës së Turqisë.

"Në emër të kryetarit Haziri dhe Drejtorisë së Arsimit të Gjilanit shpreh falënderim të madh për bashkëpunimin

e singertë mes dy drejtorive të arsimit dhe për donacionin e dhuruar për shkollat e komunës së Gjilanit", ka thënë me këtë rast drejtori i DKA-së, Nazmi Musa. Ai tha se ky donacion i dhuruar është premtuar nga vizitat e përbashkëta në mes dy drejtorive, Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Gjilanit dhe Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Bursës.





Në Gjilan shpërndahen 30 pako ushqimore për familjet në nevojë

20
KORRIK

Komuna e Gjilanit, përkatësisht Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në bashkëpunim me shoqatën humanitare “Jetimët e Ballkanit” me seli në Prizren, kanë shpërndarë sot 30 pako ushqimore për familjet në nevojë. Këto nuk janë ndihmat e para që sivjet ka shpërndarë komuna e këtushme, në bashkëpunim me donatorët. Rreth 1100 familje në Gjilan janë të përfshira në skemën sociale. Kërkesat janë më të mëdha se kaq, por mundësitë janë të kufizuara.

Drejtori i Shëndetësisë në Gjilan, Nexhat Hajrullahu, ka falënderuar kryetarin e shoqatës, Halil Kastrati për këtë donacion, duke thënë se është shumë i rëndësishëm për familjet me gjendje të rëndë sociale, duke ua lehtësuar sadopak jetesën. Vlera e një pakoje ushqimore është 120 euro. Gjatë këtij viti, Komuna e Gjilanit ka bërë shpërndarjen edhe të qindra pakove ushqimore për familjet në nevojë, në bashkëpunim me njerëzit e vullnetit të mirë.

Haziri kërkon zbatimin e rekomandimeve të Auditorit



20
KORRIK

Nën udhëheqjen e kryetarit Lutfi Haziri, është mbajtur sot mbajtur sot mbledhja e radhës e Bordit të Drejtorëve dhe përfaqësuesve të Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit të Komunës së Gjilanit. Në këtë mbledhje është diskutuar për raportin e Auditimit Gjeneral për vitin 2015, ku kryetari Haziri ka formuar një komision të veçantë për ta përpiluar planin e veprimit kohor për zbatimin e rekomandimeve.

Me këtë rast, kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, kërkuar nga drejtorët e drejtorive zbatimin e të gjitha rekoman-

dimeve të Auditorit të Përgjithshëm dhe Auditorit të Brendshëm. “Nuk ka kompromis me ata që i neglizhojnë rekomandimet e Auditorit. Të gjitha rekomandimet e Auditorit Gjeneral do të realizohen deri në fund të vitit me përpikëri, të cilat më shumë janë teknike. Ndjem i lumtur se në këtë raport për vitin 2015, Komuna e Gjilanit ka shënuar progres, ndërsa sipas raportit të Njesisë për Auditim të Brendshëm për këtë gjashtë muor ka progres të madh dhe rritje të performancës, krahasuar me vitet paraprake”, ka thënë kryetari Haziri.



Hani Elezit nderon me mirënjohje kryetarin Lutfi Haziri

20
KORRIK

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, është nderuar me mirënjohje nga ana e kryetarit të Hanit të Elezit, Rufki Suma, për kontributin e tij në themelimin e kësaj komune, në kohën kur ka qenë ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal. Kryetari Suma theksoi faktin se sot Hani i Elezit është storie e suksesit si Komunë e re, për vetëqëndrueshmërinë dhe për funksionimin e mirë.

Ndërkaq, kryetari Haziri e falënderoi kryetarin Suma për mirënjohjen, të cilën e pranoi gjatë vizitës në Komunën e Hanit të Elezit dhe e njoftoi këtë të fundit lidhur programin e mekanizmave të Komisionit Europian, që ka për qëllim bashkëpunimin ndërkufitar si mundësi për nxitjen e marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe përmirësimin e jetës së

banorëve në zonat ndërkufitare. “Objektivi i përgjithshëm i programit është të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, duke nxitur integrimin, zhvillimin e përbashkët dhe përdorimin e potencialeve dhe mundësive për të bërë zonën ndërkufitare tërheqëse për të jetuar dhe punuar. Është mundësi shumë e mirë e zhvillimit, pasi tashmë jemi duke hyrë në fazën projekteve të mekanizmave të Komisionit Europian dhe mundësi të mëdha që të konkurrohet përmes projekteve të ndryshme”, tha Haziri. “Fillimi i këtij projekti pritet të nis në tetor të këtij viti dhe komunat e zonës kufitare të Rajonit të Gjilani që kufizohen me Republikën e Maqedonisë duhet me kohë të identifikojnë projektet dhe partnerët potencial në mënyrë që të përfitohet nga ky instrument financiar”, shtoi kryetari Haziri.



Lutfi Haziri, takime të ndara me kryetarin e Kumanovës dhe atë të Likovës

19
KORRIK

Në kuadër të bashkëpunimit të mikro-regjiinit Gjilan-Preshevë, Kumanovë-Tregovishtë, në të cilin regjion janë të përfshira 17 komuna, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka takuar sot në takime të ndara kryetarin e Kumanovës, Zoran Damjanovski dhe atë të Likovës, Sadulla Durakun. Gjatë takimit me kryetarin e Kumanovës është diskutuar për hapjen e pikës kufitare Stanqiq-Bellanoc, i cili është në fazën finale, duke u potencuar se do të lehtësoj udhëtimin e banorëve Gjilan-Kumanovë.

Po ashtu, në këtë takim u fol për përgatitjet e projekteve të përbashkëta regjionale, derisa u dakorduan që të nënshkruhen marrëveshje bashkëpunimi në të ardhmen e afërt. Ndërkaq, kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, pas takimit me kryetarin e Likovës, Sadulla Durakun, kanë vizituar bashkërisht rrugën deri në afërsi të kufirit. Kryetari Haziri,

gjatë ditëve në vijim pritet të takoj edhe kryetarët e Preshevës dhe Bujanocit, e më pas do të zhvilloj takime të veçanta me kryetarët e Komunave të lindjes së Kosovës.





Në Gjilan fillojnë aktivitetet e Muajit të Mërgimtarëve

19

KORRIK

Nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka nisur mbrëmë aktiviteti i parë që shënon hapjen e Muajit të Mërgimtarëve me moton Ti je pjesë e atdheut. Ka qenë filmi për fëmijë "Na ishte një herë një vajzë" ai i cili e hapi Muajin e Mërgimtarëve, derisa u shfaq në ambientin e hapur, në amfiteatrin e bukur të parkut e ri në lagjen "Dardania".

Kreu i Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se pjesëmarrja kaq masovike e fëmijëve në shfaqjen e këtij filmi e ka bërë krenar, ndërsa ka falënderuar qytetarët tanë që jeto-

jnë në diasporë për kontributin e jashtëzakonshëm që kanë dhënë në zhvillimin e Gjilanit, Anamoravës dhe mbarë Kosovës. "Komuna e Gjilanit ndihet krenare me mërgimtarët tanë që jetojnë në Europë e Amerikë e kudo në botë. Për këta dy muaj sa qëndroni në Gjilan, ju jeni vlera më e madhe që ne e kemi në Komunën tonë. Falënderim përjetë për punën e madhe që e kanë bërë për zhvillimin e Komunës sonë", ka thënë Haziri. Ndërkohë, sonte në ora 20:30, do të shfaqen filmat e shkurtër për të rritur shqip "Çlirimi" dhe "Veç Kuq".

Haziri: Një milion euro po investohen në projektin e rrugës Gjilan-Bujanoc

17

KORRIK

Lutfi Haziri, kryetar i Komunës së Gjilanit, është shprehur të jetë tejet i kënaqur me punimet projektin e rrugës katër korsi Gjilan-Bujanoc. "Rruga katër korsi Gjilan-Bujanoc (hyrje-dalje e qytetit) është investim i Komunës, me mbështetje të qeverisë. Është investimi më i madh që kap shifrën 1 milion euro, e që punimet janë duke shkuar shumë mirë", ka thënë Haziri.

I pari i gjilanasve ka shfaqur shpresën se deri në vjeshtën e këtij viti, projektet e mëdha infrastrukturore do të marrin formë dhe dukje tjetër. "Ne me Ministrinë e Infrastruk-

turës i kemi edhe 21 programe në hapje të ofertave, pra jemi në vlerësim. Besoj shumë që deri në vjeshtën e këtij viti, Gjilani në kuptimin e infrastrukturës, nëse i vendosim edhe hyrje-daljet e prezantuara ditë më parë nga ministri Zharku dhe Autostradën, do të fillojë të marrin formë dhe dukje krejt tjetër", ka potencuar kryetari i Komunës, Lutfi Haziri. Projekti i ndërtimit të kësaj rruge, e cila nis nga kazarma e FSK-së, ka gjatësi prej 1260 metra, me gjerësi 27 metra dhe do të ketë brez të gjelbërimit, ndriçim, trotuare, stigje për biçikleta dhe të gjitha kërkesat tjera urbane.

Asfaltimi i rrugës Gjilan-Pogragjë, projekti më i madh i rindërtimit

16
KORRIK

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri asfaltimin e rrugës 14 kilometra Gjilan-Pogragjë e ka cilësuar si projektin më të madh të rindërtimit të rrugëve. Haziri është ndarë tejet i kënaqur me cilësinë e punimeve, derisa vlerësoi se tashmë banorëve të kësaj ane iu është kthyer dinjiteti.

“Ky është investimi i rindërtimit të rrugës Gjilan-Mali-shevë-Uglar-Pogragjë 14.6 kilometra dhe projekti më i madh i rehabilitimit. Kjo rrugë është ndërtuar me vetëkontribut të qytetarëve në vitet 90-ta dhe në shenjë respekti dhe solidariteti, realisht ata janë më meritoret që sot një pjesë e buxhetit shkon në rindërtim të kësaj rruge”, ka thënë Haziri. Ndryshe, investimi në asfaltimin e kësaj rruge nga ana e Komunës kap shifrën e afro 300 mijë euro.

Prezantohet projekti i autostradës Prishtinë-Gjilan-Konçul

15
KORRIK

Nën organizimin e kryetarit të Komunës së Gjilanit, Ministria e Infrastrukturës ka prezantuar të premten projektin kapital të autostradës Prishtinë-Gjilan-Konçul. Në takim ka marrë pjesë kryetari Lutfi Haziri, ministri i Infrastrukturës, Lutfi Zharku, kryetari i Kamenicës, Begzad Sinani, kryetari i Vitisë, Sokol Haliti, ai i Kllokotit, Sreçko Spasiq, kryetari i Ranillugut, Gradimir Mikiq dhe kryetari i Novobërdës, Svetislav Ivanoviq. Nikoqiri i këtij takimi, Lutfi Haziri, prezantimin e këtij projekti e ka vlerësuar historik për Gjilanin dhe Anamoravën.

“Ne sot e pamë fazën përfundimtare të trasesë së Autostradës Konçul-Gjilan-Prishtinë dhe ndërtimit të rrugëve regjionale që përfshinë Gjilan-Prishtinë, Gjilan-Ferizaj, Gjilan-Preshevë dhe Gjilan-Bujanoc. Ne si Komuna, kemi marrë obligim me efikasitet dhe me azhuritë më të madh që detyrat që jepen nga Ministria e Infrastrukturës lidhur me shpronësimet dhe me angazhimet konkrete në të ardhmen të realizohen në afat rekord, në mënyrë që Ministria përkatëse të kompletoj dosjen e fillimit të punëve”, tha Haziri. “Është lajm jashtëzakonisht i mirë, është investim kapital dhe historik për tërë Anamoravën dhe këtë zonë të lindjes së Kosovës, e cila vërtetë është shembull i mirë i bashkëpunimit ndërkomunal, shembull i mirë i bashkëjetesës dhe me nivel të sigurisë shumë të lartë dhe pa asnjë lloj incidenti për motive të tjera”, shtoi



kryetari i Gjilanit. Ministri i Infrastrukturës, Lutfi Zharku, e ka falënderuar kryetarin Haziri për realizimin e këtij takimi lidhur me prezantimin e projektit të rëndësishëm të Autostradës dhe projektin e rrugëve hyrëse dhe dalëse në Gjilan. “Projekti i Autostradës është njëri nga projektet më me rëndësi që presim se do të filloj vitin e ardhshëm. Jemi në shqyrtim së bashku me dy institucione të rëndësishme financiare, BERZH dhe Bankën Investive Europiane. Gjithashtu, do të shqyrtojmë edhe mundësinë e fillimit të punëve për pjesën e parë, që është Prishtinë-Gjilan apo Banullë-Bresalc, ajo që njihet si segmenti me buxhetin e Republikës së Kosovës. Pastaj, zgjerimin e rrugëve hyrëse dhe dalëse të Gjilanit, e që përfshihet edhe rruga Kllokot-Gjilan dhe dy rrugë për dy qytete tjera. Për këto të fundit, besojmë që do të fillojmë kah fundi i vitit”, ka deklaruar me këtë rast ministri Zharku. Zharku është zotuar se do të vazhdojë ta mbështesë Gjilanin edhe në projekte tjera të rrugëve komunale. Kostoja e përafërt e autostradës është afro 260 milionë euro, derisa për rrugët tjera hyrëse dhe dalëse vetëm për Gjilanin 14 milionë euro, e që pritet të përfundohen brenda dy vitesh. Përndryshe, Autostrada e cila u prezantua sot ka një gjatësi 47.1 kilometra, përbëhet prej shtatë segmenteve dhe gjerësia e saj do të jetë 32 metra. Në kuadër të këtij projekti do të jenë katër ura. Kjo autostradë do të lidhë korridorin 6, 7 dhe 10.



Haziri e Gecaj diskutojnë për organizimin e programeve të përbashkëta

12
KORRIK

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur sot në takim zëvendësministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Bajram Gecaj. Temë e takimit ka qenë shkalla e organizimit të programeve të përbashkëta mes MAPL-së dhe Komunës, sikurse edhe afirmimi i të drejtave të komuniteteve pakicë në Gjilan. Kryetari Haziri, pasi ka falënderuar zëvendësministrin Gecaj për vizitën, ka thënë se pushteti lokal në Kosovë duhet të riorganizohet në tërësi.

“Rishikimi i mënyrës së funksionimit të pushtetit lokal është i domosdoshëm, sepse qeverisja lokale në Kosovë

ka qenë e organizuar mbi kompromise të dhimbshme”, ka thënë Haziri. Ndërkaq, zëvendësministri i MAPL-së, Bajram Gecaj, e ka falënderuar kryetarin Haziri për pritjen miqësore, derisa takimin e ka vlerësuar tejet të rëndësishëm, duke thënë se Gjilani është shembull i mirë i integritetit dhe afirmimit të të drejtave të komuniteteve pakicë. Po ashtu, zëvendësministri Gecaj e siguroi kryetarin Haziri që do të ndodhë vlerësimi i të gjitha problemeve dhe gjetjeve sa i përket kufijve administrativ të komunave të Anamoravës. Gecaj, në fund, ka falënderuar qytetarët e Anamoravës, për siç tha, kontributin e tyre të madh për pavarësinë e Kosovës.



Shpërndahen certifikata për 100 të rinj që kanë mbajtur praktikën tre mujore në biznese

12
KORRIK

Komuna e Gjilanit, me mbështetje të Care international dhe financim të Bashkimit European, ka shpërndarë sot 100 certifikata për të rinjtë dhe studentët, të cilët kanë mbajtur praktikën në biznese të ndryshme të regjionit të Gjilanit, në një kohëzgjatje tre mujore dhe rreth 30 për qind të tyre u janë vazhduar kontratat.

Me këtë rast në emër të Komunës së Gjilanit, nënkryetari Rexhep Kadriu, ka thënë se Komuna e Gjilanit, në politikat e saj qeverisëse, ndër prioritetet me rëndësi të veçantë ka zhvillimin ekonomik, agrar dhe punësimin e të rinjve. Kryetari Haziri ka ofruar përherë mbështetjen e vazhdueshme në këtë drejtim me qëllim të zhvillimit të bizneseve të vogla dhe të mesme dhe agrobizneseve. Çdo vend i ri i punës është me rëndësi të veçantë për Komunën e Gjilanit, sepse vetëm kështu mund të arrihet zhvillim i qëndrueshëm ekonomik dhe njëkohësisht edhe qëndrueshmëri financiare të familjeve gjilanasë. "Ndjehem shumë mirë që rreth 30 për qind e këtyre praktikantëve, falë edhe angazhimit dhe gatishmërisë së tyre, kanë vazhduar tashmë kontratat edhe për të ardhmen nëpër këto biznese", ka thënë nënkryetari Kadriu. Në emër të zyrës së BE-së në Kosovë, ka folur Libor Chlad,

zëvendës shef i Seksionit të Bashkëpunimit, i cili, ka falënderuar të gjithë akterët për angazhimin dhe punën që kanë bërë në jetësimin praktik të projekteve të BE-së. "Ajo që kemi parë gjatë kësaj kohe është një përkushtimi i fuqishëm dhe një angazhim konkret në mbështetje agrobizneseve dhe gjenerimit të vendeve të reja të punës dhe kjo është arritur me sukses. Edhe sa i përket punës praktike, është fat shumë i madh që tashmë kemi rreth 30 për qind të këtyre të rinjve që kanë siguruar tashmë një vend pune. Projektet e Komisionit Evropian janë të shumta, prandaj inkurajojmë që të punohet në këtë drejtim që sa më shumë projekte të vijnë në komunën tuaj, sepse po shihet që numri i përfituesve është shumë i madh", tha Chlad. Ai ka përmendur serrat e ndërtuara, kultivimi i bimëve të ndryshme mjekësore dhe aromatike që dhe shumë përfitime të tjera që ka Gjilani. "Përkrahja e Agrobizneseve në Regjionin e Gjilanit" është projekt i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga CARE International në partneritet të ngushtë me ATRC-në dhe Komunën e Gjilanit, duke përshkruar shtyllat kryesore në të cilat zbatohet ky projekt si në zhvillimin e bujqësisë, zhvillimin ekonomik, avokimin dhe lobimin e me theks të veçantë rezultatet e arritura në punësim.

Në Gjilan u promovua projekti i kujdesit shtëpiak për nëna dhe fëmijë



8

KORRIK

Në Gjilan ka nisur zbatimi i projektit për vizitat në shtëpi dhe kujdesin për nëna dhe fëmijë, falë bashkëpunimit me Ministrinë e Shëndetësisë dhe përkrahjen e Zyrës së UNICEF-it në Kosovë. Simbolikisht, ky projekt sot ka shënuar fillimin e tij në Qendrën e Mjekësisë Familjare në lagjen "Dardania".

Kryetari Haziri, në fjalën e tij, tha se program për kujdesin për nënat dhe fëmijët është në vazhden e programeve që në shtyllat e shëndetësisë dhe në politikat e drejta shëndetësore ka qëllim shërbimet më të mira për të gjithë qytetarët të cilët kërkojnë ndihmën profesionale të mjekut. "Jemi Komuna e gjashtë në nivel të Republikës dhe e para në Anamoravë që po e nis këtë program. Me punën dhe angazhimin e përbashkët, me politikat në shëndetësinë tonë primare, që theks të veçantë ka kujdesin ndaj familjes, ndaj nënës dhe fëmijëve, kontrollet sistematike të fëmijëve nëpër shkolla, kontrollet ditore të njerëzve që kërkojnë ndihmën e mjekut, e deri tek ajo që në politikën tonë synojmë - një mjek për familje, për një shëndet të plot, e ruan karakterin e shtyllës kryesore të investimeve në politikat e shëndetësisë në Gjilan. Tani, krahas shumë punëve që janë duke u bërë, po punojmë shumë së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë që ta kemi objektin modern dhe me kushte shumë më të mira, i cili, tejkalon shumë milionëshe të investimeve, për një kujdes të vërtetë shëndetësor për pacientët", ka thënë, ndër të tjerash, kryetari Haziri. Ai ka falënderuar ministrin Shëndetësisë, Imet Rrahmani për përkushtimin që ka për shëndetësinë dhe UNICEF-in dhe gjithë donatorët për punën që po bëjnë në krijim të kushteve më të mira shëndetësore. Ministri i Shëndetësisë, Imet Rrahmani, ka thënë se fokusi kryesor është zbulimi i her-

shëm i sëmundjeve dhe kujdesi i shtuar që nga vizitat në terren e deri tek përkujdesja më e ndërlukuar për një pacient. "Identifikimi i hershëm i një problem shëndetësor tek njeriu është një mundësi më e madhe e intervenimit dhe e përmirësimit të gjendjes shëndetësore. Me këtë program, fokus kryesor është kujdesi ndaj nënave dhe fëmijëve. Synojmë që të kemi nën kontroll gjendjen shëndetësore të këtyre dy kategorive, e kështu më pas do të jetë gjendja me e mirë edhe në shumë aspekte. Politikat shëndetësore, gjithnjë do të jenë në funksion të qytetarëve të shëndosh, ndërsa kjo arrihet vetëm përmes angazhimit më të madh dhe përmes programeve sikur që po promovohet ky sot", tha ministri Rrahmani. E, Laila Omar Gad, udhëheqëse e Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, ka thënë se ofrimi shërbimeve shëndetësore përmes vizitave shtëpiake bënë që sistemi i Mjekësisë Familjare të ndihet edhe më afër nga qytetarët. "Shërbimet shëndetësore, përmes vizitave të këtyra, u mundësojnë qytetarëve që të marrin shërbime cilësore. UNICEF-i do të vazhdojë që në bashkëpunim me Ministrinë, Komunën dhe partnerët e tjerë të adresojë çështjet që lidhen me shëndetin e nënës dhe fëmijës me qëllim të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve dhe sigurimit të mirëqenies më të mirë për nënat, fëmijët dhe familjen në përgjithësi", theksoi ajo. Ndërsa, drejtori i QKMF-së në Gjilan, Fejzulla Berisha, ka shprehur falënderimet e tij të vazhdueshme për mbështetjen dhe përkushtimin e treguar për shëndetësinë primare, duke nisur nga infrastruktura e cila është shumëfish më e mirë se ajo që ishte deri më tani, pastaj personelit mjekësor që është sipas tij përherë në gjendje gatishmërie e deri te furnizimi me barëra nga lista esenciale që është për 100 për qind më e mirë se sa që ishte më parë.

Fushata vetëdijësuese “Mos ndiz zjarr...”

8

KORRIK

Komuna e Gjilanit, përmes Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, ka nisur fushatën kundër ndezjes së zjarreve fushore dhe zjarreve të tjera që shkaktojnë rrezik të përgjithshëm për qytetarët dhe ekonomitë familjare me moton “Mos ndiz zjarr që shkakton rrezik të përgjithshëm”. Ndryshe, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, sanksionon me burg nga gjashtë deri në pesë vjet, të gjithë ata që shkaktojnë rrezik të përgjithshëm përmes ndezjes së zjarreve.

Siguria për qytetarët dhe ekonomitë familjare janë prioritet i Komunës së Gjilanit në këtë aspekt, ka thënë drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim, Ensar Kadriu, i cili ka apeluar qytetarët që të kenë kujdes më të shtuar se sa gjatë stinëve të tjera të vitit sepse, sipas tij, mundësia e përhapjes së zjarrit është më e madhe tani se sa në çdo kohë tjetër, ndërsa dëmet do të mund të jenë shumë të mëdha. “Ndezja e një zjarri në çfarëdo forme është potencial i shkatërrimit dhe humbjeve të mëdha në fushën e bujqësisë, pyjeve, por edhe në rrezikim të ekonomive familjare, jetës së njeriut, por edhe ndotjes së ambientit. Prandaj, të gjithë të jemi të bashkuar në këtë fushatë e cila mbështetet nga të gjitha drejtoritë komunale, nga Shërbimi i Zjarrëfikësve, por edhe nga organet e rendit si Policia e Kosovës dhe organet e drejtësisë”, ka thënë, ndër të tjerash, me rastin e prezantimit të fushatës vetëdijësuese kundër zjarreve drejtori, Ensar Kadriu. Kadriu ka kërkuar poashtu bashkëpunimin e qytetarëve në raportimin sa më të shpejtë të zjarreve dhe në denoncim të personave të papërgjegjshëm të cilët ndezin zjarret.



Hapet fushata e korrje-shirjeve, priten rendimente rekorde



8

KORRIK

Komuna e Gjilanit ka nisur zyrtarisht të premten fushatën e korrje-shirjeve. Kreu i Gjilanit, Lutfi Haziri, në hapjen zyrtare, ka thënë këtë vit presin rendimente rekorde. “Sot po fillojmë fushatën e lamëve në komunën tonë dhe jo rastësisht e kemi zgjedhur ta hapim në tokat e bukës në Cernicë, që është simbolika e bereqetit për këtë vit në Gjilan dhe Anamoravë. Sipas njoftimeve profesionale nga Drejtoria e Bujqësisë, sivjet presim rendimente rekorde. Pas korrje-shirjeve duhet të bëhemi gati për mbjelljet vjeshtore, që nënkupton korrjen e misrit, por edhe përgatitjet për mbjelljet sezonale”, është shprehur kryetari Haziri.

Ai tha se synim i Komunës së Gjilanit është që toka e bukës të shfrytëzohet maksimalisht, në mënyrë që të mos mbetet asnjë pëllëmbë toke pa u punuar. “Në Gjilan po synojmë që asnjë pëllëmbë toke të mos e lëmë pa e mbjellë. Po punojmë shumë që, përveç grurit dhe kulturave tjera, në Gjilan të kthehet kultivimi i duhanit dhe jemi

gati që t’i subvencionojmë bujqit qind për qind. Synimi yni është që toka e bukës të shfrytëzohet maksimalisht dhe i lus familjet bujqësore dhe pronarët e tokave që vërtetë të përgatiten këtë vjeshtë për punë. Me bereqetin e këtij viti, besoj që edhe sofra do të jetë e begatshme. Urime”, tha Haziri. Drejtori i Bujqësisë në Gjilan, Ramiz Ramdani, ka informuar se në këtë vit janë të mbjella 3 mijë hektarë grurë. “Sot, pas vlerësimit se janë krijuar të gjitha kushtet dhe është bërë pjekja teknologjike e grurit, e fillojmë zyrtarisht fushatën. Komisioni komunal nga sot e deri në përmbyllje të fushatës do të jetë në monitorim intensiv. Këtë vit i kemi 3 mijë hektarë të mbjella me grurë, 100 hektarë me elb dhe 130 hektarë me tërshërë. Në komunën e Gjilanit janë 68 kombajna dhe për dy javë besoj se do ta përfundojmë fushatën e korrje-shirjeve”, ka thënë Ramadani. Për fund, kryetari Haziri dhe drejtori Ramadani kanë apeluar tek bujqit që të jenë të kujdesshëm gjatë fushatës dhe të mos i ndezin hamullore.

Haziri ofron përkujdesje institucionale për familjen Matoshi



5

KORRIK

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, në festën e Fitër Bajramit e ka vizituar sot familjen Matoshi nga Gjilani, pas tragjedisë që ka pasur një muaj më parë, ku kryefamiljari ka vdekur nga aksidenti në trafik. Me këtë rast, kryetari Haziri i ka premtuar përkrahje institucionale kryefamiljares, e cila jeton me gjendje të rëndë të banimit dhe ka mbetur me katër jetimë.

“Në këtë ditë feste, vizitova familjen Matoshi dhe i premtova përkujdesje institucionale, meqë ka humbur kryefamiljarin në një aksident trafiku dhe po i rritë katër jetimë. Është obligim yni që t’u dalim në ndihmë qytetarëve tanë në çdo kohë dhe me të gjitha mundësitë tona”, ka thënë kreu i Gjilanit. Përndryshe, shumë shpejt familja Matoshi do të bëhet me shtëpi të re, pasi që donatori Çlirim Krivaqa ia ka blerë truallin dhe pritet të nis ndërtimin e shtëpisë.

Në prag të Bajramit, Gjilani me donatorët inaugurojnë dy shtëpi për skamnorët

4

KORRIK

Komuna e Gjilanit së bashku me donatorët ka inauguruar sot dy shtëpi për familjet në nevojë. Në fshatin Zhegër ka përfituar familja e Nexhmije Hazirit me donator "Ceni Company", ndërsa në Lladovë i është ndërtuar shtëpia Bujar Jakupit nga donatori "Garage Benz".

Në ceremoninë e inaugurimit të shtëpisë në Zhegër, kryetari Haziri ka falënderuar "Ceni Company" për solidaritetin e treguar, ndërsa tha se kjo shtëpi është më e madhe sesa standardet e deritanishme. "E falënderoj donatorin "Ceni Company" që e bëri me shtëpi të re familjen e zonjës Nexhmije Haziri. Pronari Hysen Hyseni e ka dhënë premtimin për ndërtimin e kësaj shtëpie në mbrëmjen humanitare dhe ja sot në prag të festës së Bajramit e realizoi. Është një shtëpi pak më e madhe sesa standardet që i kemi punuar deri tash, pasi ka qenë vullnet i vet donatorit. E uroj zonjën dhe familjen e saj që të ketë vetëm të mira", ka thënë Haziri. Në emër të kompanisë "Ceni Company", ka folur Jehona Hyseni, e cila është

këshilltare në Kuvendin Komunal, duke thënë se ndihet mirë që familja Haziri do t'i festoj dy festa, Fitër Bajramin dhe hyrjen në shtëpinë e re. Ndërkaq, në inaugurimin e shtëpisë në Lladovë, kryetari Haziri pohoi se familja e Bujar Jakupit është e 30-ta që po u ndërtohet shtëpia me fondin e solidaritetit. "E falënderoj donatorin "Garage Benz" me pronar Besnikun për solidaritetin që e kanë treguar. Kjo është shtëpia e 30-të që po inaugurohet që prej mbrëmjes "Pak nga ne, shumë për ata. Uroj familjen e Bujar Jakupit që ta mbush me gëzim, hare e lumturi. Nuk ka ndjenjë më të mirë dhe nuk ka gëzim më të madh se sa ta gëzosh një familje me shtëpi. Ne, të gjithë gjatë gjithë jetës punojmë për një kulm mbi kokë", tha kryetari Haziri. Kryefamiljarët e dy shtëpive, Nexhmije Haziri dhe Bujar Jakupi, kanë shprehur falënderim të veçantë për kryetarin Haziri dhe donatorët, të cilët ua mundësuan që të bëjnë jetë të dinjitetshme. Në fund, kryetari i Gjilanit ka paralajmëruar se edhe shtatë shtëpi të tjera do të inaugurohen gjatë javëve në vazhdim, derisa edhe për 3 të tjera do të vënë gurëthemelin.

Haziri: Në Gjilan kemi vendosur standardin e barazisë për të gjithë



3

KORRIK

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka shtruar sot iftar për Bashkësinë Islame në Gjilan, ndërkaq ftesës i janë bashkangjitur edhe përfaqësues të partive politike, deputetë, këshilltar komunalë, nga policia, gjykata, prokuroria, FSK dhe kryetari i Preshevës dhe ai i Bujanocit.

“Prezenca e të gjitha institucioneve këtu, na bënë neve të obligueshëm që në këtë muaj të madh të Ramazanit ta shtojmë solidaritetin, mëshirën dhe angazhimin për punë. Uroj që ky muaj i Ramazanit ta ketë përmbushur misionin e tij dhe Zoti të na e pranoj agjërimin dhe lutjet tona. Ju ftoj që festën e Bajramit ta bëjmë të barabartë sepse kemi vendosur standard të ri në Gjilan - standardin e barazisë për të gjithë”, ka thënë para të pranishmëve në fjalën e tij, kryetari Haziri. Ai ka falënderuar të gjithë për prezencën, në veçanti, kryetarin e Preshevës, Shqipërim Arifin dhe atë të Bujanocit, Shaip Kamberin, pasi tha se prezenca e tyre nuk e ka vetëm simbolikën, por bashkimin e fuqive dhe energjive tona të përbashkëta. “Më lejoni që t’i falënderoj, në veçanti, dy kolegët e mi nga lindja e Kosovës që

janë sonte prezent, kryetarin e Preshevës dhe Bujanocit. Prezenca e tyre nuk e ka vetëm simbolikën, por bashkimin e fuqive dhe energjive tona të përbashkëta për të punuar edhe më shumë që të përmirësojmë gjendjen e vëllezërve tanë që edhe më tutje po e luftojnë kauzën për të qenë të barabartë”, ka thënë Haziri. Ndërkaq, kryetari i Bashkësisë Islame në Gjilan, Naim Aliu, ka falënderuar kryetarin Haziri për organizimin e iftarit, duke thënë se kjo i kontribuon bashkimit mes vete. “Organizimi i këtij iftari i kontribuon bashkimit dhe vëllazërimit me vete. Feja islame, përmes detyrimeve që ne i kryejmë për të Madhin Zot, na bënë që të vëllazërohemi më shumë mes veti dhe të përfitojmë si besimtarë. Ky muaj i shenjtë i Ramazanit është muaj i shumë epiteteve dhe mirësive. Në këtë sofër të madhe të Komunës, të gjithë ne kemi përgjegjësi për vendin, për qytetin tonë dhe e lusim Zotin që të na bëjë prej atyre njerëzve që të na bëjë prej atyre njerëzve që t’i ndritim mendjet tona, t’i zbusim zemrat tona dhe të punojmë për të mirën e vendit dhe qytetit tonë. E lusim Zotin që të na i pranoj të gjitha punët dhe lutjet tona”, ka deklaruar Aliu.



Haziri: Qeveria amerikane përkrah Gjilanin falë qeverisjes së mirë dhe disiplinës së ashpër buxhetore

2


KORRIK

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, gjatë vizitës që i ka bërë punimeve në ndërtimin e çerdhes në lagjen "Dardania", ka thënë se ky projekt po mbështetet nga qeveria amerikane, falë qeverisjes së mirë dhe disiplinës së ashpër buxhetore që, sipas tij, po aplikohet në Gjilan. Vlera e ndërtimit të çerdhes në "Dardani" është 400 mijë euro dhe është bashkëfinancim i Komunës me qeverinë amerikane.

"Qeveria amerikane e ka zgjedhur ta përkrah Gjilanin në ndërtimin e çerdhes moderne në "Dardani" falë performancës së mirë dhe disiplinës së ashpër buxhetore,

por edhe transparencës dhe kriterëve të tjera, që USAID i ka parashtruar për Komunën e Gjilanit", ka thënë Haziri. Ai tha se me ndërtimin e kësaj çerdheje, kanë arritur t'i plotësojnë kërkesat dhe nevojat arsimore të kësaj lagjeje." Projekti për ndërtimin e çerdhes në lagjen "Dardania" është për 15 mijë banorë dhe përfundimisht kemi arritur ta mbështesin propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe të prindërve të kësaj lagjeje që të kompletohet infrastruktura për institucionet parashkollore. Ky investim e plotëson nevojën arsimore për këtë pjesë të qytetit", është shprehur Haziri.

Haziri: Gjilani po bëhet me infrastrukturë moderne



1

KORRIK

“Gjilani për herë të parë po bëhet me infrastrukturë moderne”. Kështu ka thënë kryetari i Gjilanit Lutfi Haziri, gjatë vizitave që u ka bërë disa prej projekteve infrastrukturore. Haziri është ndarë i kënaqur me dinamikën në realizimin e punimeve në rrugën Gjilan-Bujanoc, e cila po bëhet me katër korsi, sikurse që ka vizituar edhe dhjetëra rrugë të tjera të qytetit.

“Me investime qind për qind të buxhetit komunal po bëhet rruga më e madhe deri tash në Gjilan, ajo në drejtim të Bujanocit. Ndërsa, dhjetëra rrugë janë asfaltuar e

po vazhdojnë të asfaltohen në qytet sipas standardeve. Po ashtu, në shumë lagje të Gjilanit kemi ndërtuar edhe rrjetin e kanalizimit dhe ujësjellësit sipas kërkesave të qytetarëve. Qëllimi ynë është që t'i përfundojmë këto projekte para se të vijë bashkatdhetarët, në mënyrë që të mos krijojmë tollovi në komunikacion”, ka vlerësuar kreu i Gjilanit. Përndryshe, vetëm projekti i ndërtimit të hyrje-daljes Gjilan-Bujanoc, kap vlerën afro 900 mijë euro. Ndërsa, gjatë këtij viti pritet të nis edhe ndërtimi i rrugës Gjilan-Prishtinë dhe Gjilan-Ferizaj.

